

**KONVENTA E NJU JORK-ut DHE INSTRUMENTAT
JURIDIKE TË NJOHJES DHE EKZEKUTIMIT TË
VENDIMEVE TË ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR NË
SHQIPËRI**

Doktoranti
ARTAN SPAHIU

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
SHKENCA JURIDIKE, me profil **E DREJTË BIZNESI**, për marrjen e
gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor
Prof.Asoc.Dr.KESTRIN KATRO

Numri i fjalëve: 69184

Tiranë, mars 2015

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

ABSTRAKTI

KONVENTA E NJU JORK-ut DHE INSTRUMENTAT JURIDIKE TË NJOHJES DHE EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE TË ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR NË SHQIPËRI

Zhvillimi dhe integrimi ekonomik i Shqipërisë në hapësirat evropiane dhe botërore, i parashtron rendit juridik nevojën për të krijuar një mjedis që shmang pasigurinë e marrëdhënieve tregtare ndërkombëtare, ku biznesi apo shteti Shqiptar është palë. Në këtë kuadër, ndër të tjera, do të preferohet një situatë juridike që garanton zgjidhjen nëpërmjet mjeteve ligjore, të gjithëpranuara prej palëve, të çdo konflikti eventual që mund të lindë. Merr kështu prioritet parashikimi sa më bashkohor në legjislacionin e brendshëm, por njëkohësisht edhe implemtimi në praktikë, i mekanizmave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ku ndër më kryesorët është arbitrazhi.

Ndërkohë, realiteti i rendit juridik Shqiptar nuk i përgjigjet vlerave që i atribuohen arbitrazhit, si një mjet shumë efektiv në zgjidhjen e konflikteve tregtare. Një moment i rëndësishëm në legjislacionin Shqiptar, që duhet të përmirësohet në frymën e Konventës së Nju Jork-ut, është njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit të huaj, fenomen ky i ballafaquar sot me mungesën e një kuadri ligjor bashkohor dhe me një jurisprudencë të pakonsoliduar. Miratimi dhe zbatimi i instrumentave juridikë, në përqsasje të kuadrit normativ modern, për arbitrazhin ndërkombëtar dhe njohjen e vendimeve të tij, do të jetë një shërbim i mirë që i bëhet procesit të integritit të ekonomisë Shqiptare.

NEW YORK CONVENTION AND THE LEGAL INSTRUMENTS ON RECOGNITION AND ENFORCEMENT OF INTERNATIONAL ARBITRAL AWARDS IN ALBANIA

The economic development and integration of Albania in the European and global spheres, sets to the legal order the immediate need to create an environment that avoids the uncertainty of international trade relationships, where the Albanian businesses or state are a party. In this context, it would be preferable to create a legal situation that guarantees solution of any possible conflict that may arise using legal instruments which are fully accepted by the parties. Consequently, this results in an immediate need of a contemporary provision in the domestic legislation as well as of the practical implementation of alternative mechanisms on settling the disputes, where the most important one is arbitration.

Meanwhile, the reality of the Albanian legal system does not respond to the values attributed to arbitration as a very effective tool in resolving commercial disputes. An important moment in the Albanian legislation, which should be improved in the spirit of the New York Convention, is the recognition and enforcement of foreign arbitral awards, a phenomenon faced today with the lack of a contemporary legal framework and an unconsolidated jurisprudence. The adaptation and the implementation of legal instruments, in approach with the modern normative framework for the international arbitration and the recognition of its awards, is going to be of good service to the integration process of the Albanian economy.

për Endin dhe Erinën

FALENDERIME

Punimi shkencor i prezantuar në këtë disertacion vjen si rezultat i një pune individuale disa vjeçare por pa dyshim edhe falë mbështetjes dhe dashurisë së disa njerëzve të shtrenjtë, të cilët gjej rastin t'i falenderoj.

Së pari, respekt dhe mirënjohje për përkrahjen dhe ndihmën shkencore të pakursyer të udhëheqëses time, As.Prof.Dr.Kestrin Katro. Gjithashtu një falenderim të veçantë i'a dedikoj mbështetjes që ma ka dhënë në këtë sipërmarrje stafi drejtues i shkollës doktorale të Universitetit European të Tiranës.

Shpreh vlerësim dhe falenderoj kolegët pedagogë të Departamentit të së Drejtës të Fakultetit Ekonomik të Universitetit "A.Xhuvani" Elbasan, të cilët shumë miqësisht më kanë mbështetur gjatë gjithë periudhës së studimeve të mia doktorale.

Dhe në fund dëshiroj të falenderoj pafundësisht familjen time, në veçanti, Endin dhe Erinën për kohën, përkushtimin dhe fjalën e munguar. Pa dashurinë e tyre asgjë nuk do të kishte vlerë.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

| | Nr. faqe |
|--|-------------|
| KAPITULLI I - HYRJE | 1 |
| KAPITULLI II - METODOLOGJIA E APLIKUAR NË PUNIM | 4 |
| II.1. Hipoteza dhe pyetjet hulumtuese. | 4 |
| II.2. Metodadat dhe metodologjia e kërkimit. | 5 |
| II.3. Pozita konkrete metodologjike. | 7 |
| II.4. Plani i strukturuar i studimit. | 8 |
| KAPITULLI III - ASPEKTE HISTORIKE DHE TEORIKE MBI ARBITRAZHIN TREGTAR NDËRKOMBËTAR | 12 |
| III.1. Arbitrazhi ndërkombëtar si një fenomen historik. | 12 |
| <i>III.1.1. Institucionalizimi i arbitrazhit ndërkombëtar tregtar – fillesat e tij.</i> | 13 |
| <i>III.1.2. Reformimi i arbitrazhit ndërkombëtar, pas viteve 1950.</i> | 15 |
| III.2. Natyra juridike e arbitrazhit - vështrim teorik. | 19 |
| <i>III.2.1. Përkufizimi i arbitrazhit - një alternativë për zgjidhjen e konflikteve.</i> | 19 |
| <i>III.2.2. Veçoritë e natyrës juridike të arbitrazhit ndërkombëtar.</i> | 20 |
| <i>III.2.3. Epërsitë e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar dhe kuadri i tij ligjor.</i> | 24 |
| III.3. Teoritë bashkohore mbi arbitrazhin ndërkombëtar tregtar dhe zbatimin e vendimeve të këtij arbitrazhi. | 27 |
| <i>III.3.1. Teoria Juridiksionale.</i> | 29 |
| <i>III.3.2. Teoria Kontraktuale.</i> | 31 |
| <i>III.3.3. Teoria Hibride.</i> | 33 |
| <i>III.3.4. Teoria Autonome.</i> | 34 |

| | |
|--|----|
| III.4. Kontributi i gjykatave shtetërore në mbarëvajtjen dhe efektivitetin e procesit të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar. | 35 |
| <i>III.4.1. Gjykata nacionale dhe zbatueshmëria e marrëveshjes së Arbitrazhit.</i> | 37 |
| <i>III.4.2. Koncepti i “Arbitrueshmërisë” në fokusin e gjykatave nacionale.</i> | 38 |
| <i>III.4.3. Ndashmëria e klauzoles së arbitrazhit nga kontrata kryesore (separability)</i> | 38 |
| <i>III.4.4. Koncepti i “Kompetencës për kompetencë” (“Kompetenz-Kompetenz”).</i> | 39 |
| <i>III.4.5. Kundërshtimi i arbitrave në gjykatën shtetërore.</i> | 40 |
| <i>III.4.6. Asistenca e gjykatave shtetërore në dhënien e masave të përkohshme dhe në marrjen e provave, gjatë një procedimi arbitrazhi.</i> | 41 |
| <i>III.4.7. Njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit nga gjykatat nacionale.</i> | 42 |
| Përfundime për kapitullin e tretë. | 43 |
| KAPITULLI IV - KONVENTA E NJU JORK-ut. VESHTRIM DOKTRINOR DHE JURISPRUDENCAL MBI EFEKTIN E SAJ NË NJOHJEN E VENDIMEVE TË ARBITRAZHEVE TË HUAJA | 45 |
| IV.1. Faktorë historikë përcaktues për risitë e Konventës së Nju Jork-ut, krahasuar me pararendëset e saj. | 47 |
| <i>IV.1.1. Rrethanat historike të lindjes së Konventës së Nju Jork-ut.</i> | 47 |
| <i>IV.1.2. Risitë që përcolli Konventa për fuqizimin e arbitrazhit ndërkombëtar.</i> | 50 |
| IV.2. Barrierat ligjore të zbatimit të vendimeve të arbitrazhit të huaj përball instrumentave të Konventës - analizë teorike. | 54 |
| <i>IV.2.1. Rregullat e procedurës dhe kushtet për zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj - kërkesa e palës së interesuar si kusht i domosdoshëm.</i> | 54 |
| <i>IV.2.2. Pengesat lëndore të zbatimit të vendimeve dhe veçoritë e aplikimit të tyre –analizë e tipareve të shkaqeve refuzuese të zbatimit, sipas Konventës së Nju Jork-ut.</i> | 56 |
| <i>IV.2.2.1. Tiparet e përgjithshme që paraqesin kushtet e njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit, në kuadër të efektit të Konventës.</i> | 56 |
| <i>IV.2.2.2. Pavlefshmëria e marrëveshjes, procesi i parregullt dhe mos-respektimi i kufirit të autoritetit të arbitrit - shkaqe qër përlligjin refuzimin e njohjes.</i> | 58 |

| | |
|--|-----|
| <i>IV.2.2.3. Veçoritë e shkakut refuzues të parregullsive në kompozimin e forumit, apo në procedurën e arbitrazhit.</i> | 60 |
| <i>IV.2.2.4. Rrëzimi i vendimit të arbitrazhit në vendin e origjinës – shkak për mosnjohjen e tij.</i> | 61 |
| <i>IV.2.2.5. Arbitrueshmëria dhe Politika Publike – mbrojtja më e mirë kundër njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj.</i> | 63 |
| IV.3. Kundërshtimi i njohjes dhe zbatimit përball ankimit të një vendimi arbitrazhi të huaj - analizë teorike mbi dallimet ndërmjet këtyre dy proceseve. | 69 |
| IV.4. Vendimi i arbitrazhit në fokusin e Konventës së Nju Jork-ut. | 71 |
| <i>IV.4.1. Llojet e vendimeve dhe efekti i Konventës mbi ta.</i> | 71 |
| <i>IV.4.2. Autonomia e vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar nga rendi juridik i shtetit të origjinës – produkt i efektit të Konventës.</i> | 76 |
| Përfundime për kapitullin e katërt. | 78 |
| KAPITULLI V - ARBITRAZHI NË JURIDIKSIONIN SHQIPTAR | 80 |
| V.1. “Ftohtësia” e ekonomisë shqiptare ndaj mekanizmit alternativ të arbitrazhit. | 80 |
| V.2. Veçoritë e natyrës juridike të arbitrazhit në Shqipëri, deri në vitin 1993. | 83 |
| V.3. Rregullimi aktual i institutit të arbitrazhit sipas Kodit të Procedurës Civile - vështrim krahasues me nivelin bashkëkohor të regjimit ndërkombëtar. | 89 |
| <i>V.3.1. Mundësia e një autoriteti shtetëror për t’iu nënshtruar arbitrazhit.</i> | 89 |
| <i>V.3.2. Përkufizimi dhe forma e marrëveshjes së arbitrazhit.</i> | 90 |
| <i>V.3.3. Ndërhyrja e gjykatës shtetërore në themelimin e forumit të arbitrazhit.</i> | 94 |
| <i>V.3.4. Juridiskioni i gjyktës së arbitrazhit dhe problematika e saj (parimi i “Kompetencës për Kompetencë” dhe parimi i “Ndashmërisë”).</i> | 95 |
| <i>V.3.5. Masat e përkohshme dhe ndërhyrja e gjykatës shtetërore.</i> | 98 |
| <i>V.3.6. Zhvillimi i procedurave të arbitrazhit.</i> | 99 |
| <i>V.3.7. Ligji i aplikueshëm për themelin e mosmarrëveshjes.</i> | 101 |
| <i>V.3.8. Marrja e vendimit përfundimtar.</i> | 103 |
| <i>V.3.9. Kundërshtimi i vendimit të arbitrazhit.</i> | 104 |

| | |
|---|-----|
| V.4. Statusi i vendimit të arbitrazhit – roli i tij në shtrirjen e efekteve të Konventës së Nju Jork-ut për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj. Aspekte thelbësore të rregulluara nga ligji i brendshëm. | 110 |
| <i>V.4.1. Fusha e aplikimit të arbitrazhit si mekanizëm për zgjidhjen e konflikteve.</i> | 110 |
| <i>V.4.2. Përcaktimi i statusit të vendimit të arbitrazhit “i brendshëm” - “i huaj”.</i> | 112 |
| <i>V.4.2.1. Analizë e kritereve të parashikuara nga neni 400 i K.Pr.C.</i> | 114 |
| <i>V.4.2.2. Analizë e përbashkët e kritereve të nenit 400 dhe 427 të K.Pr.C – përcaktimi i sferës së veprimit të arbitrazhit të brendshëm.</i> | 115 |
| <i>V.4.3. Sfera e aplikimit të Konventës së Nju Jork-ut, në praktikën gjyqësore.</i> | 122 |
| Përfundime për kapitullin e pestë. | 125 |
| KAPITULLI VI - KONVENTA E NJU JORK-ut NË DIMENSIONET E LEGJISLACIONIT DHE PRAKTIKËS GJYQËSORE SHQIPTARE PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E VENDIMEVE TË ARBITRAZHIT TË HUAJ | 127 |
| VI.1. Mjetet juridike që sigurojnë, në Shqipëri, njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj, në frymën e Konventës së Nju Jork-ut dhe perceptimi mbi efektivitetin e tyre. | 128 |
| VI.2. Instrumentat procedurale të njohjes dhe ekzekutimit të një vendimi arbitrazhi të huaj. | 137 |
| VI.3. Kodi i Procedurës Civile përball Konventës së Nju Jork-ut – vështrim analitik i problematikës së legjislacionit të brendshëm, përsa i përket njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit të huaj. | 145 |
| <i>VI.3.1. Aplikimi i dispozitave të K.Pr.C “mutatis mutandis” për vendimet e arbitrazhit të huaj – trajtim juridik mbi efektin e K.Pr.C në procedimet e njohjes së këtyre vendimeve.</i> | 146 |
| <i>VI.3.2. “Shkaqet refuzuese” për njohjen dhe zbatimin e një vendimi arbitrazhi të huaj, sipas K.Pr.C - parashikimet e nenit 394 të K.Pr.C përball nenit 5 të Konventës.</i> | 154 |
| <i>VI.3.2.1. Shkaku 1 - Kur, sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja për të cilën bën fjalë vendimi nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës (forumit) të arbitrazhit të shtetit që ka dhënë vendimin.</i> | 155 |
| <i>VI.3.2.2. Shkaku 2 – Kur, kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq (arbitrazh) nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet.</i> | 163 |

| | |
|--|-----|
| <i>VI.3.2.3. Shkaku 3 - Kur, midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata Shqiptare.</i> | 164 |
| <i>VI.3.2.4. Shkaku 4 - Kur, është duke u shqyrtuar nga gjykata Shqiptare një padi, që është ngritur përpara se vendimi i arbitrazhit të shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë.</i> | 164 |
| <i>VI.3.2.5. Shkaku 5 - Kur, vendimit të arbitrazhit të huaj i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e zbatuar prej tij.</i> | 167 |
| <i>VI.3.2.6. Shkaku 6 - Kur, vendimi i arbitrazhit të huaj nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit Shqiptar.</i> | 169 |
| <i>VI.3.2.7. Barra e provës për të vërtetuar pengesat e njohjes ndaj një vendimi arbitrazhi të huaj, në fokusin e legjislacionit të brendshëm.</i> | 170 |
| <i>VI.3.3. Kërkesa formale për paraqitjen e marrëveshjes së arbitrazhit si kusht për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj – një mungesë në parashikimet e K.Pr.C.</i> | 172 |
| <i>VI.3.4. Shqyrtimi jo në themel i konfliktit nga Gjykata e Apelit dhe vlerësimi i shkaqeve refuzuese, të parashikuara prej Konventës së Nju Jork-ut.</i> | 178 |
| <i>VI.3.5. Ndërgjyqësia në procesin civil të njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj.</i> | 184 |
| VI.4. Qasja e ligjit shqiptar për të drejtën ndërkombëtare private drejt njohjes së vendimeve të arbitrazhit të huaj. | 186 |
| VI.5. Gabimet e përkthimit të Konventës së Nju Jork-ut në tekstin e ligjit Shqiptar. | 188 |
| Përfundime për kapitullin e gjashtë | 190 |
| KAPITULLI VII - KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE DHE REKOMANDIME | 191 |
| VII.1. Përfundime dhe konkluzione. | 191 |
| VII.2. Rekomandime. | 197 |
| SHTOJCË - Teksti i plotë i Konventës së Nju Jork-ut i përkthyer në shqip | 203 |
| BIBLIOGRAFIA | 207 |

KAPITULLI I

HYRJE

Qarkullimi i lirë i mallrave dhe shërbimeve dhe fenomeni i globalizimit kanë nënvizuar rëndësinë e transaksioneve ndërkombëtare tregtare, si aspekte thelbësore të dinamikës së një tregu të hapur. Në këtë pikë, arbitrazhi e veçanërisht ai ndërkombëtar tregtar, gjithnjë e më shumë, po vlerësohet si një urë lidhëse që krijon simetrinë e nevojshme midis kuadrit të njëtrajtshëm që rrjedh nga globalizimi ekonomik dhe sistemit të fragmentuar gjyqësor ndërkombëtar¹. Arbitrazhi mund të jetë më efektiv se sa gjykatat shtetërore në arritjen e saktësisë së rezultatit të procesit, por edhe në qoftë se nuk ka saktësi të madhe të rezultateve në arbitrazh, palët gjithsesi duhet të nxiten për të “tregtuar” interesat e tyre në drejtësinë procedurale dhe eficientë e sistemit².

Tanimë, arbitrazhi e ka merituar pozitën e një “konkurenti” të denjë, përballë procesit gjyqësor, veçanërisht për zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare të tregtisë, ku ai ofrohet si një model që garanton neutralitetin e forumit dhe zbatimin e vendimeve. Në lidhje me këtë të fundit, është bërë shumë në kuadër të ndërkombëtarizimit të instrumentave ligjorë, që sigurojnë efektshmërinë e vendimeve të arbitrazhit në sa më shumë shtete të botës, ku zhvillohen transaksione tregtare. Konventa e Nju Jork-ut (1958)³ është pikërisht produkt i përpjekjeve të përbashkëta të shumë shteteve për të përafuar legjislacionet e tyre kombëtare, për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj, nëpërmjet inkorporimit të kriterëve ligjorë që marrin në konsideratë veçoritë e procesit të arbitrazhit.

Përyjashtuar traktatet themeluese të OKB-së, Konventa e Nju Jork-ut është traktati modern më i rëndësishëm, që i ka shërbyer mirë interesave të shoqërisë njerëzore, duke dhënë një kontribut të vyer në zhvillimin ekonomik botëror⁴. Për më shumë se gjysëm shekulli, ky dokument ka materializuar nevojën e shteteve në mbarë botën, për të garantuar vlerat e pakrahasueshme të tregtisë së lirë. Organizma të posaçëm ndërkombëtar kanë bërë përpjekje për implementimin në legjislacionin e shteteve anëtare të dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut. Për më tepër, ata kanë inkurajuar me veprime konkrete unifikimin, përmirësimin dhe

¹ Pedro J. Martinez-Fraga; “Influencia Amerikane në Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar – zhvillimet doktrimore dhe metodat zbuluese”, Cambridge University Press, 2009.

² Georgios I. Zekos, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar dhe Detar, Routledge-Cavendish, 2008, f.33

³ Konventa e Nju Jork-ut “Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj”, 10 Qershor 1958.

⁴ Veeder.V.V. “A është e nevojshme të ndryshohet Konventa e Nju Jorkut” (Fjalimi hapës i Forumit të Institutit të Arbitrazhit Ndërkombëtar, Dijon, shtator 2008), Revista e Vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar, qershor 2010, Emmanuel Gaillard, f.185;

modernizimin e vazhdueshem të tyre. Këto dispozita kanë ndikuar mjaft në rritjen e efikasitetit të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar, duke e bërë atë një metodë shumë të suksesshme për trajtimin e konflikteve. Për këtë arsye, një kapitull i veçantë në punim ka trajtuar në mënyrë të detajuar frymën dhe aspektet më të rëndësishme të instrumentave të themeluar prej Konventës së Nju Jork-ut, të cilat, në një rën anë, garantojnë efektivitetin e arbitrazhit ndërkombëtar në rreth 150 shtete të botës dhe në anën tjetër, unifikojnë juridiksionet kombëtare në fushën e njohjes së vendimeve të arbitrazhit.

Përgjatë rrugëtimit në kapitujt e këtij punimi, do të trajtojmë aspektet më të rëndësishme të arbitrazhit ndërkombëtar, duke nisur me shkollat doktrinare që e mbështesin dhe që janë përpjekur të shpjegojnë përqsjet e tij. Shtjellimi i literaturës, kryesisht asaj të huaj, është përdorur gjerësisht për t'i argumentuar lexuesit natyrën e arbitrazhit ndërkombëtar. Në analizë janë gërshtuar, gjithashtu, tipologjitë e interpretimeve gjyqësore të kazuseve të përcjellë nga jurisprudenca ndërkombëtare, duke nxjerrë kështu në pah implemtimin në praktikë të vlerave të institutit të arbitrazhit. Natyrshëm, duke patur në fokus misionin e punimit, i është kushtuar vëmëndje një prej epërsive më kryesore, ndoshta më e rëndësishmja, e këtij fenomeni juridik që bashkëshoqëron botën e biznesit, pikërisht njohjes dhe zbatimit, prej juridiksioneve të ndryshme kombëtare, të vendimeve të arbitrazhit që prodhohen për zgjidhjen e konflikteve.

Pjesa më e qënësishme e punimit i kushtohet dimensionit Shqiptar të arbitrazhit dhe shtrirjes së efekteve të Konventës së Nju Jork-ut për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj në Republikën e Shqipërisë. Në këtë pikë, punimi i përcjell lexuesit një tablo të plotë të stadiit në të cilën ndodhet sot instituti i arbitrazhit në rendin juridik kombëtar Shqiptar.

Duhet pranuar se në këtë punim kanë ndikuar edhe disa kufizime. Një i tillë është mosfokusimi në shtjellimin dhe analizimin, nëpërmjet metodave sasiore të kërkimit, të sjelljes tradicionale të biznesit Shqiptar, por dhe shoqërisë Shqiptare në përgjithësi, për t'iu drejtuar gjykateve shtetërore tradicionale, në vend të zgjidhjes së konflikteve me mekanizma alternativë. Ky punim nuk merr përsipër të kryejë sondazhe dhe vlerësime empirike në lidhje me nivelin dhe shkaqet e kësaj "ftohtësie" të biznesit Shqiptar ndaj mekanizmit të arbitrazhit, pasi një analizë e tillë do të kapërcente dukshëm objektivin e punimit. Megjithatë punimi guxon të japë një opinion personal në lidhje më arsyet se pse ky mekanizëm alternativ i trajtimit dhe zgjidhjes së konflikteve, veçanërisht atyre tregtare, ende nuk ka gjetur vendin që meriton dhe nuk është aq *atraktiv* sa duhet në mjedisin e biznesit Shqiptar. Mendoj se ky faktor i rëndësishëm (ndjeshmëria apo pranueshmëria ndaj arbitrazhit) duhet të studiohet dhe të jetë objekt i punimeve të tjera të kësaj natyre.

Një kufizim tjetër në punim ishte vështirësia objektive për të disponuar materiale nga jurisprudenca Shqiptare në fushën e njohjes dhe zbatimit të vendimeve të huaja të arbitrazhit. Disponueshmëria e vendimeve të Gjykatës së Apelit, të cilat janë trajtuar në këtë punim, është siguruar nëpërmjet hulumtimit të kufizuar objektivisht, për arsye burokratike, në arshivën e kësaj gjykate, nga autori i punimit. Gjykata e Apelit në adresën zyrtare të saj *on line* nuk i publikon vendimet e njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit të huaj, për një arsye të pakuptueshme. Gjithashtu nuk është publikuar deri më sot një përmbledhje e këtyre vendimeve në ndonjë manual apo revistë të posaçme. Megjithatë, duke marrë në konsideratë numrin e vogël të vendimeve të kësaj natyre, që Gjykata e Apelit ka dhënë, gjykoj se përfundimet e arritura në punim, duke argumentuar rastet e trajtuara të praktikës gjyqësore Shqiptare, janë përfaqësuese të fenomenit.

Nga analiza që punimi paraqet, për legjislacionin Shqiptar, do të konstatojmë se fatkeqësisht shumë pak është bërë në kuadër të rregullimit legjislativ të institutit procedural të arbitrazhit dhe, aq më pak, të atij ndërkombëtar. Momenti kryesor në legjislacionin tonë të brendshëm, që paraqet një nevojë imediate për përmirësim, është njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit të huaj. Që prej 12 vjetësh⁵, Konventa e Nju Jork-ut është pjesë e rendit tonë juridik, por implementimi i saj nuk është ai i duhuri. Më së shumti kjo është rezultat i pamjaftueshmërisë së procesit të përafrimit të legjislacionit të brendshëm me standartet ndërkombëtare në fushën e arbitrazhit. Nga ana tjetër, edhe praktika gjyqësore Shqiptare, e cila në këtë fushë, paraqitet e rrallë në raste dhe me elementë jo tërësisht uniformë, nuk ka luajtur rolin që i takon në promovimin e vlerave të këtij mekanizmi alternativ të zgjidhjes së konflikteve private.

Sa më sipër, në kuadër të modernizimit të legjislacionit të brendshëm, merr rëndësi prioritare analiza e kujdesshme e problematikës që manifeston realiteti Shqiptar i njohjes së vendimeve të arbitrazhit, si dhe rekomandimi për themelimin e instrumentave ligjore bashkohore, në këtë fushë. Përbushjes së këtij qëllimi i shërben, me modesti, edhe ky punim.

⁵ Ligji nr.8688, datë 9.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", është botuar në fletoren zyrtare nr.38/2000, faqe 1836, me datë botimi 01.12.2000. Instrumenti i aderimit (ligji) është regjistruar i dorëzuar, në OKB, më datë 27 qershor 2001, ndërsa data e hyrjes në fuqi të Konventës së Nju Jorkut për Shqipërinë është 25 shtatori 2001, që i korresponon ditës së 90-të pas datës së depozitimit nga shteti të instrumentit të aderimit (neni 12, pika 2 e Konventës së Nju Jork-ut).

KAPITULLI II

METODOLOGJIA E APLIKUAR NË PUNIM

II.1. Hipoteza dhe pyetjet hulumtuese.

Në këtë kapitull lexuesi njihet me mënyrën se si është realizuar studimi, me të gjithë përbërësit e tij dhe me mënyrën e kombinimit të tyre për të përfutur rezultatet e duhura. Këtu prezantohet qasja metodike dhe metodat kërkimore që janë përdorur për realizimin e studimit, si dhe shpjegohet përshtatshmëria e këtyre metodave me temën kërkimore. Kështu, në këtë seksion është paraqitur plani i studimit; ku dhe si është marrë informacioni i nevojshëm; janë përshkruar metodat e mbledhjes së të dhënave; procedurat dhe instrumentet e përdorura; procedurat e përdorura për të siguruar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e rezultateve, si dhe kufizimet e metodologjisë së përdorur.

Këndvështrimi metodologjik në mënyrë të pashmangshme është përcaktuar duke marrë për bazë qëllimin e vetë hulumtimit. Pyetjet e hulumtimit kanë rëndësi thelbësore në një punim shkencor, ato shprehin qëllimin e hartimit të punimit, por dhe drejtojnë procesin e hulumtimit. Pyetjet hulumtuese në këtë punim janë:

-A është plotësisht i përshtatshëm rregullimi juridik aktual që bën një grup dispozitash i Kodit të Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë, për të ndërtuar mekanizma që garantojnë *de jure* njohjen dhe zbatimin në shtetin tonë të vendimeve të arbitrazhit të huaj (ndërkombëtar), e krahasuar kjo edhe me rrethet juridike kombëtare të tjera apo me atë ndërkombëtar?

-A është i përshtatshëm apo konsiderohet i tejkaluar mekanizmi i njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit të huaj, nëpërmjet një norme blankete, për analogji të njohjes së vendimeve të gjykatave shtetërore të huaja, duke mos gëzuar një rregullim të drejtëpërdrejtë specifik për kategorinë e vendimeve të arbitrazhit të huaj?

-A zbatohen dhe sa ndikojnë në praktikën gjyqësore shqiptare parashikimet e konventave ndërkombëtare për çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar në përgjithësi, dhe në veçanti për çështjet e njohjes dhe dhënies fuqi të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar?

-A janë plotësisht në harmoni dispozitat e Kodit të Procedurës Civile me atë ç'ka parashikojnë dispozitat e Konventës së Nju Jorkut, në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj?

-Çfarë mund të rekomandohet për të përmirësuar kuadrin normativ përkatës?

Duke vlerësuar në tërësi rendin juridik të brendshëm - legjislacionin aktual dhe praktikën e gjyqësorit shqiptar - pranohet se vetëm në aspektin formal Republika e Shqipërisë e respekton angazhimin ndërkombëtar, të pranuar me ratifikimin e Konventës së Nju Jorkut, për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar. Por në praktikë zbatimi i vendimeve të gjykatave të arbitrazhit, që zgjidhin mosmarrëveshje të tregtise ndërkombëtare, ballafaqohet me mungesën e një kuadri ligjor bashkohor dhe me një jurisprudencë të pakonsoliduar kombëtare.

Pra, hipoteza⁶ e ngritur në punim dhe që kërkon vërtetim është: **Instrumentat e themeluar në rendin juridik shqiptar për institutin e arbitrazhit e veçanërisht për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj në Republikën e Shqipërisë, nuk e justifikojnë vendin që meriton sot ky mekanizëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile dhe tregtare**⁷. Duke e vlerësuar rendin juridik të brendshëm në të dy komponentët e tij (legjislacioni dhe praktika gjyqësore), si dhe duke konsideruar metodologjinë shkencore të nevojshme për t'u aplikuar, hipoteza e mësipërme trajtohet, në këtë punim, e ndarë në dy pjesë: Kuadri normativ kombëtar, që rregullon njohjen e efektit të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar, është i pamjaftueshëm dhe jo bashkohor, duke mos i'u përgjigjur parashikimeve dhe frymës së Konventës së Nju Jork-ut⁸. Po kështu, nuk e ka fituar rolin e duhur edhe praktika gjyqësore shqiptare në këtë fushë, e cila paraqitet *e varfër* në numër dhe përmbajtje e, për më tepër, me elementë jo tërësisht uniformë⁹.

II.2. Metodatat dhe metodologjia e kërkimit.

Metodologjia e studimit do t'i përgjigjet arritjes së qëllimeve të këtij punimi. Ekziston një postulat në Kërkimin Shkencor: *Metodat janë të varura nga teoritë, ndërsa teoritë të ndërlidhura me hipotezat dhe hipotezat me pyetjen kërkuese dhe të gjitha këto varen nga të dhënat respektive të cilat duhen interpretuar dhe analizuar*. Pikërisht në varësi të hipotezës apo pyetjeve që ngrihen në kapituj të veçantë të punimit, janë zbatuar edhe metodat e hulumtimit shkencor.

⁶ Hipoteza është një pohim i shprehur si një deklaram. Është një premisë që mund të përdoret si bazë për kërkimin shkencor. Babbie (1986) e përcakton hipotezën si “një pritje rreth asaj se si gjërat duhet të jenë në botë, nëse parashikimet teorike janë të sakta”. Hipoteza duhet konsideruar si versioni formal i hamendësimit të studjuesit, i cili më pas ia nënshtron këtë hipotezë një procedure të komplikuar dhe të hollësishme testimi. Kjo procedurë njihet si Testimi i Hipotezës. Hipoteza mund të parashikojë një drejtim ose të shpreh një marrëdhënie të pranueshme mes variablave.

⁷ Hipoteza bazë e kërkimit (H.0).

⁸ Hipoteza H.1.

⁹ Hipoteza H.2.

Qasja kryesore metodike në këtë studim është *qasja normative*, e cila konsiston rreth asaj se “si duhet të jetë” vlera dhe jo “si është”. Punimi do të ndërtohet i bazuar në metodën cilësore (*kualitative*) të kërkimit, përmes të cilave do të sigurojmë kuptimin dhe sqarimin e rasteve studimore, objekteve të hulumtimit, nga prizmi historik e juridik, duke grumbulluar të dhëna e informacione me qëllim krahasimin dhe analizën. Ndërsa metoda sasiore (*kuantitative*) e referuar do të jetë plotësuese vetëm në disa aspekte të punimit. Mund të thuhet pa mëdyshje se këto dy paradigma të kërkimit shkencor (për qasja cilësore dhe ajo sasiore) ekzistojnë të ndara nga njëra-tjetra nëse i referohemi mënyrës në të cilën secila prej këtyre dy traditave mbledh informacion dhe trajton të dhënat e mbledhura¹⁰.

Duke i'u referuar fushës së studimit dhe hipotezave të ngritura në këtë punim, ky i fundit na paraqitet si një studim kryesisht i të dhënave cilësore. Ai përqëndrohet në mbledhjen dhe analizën e të dhënave të doktrinës juridike të së drejtës së arbitrazhit, të dhëna këto të shtjelluara në literaturën ku mbështetet punimi. Gjithashtu mbledhja dhe analiza do të adresohet në kuadrin normativ të brendshëm dhe ndërkombëtar, shoqëruar edhe me interpretimin e këtij kuadri nga jurisprudenca.

Për aq sa është e mundur dhe në disa kapituj të veçantë, do të shfrytëzohen, nëpërmjet referimit, analizat numerike (sasiore) të të dhënave. Autori nuk do të zhvillojë metoda studimi sasiore, pasi ato nuk përfshihen në fokusin e metodologjisë së punimit. Por ndërkohë do të shfrytëzohen studime sasiore të autorëve apo subjekteve të tjerë, të cilat janë realizuar kohët e fundit në lidhje me aspekte të ndryshme të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar. Përmendim psh. studimin empirik të realizuar nga Shkolla e Arbitrazhit të Londrës, sponsorizuar nga shoqëria “Pricewaterhouse Coopers”¹¹, i cili bazuar në analizën e të dhënave statistikore arrin në përfundimin se palët zgjedhin arbitrazhin ndërkombëtar për të zgjidhur mosmarrëveshjet, më së shumti për dy arsye, që janë (1) neutraliteti i forumit (duke qenë në gjendje për të qëndruar jashtë juridiksionit të palës tjetër) dhe (2) mundësia e zbatimit të vendimit të arbitrazhit, nëpërmjet efektit të dispozitave të Konventës së Nju York-ut¹².

Nëpërmjet këtij kombinimi të metodave të studimit do të mund të arrinim në përfundime sa më pranë realitetit dhe sa më pak të ndikuara nga bindje personale që të ishte e mundur.

¹⁰ Brannen, J. (1992) “Kombinimi i qasjeve cilësore dhe sasiore: një përmbledhje”, fq.13

¹¹ “Queen Mary” University of London – “Arbitrazhi Ndërkombëtar: Sjellja e Korporatave dhe praktika” 2008”

¹² Margaret L. Moses; Parimet dhe praktika e Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar, 2008, Cambridge University Press, f.3.

II.3. Pozita konkrete metodologjike.

Konkretisht në këtë punim do të zbatohen këto metoda të kërkimit:

II.3.1. Metoda “Rishikim i literaturës”. Para se të krijojmë një dije të re, fillimisht ne kemi nevojë të njohim dijen ekzistuese mbi subjektin e kërkimit. Rishikimi i literaturës ka për synim të hedhë një vështrim dhe të bëjë një përmbledhje të dijes së mëparshme të besueshme. Në këtë metodë, synimi është që të mësohet sa më shumë që të jetë e mundur nga përpjekjet dhe puna që kanë bërë të tjerët, punë e cila është e botuar si “literaturë shkencore”. Gjetjet në literaturë, mund të lidhen me projektin e kërkimit në një numër rrugësh – përfshirë përcaktimin e problemit, objektivave, kuadrit konceptual dhe metodave e procedurave. Kjo metodë kërkimi do të zbatohet përgjithësisht në dy kapituj:

a. Kapitulli teorik – “Historiku i evoluimit të institutit të arbitrazhit ndërkombëtar në zgjidhjen e konflikteve tregtare”. Metoda e kërkimit “Rishikim i literaturës” do të na shërbejë për të sqaruar teoritë kryesore juridike të elaboruara prej doktrinës mbi natyrën e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar. Është shumë e nevojshme për kërkuesin, por edhe për lexuesin të kuptojë natyrën juridike dhe veçoritë që paraqet fenomeni, në rastin konkret instituti i së drejtës, që është objekt i fokusit të vetë punimit.

b. Kapitulli përshkrues - Veçoritë e Konventës së Nju Jork-ut – njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar. Metoda e kërkimit “Rishikim i literaturës” paraqitet me vlerë për këtë kapitull pikërisht në qasjen që ky i fundit bën në shtjellimin e veçorive dhe vlerave të Konventës së Nju Jork-ut. Literatura shkencore e deritanishme na paraqitet e pasur në shtjellimin e disa momenteve kyçe të hartimit të tekstit të dispozitave të kësaj konvente. Këto momente paraqiten si vlera të veçanta në krijimin e disa mekanizmave të rëndësishëm dhe shumë të vlefshëm juridikë në fazën e implementimit të këtyre dispozitave. Janë pikërisht këto momente dhe veçori, që e bëjnë tekstin e konventës si një nga më cilësorët e akteve të së drejtës ndërkombëtare private të të gjitha kohërave. Kërkuesi (autori), por edhe lexuesi duhet të njihet me trajtimin që literatura shkencore juridike i bën këtyre mekanizmave, për të kuptuar rëndësinë e dokumentit në fokusin e punimit.

II.3.2. “Metoda krahasuese”, e cila perceptohet si proces i konstatimit të ngjashmërisë dhe ndryshimeve mes dukurive të ndryshme. Kjo metode ka vlerën e vet praktike në këtë punim, sepse duke krahasuar dukuritë e ndryshme shoqërore dhe duke zbuluar vetitë e njëjta apo të ndryshme nga ky krahasim, konstatohen përparësitë apo mangësitë konkrete të asaj që dëshirojmë të studiojmë dhe të njohim. Në studimin tonë është shumë i rëndësishëm studimi

krahasues midis rendeve juridike nacionalë dhe atij ndërkombëtar, në fushën e arbitrazhit ndërkombëtar dhe posaçërisht në njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit, për të kuptuar përparësitë që kanë disa sisteme apo mangësitë që manifeston rendi juridik shqiptar. Po kështu metoda paraqet epërsi në krahasimin midis interpretimeve të bëra në vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykatat e huaja, por edhe nga ato shqiptare, në lidhje me momentet kryesore të procesit të arbitrazhit ndërkombëtar.

II.3.3. Metoda “Analizë interpretuese” do të zbatohet në këtë studim, kryesisht duke synuar kryesisht interpretimin e dispozitave të kuadrit ligjor kombëtar dhe atij ndërkombëtar. Kjo metodë i referohet në studim analizës së legjislacionit shqiptar në fushën e arbitrazhit, veçorive dhe karakteristikave të tij, duke tentuar të nxjerrë në pah anët e dobëta apo mangësitë në funksion të hipotezës dhe pyetjeve hulumtuese të punimit. Gjithashtu kjo metodë do të aplikohet në studimin e vendimeve gjyqësore, duke analizuar interpretimet e jurisprudencës shqiptare në lidhje me dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut.

II.3.4. Metoda “Studimi i rastit të veçuar” (metodë induktive)¹³. Një metodë mjaft e popullarizuar në studimet e shkencave shoqërore është modeli i rasteve të veçanta studimore (case study). Nëpërmjet metodologjisë së mësipërme synohet nxjerrja e të dhënave, përvijimi i analizës dhe nxjerrja e konkluzioneve për të vërtetuar hipotezën dhe për t’i dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura. Situata metodologjike e mësipërme garanton përfaqshjen e një punimi **induktiv**: mbi bazën e konstatimeve të rezultuara nga *hulumtimi i literaturës, krahasimi i fenomeneve, analiza e dokumentave*, dhe *rasteve studimore* do të nxirren përfundime për situatën e përgjithshme.

II.4. Plani i strukturuar i studimit.

Punimi do të konsiderohet i ndarë në dy pjesë, pjesa i përket metodologjisë së përdorur, përpos pjesës së konkluzioneve.

II.4.1. Pjesa *e parë* e punimit është e strukturuar në 2 kapituj, si më poshtë:

a. Kapitull historik dhe teorik. Në këtë kapitull do të paraqitet historiku i evoluimit të institutit procedural të arbitrazhit ndërkombëtar në zgjidhjen e konflikteve tregtare dhe teorive juridike të zhvilluara në këtë fushë. Pasqyrimi i këtyre teorive, duke shtjelluar karakterin kontraktual dhe juridiksional të arbitrazhit, i nevojitet lexuesit për të krijuar një ide

¹³ Një përfaqshje deduktive është ajo që kalon nga një teori ose hipotezë në vëzhgime empirike dhe në konkluzione. Një përfaqshje induktive është ajo që ndjek rrugën e anasjelltë, pra kur vëzhgimi i paraprind hipotezës, teorisë dhe interpretimit (Ritchie J, Lewis J. (2003).

të plotë dhe të qartë mbi natyrën e këtij mekanizmi të zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve. Nga ana tjetër, një përshkrim i tillë i nevojitet gjithashtu edhe analizës së mëtejshme të autorit, përse i përket objektit të hulumtimit shkencor. Kjo, sepse është pikërisht natyra juridike e këtij instituti ajo që përcakton apo ndikon në karakteristikat e veçanta të momentit të njohjes dhe zbatimit të vendimeve arbitrale. Në këtë kapitull do të analizohet një përmbledhje e literaturës doktrinale të autoreve më të rëndësishëm të fushës së arbitrazhit ndërkombëtar, veçanërisht trajtimet që i janë bërë problematikës së zbatimit të vendimeve të këtij arbitrazhi. Nëpërmjet metodës “**Rishikim i literaturës**” do të synohet veçanërisht evidentimi i përparësive të mekanizmave juridike të arbitrazhit ndërkombëtar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare.

b. Kapitull analizues i parashikimit të dispozitave dhe në përgjithësi të frymës së Konventës së Nju Jork-ut, si një nga aktet më të rëndësishme të së Drejtës Ndërkombëtare Private. Këtu do të shfrytëzohen si burime parësore dispozitat e vetë dokumentit të Konventës dhe protokollet e mbajtura me rastin e draftimit dhe miratimit të saj. Këto janë dokumenta zyrtare të disponuara në arkivën elektronike të dokumentave të Kombeve të Bashkuara (të aksesueshme on line). Gjithashtu do të shfrytëzohen si burime dytësore studimet e autorëve të huaj për trajtimin e parimeve që themelojnë mekanizmat juridikë, të formalizuar nëpërmjet dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut. Nëpërmjet metodës “rishikim i literaturës”, “metodës krahasuese” dhe “analizës interpretuese” do të synohet evidentimi i vlerave të kësaj Konvente si një instrument që siguron efektivitetin e alternativës të zgjidhjes me arbitrazh të mosmarrëveshjeve tregtare. Në këtë pjesë të punimit do të shfrytëzohen edhe të dhëna statistikore të mbledhura dhe të përpunuara nga institucione prestigjioze¹⁴, për të nxjerrë në pah vlerat e Konventës së Nju Jork-ut dhe efektin që ajo ka patur në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare ndërkombëtare e për rrjedhojë edhe në tregtinë botërore.

II.4.2. Në pjesën e dytë të punimit, e cila do të strukturohet në 2 kapituj, do të paraqitet një përshkrim, analizë dhe studim krahasimor midis sistemit ndërkombëtar (ku përfshihen dispozitat e Konventës së Nju Jorkut dhe modeleve të tjera ligjore të fushës, psh. ligji italian, anglez, ligji model UNCITRAL¹⁵, etj.) dhe sistemit të së drejtës së brendshme të Republikës së Shqipërisë, përse i përket institutit të arbitrazhit në përgjithësi dhe aplikimit të instrumentave të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar, në

¹⁴ “Arbitrazhi Ndërkombëtar: Sjellja e Korporatave dhe praktika 2008”, të dhëna statistikore empirike dhe kualitative të siguruar nga kërkimi i zhvilluar prej *School of International Arbitration, Queen Mary University of London*, me mbështetjen e *PricewaterhouseCoopers*.

¹⁵ Ligji model UNCITRAL (United Nations Commission on International Trade Law) “Mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar”, miratuar më 21 qershor 1985, amenduar në 2006.

veçanti. Nëpërmjet këtij studimi krahasues, të realizuar me “Metodën krahasuese” dhe “Analizën interpretuese” do të tentohet të vihet theksi dhe të analizohen momente të veçanta që paraqiten si *veçori Shqiptare* të aplikimit të këtyre instrumentave, në zgjidhjen e konflikteve. Një analizë e tillë do të realizohet si në aspektin teorik të parashikimit normativ, ashtu dhe në atë praktik nëpërmjet shtjellimit të problematikës konkrete të praktikës gjyqësore shqiptare. Për të realizuar qëllimin e mësipërm metodologjia kërkimore do të aplikohet në dy shtylla kryesore, duke e strukturuar përgjithësisht këtë pjesë të punimit në dy pjesë të veçanta, por të koordinuara me njëra-tjetrën.

a. Kapitulli analitik (1) do t’i përkasë përshkimit, krahasimit dhe analizës së të dhënave dhe informacionit të mbledhur nga procesi i hulumtimit të dokumentave zyrtare (akte ligjore shqiptare, veçanërisht Kodi i Procedurës Civile), duke shfrytëzuar gjithashtu vlerësime dhe analiza të literaturës doktrinale¹⁶, mbi arbitrazhin në Shqipëri. Në këtë pjesë, nëpërmjet metodave të kërkimit shkencor (“metodës krahasuese” dhe “analizës interpretuese”), do të arrihet në një konkluzion, duke ngritur kështu një teori të mbështetur në të dhëna, një përjasje kjo që presupozon një stil të zhvillimit të analizës cilësore¹⁷. Do të tentohet që analiza të provojë hipotezën: *Kuadri ligjor Shqiptar, që rregullon arbitrazhin e brendshëm është i pamjaftueshëm dhe jo bashkohor.*

b. Kapitulli analitik (2) i përkushtohet analizës së detajuar, ligjore dhe jurisprudenciale, të parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile mbi njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj, duke e krahasuar me frymën e Konventës së Nju Jork-ut. Në këtë pjesë të punimit do të analizohen, gjithashtu, raste studimore të disa çështjeve gjyqësore, të shqyrtuara prej Kolegjit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe që kanë të bëjnë me njohjen dhe dhënien fuqi vendimeve të arbitrazhit të huaj në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kapitull, i cili konsiderohet edhe shtylla e punimit, do të aplikohen “metoda krahasuese”, “analiza interpretuese”, si dhe metoda induktive e kërkimit shkencor “Studimi i rastit të veçuar”¹⁸. Do të tentohet që analiza e veçorive që paraqet kuadri ligjor dhe rastet e studiuara të praktikës gjyqësore, të provojë hipotezën: *Realiteti Shqiptar, për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj, nuk është në lartësinë e vlerave që kërkon Konventa e Nju Jork-ut në*

¹⁶ Literatura që do të përfshihet në bibliografinë e studimit.

¹⁷ Bell Judith, “Si veprohet në një projekt kërkimor”, f.36, p.1.

¹⁸ “Studimi i rastit të veçuar” - një qasje, apo stil kërkimi ku kërkuesi kap dhe studion një shembull të veçantë dhe hulumton rreth tij, duke u munduar që rezultatet t’i përgjithësojë për fenomenin. Duke mbledhur fakte rreth shembullit në mënyre sistematike studiohet korelacioni midis dy a më shumë ndryshoreve (cilësi apo karakteristika), pra vlerësohet si rrijnë ato në raport me njëra-tjetrën ose efektin që ka tek njëra ndryshimi i tjetrës – “Si veprohet në një projekt kërkimor”, Judith Bell, f.27, p.1.

fushën e arbitrazhit ndërkombëtar. Kështu, kuadri normativ i brendshëm nuk i përgjigjet parashikimeve dhe frymës së Konventës, ndërsa praktika gjyqësore shqiptare në fushën e njohjes së vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar, është e varfër dhe jo e unifikuar.

Të dyja pjesët së bashku do të synojnë të japin, si konkluzion, një panoramë të përgjithshme të veçorive të realitetit shqiptar, në fushën e arbitrazhit dhe atë të njohjes së vendimeve të tij, e parë kjo në dritën e parashikimeve të Konventës së Nju Jork-ut

II.4.3. Pjesa e tretë dhe e fundit e punimit është pjesa e përfundimeve dhe rekomandimeve, e strukturuar në një kapitull të veçantë. Ky seksion do të përfshijë në mënyrë të përmbledhur konstatimet dhe përfundimet e kapitujve paraardhës, të përkufizuar në funksion të hipotezave dhe pyetjeve hulumtuese të ngritura që në fillim të punimit. Punimi do të konsiderohej thjesht përshkrues dhe jo analitik nëse do të mbeteshim vetëm në rrafshin evidentues të problematikave që hasen. Rrjedhimisht pyetja e fundit e studimit synon të nxisë të menduarit kritik mbi atë çfarë mund të përmirësohet dhe ndryshohet, duke synuar kryesisht përmirësimin dhe harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me legjislacionin dhe praktikën ndërkombëtare.

KAPITULLI III

ASPEKTE HISTORIKE DHE TEORIKE MBI ARBITRAZHIN TREGTAR NDËRKOMBËTAR

III.1. Arbitrazhi ndërkombëtar si një fenomen historik.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve nuk ka qenë dhe, sikurse pritet, nuk do të jetë kurrë një funksion eskluziv i shtetit¹⁹. Shteti ofron vetëm një formë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve private, nëpërmjet ndërhyrjes së një pale të tretë, duke ngritur dhe ruajtur një sistem gjyqësor në të cilin palët mund të "konfrontohen" me fakte dhe prova. Nga ana tjetër është gjithashtu e mundur që palët, me vullnetin e tyre të lirë, të përfshijnë personat e tretë në një proces privat për të zgjidhur ose për të ndihmuar ata (palët) të zgjidhin mosmarrëveshjen. Ndër sistemet që parashikojnë involvimin e palës së tretë për zgjidhjen private të konflikteve, *arbitrazhi* është mekanizmi më i dalluar për nga efektiviteti edhe pse nuk është i vetmi²⁰.

Një fakt, i cili duhet nënvizuar paraprakisht, është se arbitrazhi privat daton më parë në kohë sesa sistemi gjyqësor publik²¹, duke u paraqitur si një mekanizëm ekstrajyqësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Persianët, egjiptianët, grekët dhe romakët, të gjithë kishin një traditë të arbitrazhit. Në të drejtën romake, psh. marrëveshjet e arbitrazhit ishin të pranueshme si një reflektim i parimit të njohur të lirisë së kontratës. Në Egjiptin e lashtë, tregtarët me entuziazëm pranonin si përfundimtar vendimin e miqve të tyre tregtarë, me njohuri dhe ekspertizë në fushën përkatëse²².

Është karakteristik fakti se arbitrazhi perceptohej si superior për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të çmimeve apo dëmtimeve.²³ Madje edhe në vitet 1800, arbitrazhi vlerësohej për avantazhet e tij në kursimet e kostove. Arbitrazhi filloi kështu ngritjen e tij në fazën foshnjërore të shoqërisë, si një metodë e vetë-rregulluar, e dallueshme nga procesi gjyqësor dhe jo si një pasojë e zhvillimit të gjykatave publike²⁴.

¹⁹ Sarah Rudolph Cole; Arbitrazhi dhe veprimi i shtetit, 2005; Buletini Juridik 1 i Universitetit Brigham Young, f.47.

²⁰ Forma të tjera të Zgjidhjeve Alternative të Mosmarrëveshjeve (ADR - alternative dispute resolution) janë negociimi, ndërmjetësimi, pajtimi, minigjyqjet, etj.

²¹ William Holdsworth, xiv "Një histori e ligjit anglez", A.L.Goodhart & H.G.Hanbury bot. 1964.

²² Margit Mantica, "Arbitration in Ancient Egypt" (1957), Revista e Arbitrazhit 12, f.155, 155-59, 160-61.

²³ Shiko çështjen "Delaware & H. Canal Co. kundër Pennsylvania Coal Co." (50 N.Y. 250, 263 (N.Y. 1872); çështjen "Hamilton kundër Insurance Co.", (136 U.S. 242 (1890).

²⁴ Julius Henry Cohen, "Arbitrazhi Tregtar dhe Ligji", 25 (1918), Traktat mbi të Drejtën e Arbitrazhit në Skoci (botimi i dytë. 1877), 22-27 (duke theksuar rëndësinë e veçantë të arbitrazhit, pavarësisht nga zhvillimi i një sistemi gjyqësor me reputacion, në çështjet tregtare, në të cilat ekspertiza e arbitrit, për çështjet teknike, është thelbësore)

III.1.1. Institucionalizimi i arbitrazhit ndërkombëtar tregtar – fillesat e tij.

Arbitrazhi ndërkombëtar tregtar, siç e njohim ne sot, u shfaq në Evropën kontinentale në vitet 1920. Ka pasur dy vështirësi të mëdha në situatën e atëhershme. *Vështirësia e parë* ishte se në shumë vende, një marrëveshje për arbitrazh mund të konsiderohej e vlefshme vetëm nëse kishte lidhje me një mosmarrëveshje ekzistuese (të ashtuquajturat "kompromis"), ndërsa për mosmarrëveshje, që mund të lindin në të ardhmen, në lidhje me një kontratë, marrëveshja e arbitrazhit nuk ishte e vlefshme ("klauzolë kompromisi")²⁵. Ishte gjithashtu e zakonshme që edhe në vendet në të cilat kjo marrëveshje, për të arbitruar mosmarrëveshje të ardhshme, ishte e vlefshme, ajo shpesh nuk e ndalonte në mënyrë efektive një gjykatë nga marrja e juridiksionit mbi konfliktin²⁶.

Vështirësitë në lidhje me marrëveshjen e arbitrazhit u eliminuan, në mënyrë efektive, për marrëveshjet jo kombëtare të arbitrazhit, nga Protokollin i Gjenevës i vitit 1923 "Për dispozitat e Arbitrazhit"²⁷. Protokollin shënoi një sukses, si në aspektin e numrit të shteteve që u bënë palë në të, ashtu dhe në lidhje me përmbajtjen e tij, duke njohur vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit, pavarësisht nëse paraqitej në formën e kompromisit, apo klauzolës së kompromisit arbitral²⁸. Protokollin siguroi gjithashtu se procedura, përfshirë edhe krijimin e tribunalit të arbitrazhit, duhej të qeverisej nga vullneti i palëve dhe nga ligji i vendit në territorin e të cilit zhvillohej arbitrazhi²⁹. Pas këtij momenti, me sanksionimin e njohjes së vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit, gjykatat në Evropë dhe në SHBA kishin për të ndryshuar qëndrimin e tyre armiqësor ndaj arbitrazhit tregtar³⁰.

Vështirësia e dytë, e njohur gjerësisht, konsistonte në njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit. Prandaj, katër vjet pas miratimit të Protokollit të Gjenevës, në vitin 1927, Lidhja e Kombeve miratoi Konventën e Gjenevës "Për ekzekutimin e vendimeve të

²⁵ Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38), f. 20.

²⁶ Craig, Park & Paulsson, Arbitrazhi i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (3rd ed.), Oceana Publications, Inc., Dobbs Ferry, 2000, f. 273-274.

²⁷ Protokollin i Gjenevës "Për dispozitat e arbitrazhit", u nënshkrua në një takim të Asamblesë së Lidhjes së Kombeve, më 24.09.1923.

²⁸ Protokollin i Gjenevës, 1923, neni 1: "*Secili prej Shteteve Kontraktuese njih vlefshmërinë e marrëveshjes, pavarësisht nëse ka lidhje me mosmarrëveshjet ekzistuese apo të ardhshme, ndërmjet subjekteve respektivisht në juridiksionin e Shteteve Kontraktuese të ndryshme, me anë të së cilës palët në një kontratë bien dakord që t'i nënshtrorjnë arbitrazhit të gjitha ose ndonjë çështje tjetër të aftë të zgjidhet nga arbitrazhi, pavarësisht nëse arbitrazhi do të zhvillohet apo jo në një shtet, në juridiksionin e të cilit asnjëra nga palët nuk është subjekt*".

²⁹ Protokollin i Gjenevës, 1923, neni 2; Kjo përmbajtje e Protokollit sot është inkorporuar në nenet II dhe V(d) të Konventës së Nju Jorkut 1958 vetëm me disa ndryshime të vogla.

³⁰ Samuel Marful-Sau, "Mundet arbitrazhi ndërkombëtar tregtar të jetë efektiv pa gjykatat kombëtare? Një perspektivë e përfshirjes së gjykatave në arbitrazhin ndërkombëtar tregtar", Universiteti Dundee, Revista Vjetore e CEPMLP 2010, f.9.

huaja të arbitrazhit”³¹. Shtetet kontraktuese ranë dakord për të zbatuar vendimet e arbitrazhit të marra në përputhje me Protokollin e vitit 1923, në territorin e një shteti tjetër kontraktues³². Konventa ishte miratuar, sikurse edhe Protokollin, nga një numër i madh shtetesh dhe ishte në përgjithësi një sukses përse i përket përmbajtjes së saj.

Në të njëjtën kohë u ndie nevoja për një organizatë arbitrazhi që duhet të kishte një natyrë *ndërkombëtare*. Si pasojë, në vitin 1922, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC)³³ miratoi rregulloren e saj të parë të arbitrazhit dhe në vitin 1923 themeloi Gjykatën e Arbitrazhit³⁴. Edhe pse selia e ICC-së është në Paris, nuk ka patur ndonjë sugjerim apo paramendim që Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar e ICC-së do të ishte një organizatë arbitrazhi Franceze, fakt ky që njihet botërisht sot³⁵.

Përpos asaj çka ishte arritur me miratimin e Protokollit dhe Konventës, si dhe me krijimin e Gjykatës së Arbitrazhit të ICC-së, perceptohej gjithashtu nevoja për të patur marrëveshje mbi rregullat procedurale të zbatueshme në arbitrazh. Një pasojë e drejtëpërdrejtë e këtij fakti ishte miratimi prej Shoqatës së të Drejtës Ndërkombëtare³⁶, në vitin 1938, të Rregullores së Amsterdemit, e cila, megjithë rëndësinë historike, nuk pati asnjë efekt praktik mbi rregullimin procedural të arbitrazhit³⁷. Për më tepër, Instituti Ndërkombëtar për Unifikimin e së Drejtës Private (UNIDROIT)³⁸ përgatiti edhe një projekt-ligj uniform për arbitrazhin, por shpërthimi i luftës së dytë botërore në Evropë, në 1939, solli që këto përpjekje të ndalnin³⁹.

³¹ Konventa mbi ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit, nënshkruar në Gjenevë në 26 shtator 1927.

³² *Id.*, neni 1.

³³ Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë është krijuar në vitin 1919, nga një grup industrialistësh, të cilët e quanin veten "tregtarët e paqes" (<http://www.iccwbo.org/about-icc/history/>).

³⁴ Arbitrazhi i ICC-së është një procedurë fleksibël dhe efikase për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të brendshme dhe ndërkombëtare. Vendimet janë të detyrueshme, përfundimtare dhe lehtësisht të zbatueshëm kudo në botë. Themeluar në vitin 1923, si trupa e arbitrazhit të ICC-së, Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit konsiderohet si pionere e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar, siç është e njohur edhe sot. (<http://www.iccwbo.org/products-and-services/arbitration-and-adr/arbitration/>).

³⁵ *Id.*: Nuk ka kufizime për ata të cilët mund të përdorin arbitrazhin ICC, si dhe për ata që mund të veprojnë si arbitra. Kjo reflektohet në numrin në rritjen të kombësive të përfaqësuara në Gjykatë. Që nga fillimi i tij, Gjykata e Arbitrazhit ka administruar më tepër se 19,000 raste, që përfshijnë palë dhe arbitra nga rreth 180 shtete.

³⁶ Shoqata e të Drejtës Ndërkombëtar (ILA) është themeluar në Bruksel në vitin 1873. Objektivat e saj, sipas Kushtetutës së Shoqatës (të miratuar në Conferencën e 75^{-të}, 2012), neni 3.1, janë: “Studimi, sqarimi dhe zhvillimi i të drejtës ndërkombëtare, publike dhe private, mbështetje ndaj mirëkuptimit ndërkombëtar dhe respekti për ligjin ndërkombëtar”. ILA ka status konsultativ, si një organizatë ndërkombëtare jo-qeveritare, me një numër agjencish të specializuara të Kombeve të Bashkuara (http://www.ila-hq.org/en/about_us/index.cfm).

³⁷ Raportim i UNCITRAL (Ion Nestor, Raportues Special) – “Problemet që lidhen me aplikimin dhe interpretimin e Konventave ekzistuese multilaterale mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar dhe çështjet e lidhura me to”, (A/CN.9/64, para.29, Vjetar i UNCITRAL, 1972, f.193)

³⁸ Instituti Ndërkombëtar për Unifikimin e së Drejtës Private (UNIDROIT) është një organizatë e pavarur ndërqeveritare, me seli në Romë. Qëllimi i saj është të studiojë nevojat dhe metodat për modernizimin, harmonizimin dhe bashkërendimin e të drejtës private dhe në veçanti asaj tregtare, ndërmjet shteteve dhe grup-shteteve, si dhe të formulojnë instrumenta uniforme ligjore, parime dhe rregulla për të arritur këto objektiva. Kjo

Mund të thuhet pra, që gjatë dy dekadave (nga viti 1920 deri në 1950), në Evropë ka pasur një zhvillim të qëndrueshëm të arbitrazhit, si mjet i njohur i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në çështjet ndërkombëtare tregtare. Megjithatë, në terma sasiorë, zbatimi i këtij mekanizmi (arbitrazhit) ndërmjet subjekteve tregtare nga vende të ndryshme ishte ende mjaft i kufizuar, me përjashtim të atyre rasteve kur arbitrazhi zhvillohej brenda shoqatës tregtare përkatëse. Për më tepër, zhvillimi i arbitrazhit për mosmarrëveshjet ndërkombëtare tregtare, që u vu re në Evropë, në përgjithësi nuk shtrihej në pjesën tjetër të botës⁴⁰.

III.1.2. Reformimi i arbitrazhit ndërkombëtar, pas viteve 1950.

Zhvillimi i arbitrazhit ndërkombëtar mori një tjetër hov pas vitit 1950. Në fakt, gjysma e dytë e shekullit të kaluar njihet për zhvillimin e arkitekturës procedurale të arbitrazhit. Pjesa më e madhe e ndryshimeve ka qenë drejtuar në rritjen e besueshmërisë së procesit të arbitrazhit. Në këtë kuadër, për t'i dhënë një monedhë globale vendimeve tregtare të arbitrazhit, Kombet e Bashkuara, në vitin 1958, miratuan Konventën e Nju Jork-ut.⁴¹ Tashmë është vënë në dukje gjerësisht se Konventa e Nju Jorkut është gur themeli mbi të cilin është ndërtuar gjithë ngrehina e arbitrazhit tregtar ndërkombëtar. Në konferencën diplomatike që u mbajt për miratimin e saj, u gjykua e dobishme ideja për të kombinuar dispozitat e dy dokumentave pararendës (Protokollit-1923 dhe Konventës-1927) në një konventë të vetme. Rezultati ishte Konventa e vitit 1958 për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit (Konventa e Nju Jork-ut)⁴². Të gjithë shtetet që kanë ratifikuar Konventën (sot 149)⁴³ e kanë angazhuar veten për njohjen e marrëveshjes dhe vendimit të arbitrazhit edhe kur arbitrazhi do të zhvillohet në një vend të huaj⁴⁴. Duke bërë një “premtim” të tillë, ata kanë rënë dakord

organizatë është themeluar në 1926 si një organ ndihmës i Lidhjes së Kombeve dhe, pas rënies së Lidhjes, u rithemelua në vitin 1940 mbi bazën e një marrëveshjeje shumëpalëshe.

³⁹ Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38), f.21.

⁴⁰ Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38), f.21-22

⁴¹ Konventa “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”, (Seria e Traktateve të KB, vol. 330, f.3, miratuar 10 qershor 1958, regjistruar dhe hyrë në fuqi në 7 qershor 1959, Nr.4739). Shiko: Albert Jan van den Berg, “Konventa e Arbitrazhit të Nju Jork-ut e 1958” (1981); W.Laurence Craig, William W. Park, & Jan Paulsson, “Dhoma Ndërkombëtare e Arbitrazhit Tregtar”, (bot.3^{te}, 2000); William W.Park, “Konventa e Kombeve të Bashkuara për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”, B.Barin ed. (1999); shiko gjithashtu: Raport i ICC-së, “Zbatimi i vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar”, Raport dhe draft paraprak i Konventës, (broshura e ICC-së Nr.174 (1953), riprintuar në Dok.të K.B (E/C.2/373); Stimuli i menjëhershëm për Konventën e Nju Jork-ut ishte një raport nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, që nënvizonte nevojën për t'i bërë vendimet e arbitrave të transportueshëm ndërmjet kufijve kombëtare.

⁴² Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38), f. 23.

⁴³ Burimi: <http://www.newyorkconvention.org/new-york-convention-countries/contracting-states>.

⁴⁴ Neni 2(1) dhe 3 i Konventës

gjithashtu që gjykatat e tyre nuk do të ushtrojnë juridiksion mbi themelin e mosmarrëveshjes për atë kohë sa njëra palë insiston për klauzolën e arbitrazhit⁴⁵.

Duhet të theksohet megjithatë, se aktorët kryesorë të fushës së tregtisë ndërkombëtare mendonin se nuk mjaftonte vetëm një Konventë për të bërë eficient arbitrazhin ndërkombëtar tregtar. Kjo, sepse njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit konsiderohej vetëm një aspekt i tij. Në fakt prej kohësh ka qenë e njohur se zhvillimi i arbitrazhit, si një mjet për të zgjidhur mosmarrëveshjet tregtare ndërkombëtare, është penguar kryesisht nga dallimet ekzistuese në legjislacionin e vendeve të ndryshme në lidhje me procedurat dhe efektin e arbitrazhit, nga mungesa e uniformitetit në rregullat e forumeve arbitrale, si dhe nga komplikimet që rrjedhin nga konflikti i ligjeve në këtë fushë. Kështu që përveç hartimit dhe nënshkrimit të një dokumenti për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit ishin të nevojshme edhe masa të tjera. Disa organizata publike dhe private, të interesuara në rritjen e përdorimit të arbitrazhit në tregtinë ndërkombëtare, qëndruan të angazhuara në mënyrë aktive në promovimin e unifikimit të ligjeve të arbitrazhit. Ato inkurajuan përfundimin e traktateve unifikuese të arbitrazhit, duke mbrojtur standartizimin ose të paktën koordinimin e rregullave dhe procedurave të organeve ekzistuese të arbitrazhit⁴⁶.

Pas konferencës diplomatike të 1958, interesi drejt arbitrazhit vazhdoi të rritej. Në vitin 1961, tre vjet pas miratimit të Konventës së Nju Jork-ut, u miratua Konventa Evropiane për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar⁴⁷. Ky dokument i rëndësishëm është instrumenti i parë ndërkombëtar që përfshin në titullin e saj fjalët “arbitrazh ndërkombëtar tregtar”. Kjo ishte më shumë se një kuriozitet, pasi sinjalizoi një ndryshim në qëndrimin ndaj arbitrazhit të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare tregtare. Kuptohet që *shteti*, si juridiksion sovran, vazhdon të ketë autoritetin të bëjë rregullat edhe përsa i përket zgjidhjes së konflikteve me arbitrazh, por ato rregulla duhet të njohin kërkesat e veçanta të një arbitrazhi që përfshin transaksione ekonomike ndërkombëtare dhe në të cilin një ose të dyja palët mund të jenë të huaj⁴⁸.

⁴⁵ Neni 2(3) i Konventës

⁴⁶ Memorandum i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj, dokument i Këshillit Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara (ECOSOC), sesioni 21, nr.E/2840, 22 mars 1956 (siguruar on line); f.3, par.5 (*travaux préparatoires*).

⁴⁷ Konventa u përgatit dhe u hap për nënshkrim më 21 prill 1961 nga Mbledhja e Posaçme, e mbajtur në Zyrën Evropiane të Kombeve të Bashkuara në Gjenevë (Seria e Traktateve të KB, vol. 484, f.349).

⁴⁸ Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38), f. 23.

Në lidhje me rregulloret e procedurës së arbitrazhit, pavarësisht se u bënë disa përpjekje në vitet 1960⁴⁹, rezultate efektive e arritën vetëm me Rregullat e Arbitrazhit, të miratuara nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL)⁵⁰ në prill të vitit 1976. Rregullat, të cilat ishin projektuar posaçërisht për përdorim në arbitrazhet “*ad hoc*” të të dy sistemeve ligjore (*common law* dhe *civil law*), kanë marrë miratimin e Komitetit Aziatiko-Afrikan për Këshillime Ligjore (AALCC) në korrik të atij viti⁵¹. Gjashtë muaj më vonë u arrit një marrëveshje rekomanduese që kontratat tregtare midis Bashkimit Sovjetik dhe SHBA, për çdo mosmarrëveshje, t’i referoheshin arbitrazhit, që do të zhvillohej në Stokholm, sipas rregullave të arbitrazhit UNCITRAL⁵². Miratimi i kësaj rregulloreje nga një numër i madh vendesh në zhvillim (të përfaqësuar nga AALCC), nga Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara nënkuptonte faktin se Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL kanë qenë politikisht të pranueshme nga një segment i madh i shteteve të botës⁵³.

Duke qënë se Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL janë hartuar për arbitrazhin *ad hoc*, domosdoshmërisht ato lejojnë palët të shprehin lirisht vullnetin mbi procedurën e arbitrazhit. Megjithatë, këto rregulla sanksionojnë se ligji që rregullon arbitrazhin mund të përmbajë një dispozitë, nga e cila palët nuk mund të derogojnë, pasi në një rast të tillë dispozita do të mbizotërojë⁵⁴. Gjithashtu, në vitin 1982, UNCITRAL e pa të arsyeshme të nxjerrë një Udhëzues për *Arbitrazhet e Administruara*, i cili përfshinte një përshkrim të ndryshimeve që

⁴⁹ *Id.*, f.23-24: Në 1966 Rregulloret e Arbitrazhit për arbitrazhin “*ad hoc*” u miratuan si nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën (ECE) dhe Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Azinë dhe Lindjen e Largët (ECAFE). Në të njëjtin vit një Konventë Evropiane, që siguroi një Ligj Uniform mbi Arbitrazhin, u miratua nga Këshilli i Evropës. Këto tre tekste janë të rëndësishme kryesisht për shkak se ata demonstuan dëshirën e fortë në vitet 1960, për rregullimet uniforme, ndërkombëtarisht të pranueshme, të procedurës së arbitrazhit. Vetëm Rregullat e miratuara nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën mund të thuhet se patën sukses. Ata janë përdorur gjerësisht në Evropën kontinentale për arbitrazhin “*ad hoc*”, por ata konsiderohet të jenë të papërshtatshëm për arbitrazhet midis vendeve që i perkasin sistemeve të ndryshme ligjore *common law* dhe *civil law*. Në anën tjetër, Rregullat e miratuara nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Azinë dhe Lindjen e Largët duket se kanë qenë përdorur rrallë, për të mos thënë fare, ndërsa Ligji Uniform nuk hyri kurrë në fuqi, pasi Konventa u ratifikua vetëm nga Belgjika.

⁵⁰ Arsyeja e krijimit të këtij Komisioni në vitin 1966 (Rezoluta 2205(XXI) 17.12.1966) ishte evidentimi i pabarazive ndërmjet legjislacioneve nacionale, që rregullonin tregtinë ndërkombëtare, duke krijuar kështu pengesa në këtë fushë. Per rrjedhoje Asambleja e Përgjithshme e OKB-së vlerësoi këtë Komision si një mjet, nëpërmjet të cilit OKB-ja mund të luante një rol më aktiv në zvogëlimin apo heqjen e këtyre pengesave (<http://www.uncitral.org>).

⁵¹ Rezoluta e AALCC (tani e njohur si Organizata Konsultative Ligjor Aziatike-Afrikane) është riprodhuar nga UNCITRAL ne dokumentin A/CN.9/127.

⁵² Marrëveshja ndërmjet Shoqatës Amerikane të Arbitrazhit, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike dhe Dhomës Ekonomike të Stokholmit në lidhje me opsionin e klauzolës së arbitrazhit për përdorim në kontratat e tregtisë se vitit 1977 midis BRSS-SHBA; 12 janar 1977.

⁵³ Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38), f. 24.

⁵⁴ Neni 1(2) i Rregullores së Arbitrazhit UNCITRAL.

mund të bëhen në Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL, kur ato i përshtaten përdorimit si rregulla të forumeve të përhershme të arbitrazhit⁵⁵.

Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL u pasuan nga Ligji Model, në vitin 1985, i cili karakterizohet jo vetëm për mbështetjen ndaj procesit të arbitrazhit, por edhe nga shkalla e lirisë, të cilën ai u garanton palëve për të zhvilluar arbitrazhin siç ata dëshirojnë. Arbitrazhi mund të jetë *institucional* ose *ad hoc*⁵⁶, por pavarësisht nga lloji i tij, liria e vullnetit të palëve për të rregulluar procedurat garantohet⁵⁷. Është e rëndësishme të theksohet se ligji model është hartuar për të rregulluar vetëm arbitrazhin ndërkombëtar tregtar, ç'ka do të thotë se ai shtet, që miraton ligjin model, duhet të ketë një ligj të veçantë që rregullon arbitrazhin e brendshëm. Miratimi i ligjit model i mundëson shtetit miratues të ofrojë një rregullim të tillë të arbitrazhit, ku mbizotërues është parimi i konsensusit për procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar⁵⁸. Me qëllimin për të rritur efektivitetin e këtij ligji, UNCITRAL-i miratoi amendimet përkatëse në vitin 2006, duke i'u përshtatur praktikave aktuale të tregtisë ndërkombëtare dhe mjeteve moderne të kontraktimit⁵⁹.

Gjithashtu, në periudhën pas viteve 1950, edhe legjislaturat kombëtare u përfshinë në procesin e modernizimit të arbitrazhit ndërkombëtar, nëpërmjet reformave ligjore. In 1979, Anglia startoi e para me një ligj të ri, që reduktonte shkaqet e kundërshtimit të vendimit të arbitrazhit⁶⁰. Reforma e arbitrazhit lulëzoi gjatë dy dekadave të ardhshme, me ligje të reja në Francë, Belgjikë, Itali, Hollandë dhe Zvicër, si dhe me një raund tjetër reformues në Angli (Arbitration Act 1996)⁶¹.

⁵⁵ Rekomandime për të ndihmuar institucionet e arbitrazhit dhe organet e tjera të interesuara në lidhje me arbitrazhet sipas Rregullores së Arbitrazhit UNCITRAL, të miratuara në seancën e 15^{të} të Komisionit; Vjetari UNCITRAL (1982), f.420.

⁵⁶ Shërbimi i arbitrazhit *institucional* ofrohet nga organizata që funksionojnë si institucione, të cilat kanë seli fikse, rregullore procedurale dhe listë arbitrazh. Në këtë rast, procedura e arbitrazhit do të zhvillohet në përputhje me rregulloren e institucionit në fjalë. Me arbitrazh *ad hoc* kuptohet një apo disa arbitra, të cilët emërohen nga palët vetëm për një çështje të veçantë, pra forumi i arbitrazhit nuk është i përhershëm por ngrihet rishtas për çdo çështje të caktuar. Ky lloj arbitrazhi, që nuk ka as seli dhe as statut, është me fleksibël dhe kërkon një mirëkuptim më të madh të palëve; *shiko* Gary B.Born, "Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar, Komentari dhe Materiale" (botimi i 2^{të}), Transnational Publishers, Kluwer Law International, 2001.f.11.

⁵⁷ Ligji Model UNCITRAL, në nenin 18 dhe 19(1) parashikon që *palet do të trajtohen me barazi dhe secilës palë do t'i jepet një mundësi e plotë në paraqitjen e çështjes së tij dhe se palët janë të lira për të rënë dakord mbi procedurën që do të ndiqet nga forumi i arbitrazhit në kryerjen e procedurave.*

⁵⁸ Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38), f. 25.

⁵⁹ Rezoluta e Asamblesë së Përgjithsme K.B 61/33, 4 dhjetor 2006, (U.N.Publication Sales No.E.08.V.4, p.viii).

⁶⁰ Arbitration Act (Ligji i Arbitrazhit), 1979 (në fuqi nga 1 gushti 1979).

⁶¹ William W.Park, "Arbitrazhi i mosmarrëveshjeve të biznesit ndërkombëtar", Oxford University Press, 2006, Pjesa I "Zhvillimi procedural në arbitrazhin e biznesit", f.6.

Argumentohet se, që prej viteve 1990, arbitrazhi ndërkombëtar tregtar, është bërë i pavarur dhe aq atraktiv sa shumë vende të zhvilluara konkurojnë sot për t'u zgjedhur si seli arbitrazhi. Ishte pikërisht kjo arsyeja, që Belgjika në 1985, reformoi ligjet nacionale, për të përjashtuar totalisht ndërhyrjen gjyqësore në procedimin arbitral. Por, ndryshe nga sa pritej, një gjë e tillë krijoi më shumë ankth sesa konfort tek biznesi. Dështimi i këtij eksperimenti e detyroi Belgjikën të rishikonte politikën e saj, duke i rikthyer gjykatave pushtet të rëndësishëm mbikqyrës në ndihmë të arbitrazhit⁶². Në fakt, eksperiencia Belge demostroi nevojën që gjykatat nacionale të mbështesnin efikasitetin e procesit të arbitrazhit. Ajo gjithashtu konfirmoi përfundimisht se gjykatat kombëtare mund të ekzistojnë më vehte, si juridiksion i pavarur, ndërsa arbitrazhi nuk mund të ekzistojë pa gjykatat.⁶³

III.2. Natyra juridike e arbitrazhit - vështrim teorik.

III.2.1. Përkufizimi i arbitrazhit - një alternativë për zgjidhjen e konflikteve.

Para se të thellohem në natyrën juridike të këtij instituti, le të tentojmë fillimisht të sqarojmë se çfarë është *arbitrazhi*, pasi shpesh merr një rëndësi të madhe përcaktimi nëse një procedurë e plotëson të gjitha kushtet për t'u cilësuar si *arbitrazh*⁶⁴. E vërteta e parë për arbitrazhin është se nuk ka një përkufizim zyrtar për të. Konventat ndërkombëtare, të miratuara në këtë fushë, nuk i kanë dhënë zgjidhje nevojës që hera herës shfaqet për të patur gjithsesi një përkufizim të këtij instituti. Kështu psh., Konventa e Nju Jork-ut⁶⁵, parashikon se çdo shtet kontraktues do të njohë marrëveshjen e shkruar, sipas të cilës palët marrin përsipër t'i nënshtrohen arbitrazhit, pa u shprehur se çfarë kuptohet me këtë të fundit. Po kështu, Konventa e Gjenevës apo Ligji Model UNCITRAL nuk e përkufizojnë arbitrazhin, pavarësisht se një përkufizim është propozuar nga Sekretariati UNCITRAL⁶⁶.

Pavarësisht se termi "*arbitrazh ndërkombëtar tregtar*" asnjëherë nuk ka qenë zyrtarisht i definuar, ka një marrëveshje të qartë dhe të gjithëpranuar mbi elementet e tij përbërës, duke identifikuar kështu kufijtë e këtij fenomeni⁶⁷. Nëse do të donim të jepnim informacion të

⁶² *Id.*, f.18.

⁶³ Samuel Marful-Sau, "Mundet arbitrazhi ndërkombëtar tregtar të jetë efektiv pa gjykatat kombëtare? Një perspektivë e përfshirjes së gjykatave në arbitrazhin ndërkombëtar tregtar", 2010, f.10

⁶⁴ Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38), f.4.

⁶⁵ Neni 2(1) i Konventës.

⁶⁶ Raporti i Grupit të Punës mbi Praktikat e Kontratës Ndërkombëtare, gjatë punimeve të sesionit të saj të tretë, A/CN.9/216, par.15-18; Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm - Tiparet e mundshme të një ligji Model për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, A/CN.9/207, par.29-30

⁶⁷ Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38), f.17.

mjaftueshëm, për t'a kornizuar sa më mirë këtë institut juridik, mund të konkludonim në përkufizime përgjithësuese, si psh: *arbitrazhi ndërkombëtar është një mënyrë konsensuale, apo një mjet, nëpërmjet të cilit mosmarrëveshjet ndërkombëtare mund të zgjidhen përfundimisht, bazuar në marrëveshjen e palëve, nga vendim-marrës të pavarur, jo publikë (jo shtetërorë), të cilët prodhojnë një vendim ligjërish të detyrueshëm dhe forcërisht të zbatueshëm*⁶⁸.

Përsa i përket doktrinës, duhet përmëndur se ekzistojnë disa përkufizime, nga autorë të ndryshëm, për arbitrazhin ndërkombëtar tregtar⁶⁹. Kështu arbitrazhi është përkufizuar si *një metodë kontraktuale e zgjidhjes relativisht private të mosmarrëveshjeve*⁷⁰, apo si *nënshtrim vullnetar nga palët ndaj një lloj gjyqi privat, i cili është pranuar, toleruar dhe sanksionuar nga e drejta ndërkombëtare dhe nga shumica e juridiksioneve të civilizuar*⁷¹. Gjithashtu, përkufizime janë bërë edhe nga jurisprudenca ndërkombëtare, sikurse është ai i Gjykatës Supreme të SHBA, e cila deklaroi se *një marrëveshje për të arbitruar përpara një gjykatë të specifikuar është, në fakt, një lloj i veçantë i klauzolës për zgjedhëse të forumit, klauzolë që parashtron jo vetëm vendin e padisë por edhe procedurën që do të përdoret në zgjidhjen e konfliktit*⁷²..

III.2.2. Veçoritë e natyrës juridike të arbitrazhit ndërkombëtar.

Arbitrazhi tregtar është i ngjashëm si në kontesktin ndërkombëtar, ashtu edhe në atë të brendshëm, por në secilin këndvështrim, arbitrazhi tregtar ka disa karakteristika specifike. *Së pari*, arbitrazhi është një mekanizëm konsensual, pra palët duhet të bien dakort midis tyre, për të arbitruar mosmarrëveshjet midis tyre. *Së dyti*, çështjet në arbitrazh gjykohen dhe zgjidhen nga vendim-marrës jo shtetërorë, ç'ka do të thotë se arbitrat nuk veprojnë si gjykatës shtetëror, apo si agjent qeveritar, por janë persona private të zgjedhur nga vetë palët në mosmarrëveshje. *Së treti*, procesi arbitral siguron një vendim detyrues për palët në

⁶⁸ Gary B. Born, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar, Komentar dhe Materiale (botimi i 2^{të}), bot. Kluwer Law International, 2001. f.1.

⁶⁹ Shiko: Brown H., Marriot A., "Parimet dhe praktika e ADR", 1993, f.56-57 - "*Proçesi me të cilin palët vullnetarisht referojnë mosmarrëveshjet e tyre ndaj një personi të tretë të paanshëm, një arbitri, të përzgjedhur nga ata, për të dhënë një vendim në bazë të provave dhe argumenteve të paraqitura përpara gjykatës së arbitrazhit*"; shiko gjithashtu: de Vries "Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar: Një zëvendësim kontraktual i Gjykatave Nacionale", Tulane L.Rev, 1982, f.42-43 "*Një mënyrë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nga një apo disa persona, pushteti i të cilëve rrjedh nga marrëveshja e palëve dhe vendimi i të cilëve është detyrues për ta*", etj.

⁷⁰ Reisman M., Craig L., Park W., & Paulsson J., "Arbitrazhi ndërkombëtar Tregtar", xxviii, 1997.

⁷¹ Wetter, "Korniza ligjore e tribunaleve ndërkombëtare të arbitrazhit - pesë shenjat në kontratat ndërkombëtare", 1981, f.271-274.

⁷² Shiko çështjen "Scherk kundër Alberto-Culver" 417 US 506.

mosmarrëveshje, i cili ka mundësinë e zbatimit nëpërmjet gjykatave kombëtare (gjykatave shtetërore të shtetit ku kërkohet zbatimi). Pra nuk bëhet fjalë për rekomandime jo me fuqi detyruese, si ato që propozon ndërmjetësi, apo pajtuesi. *Së katërti*, arbitrazhi është një proces relativisht fleksibël, krahasimisht me një proces gjyqësor, në gjykatat nacionale⁷³.

Arbitrazhi nuk është pjesë e sistemit shtetëror të gjykatave. Siç është vënë në dukje tashmë, ai është një procedurë konsensuale e bazuar në marrëveshjen midis palëve. Megjithatë, ai përmbush të njëjtin funksion sikurse përballja gjyqësore në sistemin gjyqësor shtetëror. Rezultati përfundimtar është një vendim, i cili është i ekzekutueshëm nga gjykatat, zakonisht duke ndjekur të njëjtën procedurë ose një procedurë të ngjashme sikurse edhe zbatimi i një vendimi gjyqësor. Rrjedhimisht, shteti ka interes në ecurinë e sistemit të arbitrazhit përtej interesit që ai ka në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas procedurave të tjera që janë alternativa të procesit gjyqësor.

Në shumë vende lidhja e ngushtë në mes të arbitrazhit dhe procesit gjyqësor ilustron nga fakti se kuadri ligjor i arbitrazhit gjendet në Kodin e Procedurës Civile⁷⁴. Megjithatë, trendi aktual është që t'u akordojë palëve dhe forumit të arbitrazhit, autonomi të plotë në zhvillimin e procedurës, me kushtin e vetëm për të respektuar detyrimin e barazisë së palëve në proces⁷⁵. Ndërkohë, gjykatat shtetërore kanë atributin për të siguruar se në arbitrazh është ndjekur procedura e duhur, duke ushtruar autoritetin e tyre për të anuluar një vendim arbitrazhi, apo për të refuzuar njohjen dhe zbatimin e tij⁷⁶.

Duke qënë se tradicionalisht arbitrazhi ndërkombëtar tregtar është zhvilluar midis dy kompanive tregtare, të cilat mund ta zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre nëpërmjet bisedimeve ose mjeteve të tjera private dhe konfidenciale, është pranuar tashmë që, në kuadër të parimit të ruajtjes së besimit midis palëve, natyra private e arbitrazhit çon gjithashtu në *konfidencialitetin* e procesit⁷⁷. Kjo kuptohet në atë që as palët, arbitrat, dëshmitarët, ekspertët apo personeli mbështetës i forumit, nuk duhet të zbulojë asgjë rreth arbitrazhit, përfshirë këtu edhe vetë ekzistencën e tij. Nga parimi i Konfidencialitetit ka një përjashtim, nëse njëherë nga

⁷³ Gary B. Born, *Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar, Komentar dhe Materiale* (botimi i 2^{të}), bot. Kluwer Law International, 2001, f.1.

⁷⁴ Psh. Ligji Gjerman i Arbitrazhit, i bazuar në Ligjin Model dhe në fuqi që nga viti 1998, gjendet në Librin 10 të Kodit të Procedurës Civile. Po kështu ligji Italian, ligji Shqiptar, etj.

⁷⁵ Ligjit Model, neni 18: *Palët do të trajtohen me barazi dhe secilës palë do t'i jepet një mundësi të plotë për të paraqitur çështjen e tij.*

⁷⁶ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5; Ligji Model, nenet 34 – 36.

⁷⁷ Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38), f.7-8.

palët i është dashur të kërkojë ndihmën e një gjykate nacionale në lidhje me vendimin e arbitrazhit, për ta anuluar apo për ta zbatuar forcërisht atë.⁷⁸.

Shumë rregullore arbitrazhi, të tilla si Rregullorja e Arbitrazhit të ICC-së⁷⁹, në mënyrë specifike parashikojnë që çdo vendim arbitrazhi do të jetë detyrues për palët. Në fakt, nuk është e nevojshme për rregulloret që administrojnë arbitrazhin të shprehen në këtë formë. Kjo sepse, një procedurë që nuk të çon në një përcaktim përfundimtar dhe detyrues për të drejtat dhe detyrimet e palëve, nuk është procedurë arbitrazhi. Një çështje e tillë u ngrit në Gjykatën Supreme të Austrisë, e cila deklaroi se: *“Neni 4 i Politikës së WIPO-s⁸⁰, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për Emrin Uniform të Domain-it⁸¹, parashikon se fillimi i procedurave, sipas kësaj Politike, nuk përjashton një palë nga e drejta për paraqitjen e kontestit në një gjykatë shtetërore të juridiksionit kompetent. Duke qenë së procedura e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për Emrin e Domain-it nuk çon në një vendim përfundimtar dhe detyrues, atëherë kjo nuk është një procedurë arbitrazhi dhe shpenzimet e kryera nuk mund të mbulohen nga pala humbëse si “shpenzime procedurale”, sikurse mund të pranohet për kostot e arbitrazhit”⁸². Më i rëndësishëm, në kuadër të kësaj çështje, është parashikimi i nenit 3 të Konventës së Nju Jork-ut, e cila i kërkon shteteve kontraktuese të “njohin” vendimet e arbitrazhit si detyrues dhe t’i “zbatojnë” ato në përputhje me rregullat e shtetit ku zbatohet vendimi.*

Arsyet pse palët zgjedhin arbitrazhin tregtar ndërkombëtar për të zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre mund të jenë⁸³: (a) Arbitrazhi lejon palët të zgjedhin persona me njohuri të specializuara për të gjykuar mosmarrëveshjen e tyre; (b) Arbitrat janë zgjidhur për një mosmarrëveshje të veçantë dhe me zgjidhjen e saj, ata shpërndahen; (c) Arbitrazhi nuk është subjekt që i

⁷⁸ Një shembull i kuptimit të këtij parimi është parashikuar në nenin 30 të Rregullores së Arbitrazhit LCIA (London Court of International Arbitration – Gjykata e Londrës për Arbitrazhin Ndërkombëtar), e cila është miratuar për të hyrë në fuqi nga 1 Janari 1998: *“Përveç rastit kur palët shprehimisht bien dakord me shkrim për të kundërtën, palët marrin përsipër si një parim i përgjithshëm që të mbajnë në kofidencë të gjitha vendimet e arbitrazhit të tyre, së bashku me të gjitha materialet e krijuara për qëllimin e arbitrazhit – me përjashtim të rastit kur kërkohet dhe në atë masë që mund të kërkohet publikimi (zbulimi) nga një palë për shkak të detyrës ligjore, për të mbrojtur ose për të ndjekur një të drejtë ligjore, apo për të zbatuar ose kundërshtuar një vendim arbitrazhi përpara një gjykatë shtetërore ose autoriteti tjetër gjyqësor”.*

⁷⁹ Rregullorja e arbitrazhit të ICC-së, neni 28/6: *“Me dorëzimin në arbitrazh të mosmarrëveshjes, sipas këtyre Rregullave, palët marrin përsipër të zbatojnë çdo vendim pa vonesë ”.*

⁸⁰ WIPO - World Intellectual Property Organization – Organizata Botërore për Pronësinë Intelektuale, e cila administron një Qendër Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në këtë fushë.

⁸¹ Politika e Zgjidhjes së Konfliktëve për emrin e Domain-it (The Uniform Domain-Name Dispute-Resolution Policy (UDRP), është një procedurë për zgjidhjen e konflikteve mbi regjistrimin e emrave të domain-eve (faqeve) të internetit.

⁸² Buletini i Bashkimit Austriak për Arbitrazhin, janar 2005, cituar OGH 16.3.2004, 4 Ob 42/04m (Austria, Gjykata Supreme).

⁸³ Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38), f.14-15

nënshtrohet apelimit për themelin e konfliktit; (d) Vendime më të shpejta dhe kosto më të ulëta, në krahasim me çështjet gjyqësore në gjykatat shtetërore, ka qenë një nga argumentet tradicionale në favor të arbitrazhit. Shumë nga rregulloret e arbitrazhit parashikojnë një procedurë të përshpejtuar për pretendime të vogla (psh., në rastin e Rregullave Zvicerane të Arbitrazhit Ndërkombëtar, ku një procedurë e tillë parashikohet për pretendimet për më pak se 1.000.000 franga)⁸⁴.

Arbitrazhi i brendshëm dhe ai ndërkombëtar janë krijesa të së njëjtës familje, të zhvilluara për të njëjtat avantazhe që paraqesin ndaj gjyqësorit tradicional dhe formave të tjera të ADR. Megjithatë, është mjaft i hershëm mendimi se *arbitrazhi i tregtisë ndërkombëtare* është një instrument i veçantë, që nuk i nënshtrohet rregullimeve kufizuese të sistemeve të së drejtës së brendshme. Kjo për disa arsye si psh: (a) rëndësia e padiskutueshme që paraqesin marrëdhëniet e tregtisë ndërkombëtare për disa vende; (b) përhapja gjithnjë e më shumë e arbitrazhit si mjet për zgjidhjen e konflikteve në marrëdhëniet tregtare ndërkombëtare dhe (c) përsosja e kuadrit ndërkombëtar rregullator, *taksativ-detyrues* apo *fakultativ* në këtë fushë (Konventa, Ligje model, etj)⁸⁵.

Kështu, arbitrazhi ndërkombëtar mund ta anashkalojë të drejtën e brendshme të vendit ku zhvillohet, nëpërmjet aplikimit të së drejtës së një vendi tjetër, aplikimit të konventave ndërkombëtare ose aplikimit të rregullave të përgjithshme të tregtisë ndërkombëtare të njohura si *lex mercatoria*⁸⁶. Për më tepër, dinamika e zhvillimit të këtij instrumenti ka arritur t'u ofroje palëve në konflikt, mundësi edhe përtej kufizimeve të një sistemi të caktuar të së drejtës. Përmendim, për shembull, procedurën e marrjes së provave, e cila në varësi të sistemit (të drejtës civile apo common law) është shumë e ndryshme. Për të evituar vështirësi

⁸⁴ Rregullat Zvicerane, neni 42: Procedura e përshpejtuar parashikon një periudhë kohe të shkurtuar, një tribunal me një arbitër dhe jo më shumë se një seance për shqyrtimin e dëshmive dhe argumentave verbalë të palëve.

⁸⁵ Jean-Francois Poudret, Sebastien Besson, "E drejta e krahasuar e arbitrazhit ndërkombëtar", bot.2^{-të}: autorët citojnë raste të shumta të *Court de Cassation*, të cilat që prej vitit 1930 kanë theksuar vecantinë e "...*interesave të tregtisë ndërkombëtare*". Ky qëndrim i gjykatave Franceze ka ardhur në përgjigje të mosmarrëveshjeve që rridhnin nga kufizime që legjislacioni i brendshëm francez vendoste për arbitrueshmërinë e çështjeve apo aftësinë e subjekteve juridike shtetërore për t'i zgjidhur me anë të arbitrazhit mosmarrëveshjet në të cilat ishin palë. Gjykatat kanë mbështetur për dekada me rradhë qëndrimin se për sa kohe objekti i kontratës kishte të bënte me tregtinë ndërkombëtare, kufizimet e të drejtës së brendshme nuk mund të gjenin zbatim.

⁸⁶ Termi *lex mercatoria* nuk i referohet një sistemi konkret me korniza të mirëpërcaktuara. Ai është një term gjeneralist që përdoret më së shumti në sferën e tregtisë ndërkombëtare, por jo vetëm, për të treguar ligjet dhe zakonet e aplikueshme në një treg të caktuar, qofshin këto ligje të detyrueshme – si për shembull konventa ndërkombëtare – apo rregulla fakultative – si për shembull ligjet model, apo zakone të një tregu të caktuar.

të tilla, institucione arbitrazhi ndërkombëtar kanë hartuar rregullat e tyre të marrjes së provave të cilat ndërthurin të dy sistemet⁸⁷.

Në lidhje me karakterin *ndërkombëtar*, doktrina e së drejtës ndërkombëtare private thekson se arbitrazhi do të jetë i tillë (pra do të jetë “ndërkombëtar”) për shkak të zotësisë së palëve për të vendosur apo për të zhvilluar një autonomi complete, në krahasim me rendin juridik nacional të vendeve të tjera⁸⁸. Baza juridike e një konceptimi të tillë të problemit është gjetur në autonominë e gjerë, të njohur, të vullnetit të palëve, në rregullimin e marrëdhënieve të tregtisë ndërkombëtare, siç është pohuar nga disa ligje nacionale dhe konventa ndërkombëtare⁸⁹. Kësisoj, koncepti i “denacionalizimit” të arbitrazhit ndërkombëtar duhet kuptuar jo si një shkoputje përfundimtare nga çdo juridiksion nacional⁹⁰, por si një aplikim i natyrshëm, jo i detyrueshëm, por i vullnetshëm i rendeve juridike kombëtare, për rregullimin e procedurës arbitrale dhe zgjidhjen në themel të konfliktit, duke i lënë fushë sa më të madhe shprehjes së autonomisë së vullnetit të palëve⁹¹.

III.2.3. Epërsitë e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar dhe kuadri i tij ligjor.

Epërsitë e arbitrazhit ndërkombëtar mund të permbliohen shkurtimisht në tre aspektet e mëposhtme:

(i) Arbitrazhi ndërkombëtar është ndërtuar dhe pranuar, me qëllimin për t’i siguruar palëve, të cilëve u përkasin juridiksioneve të ndryshme, që mosmarrëveshja e tyre do të trajtohet dhe zgjidhet në mënyrë neutrale. Palët zakonisht kërkojnë një vendim-marrës, që të mos jetë i lidhur me asnjë prej rendeve juridike nacionale në konflikt, si dhe të mos ketë ndikime kulturore të asnjë pale. Për zgjidhjen e konfliktit, ata preferojnë aplikimin nga arbitrat të rregullave procedurale ndërkombëtare neutrale⁹²;

⁸⁷ Përmendim për ilustrim Rregullat mbi Marrjen e Provave në Arbitrazhin Ndërkombëtar të përpunuara nga International Bar Association (IBA), të cilat kanë ndërthurur elementë të të dy sistemeve http://www.ibanet.org/Publications/publications_IBA_guides_and_free_materials.aspx.

⁸⁸ Kalia Ardjan, “E drejta ndërkombëtare private”, bot.FLESH, 2010, f.331-332

⁸⁹ Kështu psh., Konventa e Gjenevës e viti 1961 “Konventa Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar”, në nënin 4 “Organizimi i arbitrazhit” dhe nënin 7 “Ligji i zbatueshëm”, parashikon se liria e palëve kontraktuese për të përcaktuar rregullat e procedurës së arbitrazhit dhe ligjin e themelit të konfliktit, është e pavarur nga ligjet nacionale të çfarëdoqësi.

⁹⁰ Juridiksionet nacionale kanë një rëndësi themelore për arbitrazhin, sepse rregullojnë: aftësinë e palëve, për të lidhur një marrëveshje arbitrazhi; objektin e mosmarrëveshjeve, që mund të zgjidhen me arbitrazh; kriteret e formës së marrëveshjes së arbitrazhit; kushtet ligjore për përjashtimin/zëvendësimin e arbitrave; kushtet ligjore, kur një gjykatë nacionale ndërhyt si mbështetëse në procesin e arbitrazhit; kushtet ligjore për t’u ankuar ndaj vendimit të arbitrazhit; kushtet ligjore për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar (shiko Konventën e Nju Jork-ut, neni 2,3,5; Konventën e Gjenevës, neni 9; Ligjin model, etj).

⁹¹ Kalia Ardjan, “E drejta ndërkombëtare private”, bot.FLESH, 2010, f.333.

⁹² Mazza Francesca, “Rregullorja e re e arbitrazhit”, De Jure, 2012, A.Giuffrè Editore S.p.A, f.3.

(ii) Arbitrazhi ndërkombëtar, konsiderohet përgjithësisht si një mjet që zbut paqartësitë, që shoqërojnë një mosmarrëveshje transnacionale, siç mund të jenë mosmarrëveshjet e juridiksionit, procedimet paralele të kushtueshme dhe debatet e zgjedhjes së ligjit të aplikueshem. Arbitrazhi ndërkombëtar tenton të shmangë këto paqartësi duke ngritur një mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të vetëm dhe ekskluziv;

(iii) Vendimet e arbitrazhit ndërkombëtar janë shpesh më lehtësisht të zbatueshëm në juridiksione të ndryshme nga shteti i tyre i origjinës, sesa vendimet e gjykatave shtetërore të zakonshme. Kështu, psh. Konventa e Brukselit⁹³, apo akte të tjera ndërkombëtare, që rregullojnë zbatimin e vendimeve gjyqësore për çështjet tregtare në shtetet e huaja⁹⁴, nuk i shtrijnë efektet e tyre në SHBA dhe në vendet jashtë Bashkimit Evropian.

Pavarësisht se, sikurse thamë më sipër, arbitrazhi është një mjet konsensual i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ai ka efekt detyrues mbi palët, si pasojë e një kuadri normativ kompleks, kombëtar dhe ndërkombëtar. Kështu një sërë konventash ndërkombëtare, legjislacionesh të brendshme dhe rregulloresh të arbitrazheve institucionale, sigurojnë një regjim ligjor të posaçëm për arbitrazhin ndërkombëtar⁹⁵. Vitet e fundit vihet re një frymë e re e orientuar drejt harmonizimit të legjislacionit nacional në fushën e arbitrazhit ndërkombëtar, nëpërmjet hartimit të akteve model⁹⁶.

Në këtë kuptim arbitrazhi ndërkombëtar tregtar ka marrë një karakter të vërtetë transnacional, pasi tashmë kemi të bëjmë me një mekanizëm që nuk është krijesë e një legjislacioni të vetëm kombëtar. Kështu, palët përgjithësisht kanë kombësi të ndryshme, arbitrat mund të kenë kombësi të ndryshme nga palët, ligji i aplikueshem mund të vendoset nga sisteme të ndryshme ligjore, ndërsa vendimi i arbitrazhit është i zbatueshëm pothuajse në mbarë botën, falë Konventës së Nju Jork-ut. Për më tepër, objekti i mosmarrëveshjeve në arbitrazh po bëhet gjithnjë e më shumë ndërkombëtar, ndërsa forumi i arbitrazhit nuk është më i lidhur me

⁹³ Konventa e Brukselit “Për juridiksionin dhe për zbatimin e Vendimeve gjyqësore për çështjet civile dhe tregtare”, e vitit 1968, e cila është zëvendësuar për të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së, me përjashtim të Danimarkës, me Rregulloren e Këshillit (KE) nr.44/2001, e 22 dhjetorit 2000, “Për juridiksionin dhe njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare” (Gazeta Zyrtare 12, 16.01.2001).

⁹⁴ Konventa e Luganos “Për juridiksionin dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare”, 16 shtator 1988; Rezoluta e Këshillit të Bashkimit Evropian “Për juridiksionin dhe Njohjen dhe Zbatimin e vendimeve gjyqësore për çështje civile dhe tregtare” (e ashtuquajtura Bruksel I). Kjo Rezolutë, sikundër edhe Konventa e mëparshme e Brukselit apo Konventa e Luganos e përjashtojnë arbitrazhin nga sfera e tyre e veprimit.

⁹⁵ Përmendim: Konventa e Nju Jork-ut, e ratifikuar sot nga rreth 150 shtete, e cila i angazhon këta të fundit të njohin dhe të zbatojnë marrëveshjen e arbitrazhit dhe vendimin arbitral; Konventa Inter-amerikane “Për arbitrazhin ndërkombëtar tregtar”, 1975; Konventa “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e Invenstiveve”, 1965; Konventa Europiane “Për arbitrazhin ndërkombëtar tregtar”, etj.

⁹⁶ Psh. ligji model UNCITRAL për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar, 1985, amenduar në 2006.

një sovranitet të caktuar. Pavarësisht diferencave në shtete të ndryshme, përsëri niveli i uniformitetit është i tillë që justifikon përfaqshjen transnacionale të institutit të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar⁹⁷. Bazuar në këtë kuadër rregullator të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar, konstatohen 4 momente kryesore të jetës së një procesi arbitrazhi:

(a) *Marrëveshja për arbitrazh*⁹⁸ - arbitrazhi ndërkombëtar tregtar është themeluar mbi konsensusin e palëve për të zgjidhur mosmarrëveshjen e tyre. Pa një marrëveshje arbitrazhi, një vendim arbitrazhi nuk mund të zbatohet në kuptim të Konventës së Nju Jork-ut⁹⁹. Ndërsa, ligji model parashikon se, në rast të një çështje, subjekt i marrëveshjes arbitrale, sillet në një gjykatë shtetërore, kjo e fundit i referon palët në arbitrazh vetëm nëq marrëveshja është nul dhe e pavlefshme, jo e zbatueshme apo e pamundur për tu zbatuar¹⁰⁰. Kësisoj, marrëveshja e arbitrazhit është premisë për përjashtimin e juridiksionit të gjykatës shtetërore, me përjashtim të rastit kur ajo ka mangësi apo parregullsi, që e bëjnë atë të paafte për t'u zbatuar.

(b) *Zgjedhja e arbitrave* - palët kanë të drejtën të zgjedhin arbitrat e tyre, të cilët mund të jenë ekspertë të arbitrazhit ndërkombëtar ose persona me eksperiencën e duhur tregtare, apo industriale, për çështjen objekt të mosmarrëveshjes¹⁰¹;

(c) *Vendimarrja e tribunalit të arbitrazhit* - vendimarrja e arbitrave ka formën e një vendimi, i cili është final dhe detyrues. Krahasuar me një vendim gjyqësor, vendimet e arbitrazhit, përgjithësisht, mund t'i nënshtrohen apelimit vetëm për arsye të përcaktuara qartë dhe në mënyrë shteruese¹⁰²;

(d) *Zbatimi i vendimit të arbitrazhit* - vendimet e arbitrazhit janë të zbatueshëm njëlloj si vendimet e gjykatës. Konventa e Nju Jork-ut, garanton njohjen dhe zbatimin forcërisht të vendimit, nëpërmjet një autorizimi të dhënë nga një gjykatë e shtetit, ku pala humbëse ka selinë, apo asetet e saj. Kjo e bën arbitrazhin tregtar ndërkombëtar atraktiv ndaj komunitetit

⁹⁷ Tibor Varady, John J. Barcelo; Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Një prespektivë Trans-nacionale (Seria Amerikane e Përmbledhjeve të Çështjeve (Casebook Series), bot.4^{-tërt}, hyrje.

⁹⁸ Neni 1 i Konventës Europiane të Arbitrazhit dhe neni 2/2 i Konventës së Nju Jorkut, parashikojnë se dy janë format klasike të marrëveshjes për arbitrazh. E para është “klauzola e arbitrazhit” (*clause compromissoire*), e cila i referon mosmarrëveshjet e ardhshme për t'u zgjidhur me arbitrazh. Tjetra është “marrëveshja për t'u nënshtroar arbitrazhit” (*submission agreement - acte de compromis*), e cila zakonisht hartohet pas lindjes së mosmarrëveshjes dhe palët nëpërmjet saj bien dakort të dërgojnë në arbitrazh një mosmarrëveshje që tashmë ka lindur.

⁹⁹ Konventa e Nju Jork-ut, neni 4(1): “Për të siguruar njohjen dhe ekzekutimin e vendimit ..., pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin duhet të paraqesë, në të njëjtën kohë me kërkesën sa vijon: (a) origjinalin e vendimit, ...; (b) origjinalin e marrëveshjes së arbitrazhit

¹⁰⁰ Neni 8 i ligjit model UNICITRAL.

¹⁰¹ Neni 10/1 i Ligjit model UNCITRAL.

¹⁰² Shiko nenin 9/1 të Konventës Europiane të Arbitrazhit (1961).

ndërkombëtar të biznesit¹⁰³.

III.3. Teoritë bashkohore mbi arbitrazhin ndërkombëtar tregtar dhe zbatimin e vendimeve të këtij arbitrazhi.

Për teorinë ligjore të arbitrazhit ndërkombëtar, duhet t'i referohemi Berthold Goldman-it dhe diskutimit të tij në Akademinë e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare, në vitin 1963, mbi konfliktin e ligjeve në arbitrazhin ndërkombëtar, i cili çoi në rinovimin e vizionit mbi këtë teori. Këndvështrimi i deri asaj kohe paraqitej në Rezolutën e Amsterdimit, të adaptuar në vitin 1957, nga Instituti i të Drejtës Ndërkombëtare, e cila sugjeronte se arbitrat duhet të aplikonin rregullat e konfliktit të vendit të arbitrazhit si *lex fori*¹⁰⁴. Duke thyer këtë opinion dominant deri në atë kohe, ai propozoi idenë e fuqishme se “arbitrat nuk kanë një forum” dhe nëse dikush do t'i atribuonte arbitrave një të tillë, ky forum do të ishte “e gjithë bota”. Në aspektin e teorisë juridike, kjo nënkuptonte marrëdhëniet midis arbitrazhit ndërkombëtar dhe rregullimeve ligjore kombëtare. Në zemër të kësaj fushe studimi, qëndrojnë pikërisht nocionet fundamentale filozofike të autonomisë dhe lirisë, nga ku buron edhe parimi i “lirisë kontraktore të palëve”¹⁰⁵.

Janë pikërisht këto nocione që esencialisht i japin përgjigje pyetjeve në lidhje me legjitimitetin e lirisë së palëve për t'iu drejtuar një forme private të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, autonome nga gjykatat nacionale, për të caktuar arbitrat e tyre, për të caktuar procedurën që ata e vleresojnë si të duhurën, për të caktuar rregullat që do të rregullojnë mosmarrëveshjen edhe kur ato rregulla nuk janë ato të përcaktuara nga një sistem i dhënë ligjor¹⁰⁶. Sikurse thamë më lart, thelbi i suksesit të arbitrazhit ndërkombëtar qëndron në faktin se, palët më shumë preferojnë t'ia nënshtrojnë konfliktin një forumi që nuk është pjesë e ndonjë strukture qeveritare të ndonjë shteti të veçantë, për të shmangur kështu të ashtuquajturën “favorizim kombëtar” të palës në proces.

¹⁰³ Neni 35/1 i Ligjit model UNCITRAL - Një vendim arbitrazhi, pavarësisht nga vendi në të cilin është marrë, duhet të njihet si i detyrueshëm dhe, nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar gjykatës kompetente, duhet të detyrojë forcërisht subjektet përkatëse, të detyruar sipas vetë vendimit.

¹⁰⁴ Instituti i të Drejtës Ndërkombëtare Private, Vjetari 1952, vol.44, pjesa I, faqe 469, par.571.

¹⁰⁵ Mariana Tutulani-Semini; E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Pjesa e Përgjithshme; Skanderbeg books, 2006, f.40: “...Që në shekullim XIX ka lindur për herë të parë e ashtuquajtura teoria e autonomisë së vullnetit, sipas të cilës vullneti kontraktor është kushti themelor i ekzistencës së kontratës....Kjo teori e trajton pikëpamjen e mësipërme në tri drejtime kryesore: Drejtimi filozofik, që mbështetet tek pikëpamja e Rusoit, sipas të cilit njeriu është një qenie e lirë nga natyra dhe si i tillë duhet të jetë i lirë të lidhë çdo marrëdhënie juridike...”.

¹⁰⁶ Emmanuel Gaillard, Teoria Ligjore e Arbitrazhit Ndërkombëtar, Leiden - Boston 2010.

Është vërejtur se interpretime të ndryshme janë dhënë nga gjykatat kombëtare mbi aspekte të ndryshme të arbitrazhit. Një gjë e tillë ka si shpjegim edhe faktin se gjykatat kombëtare të ndryshme orientohen nga teori të ndryshme në lidhje me arbitrazhin ndërkombëtar tregtar¹⁰⁷. Kështu psh. gjykatat Franceze dhe Amerikane i mëshojnë më shumë elementeve të teorisë kontraktuale, duke zbatuar kështu disa vendime arbitrazhi, të cilat janë anuluar në shtetin e origjinës, ndërkohë që gjykatat angleze ende mbështesin kryesisht natyrën juridiksionale të arbitrazhit ndërkombëtar¹⁰⁸. Komentimet e ndryshme mbi natyrën juridike të arbitrazhit janë përmbledhur në katër teori të ndryshme: (i) teoria *juridiksionale*, (ii) teoria *kontraktuale*, (iii) teoria *hibride* dhe (iv) teoria *autonome*¹⁰⁹.

Këto katër teori dallojnë kryesisht për shkak të disa kriterëve, që kanë të bëjnë me këndvështrimin mbi disa momente shumë të rëndësishme të procesit të arbitrazhit. *Së pari*, duke u nisur nga natyra e arbitrazhit tregtar ndërkombëtar, çdo teori jep një definicion përsa i përket mekanizmit të arbitrazhit tregtar ndërkombëtar dhe llojit të marrëdhënies që duhet të ekzistojë midis arbitrazhit ndërkombëtar dhe gjykatave nacionale, apo e thënë ndryshe nga niveli i ndërhyrjes së gjykatave nacionale në arbitrazhin ndërkombëtar tregtar¹¹⁰. *Së dyti*, duke u nisur nga natyra dhe qëllimi i pushtetit të arbitrit, në këndvështrimin e marrëdhënies midis palëve dhe arbitrit. *Së treti*, teoritë ndryshojnë përsa i përket statusit të vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar, duke patur parasysh konfliktet që krijohen në fazën e zbatimit të tij.

Debati sot në arbitrazhin ndërkombëtar tregtar, fokusohet në atë se deri në çfarë shkalle duhet të lejohet ndërhyrja e gjykatave shtetërore në procesin e arbitrazhit. Ndërkohë që argumentohet se arbitrazhi duhet të jetë “i lirë” nga gjykatat, me qëllim për të qënë eficient, pranohet gjithashtu se ai ka nevojë për ndihmën e gjykatave shtetërore, me qëllim që të jetë efektiv¹¹¹ duke iu referuar, në këtë pikë, njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit nga gjykatat shtetërore.

¹⁰⁷ Hong-lin Yu, “Një vështrim teorik mbi themelet e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar”, Revista Bashkëkohore e Arbitrazhit Aziatik 1(2), 2008, f.257.

¹⁰⁸ Shiko çështjen: “Channel Tunnel Group Ltd. kundër Balfour Beatty Construction Ltd.”; HL, 17.02.1993, ku gjykata u shpreh se: “.....Gjykata ka fuqinë për të dhënë në masë të përkohëshme, bazuar në një shkak shumë të bazuar (psh. dhunimi i të drejtave thelbësore) të njohur nga ligji anglez, kundër një të pandehuri të shërbyer (të njoftuar) në mënyrë të rregullt, kur një masë e tillë është ndihmëse ndaj një vendimi përfundimtar pavarësisht nëse ky i fundit do të jepet nga gjykata angleze ose nga ndonjë gjykatë ose organ tjetër arbitral”.

¹⁰⁹ *Id.*, shiko gjithashtu: Angualia Daniel “Roli i gjykatave nacionale në Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar”, 2010, f.9. (<http://www.ssrn.com/abstract=1674760>).

¹¹⁰ Angualia Daniel, “Roli i gjykatave nacionale në Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar”, 2010, f.9-14.

¹¹¹ Redfern, A., Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar: Juridiksion i mohuar: Rënia e Piramidës, (1986) JBL, f.15.

Niveli i ndërhyrjes dhe mbikqyrjes së procesit të arbitrazhit nga gjykatat shtetërore, varet shumë nga natyra e arbitrazhit. Sipas Bernard¹¹² ekzistojnë tre teori që shpjegojnë nivelin e kësaj ndërhyrjeje. Sipas *teorisë së parë*, marrëveshja e arbitrazhit dhe vendimi i arbitrazhit janë dy gjëra të ndryshme dhe i dyti (vendimi i arbitrazhit) është i ngjashëm me vendimin e një gjykate shtetërore. Sipas *teorisë së dyte*, vendimi i arbitrazhit është rrjedhojë e marrëveshjes së arbitrazhit, kështu që marrëveshja dhe vendimi janë të pandarë nga njëri-tjetri. Për rrjedhojë vendimi i arbitrazhit është në thelb një kontratë, më shumë sesa një vendim gjyqësor. *Teoria e tretë* është një kompromis midis dy të parave dhe pretendon që një vendim arbitrazhi është i lidhur me marrëveshjen e arbitrazhit, duke qënë në fakt produkt i saj, por njëkohësisht konsiderohet i ngjashëm me një vendim gjyqësor në kushtet kur nevojitet një urdhër i gjykatës shtetërore për zbatimin e tij¹¹³. Keto tre teori tashmë njihen me emrat: teoria juridiksionale, kontraktuale dhe hibride, apo mikse¹¹⁴.

III.3.1. Teoria Juridiksionale.

Kjo teori sugjeron që arbitrazhi operon brenda një kornize ligjore dhe një shtet ka autoritetin e plotë të kontrollojë dhe rregullojë të gjithë arbitrazhet që zhvillohen në juridiksionin e tij. Ndërkohë që kjo teori e pranon faktin se vendimi i arbitrazhit vërtet bazohet në marrëveshjen midis palëve për arbitrazh, ajo insiston se çështje të tilla si: vlefshmëria e marrëveshjes dhe vendimit të arbitrazhit, pushteti i arbitrave dhe zbatueshmëria e vendimeve të arbitrazhit, varen nga ligji i vendit të arbitrazhit dhe nga ligji i vendit të zbatimit të vendimit të arbitrazhit¹¹⁵. Një marrëveshje arbitrazhi do të jetë e vlefshme dhe një vendim arbitrazhi do të zbatohet vetëm nëse të dy ligjet (ligji i vendit të arbitrazhit dhe ligji i vendit të zbatimit të vendimit) e njohin dhe pranojnë faktin që palët kanë të drejtë të referojnë çështjen në arbitrazh, që arbitrat kanë juridiksionin mbi çështjen në fjalë dhe që vendimi i arbitrazhit është i zbatueshëm¹¹⁶.

Ligji lejon palët t'i drejtohen arbitrazhit, sepse ai do që arbitrazhi të ushtrojë një funksion të ngjashëm me atë të gjykatës shtetërore. Dallimi i vetëm midis arbitrave dhe gjyqtarëve, siç

¹¹² Lew, Julian D.M., *Ligji i Aplikueshëm në Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar*, Nju Jork (Oceana Publications, Inc.), 1978, f.51-52.

¹¹³ *Id.*

¹¹⁴ Hong-lin Yu, "Ndarja e plotë e Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar dhe regjimit të gjykatave nacionale", *Revista e Arbitrazhit Ndërkombëtar (J.Int.Arb.)*, 5(2) 1988, f.148; Georgios I. ZEKOS, "Probleme të ligjit të aplikueshëm në arbitrazhin tregtar dhe detar", *J.Int.Arb.* 16(4) 1999, f.177; Gunther J. Horvath, "Detyra e tribunalit të nxjerrë një vendim të zbatueshëm", *J.Int.Arb.* 18(2) 2001, f.147-148.

¹¹⁵ Angualia Daniel, "Roli i gjykatave nacionale në Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar", 2010, f.10.

¹¹⁶ Han Jian, "Teori dhe praktikë mbi të drejtën ndërkombëtare tregtare modern", Pekin, Law Press, 2000, 35.

ilustrohet nga Niboyet¹¹⁷, është se për një gjyqtar, autoriteti dhe emërimi rrjedh direkt nga sovrani, ndërsa, për një arbitër, autoriteti buron nga sovrani, ndërsa emërimi i tij është një çështje e palëve¹¹⁸. Meqënëse fuqia dhe funksionet e arbitrave dhe gjyqtarëve janë të njëjta, apo të paktën jashtëzakonisht të ngjashme, atëherë mund të themi se vendimet e arbitrazhit duhet të konsiderohen si një lloj vendimi gjykate dhe duhet të kenë të njëjtin efekt¹¹⁹.

Kjo teori thekson rëndësinë që ka mbikqyrja e shtetit mbi arbitrazhin, limiton autonominë e arbitrave dhe legjitimon pushtetin e ligjit të brendshëm, i cili kërkon që vendimi i arbitrazhit të jetë konsistent me ligjin e vendit të zbatimit të vendimit. Propoganduesit e teorisë juridiksionale, për shembull Dr.Mann, theksojnë në veçanti rëndësinë e ligjeve të shteteve relevante në arbitrazh, veçanërisht të ligjit të shtetit të vendit ku mbahet arbitrazhi (lex fori)¹²⁰. Premisa e argumentit të Dr.Mann është se çdo shtet sovran ka të drejtë të miratojë apo refuzojë çdo aktivitet ligjor procedurial të kryer brenda territorit të tij. Rrjedhojë e kësaj premise është fakti se çdo arbitrazh është subjekt i ligjit ku ai zhvillohet (Lex facit arbitrum). Çdo akt i arbitrave që kundërshton *normat e aplikimit të nevojshëm dhe politikën publike* të vendit të arbitrazhit është konsideruar si juridikisht i pajustificuar¹²¹.

Me fjalë të tjera, çështje të ndryshme që ngrihen në kuadër të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar, të tilla si: vlefshmëria e marrëveshjes së arbitrazhit, procedurat e arbitrazhit, pushteti i arbitrit dhe zbatueshmëria e vendimit të arbitrazhit duhet të vendosen brenda rregullave dhe politikave publike të lex fori-t. Nëse nuk ndodh kështu, atëherë vendimet e arbitrazhit mund të hidhen poshtë nga gjykata e vendit të arbitrazhit dhe për më tepër, njohja ose zbatimi i vendimeve mund të refuzohet nga gjykatat e shteteve ku kërkohet zbatimi. Teoria juridiksionale justifikon në këtë mënyrë një lidhje të fortë midis arbitrazhit dhe gjykatave nacionale, si dhe mundësinë që këto të fundit të mbikqyrin arbitrazhin, ç'ka në fakt konfirmohet edhe nga dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut¹²².

¹¹⁷ J.P.Niboyet, "Traktati i së Drejtës Ndërkombëtare Private Franceze", (1950).

¹¹⁸ Julian D.M.Lew, "Ligji i aplikueshëm në arbitrazhin ndërkombëtar tregtar: Një studim mbi vendimet e arbitrazhit tregtar", (1978), f.53.

¹¹⁹ Hong-lin Yu, "Ndarja e plotë e Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar dhe regjimit të gjykatave nacionale", Revista e Arbitrazhit Ndërkombëtar, 5(2) 1988, f.258.

¹²⁰ Shiko Francis A.Mann, Lex Facit Arbitrum (ligji bën arbitrazhin), 2(3) Arb.Int'l. 245 (1983); Mann dhe përkrahësit e tij mbrojnë opinionin se arbitrazhi ekziston vetëm nëse vendi i arbitrazhit e lejon atë.

¹²¹ Neni 5/2 i Konventës së Nju Jorkut: "Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi arbitrazhi mund të refuzohen gjithashtu në qoftë se autoriteti kompetent i vendit, ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi, konstaton se: (a) objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi, sipas ligjit të këtij vendi, ose (b) njohja ose ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me rendin publik të këtij vendi".

¹²² Konventa e Nju Jork-ut, neni 5/1(a),(e),(d), parashikon të drejtën e gjykatës nacionale të mbikqyrë nëse, në mungesë të zgjedhjes së shprehur të ligjit nga palët, vlefshmëria e marrëveshjes së arbitrazhit dhe vendimit të

III.3.2. Teoria Kontraktuale.

Duke refuzuar rëndësinë e *lex fori-t*, ithtarët e teorisë kontraktuale argumentojnë se arbitrazhi bazohet në marrëveshjen midis palëve. Ata mohojnë ekzistencën e çdo lidhje të fortë midis procedurave të arbitrazhit dhe ligjit të vendit në të cilin ai zhvillohet. Palët kanë lirinë për të vendosur çështjet relevante lidhur me procedurat e arbitrazhit dhe të kjo liri, në përgjithësi, shtetet nuk duhet të ndërhyjnë. *Qëllimi i shprehur i të dy palëve për të hyrë në marrëveshjen e arbitrazhit është ekzistenca thelbësore e këtij procesi* [Martin Domke, “Arbitrazhi Tregtar” 1965]. Këta përfaqësues besojnë se forca detyruese e marrëveshjes së arbitrazhit vjen nga parimi “*pacta sunt servanda*” (marrëveshja duhet të zbatohet), parim i cili vlen edhe për kontratat tjera të zakonshme, pa patur nevojë për ndonjë autorizim shtetëror¹²³.

Teoria kontraktuale, ndryshe nga teoria juridiksionale, e hulumton natyrën e arbitrazhit nga një këndvështrim kontraktual. Sipas saj, tre janë arsyt kryesore pse esenca e arbitrazhit është kontraktuale: *Së pari*, arbitrazhi ngrihet mbi marrëveshjen e palëve. Atje ku nuk ka marrëveshje, asnjëra prej palëve nuk mund të detyrojë palën tjetër për të referuar konfliktin e tyre në arbitrazh¹²⁴. *Së dyti*, të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me arbitrazhin (çaktimi i arbitrave, kohës dhe vendit të arbitrazhit, etj.) mund të vendosen nga marrëveshja e palëve. Madje, palët mund të bien dakort edhe për procedurën e arbitrazhit, ndërkohë që rregullat e ligjit të brendshëm veprojnë në situatën kur palët nuk janë marrë vesh për një çështje të tillë¹²⁵. *Së treti*, arsyeja pse një vendim arbitrazhi njihet dhe zbatohet është pikërisht për shkak të forcës detyruese të marrëveshjes së arbitrazhit. Çdo palë ka detyrimin të zbatojë vendimin e arbitrazhit, në të kundërt pala tjetër mund të kerkojë në gjykatën shtetërore zbatimin e këtij vendimi, nëpërmjet forcës shtrënguese të shtetit¹²⁶.

arbitrazhit, përbërja e autoritetit të arbitrazhit dhe procedurat e arbitrazhit, janë apo jo, në përputhje me ligjin e vendit ku është zhvilluar arbitrazhi.

¹²³ Kitagawa, *Autonomia Kontraktore në Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar*, bot. Pieter Sanders, 1967, f.133, 138.

¹²⁴ Neni 1 i Konventës Europiane të Arbitrazhit: “*Kjo Konventë zbatohet: a) për marrëveshjet e përfunduara të arbitrazhit që kanë për qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga tregtia ndërkombëtare ndërmjet personave fizikë ose juridikë, të cilët në çastin e përfundimit të marrëveshjes e kanë selinë e tyre të zakonshme ose qendrën e tyre në shtetet kontraktuese të ndryshme; b) për procedurat dhe vendimet e arbitrazhit, që bazohen në marrëveshjet e parashikuara në paragrafin 1/a më sipër*”. Neni 403 i KPrC “Marrëveshja për arbitrazh”: “*Mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm në qoftë se ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë t’ia nënshtrijnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre*”.

¹²⁵ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(1)(d), parashikon si shkak refuzues kur procedura e arbitrazhit nuk ka qënë në përputhje me marrëveshjen e palëve, ose kur mungon një marrëveshje e tillë, nuk ka qënë në përputhje me ligjin e vendit ku është zhvilluar arbitrazhi.

¹²⁶ Domke Martin, “Arbitrazhi tregtar”, Englewood Cliffs: N. J. Prentice-Hall, 1965, f.2.

Në shumicën e juridiksioneve, mekanizmi i arbitrazhit ndërkombëtar tregtar është projektuar në mënyrë të pamohueshme në bazë të teorisë kontraktuale. Duke njohur dëshirat e njerëzve të biznesit që të disponojnë një metodë më fleksibël dhe më informale të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, shumica e gjykatave kanë tendencë për të ndjekur teorinë kontraktuale, madje dhe për të interpretuar marrëdhëniet midis palëve dhe arbitrave si një kontratë. Për shembull në Angli, në çështjen “*Cereals S.A. kundër Tradax Export S.A.*”¹²⁷, gjykata deklaroi se, para së gjithash, ekzistonte një marrëdhënie kontraktuale midis palëve dhe arbitrave dhe këta të fundit bëhen palë në marrëveshjen e arbitrazhit në momentin që ata pranojnë detyrën e caktuar nga palët¹²⁸. Një ide e ngjashme u mbështet nga gjykata edhe në një çështje tjetër gjyqësore¹²⁹, në lidhje me shpërblimin e arbitrave, ku gjykata u shpreh se arbitrat kanë të drejtë për një shpërblim të arsyeshëm, e drejtë kjo që buron nga një kontratë “tre-palëshe”, e lidhur ndërmjet dy palëve të marrëveshjes së arbitrazhit dhe arbitrave¹³⁰. Pra, sipas teorisë kontraktuale, marrëdhënia midis palëve dhe arbitrave mund të portretizohet si një kontratë, ku palët kanë detyrimin për t’i paguar arbitrat për shërbimin e tyre, i cili nuk është gjë tjetër veçse marrja e një vendimi final. Në këtë mënyrë arbitrat konsiderohen si *agjentë* të palëve, duke vepruar për llogari të tyre në shqyrtimin e çështjes dhe marrjen e vendimit të arbitrazhit¹³¹.

Bazuar në “teorinë e agjentit”, mbështetet ideja¹³² se vendimi i arbitrazhit është një kontratë. Kështu vendimet e arbitrazhit janë konsideruar si kontrata të bëra nga arbitrat që veprojnë si agjentë të palëve. Si rezultat i kësaj marrëdhënie midis palës (porositësit) dhe agjentit, kontrata e bërë nga agjentët, që është vendimi i arbitrazhit, ka një efekt detyrues mbi porositësit pra mbi palët¹³³. Palët duhet të pranojnë vendimin e arbitrazhit pasi ka fuqi të detyrueshme kontraktuale dhe duhet që vullnetarisht ta zbatojnë atë. Pikërisht për shkak të natyrës së tij kontraktuale, një vendim arbitrazhi duhet të zbatohet kudo në botë¹³⁴. Ky

¹²⁷ *Compagnie Europeene de Cereals SA versus Tradax Export SA* [1986] 2 Lloyd’s Rep. 301 (U.K.).

¹²⁸ Po aty, gjykata shprehet se: *Është marrëveshja e arbitrazhit ku arbitrat bëhen palë pas miratimit të emërimit të tyre. Të gjitha palët në arbitrazh janë të detyruara nga termit e kontratës së arbitrazhit.*

¹²⁹ Çështja “*K/S Norjarl A/S kundër Hyundai Heavy Industries Co. Ltd.*” [1991] 3 All ER 211 (CA) (U.K.)

¹³⁰ *Id.* gjykata shprehet se “*Kushtet e kësaj kontrate tre-palëshe kërkojnë që arbitrat “të kryejnë arbitrimin me përkushtimin e duhur dhe kundrejt një tarife të arsyeshme”.*

¹³¹ Hong-lin Yu, “Një vështrim teorik mbi themelet e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar”, *Revista Bashkëkohore e Arbitrazhit Aziatik* 1(2), 2008, f.267-268.

¹³² Propoganduesi kryesor i kësaj ideje njihet Philippe Antoine Merlin.

¹³³ Per analogji neni 950 i Kodit Civil Shqiptar parashikon se “Me kontratën e agjencisë, njëra palë merr përsipër në mënyrë të vazhdueshme dhe me shpërblim, që të lidhë kontratat në një zonë të caktuar, për llogari të palës tjetër”.

¹³⁴ Sikurse *Merlin* komentonte: asnjë pyetje mbi territorialitetin nuk duhet të ngrihet në lidhje me vendimet e arbitrazhit. Këto vendime duhet të njihen dhe të zbatohen si kontrata nga çdo gjykatë kombëtare sepse asnjë

argument ka pasur ndikim të caktuar në zhvillimin e të drejtës franceze të arbitrazhit. Kështu psh, në vitin 1937, Gjykata Franceze e Kasacionit u shpreh që “Procedurat e zbatimit për vendimet e arbitrazhit mund të jenë më pak të rënda sesa ato për një vendim gjyqësor të huaj, sepse vendimet e arbitrazhit, të cilat kanë si bazë të tyre një marrëveshje arbitrimi, formojnë një entitet të vetëm me të dhe përftojnë karakterin kontraktual të saj”¹³⁵.

Në përfundim, në lidhje me këtë teori, mund të themi se vendimet e arbitrazhit kanë një natyrë kontraktuale, pasi arbitrat nuk disponojnë pushtet të prejardhur nga një juridiksion shtetëror (ligji apo një autoritet gjyqësor), por një pushtet që buron nga konsensusi i palëve. Arbitri vendos, ashtu sikurse palët mund të kishin vendosur me marrëveshje, pra palët i kanë dhënë arbitrave një mandat që të vendosin në vend të tyre. Vendimi i arbitrazhit është i mbarsur, kështu, me një karakter kontraktual, duke u konsideruar si një produkt i vullnetit të palëve. Si i tillë, vendimi i arbitrazhit duhet të ketë, sikurse të gjitha marrëveshjet private, forcën e ligjit dhe të garantohet në zbatueshmërinë e tij nga rendi juridik, njëlloj si një vendim gjyqësor final.

III.3.3. Teoria Hibride.

Teoria juridiksionale dhe teoria kontraktuale kanë të dyja mbështetje të konsiderueshme në skajet e kundërta të spektrit të arbitrazhit. Megjithatë, për disa juristë, as teoria juridike as teoria kontraktuale nuk siguron një shpjegim të kënaqshëm dhe logjik të kuadrit modern të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar. Në këto rrethana nuk është për t'u habitur që një teori kompromisi me një karakter hibrid apo të përzier të jetë zhvilluar. Ithtarët e kësaj teorie besonin në korrelacionin dhe pandashmërinë e karakterit juridiksional dhe kontraktual të arbitrazhit¹³⁶. Duke sugjeruar se arbitrazhi ndërkombëtar tregtar është një mekanizëm me një karakter të dyfishtë, mbrohet ideja se, në njërin anë, arbitrazhi e ka origjinën e vet në një kontratë private, por nga ana tjetër, arbitrazhi duhet të zhvillohet brenda regjimeve ligjore kombëtare në mënyrë që të njihet dhe të kenë efekt pushteti i palëve për të lidhur marrëveshje arbitrazhi, vlefshmëria e marrëveshjes së arbitrazhit dhe zbatueshmëria e vendimit të arbitrazhit¹³⁷.

pushtet apo autoritet shtetëror nuk është i përfshirë në procedurat vendim-marrëse (shih Merlin, “Klasifikimi alfabetik i çështjeve ligjore” 144);.

¹³⁵ Çështja e Rosëve (The Roses case), [1938] I Dalloz 25.

¹³⁶ Sauser-Hall, Georges, “Arbitrazhi në të Drejtën Ndërkombëtare Private”, 1952, f.469.

¹³⁷ Kështu marrëveshja e arbitrazhit është një kontratë dhe vlefshmëria e saj do të përcaktohet në rradhë të parë, në përputhje me parimet kontraktuale. Por, ndërkohë, vendimi i arbitrazhit nuk do të zbatohet, panvarësisht se

Mbështetësit¹³⁸ e kësaj teorie insistojnë që megjithëse teoritë e karakterit juridiksional dhe kontraktor janë diametralisht kundërshtuese, ato mund të shërbejnë së bashku në një mënyrë të studiuar, për të shpjeguar thelbin e arbitrazhit. Prandaj, arbitrazhi është definuar si një institut juridik “i përzier” *sui generis*, i cili e ka origjinën e vet në marrëveshjen e palëve dhe që i nxjerr efektet e tij juridiksionalë nga legjislacioni civil. Kështu themelimi i arbitrazhit dhe pushteti i arbitrave për të marrë vendim bazohet në marrëveshjen e arbitrazhit, por ndërkohë vlefshmëria e kësaj marrëveshje dhe zbatimi i vendimeve vlerësohet konform politikës publike dhe normave të aplikimit të detyrueshëm, të ligjit relevant (ligji i vendit të origjinës së vendimit, apo ligji i vendit ku kërkohet ekzekutimi i tij)¹³⁹.

III.3.4. Teoria Autonome.

Kjo teori pretendon që arbitrazhi ndërkombëtar tregtar nuk është as juridiksional dhe as kontraktual, madje as i përzier¹⁴⁰. Me qëllim që të përcaktohet thelbi i arbitrazhit, duhet konsideruar funksioni dhe qëllimi i tij. Kjo teori e shikon arbitrazhin nga një këndvështrim tërësisht të ndryshëm nga tre teoritë e tjera, duke u përqëndruar në çështjet e vetë arbitrazhit, si psh. qëllimi i arbitrazhit, procedurat e arbitrazhit, funksioni i arbitrazhit dhe arsyeja pse ai mund të ketë të tilla funksione¹⁴¹.

Përfaqësuesi i kësaj teorie (Devichi) sugjeronte se as teoria juridiksionale dhe as teoria kontraktuale, nuk mund të reflektonin saktë thelbin e arbitrazhit, ndërkohë që edhe kombimi i tyre, ç’ka sugjeronte teoria hibride, nuk mund të ndodhte pasi ishin thelbësisht të kundërta. Ajo gjithashtu argumentonte se të tre teoritë e para vendosnin limite mbi arbitrazhin, ç’ka do të kufizonte disa avantazhe që në fakt udhëheqin biznesmenët të preferojnë arbitrazhin ndaj padisë gjyqësore dhe ç’ka do të pengonte arbitrazhin të zhvillohej. Arbitrazhi fillimisht u krijua dhe me pas u zhvillua nga biznesmenët, pa u ndikuar nga ligji i brendshëm, i cili thjesht e pranon ose bie dakort me arbitrazhin¹⁴². Në këtë arsyetim, në vend që të ndiqte debatin tradicional mbi karakterin juridiksional apo kontraktual të arbitrazhit, Devichi i qëndroi idesë se karakteri real i arbitrazhit duhet të përcaktohet bazuar në qëllimin e tij, duke

është vendosur mbi bazën e marrëveshjes së palëve, nëse psh. ligji i forumit (i vendit ku kërkohet zbatimi) konstaton se ky vendim bie ndesh me politikën publike të vendit ku vendimi i arbitrazhit kërkohet të zbatohet.

¹³⁸ Për shembull Redfern dhe Hunter, të cilët shprehimisht kanë deklaruar se: Arbitrazhi ndërkombëtar tregtar është një institucion hibrid.

¹³⁹ Hong-lin Yu, Një vështrim teorik mbi themelet e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar (2008), 276-277.

¹⁴⁰ Rubellin-Devichi, Jacqueline, “Arbitrazhi. Natyra juridike në të drejtën e brendshme dhe të drejtën ndërkombëtare private”, Biblioteka Genei e të Drejtës dhe Jurisprudencës, Paris, 1965, par. 14.

¹⁴¹ Angualia Daniel “Roli i gjykatave nacionale ne Arbitrazhin Nderkombetar Tregtar”, f.12-13.

¹⁴² *Id.f.*13.

e vendosur arbitrazhin në një nivel supra-nacional dhe duke njohur detyrimisht natyrën e tij të pavarur¹⁴³.

Autonomia e palëve për të përcaktuar ligjin e themelit dhe ligjin proçedural, nuk mbështetet as në karakterin juridiksional të arbitrazhit dhe as në atë kontraktual, por në nevojën e zakonit tregtar. Në menyrë të ngjashme, arsyeja pse marrëveshja e arbitrazhit dhe vendimet e arbitrazhit janë të zbatueshme nuk është për shkak se ato janë kontrata, apo sepse shteti ku kerkohet zbatimi jep pëlqimin (lejen), por sepse biznesmenët në mbarë botën nuk do të mundnin përndryshe të zhvillonin marrëdhëniet ndërkombëtare tregtare, nëse vendimet e arbitrazhit nuk do të ishin të zbatueshëm¹⁴⁴.

III.4 Kontributi i gjykatave shtetërore në mbarëvajtjen dhe efektivitetin e procesit të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar.

Teorikisht, me qëllim që arbitrazhi të jetë një alternativë jashtëqjyqësore efektive e zgjidhjes së konflikteve, është e nevojshme që ai të mbahet sa më larg të jetë e mundur nga dyert e gjykatës shtetërore. Në fillimet e tij, arbitrazhi ndiente nevojën të çlironte vehten nga kontrolli i rreptë i gjykatës kombëtare, e cila tradicionalisht kishte mandatin për të administruar drejtësinë. Për rrjedhojë, si rezultat i modernizimit të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar, pas viteve 1950, falë konventave të miratuara në këtë fushë (si psh., Konventa e Nju Jork-ut, etj.), shumë shtete miratuan ligje që kufizonin ndërhyrjen negative të gjykatës nacionale në procesin e arbitrazhit. Kështu psh., legjislacioni në Angli dhe SHBA, sikurse edhe praktika gjyqësore, kanë parashikuar të zbatojnë doktrinën e “shenjtërisë” së kontratës, duke mbrojtur kështu procesin e arbitrazhit¹⁴⁵.

Pavarësisht se palët janë plotësisht të lira që në mënyrë të pavarur të krijojnë mekanizmat e tyre të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ato shpesh i drejtohen një gjykate shtetërore gjatë procesit të arbitrazhit. Ekziston, pra, një lidhje midis arbitrazhit dhe gjykatës, që mundësohet nëpërmjet legjislacionit nacional¹⁴⁶. Përfshirja e gjykatave shtetërore në procesin e arbitrazhit ndërkombëtar, fillon para se tribunali i arbitrazhit të themelohet, kur padia në

¹⁴³ J.Rubellin-Devichi, “Arbitrazhi. Natyra juridike në të drejtën e brendshme dhe të drejtën ndërkombëtare private” (1965): “...duhet të lejohet arbitrazhi të gëzojë ekspansionin që meriton,.....prandaj besoj se natyra e arbitrazhit nuk është kontraktuale apo juridiskionale, as hibride, por e pavarur”

¹⁴⁴ Angualia Daniel “Roli i gjykatave nacionale ne Arbitrazhin Nderkombetar Tregtar”, f.13.

¹⁴⁵ Fox, William (i riu) “Marrëveshja e tregtisë ndërkombëtare”, bot.3^{te}, Kluwer Law International 1998, f.331-332.

¹⁴⁶ Redfern A., & Hunter M., “E drejta dhe praktika e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar”, botimi i 4-të, Sweet and Maxwell, 2004, f.13; shiko gjithashtu Suela Mëneri, “E drejta e arbitrazhit dhe e ndërmjetësimin ndërkombëtar tregtar”, bot.Dudaj 2012, f.44, 45.

gjykatën nacionale përdoret për të mbrojtur provat, apo për të vendosur masa sigurie për të shmangur dëmet e mundshme e të pakthyeshme, që mund t'i shkaktohen palës pretenduese, deri në përfundimin e procesit të arbitrazhit¹⁴⁷. Gjykata më pas mund të ndërhyjë për të zbatuar marrëveshjen e arbitrazhit, në rast konflikti midis palëve për emërimin e arbitrave¹⁴⁸, apo për çështjen e juridiksionit të forumit të arbitrazhit¹⁴⁹. Gjatë kohës që arbitrazhi zhvillohet, gjykata mund të ndërhyjë për të nxjerrë dhe ekzekutuar masat e përkohëshme¹⁵⁰ dhe në fund të procesit, gjykata shtetërore mund të ndërhyjë për të anuluar vendimet e arbitrazhit¹⁵¹ apo për t'i njohur dhe zbatuar ato¹⁵².

Në këtë optikë konstatohet se, në lidhje me procesin e arbitrazhit, gjykatat shtetërore kryejnë përgjithësisht dy funksione: në njërin anë gjykatat ofrojnë asistencë dhe mbështetje dhe në anën tjetër ato mbikqyrin dhe kontrollojnë. Sa më sipër, janë të justifikueshëm argumentat kundër pretendimit që procesi i arbitrazhit të jetë tërësisht i pavarur nga sistemet e gjykatave nacionale. Kështu, *së pari*, gjyqësori është i rëndësishëm në garantimin e integritetit të procesit të arbitrazhit¹⁵³. *Së dyti*, autoriteti i arbitrave buron nga marrëveshja midis palëve, kështu që duhet të ekzistojë një sistem që të monitorojë apo kontrollojë arbitrat kur e shtrojnë autoritetin e tyre përtej kufijve që vendos marrëveshja. *Së treti*, palët duan siguri ndaj rezultateve të parashikueshme, prandaj atyre duhet t'u rezervohet e drejta për të ankimuar një vendim arbitrazhi në një gjykatë shtetërore, pavarësisht se në raste të kufizuara dhe shumë të mirëpërcaktuara. *Së katërti*, vetë shtetet, në varësi të politikave nacionale, janë të interesuar të rishikojnë vendimet e arbitrazhit, për të mbrojtur palët e dobëta, palët e treta apo interesat e tyre kombëtare. *Së pesti*, palët nuk kërkojnë thjesht një copë letër që ju njeh të drejtën, por duan që sa më shpejt ta ekzekutojnë këtë të drejtë, mundësi që ia garantojnë sot gjykata

¹⁴⁷ Ligji Model UNCITRAL, parashikon se, pavarësisht ekzistencës së një marrëveshje arbitrazhi të vlefshme, juridiksioni i gjykatës shtetërore do të jetë i vlefshëm, kur bëhet fjalë për masat e përkohshme, psh. sigurim padie. (neni 9: nuk bie ndesh me juridiksionin e vendosur nga marrëveshja e arbitrazhit nëse një palë ka kërkuar, para apo gjatë një procedimi arbitral, nga një gjykatë shtetërore, marrjen e një vendimi për një masë paraprake mbrojtëse dhe kjo gjykatë e ka dhënë një vendim të tillë).

¹⁴⁸ *Id.*, neni 11 “Caktimi i arbitrave”; neni 13 “Procedura e kundërshtimit të arbitrit”

¹⁴⁹ *Id.*, neni 16(3): “Në qoftë gjykata e arbitrazhit vendos, si një çështje paraprake, që ajo ka juridiksion, çdo palë mund t'i kërkojë, brenda tridhjetë ditëve pasi ka marrë njoftimin për atë vendim, gjykatës përkatëse të çdo shteti, të vendosë mbi çështjen e juridiksionit”.

¹⁵⁰ *Id.*, neni 17/H: “Një masë e përkohshme e lëshuar nga një tribunal arbitrazhi do të njihet si e detyrueshme dhe, përveç kur parashikohet ndryshe nga tribunali i arbitrazhit, do të jetë e ekzekutueshme forcërisht në bazë të kërkesës në gjykatën kompetente, pavarësisht nga vendi në të cilin është lëshuar”.

¹⁵¹ *Id.* neni 34.

¹⁵² *Id.*, neni 35, shiko gjithashtu Konventën e Nju Jork-ut, neni 3, 4, 5.

¹⁵³ Neni 418 i K.Pr.C të RSh-së: Gjykata e arbitrazhit, me kërkesën e njëres prej palëve mund të vendosë marrjen e masave për sigurimin e padisë, përveç kur ka marrëveshje të kundërt ndërmjet palëve..... Nëse pala tjetër nuk zbaton vullnetarisht këto masa, gjykata e arbitrazhit i drejtohet gjykatës kompetente, e cila vendos sipas rregullave të caktuara në këtë Kod. Neni 421 i KPrC: Gjykata e arbitrazhit vepron vetë për marrjen e provave të nevojshme. Në rast se ndeshen vështirësi në marrjen e tyre, këto i kërkojnë gjykatës së shkallës së parë, e cila vepron sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod për gjykatat.

nacionale, nëpërmjet mekanizmave të Konventës së Nju Jorkut. Megjithatë, autoriteti i gjykatës kombëtare mbi procesin e arbitrazhit është i kufizuar, pasi ai mund të ushtrohet vetëm kur konstatohen defekte të rënda procedurale apo shkelje në politikën publike të shtetit të juridiksionit të gjykatës¹⁵⁴.

Në vijim trajtohet, në mënyrë të detajuar, roli i gjykatave shtetërore në fazat më të rëndësishme të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar.

III.4.1. Gjykata nacionale dhe zbatueshmëria e marrëveshjes së Arbitrazhit.

Sikurse thamë më sipër, arbitrazhi bazohet në një marrëveshje të vlefshme midis palëve, për të arbitruar, e cila sipas ligjit model UNCITRAL dhe Konventës së Nju Jork-ut, duhet të jetë me shkrim dhe të firmoset nga palët¹⁵⁵. Njohja e efektit të marrëveshjes së arbitrazhit, nga gjykatat nacionale, nuk është gjë tjetër veçse zbatimi i të drejtave thelbësore kontraktuale të palëve. Zbatimi i kësaj marrëveshje shtron para gjykatave shtetërore dy detyra. Së pari, duhet përcaktuar nëse një marrëveshje arbitrazhi është e vlefshme dhe më pas nëse duhet zbatuar ajo.

Gjykatat shtetërore kanë zhvilluar një përqsasje progresive për të interpretuar marrëveshjen e arbitrazhit. Psh. në çështjen e korporatës Arabo-Afrikane të Energjisë kundër kompanisë “Olieprodukten Nederland BV”¹⁵⁶, gjykata angleze konsideroi si një marrëveshje të vlefshme dhe detyruese arbitrazhi një korrespondencë të thjeshtë midis dy firmave, ku evidentohet pranimi për *arbitrazhin sipas ligjit anglez, në Londër, sipas Rregullave të ICC-së*¹⁵⁷.

Gjithashtu, në përcaktimin e vlefshmërisë së klauzolës së arbitrazhit, shumë gjykata shtetërore shikojnë në themelin e çështjes, më shumë sesa në formën e saj, duke zbatuar kështu qëllimin kontraktual të palëve. Në këtë mënyrë, gjykatat shtetërore luajnë një rol të madh në imponimin forcërisht të asaj çfarë disponon vullneti autonom i palëve, duke mos lejuar që një marrëveshje arbitrazhi të zhvleftësohet nga braktisja e njëanshme e palëve¹⁵⁸.

¹⁵⁴ Thomas E. Carbonneau, “Ribërja e Arbitrazhit; Projektim dhe Fat në Lex Mercatoria dhe Arbitrazh” 1990, f.10 (vërehet se Gjykata Franceze e Kasacionit ka hartuar një nocion të veçantë të “rendit publik” për vendimet e arbitrazhit ndërkombëtar.).

¹⁵⁵ Neni 7 i ligjit model UNCITRAL.

¹⁵⁶ Çështja e referuar: Arab African Energy Corp. Ltd kundër Olieprodukten Nederland BV [1983], 2 Lloyd’s Rep.419.

¹⁵⁷ Redfern A., & Hunter M., “E drejta dhe praktika e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar”, f.160.

¹⁵⁸ Në çështjen e Gjykatës së Apelit “Fulgensius Mungereza kundër kompanisë Pricewatercoopers të Afrikës Qendrore (Kampala, Uganda, Nr 34, 2001)”, apeluesi, inter alia, ankimonte vendimin e një gjykate më të ulët, për të pezulluar procedurat e gjykimit mbi bazën e një klauzole arbitrazhi ekzistuese në një marrëveshje kuadër.

Kështu, gjykatat shtetërore në Kanada kanë zhvilluar një standart që garanton autonominë e forumit të zgjedhur nga palët dhe limitojnë ndërhyrjen gjyqësore në zgjedhjen e tyre. Në lidhje me këtë, gjykata Kanadeze, në çështjen Ontario-s “*Boart Sweden AB kundër NYA Stromnes AB*”¹⁵⁹, duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit Model, e konsideroi “politikë shumë të fortë publike” mbështetjen nga gjykata të marrëveshjes së palëve për të arbitruar pretendimet e tyre. Po kështu, Gjykata e Lartë e SHBA-së, në çështjet: *Mitsubishi kundër Solar Chrysler Plymouth Inc*¹⁶⁰ dhe *Gulfstream Aerospace Corp kundër Mayacamas Corp*¹⁶¹, ka vendosur standartin për të imponuar arbitrazhin si juridiksion, pavarësisht çështjeve të politikës publike, duke mbështetur apelimet e palëve kur gjykatat federale marrin juridiksionin e çështjeve, megjithëse palët kanë përfunduar marrëveshje arbitrazhi.

III.4.2. Koncepti i “Arbitrueshmërisë” në fokusin e gjykatave nacionale.

Koncepti i arbitrueshmërisë, ka lidhje me mosmarrëveshjet që mund t’i nënshtrohen arbitrazhit dhe normalisht varet nga politika publike e çdo shteti. Konventa e Nju Jork-ut është e zbatueshme vetëm për ato mosmarrëveshje që janë të afta t’i nënshtrohen arbitrazhit¹⁶². Roli i gjykatës shtetërore, në këtë pikë, është të vendosë, bazuar në parimet dhe rregullat e *lex fori-t*, nëse një mosmarrëveshje është apo jo e arbitrueshme. Në kushtet kur politika publike ndryshon në shtete të ndryshme, ky rol pozitiv i gjykatës shtetërore e fuqizon zbatimin e vendimit të arbitrazhit, pasi një vendim i tillë do mund të jetë potencialisht i zbatueshëm, të paktën në një shtet¹⁶³.

III.4.3. Ndashmëria e klauzoles së arbitrazhit nga kontrata kryesore (Separability).

Ky koncept nënkupton faktin që marrëveshja e arbitrazhit, e përfshirë në një kontratë, ekziston e pavarur nga kjo kontratë kryesore¹⁶⁴. Gjykatat nacionale e kanë njohur, në

Gjykata u shpreh se: “Marrëveshja e arbitrazhit ka hyrë në fuqi, vullnetarisht dhe lirisht, nga palët (paditësi dhe i padituri). Për t’u shkëputur nga marrëveshja, apeluasi duhet të tregojë arsye të forta dhe bindëse. Fatkeqësisht asnjë arsye nuk është treguar. Për rrjedhojë, gjykata është e justifikuar që ka urdhëruar pezullimin e procedimit gjyqësor”.

¹⁵⁹ Çështja e referuar: (1988), B.L.R 295 (Ont. H.C): Gjyqtari Campbell J., pezulloi përkohësisht procedimin gjyqësor për ato pretendime që bien brenda klauzolës së arbitrazhit.

¹⁶⁰ Çështja e referuar: 473 U.S 614 (1985).

¹⁶¹ Çështja e referuar: 485 U.S. 271/108 S. Ct.1133 (1988).

¹⁶² Neni 2(1) i Konventës së Nju Jork-ut.

¹⁶³ Samuel Marful-Sau, “Mundet arbitrazhi ndërkombëtar tregtar të jetë efektiv pa gjykatat kombëtare? Një perspektivë e përfshirjes së gjykatave në arbitrazhin ndërkombëtar tregtar”, 2010, f.13.

¹⁶⁴ Ligji model, neni 16(1): “...Për këtë qëllim, një klauzolë arbitrazhi, e cila formon një pjesë të kontratës midis palëve, do të trajtohet si një marrëveshje të pavarur ndaj kushteve të tjera të kontratës. Një vendim nga tribunali i arbitrazhit që kontrata është absolutisht i pavlefshëm nuk do të sjellë *ipso jure* pavlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit”.

vendimet e tyre, këtë koncept, i cili përbën një burim të autoritetit të tribunalit të arbitrazhit. Kështu, në çështjen *Prima Paint Corp. kundër Flood & Conklin Manufacturing Co*¹⁶⁵, Gjykata supreme amerikane ka mbajtur qëndrimin se klauzolat e arbitrazhit, si një çështje e ligjit federal janë të ndashme (të pavaruara) nga kontrata në të cilat ato përfshihen apo bëjnë pjesë¹⁶⁶. Po kështu, në çështjen “*SNE kundër Joc Oil Ltd.*”, Gjykata e Apelit e Bermudës argumentoi që, edhe nëse kontrata kryesore është anuluar, për shkak të nënshkrimit jo sipas mënyrës së duhur të SNE-së, marrëveshja e arbitrazhit do të mbijetojë dhe do t’i shërbejë tribunalit të arbitrazhit për të fituar juridiksionin¹⁶⁷. Doktrina e “ndashmërisë” presupozon faktin që, përveç kontratës kryesore të lidhur midis palëve, këto të fundit janë të lidhura gjithashtu me një kontratë të dytë, që është pikërisht klauzola e arbitrazhit¹⁶⁸. Duke e trajtuar këtë të fundit si të *ndarë* dhe të *pavarur* nga kontrata kryesore, ku bën pjesë klauzola, gjykatat shtetërore kanë siguruar që palët të mos mund të heqin dorë nga një marrëveshje arbitrazhi me preteksin se kontrata kryesore është e pavlefshme, nul apo jooperative.

III.4.4. Koncepti i “Kompetencës për kompetencë” (“Kompetenz-Kompetenz”).

Parimi i “Kompetencës për kompetencë” është bazuar gjërësisht në nenin 16/1 të ligjit model UNCITRAL, i cili parashikon se: “Gjykata e arbitrazhit mund të vendosë vetë për juridiksionin e saj, duke përfshirë gjykimin edhe të ndonjë pretendimi në lidhje me ekzistencën ose vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit”. Ky parim, në thelb, nënkupton faktin që juridiksioni i forumit të arbitrazhit duhet të shqyrtohet, të paktën fillimisht, nga vetë ky forum. Duke përdorur si argumentim konceptin e “ndashmërisë” (pavarësisë së marrëveshjes së arbitrazhit), gjykatave të arbitrazhit u është njohur e drejta për të përcaktuar ata vetë kompetencën e tyre, e drejtë kjo që njihet dhe zbatohet forcërisht nga gjykatat shtetërore. Kështu, në çështjen *Dalmia Dairy Industries Ltd kundër National Bank of*

¹⁶⁵ Çështja e referuar: Gjykata e Lartë e SHBA - 388 U.S. 395 (1967)

¹⁶⁶ *Id.*: ...nëse ngrihet një pretendim se kontrata duhet të konsiderohet e pavlefshme pasi është e lidhur me mashtrim, por një pretendim i tillë nuk është ngritur specifikisht për klauzolën e arbitrazhit, të përfshirë në këtë kontratë, atëherë klauzola e arbitrazhit nuk do të “preket” nga ky pretendim, por do të jetë e vlefshme dhe do të sjellë efektet e saj.

¹⁶⁷ Babatunde Osadare, “Juridiksioni dhe kompetencat e tribunaleve të arbitrazhit: Kush vendos?”, Universiteti Dundee, Revista Vjetore e CEPMLP 2010, f.5: “Tribunalit të arbitrazhit i’u desh të vendoshte mbi vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit, të bërë sipas ligjit Sovjetik dhe (si pjesë e kontratës kryesore) të firmosur nga një zyrtar në vend të dy (që duheshin). Tribunali pranoi se kontrata midis palëve ishte e pavlefshme, si pasojë e parregullsisë së mësipërme, por gjithsesi urdhëroi të paditurin që të paguajë 200 milion US \$, për shkak të pasurimit të padrejtë dhe si dëmshpërblim. Tribunali arriti në këtë konkluzion, pasi e konsideroi marrëveshjen e arbitrazhit të vlefshme, pavarësisht pavlefshmërisë së kontratës kryesore, duke bërë një dallim midis nulitetit dhe mos-ekzistencës së kontratës”.

¹⁶⁸ Angualia Daniel “Roli i gjykatave nacionale në Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar”, f.19.

*Pakistan*¹⁶⁹, Gjykata Angleze e Apelit pranoi të zbatonte rregullat e ICC-së, të cilat parashikojnë se arbitrat kanë pushtet për të vendosur mbi juridiksionin e tyre. Duke njohur pushtetin e tribunalit të arbitrazhit për të vendosur mbi juridiksionin e vet kur ai është i kontestuar, gjykatat shtetërore reduktojnë nivelin e ndërhyrjes së tyre në procesin e arbitrazhit, duke promovuar kështu arbitrazhin ndërkombëtar tregtar.

III.4.5. Kundërshtimi i arbitrave në gjykatën shtetërore.

Arbitrat duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm në përmbushjen e detyrës së tyre. Për rrjedhojë, palët në arbitrazh mund të kundërshtojnë arbitrat, pra mund të kërkojnë përjashtimin e tyre, nëse ata nuk arrijnë të përmbushin këtë kusht. Gjykata shtetërore mund të investohen pikërisht në këto kërkesa të palëve për përjashtimin e një arbitri¹⁷⁰, si dhe për anulimin e një vendimi arbitrazhi për shkaqe që lidhen me pa-anshmërinë apo paragjykimin e forumit të arbitrazhit. Në këtë mënyrë, gjykatat e brendshme shërbejnë si një filtër kontrolli për arbitrat, duke ruajtur për rrjedhojë integritetin dhe besueshmërinë në procesin e arbitrazhit¹⁷¹.

Ligji model nuk paraqet ndonjë dallim midis *paanshmërisë* apo *pavarësisë* së arbitrit¹⁷², ndërsa sipas Aktit Anglez të Arbitrazhit (1996), vetëm “paanshmëria” përbën një shkak të ligjshëm për të kundërshtuar emërimin e një arbitri¹⁷³.

Përsa i përket marrjes në konsideratë të shkaqeve të pazbuluara të anshmërisë dhe paragjykimit të arbitrave, si shkaqe të mjaftueshme ligjore për anulimin e vendimit të arbitrazhit, gjykatat shtetërore kanë mbajtur qëndrime të ndryshme. Kështu, në çështjen *AT&T Corporation kundër Saudi Cables Corp.*¹⁷⁴, gjykata tregtare hodhi poshtë kërkesën për rrëzimin e një vendimi arbitrazhi, e cila bazohej në mungesën e prezumuar të pa-anshmërisë së kryetarit të një Tribunali Arbitrazhi të ICC-së, pasi ky i fundit nuk e kishte bërë prezent statusin e tij si një drejtor joekzekutiv i një konkurenti të paditësit. Çështja e

¹⁶⁹ Çështja e referuar: “Dalmia Dairy industries v. National Bank of Pakistan” [1978] 2 Lloyds Rep. 223 CA.

¹⁷⁰ Ligji model, neni 13(3): *Nëse kundërshtimi sipas procedurës së rënë dakord nga palët nuk është e suksesshëm, pala kundërshtuese mund të kërkojë, brenda tridhjetë ditëve pasi ka marrë njoftimin e vendimit të refuzimit të kundërshtimit, gjykatës shtetërore ose autoritetit tjetër të vendosë mbi kundërshtimin e arbitrit.*

¹⁷¹ Samuel Marful-Sau, “Mundet arbitrazhi ndërkombëtar tregtar të jetë efektiv pa gjykatat kombëtare? Një perspektivë e përfshirjes së gjykatave në arbitrazhin ndërkombëtar tregtar”, 2010, f.14.

¹⁷² Ligji model, neni 12(2): *Një arbitër mund të kundërshtohet vetëm në qoftë se ekzistojnë rrethana që ngrejnë dyshime të justifikueshme mbi paanësinë apo pavarësinë e tij, ose kur ai nuk zotëron kualifikimet e rëna dakord nga palët.*

¹⁷³ Akti Anglez i Arbitrazhit (1996), neni 24: (1) Një palë në procedurën e arbitrazhit, mund (pas njoftimit ndaj palës tjetër, ndaj arbitrit në fjalë dhe ndaj çdo arbitri tjetër) të aplikojnë në gjykatë për të hequr një arbitër bazuar mbi ndonjë nga këto shkaqe: (a) ekzistojnë rrethanat që sjellin dyshime të arsyeshme lidhur me paanësinë e tij;

¹⁷⁴ *AT&T Corp v Saudi Cable Co.* (2000) CA: Gjykata shprehet se: *në këtë rast, nuk ka pasur asnjë shkak thelbësor ne pretendimet e paraqitura për sjellje të pahijshme apo paragjykim të arbitrit.*

mësipërme është në kontrast me çështjen në SHBA, *Commonwealth Coatings Corp* kundër *Continental Casualty Co.*¹⁷⁵, ku Gjykata Supreme anuloi një vendim arbitrazhi për shkak të moszbulimit, që në fillim të procedimit arbitral, të lidhjeve të biznesit nga njëri prej arbitrave me një palë në proces, megjithëse ky paragjykim nuk ishte provuar që kishte sjellë pasoja¹⁷⁶.

III.4.6. Asistenca e gjykatave shtetërore në dhënien e masave të përkohshme dhe në marrjen e provave, gjatë një procedimi arbitrazhi.

Gjykatat shtetërore, gjatë një procedimi arbitral, kanë fuqinë të marrin masa të përkohshme në mbështetje të tij, mbi bazën e kërkesës së palës së interesuar, në disa raste të limituara, të cilat vlerësohen nga gjykata si të drejta dhe të përshtatshme, si psh. në nxjerrjen e urdhërave të ndërmjetëm, dhënien e masave konservuese (garantuese), etj.¹⁷⁷ Praktika gjyqësore e ka mbështetur këtë autoritet të gjykatave nacionale. Kështu, Gjykata e Lartë Indiane në çështjen *Olex focas Pvt. Ltd* kundër *Skoda Export Co. Ltd.*¹⁷⁸, argumentoi se gjykata shtetërore është veshur me juridiksion dhe pushtet për të dhënë masa të përkohshme, në një proces arbitrazhi, për çështje të përshtatshme¹⁷⁹. Gjykatat e brendshme në këtë mënyrë, luajnë një rol të rëndësishëm mbështetës, duke zgjidhur çështje që përbëjnë pjesë shumë delikate në procedimin e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar. Pa këtë ndërhyrje, arbitrazhi nuk mund të jetë efektiv.

Një tjetër aspekt i mbështetjes së procedimit arbitral, prej gjykatës shtetërore, është mbështetja në marrjen e provave që konsiderohen të vlefshme për një procedim arbitrazhi. Një autoritet të tillë, gjykatave të një shteti ia garantojnë, përveçse ligji i brendshëm, edhe dispozitat e Ligjit Model UNCITRAL (neni 27)¹⁸⁰. Në fakt, ky pushtet i atribuohet gjykatës

¹⁷⁵ Çështja e referuar: 393 US 145 (1968): Gjykata shprehet se: “Arbitrat duhet të japin informacione shpjeguese për palët mbi çdo marrëdhënie e cila mund të krijojë një përshtypje për paragjytime të mundshme. Meqënëse, lidhja e biznesit midis arbitrit dhe kontraktorit të parë nuk është deklaruar nga arbitri, vendimi i arbitrazhit duhet të anulohet, bazur në nenin 10 të Aktit të Arbitrazhit të Shteteve të Bashkuara, i cili autorizon pushimin një vendimi të siguruar nga. . . mjete të panevojshme ose ku kishte *anëshmëri evidente*. . . tek arbitrat”.

¹⁷⁶ Redfern, A. & Hunter, M., “E drejta dhe praktika e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar”, f.248.

¹⁷⁷ Neni 9 i ligjit model UNCITRAL - Nuk është e papajtueshme me një marrëveshje arbitrazhi kërkesa e një pale, para ose gjatë procedurave të arbitrazhit, drejtuar një gjykate (shtetërore) për marrjen e një mase të përkohshme për mbrojtje, sikurse edhe për një gjykatë të japë një masë të tillë.

¹⁷⁸ Çështja e referuar: AIR 2000 Delhi 161.

¹⁷⁹ Argumentimi i gjykatës për dhënien e masës së përkohshme nga gjykata shtetërore (masë konservative ndaj një prone) u mbështet në Rregullat e ICC (1998), sipas të cilave lejohet posaçërisht dhënien e urdhërave të përkohshëm dhe masave konservatore, si nga arbitrat në procedimin arbitral, ashtu dhe nga një autoritet kompetent gjyqësor në “rrethana të përshtatshme”.

¹⁸⁰ Neni 27 i ligji model: Gjykata e arbitrazhit ose një palë, me miratimin e gjykatës së arbitrazhit, mund të kërkojë nga një gjykatë kompetente shtetërore ndihmë në marrjen e provave. Gjykata mund të përmbushi kërkesën brenda kompetencave të saj dhe në pajtim me rregullat e saj për marrjen e provave.

shtetërore vetëm brenda shtetit të selisë së arbitrazhit (neni 1(2) i ligjit model)¹⁸¹. Grupi i punës që draftoi nenin 27 të ligjit model, mendonte se mund të ishte e dobishme të adresonte edhe asistencë gjyqësore të huaj në ndihmë të arbitrazhit ndërkombëtar, duke bërë përpjekje për të adaptuar bashkëpunimin ndërkombëtar, në bazë të parimit të reciprocitetit. Por, këto përpjekje dështuan dhe drafti final i ligjit model (neni 27) nuk lejon kërkesa për mbështetje, në marrjen e provave të nevojshme për procedimin arbitral, nga një gjykatë shtetërore jashtë vendit të arbitrazhit¹⁸².

III.4.7. Njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit nga gjykatat nacionale.

Fakti që vendimi i arbitrave, dhënë mbi një konflikt të arbitrueshëm, është detyrues dhe final për palët, mund të konfirmohet vetëm nga gjykatat shtetërore. Njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit krijojnë “res judicata” (gjë të gjykuar) dhe për palët çështja mbyllet¹⁸³. Nëse pala humbëse nuk e përmbush vendimin e arbitrazhit, pala fituese do të kërkojë pushtetin e gjykatës së brendshme për të zbatuar, nëpërmjet forcës shtrënguese shtetërore, vendimin e arbitrazhit, njëlloj si një vendim gjyqësor. Me Konventën e Nju Jork-ut, gjykatat shtetërore fituan një mekanizëm të rëndësishëm juridik, për të zbatuar një vendim arbitrazhi ndërkombëtar, me përjashtim të disa rasteve rigorozisht të parashikuara në Konventë¹⁸⁴. Për shembull në çështjen *Soleimany kundër Soleimany*¹⁸⁵, gjykata Angleze refuzoi të zbatonte një vendim arbitrazhi, bazuar në shkakun e politikës publike, sepse kontrata e palëve ishte mbështetur në elemente të paligjshëm.

Sot ekziston një konsensus universal që mbështet rolin e gjykatave të brendshme në njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit, pa të cilin arbitrazhi do të kishte mungesë efikasiteti. Për rrjedhojë, ndërtimi i një kuadri efikas për arbitrazhin kërkon që ligjvënësit dhe gjykatat të angazhohen në një proces ligjor që balancon shqetësimin e palës fituese, në një proces arbitrazhi, për të finalizuar të drejtën e saj dhe dëshirës së humbësit për mbrojtje

¹⁸¹ Neni 1/(2) - Dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të neneve 8, 9, 17 H, 17 I, 17 J, 35 dhe 36, zbatohen vetëm në qoftë se vendi i arbitrazhit është në territorin e këtij shteti (shteti që ka adaptuar ligjin model).

¹⁸² Komentim analitik i draft-tekstit të Ligjit Model për Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar: Raport i Sekretarit të Përgjithshëm (A/CN.9/264) f.131 e më tej.

¹⁸³ Redfern, A. & Hunter, M., “E drejta dhe praktika e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar”, f.516

¹⁸⁴ Shiko nenin 5 të Konventës së Nju Jork-ut.

¹⁸⁵ *Sion Soleimany (babai) kundër Abner Soleimany (i biri)*, Gjykata e Apelit të M.Bashkuar, Seksioni Civil, 30 Janar 1998; Vjetari i Arbitrazhit Tregtar, XXIV (1999), f.329-342: S.Soleimany kundërshtoi në Gjykatën e Apelit zbatimin e vendimit të arbitrit të vetëm, me argumentin se marrëdhënia ishte ndërtuar mbi elementë paligjshmërie (evazion fiskal), sipas legjislacionit Iranian, të provuar në procesin e arbitrazhit, që çënonin rendin publik. Gjykata e Apelit, deklaroi se *vendimi i arbitrazhit që pretendon të zbatohet një kontratë të paligjshme, nuk është i zbatueshëm në Angli dhe Uells.*

procedurale¹⁸⁶.

Përfundime për kapitullin e tretë.

Rregullimi ligjor modern i arbitrazhit ndërkombëtar tregtar ka filluar vetëm në vitet 1920, me miratimin e Protokollit për Dispozitat e Arbitrazhit, Konventës për Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit dhe krijimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të ICC-së. Por, periudha e zhvillimit substancial të këtij instituti fillon me miratimin e Konventës së Nju Jork-ut, në vitin 1958. Për mirë-rregullimin e procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar, një kontribut të rëndësishëm ka, pa më të voglën mëdyshje, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL), i cili nëpërmjet draftimit dhe miratimit të akteve model u ka krijuar shteteve miratuese komoditetin e unifikimit të këtyre procedurave.

Pyetja më e rëndësishme në lidhje me arbitrazhin është burimi i fuqisë së arbitrave për të gjykuar konfliktin. Teoritë kryesore doktrinale që justifikojnë këtë fuqi janë teoria *kontraktuale* dhe ajo *juridiksionale*. Të dyja këto teori i justifikojnë vlerat e institutit të arbitrazhit, për rrjedhoje edhe efektivitetin e tij, por secila në mënyrën e vet. E para i referohet, për këtë qëllim, rëndësisë që ka për të drejtën private liria e vullnetit kontraktor, nga ku buron edhe pushteti i arbitrave. Ndërsa e dyta e vë theksin tek rendi juridik shtetëror dhe njohja që, domosdoshmërisht, ky rend duhet t'i garantojë vullnetit të palëve për të rregulluar marrëdhënien e tyre, si kusht esencial për të njohur efektin e marrëveshjes së arbitrazhit dhe fuqinë e vendimit të tij.

Arbitrazhi është privat në natyrë dhe si i tillë palët do të kenë nevojë për gjykatat nacionale për t'i dhënë fuqi marrëveshjes arbitrale, pa të cilën nuk ka juridiksion forumi, si dhe për të zbatuar vendimet e arbitrazhit. Duke qenë një mekanizëm jo i vetë-zbatueshëm, është fakt që pa ndihmën e gjykatave shtetërore, procesi i arbitrazhit nuk mund të jetë efektiv dhe nuk mund ta ruajë integritetin e tij. Për rrjedhojë, një nga arsyet pse disa shtete nuk janë shumë të tërhequra nga arbitrazhi ndërkombëtar, mund të jetë edhe fakti se gjykatat e tyre nuk e mbështesin aq sa duhet procesin e arbitrazhit.

Është shumë e rëndësishme arritja e një ekuilibri midis autonomisë së arbitrazhit nga gjyqësori, më qëllim që biznesit t'i ofrohet një alternativë atraktive të zgjidhjes së konflikteve tregtare dhe nevojës që arbitrazhi t'i nënshtrohet kontrollit të autoritetit gjyqësor me qëllim

¹⁸⁶ William W. Park, "Detyra dhe Diskrecioni në Arbitrazhin Ndërkombëtar", Revista Amerikane e të Drejtës Ndërkombëtare, nr.93, 805 (1999), f.43.

arritjen e efektivitetit. Analiza tregon se gjykatat kombëtare janë të përfshira në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar, duke i ndihmuar gjykatat e arbitrazhit të konkludojnë me sukses. Por, autoriteti i gjykatës kombëtare për të kontrolluar procesin e arbitrazhit është i kufizuar dhe mund të shtrihet vetëm për defekte të rënda procedurale apo për shkelje në politikën publike të shtetit të juridiksionit të gjykatës.

Në përfundim, konkludojmë se zgjerimi i tregtisë dhe investimeve ndërkombëtare, të cilat kërkojnë prezencë aktive të arbitrazhit ndërkombëtar, justifikojnë nevojën për të sensibilizuar gjykatat e brendshme shtetërore për të mbështetur procesin e arbitrazhit, veçanërisht në ekonominë në zhvillim.

KAPITULLI IV

KONVENTA E NJU JORK-ut VESHTRIM DOKTRINOR DHE JURISPRUDENCAL MBI EFEKTIN E SAJ NË NJOHJEN E VENDIMEVE TË ARBITRAZHEVE TË HUAJA

Në këtë kapitull do të fokusohemi në trajtimin teorik të Konventës së Nju Jork-ut, këtij instrumenti juridik të themeluar në funksion të ndërkombëtarizimit të njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit. Duke patur parasysh misionin e këtij punimi, e konsideroj mjaftueshmërisht të nevojshme një analizë të tillë, me synimin për të njohur paraprakisht vlerat juridike të Konventës dhe interpretimin e unifikuar të saj prej doktrinës dhe jurisprudencës ndërkombëtare. Vetëm në këtë mënyrë do të jemi në gjendje të kalojmë më pas në menyrën se si trajtohen instrumentat e Konventës në juridiksionin Shqiptar.

Edhe pse arbitrazhi është konsensual, zbatimi i vendimeve të arbitrazhit nuk është i tillë. Asgjë nuk i fruston më shumë palët sesa të zbulojnë, pas një “beteje” procedurale të gjatë dhe të kushtueshme arbitrazhi, se vendimi i dhënë nga arbitrat nuk mund të zbatohet. Perceptimi për zbatueshmërinë e vendimit ka shumë të ngjarë të influencojë vendimarrjen e një biznesmeni, për të zgjedhur arbitrazhin apo gjykatën si juridiksion për mosmarrëveshjen e tij, madje mund të ndikojë deri në vendimin për të financuar apo për të bërë apo jo biznes me palën tjetër. Studimet e kohëve të fundit vërtetojnë faktin se palët zgjedhin arbitrazhin ndërkombëtar për të zgjidhur mosmarrëveshjet, më së shumti për dy arsye që janë (1) neutraliteti i forumit (duke qenë në gjendje për të qëndruar jashtë juridiksionit të palës tjetër) dhe (2) mundësia e zbatimit të vendimit të arbitrazhit, nëpërmjet efektit të dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut¹⁸⁷.

Konventa për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj¹⁸⁸, miratuar në Nju Jork, më 10 qershor 1958 (më tej, Konventa e Nju Jork-ut), është përshkruar nga një personalitet i shquar i fushës - Albert Jan van den Berg - si traktati më i suksesshëm në të drejtën ndërkombëtare private¹⁸⁹. Ajo është cilësuar, gjithashtu, si *superlubrifikant* për makinerinë komplekse, e cila ka bërë të mundur shpërthimin e tregtisë globale gjatë pesëdhjetë viteve të

¹⁸⁷ Margaret L. Moses; Parimet dhe praktika e Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar, 2008, Cambridge University Press, f.3.

¹⁸⁸ Konventa mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj – u hartua dhe u paraqit për nënshkrim më datë 10 Qershor 1958 në Konferencën e Kombeve të Bashkuara “Mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar”, thirrur në përputhje me Rezolutën 604 (XXI) të Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara, të datës 3 Maj 1956. Konferenca u mbajt në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork nga 20 Maj deri më 10 Qershor 1958.

¹⁸⁹ Website - <http://untreaty.un.org/cod/avl/ha/crefaa/crefaa.html>.

fundit”¹⁹⁰. Duke ndikuar drejtpërdrejt në jetën e miliarda njerëzve nëpër botë, në mënyra të dallueshme dhe të padallueshme, ky dokument ndërshtetëror praktikisht është teksti “i shenjtë” laik më i rëndësishëm për çdo banor të globit të shekullit të 21-të¹⁹¹. Konventa sot gjen zbatim sot në 145 shtete të botës, duke u bërë pjesë e rendit juridik të brendshëm të tyre. Kjo Konventë është një instrument ndërkombëtar që ka zhvilluar arbitrazhin tregtar modern, duke promovuar respekt ndaj angazhimeve detyruese, pavarësisht nëse ato janë marrë përsipër nga palë private, apo qeveri¹⁹².

Ndikimi i Konventës së Nju Jork-ut në zhvillimin e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar, ka qenë fenomenal, duke konsoliduar dy shtyllat themelore të kuadrit regullator në këtë fushë. *Së pari*, ajo siguroi zbatimin e detyrueshëm të çdo vendimi arbitrazhi të huaj¹⁹³ në shtetet anëtare të Konventës. *Së dyti*, Konventa modifikoi rrënjësisht marrëdhënien midis marrëveshjeve të arbitrazhit dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, sepse shtetet nëpërmjet këtij dokumenti të rëndësishëm ranë dakord që marrëveshjet e vlefshme të paleve për arbitrazh të përbënin shkak ligjor të mjaftueshëm, që gjykatat e zakonshme të shpallnin mungesën e kompetencës së tyre në favor të arbitrazhit¹⁹⁴. Prandaj Konventa e Nju Jorkut është ndoshta arsyeja kryesore pse arbitrazhi është metodë e preferuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të biznesit ndërkombëtar.

Suksesi universal i Konventës së Nju Jork-ut mund të matet në mënyra të shumta. Në rradhë të parë, numri i shteteve nënshkrues të Konventës (sot 149), është sigurisht simbolika më universale e pranimit të Konventës, e cila mund të përkthehet si një tregues shumë kuptimplotë i suksesit të saj. Një simbol tjetër i suksesit është ilustruar nga niveli i kontributit të Konventës në lidhje me legjitimitetin universal dhe besueshmërinë e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar. Ky status, i cili ka sfiduar dhe tejkaluar skepticizmin gjyqësor ndaj arbitrazhit, ka siguruar për arbitrazhin ndërkombëtar bazën normative të nevojshme për të shërbyer si një zëvendësues i denjë për gjykatën. Një studim empirik, psh. ka vënë në dukje se për avokatët e korporatave, arsyeja më e rëndësishme për zgjedhjen e arbitrazhit

¹⁹⁰ Veeder.V.V. “A është e nevojshme të ndryshohet Konventa e Nju Jorkut” (Fjalimi hapës i Forumit të Institutit të Arbitrazhit Ndërkombëtar, Dijon, shtator 2008), Revista e Vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar, qershor 2010, Emmanuel Gaillard, f.185.

¹⁹¹ *Id.*, f.186; par.1.

¹⁹² Kofi Annan, ish Sekretari i Përgjithshëm i OKB, fjalë përshëndetëse në festimin e 40 vjetorit të Konventës së Nju Jork-ut. Nju Jork, 10 qershor 1998,

¹⁹³ Veprimi i parë është njohja dhe zbatimi i vendimeve përfundimtare të arbitrazhit të huaj, të cilat sipas Konventës gëzojnë statusin për t’u cilësuar si të tilla. Një palë që kërkon ekzekutimin e një vendimi të tillë duhet të paraqesë një kërkesë në autoritetin kompetent të vendit ku kërkohet njohja (neni 1, 4 i Konventës).

¹⁹⁴ Një gjykatë e një shteti kur thirret për një çështje, në lidhje me të cilën palët kanë bërë një marrëveshje arbitrazhi, duhet të deklarojë moskompetencën dhe t’i referojë palët tek arbitrazhi (neni 2 i Konventës).

përkundrejt procesit gjyqësor për të zgjidhur mosmarrëveshjet, ishte zbatueshmëria e vendimeve që prodhonin arbitrat¹⁹⁵.

IV.1. Faktorë historikë përcaktues për risitë e Konventës së Nju Jork-ut, krahasuar me pararendëset e saj.

IV.1.1. Rrethanat historike të lindjes së Konventës së Nju Jork-ut.

Lindja e Konventës i atribuohet disa rrethanave historike, që krijuan premisën dhe lanë gjurmë në hartimin e tekstit të saj. Pas përfundimit të luftës së II-të botërore, nevoja për zhvillim ekonomik të vendeve domosdoshmërisht do të ndikonte në zgjerimin e tregtisë ndërkombëtare. Arbitrazhi ndërkombëtar konsiderohej në atë kohë, si një mjet i suksesshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në këtë fushë. Tregtarët ndërkombëtar shpesh preferonin arbitrazhin, përkundrejt procesit gjyqësor, sepse ai konsiderohej më i shpejtë, më pak i kushtueshëm dhe më shumë fleksibël¹⁹⁶. Por efektiviteti i këtij mekanizmi "sabotohej" dhe vihej në pikëpyetje nga vështirësitë që dilnin në lidhje me zbatimin e vendimeve të arbitrazhit në shtete të ndryshme. Veprimtaria e institucioneve të arbitrazhit¹⁹⁷ nuk ishte atraktive aq sa duhej pikërisht për shkak të problemeve që krijonte zbatimi i vendimeve që ato prodhonin në funksion të zgjidhjes së konflikteve.

Rritja e vrullshme e tregtisë ndërkombëtare do të rriste gjithnjë e më shumë nevojën për zgjidhje të shpejta dhe efektive të mosmarrëveshjeve përkatëse. Kjo nevojë nuk mund të plotësohej me mekanizmat që ofroheshin nga Protokollin e Gjenevës "Mbi dispozitat e Arbitrazhit" e vitit 1923 dhe Konventën e Gjenevës "Për ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit" e vitit 1927. Për rrjedhojë, përfundimi i një Konvente të re me kushte më liberale se dokumentat e mësipërm, në përgjithësi konsiderohej si detyra më e ngutshme në fushën e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar¹⁹⁸.

¹⁹⁵ Loukas Mistelis, "Arbitrazhi Ndërkombëtar - Qëndrimet dhe Praktikët e Korporatës – 12 Perceptimet e Testuara"; Raport kërkimor mbi të dhëna dhe analiza të 15 Revistave Amerikane të Arbitrazhit Ndërkombëtar (studimi i kryer në vitin 2005).

¹⁹⁶ Tibor Varady, John J.Barcelo - "Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Një "Perspektivë Transnacionale" (American Casebook Series), botimi i katërt, 2009, f.841.

¹⁹⁷ Shoqata Amerikane e Arbitrazhit (AAA), Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC), Gjykata e Arbitrazhit të Londrës, etj,

¹⁹⁸ Memorandum i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj, dokument i Këshillit Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara (ECOSOC), sesioni 21, nr.E/2840, 22 mars 1956 (siguruar on line); f.3, par.5 (*travaux préparatoires*).

Iniciativa për të zëvendësuar traktatet e mësipërme (Protokollin dhe Konventën e Gjenevës) erdhi nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (International Chamber of Commerce - ICC)¹⁹⁹, e cila hartoi edhe një draft paraprak të Konventës në vitin 1953. Iniciativa e ICC-së u zhvillua më tej nga Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara²⁰⁰. Ky i fundit për këtë qëllim, në sesionin e tij të 17-të miratoi një Rezolutë²⁰¹, nëpërmjet të cilës u krijuar një komitet "ad hoc" me përfaqësuesit e tetë shteteve anëtare të OKB-së²⁰².

Komiteti e zhvilloi punën e tij, duke marrë në shqyrtim çështjen e ngritur nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, për nevojën e miratimit të një dokumenti ndërkombëtar, në lidhje me dhënien fuqi të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar. Deri në atë moment ishin në fuqi dy konventa shumëkombëshe në lidhje me arbitrazhin tregtar, të cilat ishin miratuar nën kujdesin e Kombeve të Bashkuara²⁰³. Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë shprehu opinionin se sistemi i vendosur nga keto konventa, nuk i përgjigjej më kërkesave të tregtisë ndërkombëtare²⁰⁴.

Në këtë kohë u vunë re edhe disa rrethana të cilat lehtësonin punën për hartimin e draftit të Konventës. Kështu brenda OKB-së, Komisioni Ekonomik për Europën dhe Komisioni Ekonomik për Azinë dhe Lindjen e Largët po i kushtonin një vëmendje të madhe zhvillimit të lehtësive të arbitrazhit ndërkombëtar, ku bënte pjesë edhe zbatimi i vendimeve të tij. Gjithashtu interesi i disa organizatave ndërqeveritare në këtë fushë ishte rritur, sikurse u demonstrua në draftin "Për ligjin uniform për arbitrazhin, në zbatim të marrëdhënieve ndërkombëtare të së Drejtës Private", të hartuar nga Instituti Ndërkombëtar për Unifikimin e së Drejtës Private në Romë²⁰⁵.

¹⁹⁹ Ky organizëm u themelua në 1919 me Sekretariatit Ndërkombëtar në Paris dhe pranë tij (më 1923) u themelua Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit. ICC-ja ka statusin e mbikqyrësit të përhershëm në OKB, duke patur ndikim të madh në çështjet e tregtisë ndërkombëtare. Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë konsiderohej në atë kohë (vitet 1950), ashtu si edhe sot, si organizata përfaqësuese më e madhe e biznesit në botë, ku janë anëtarësuar me qindra mijëra kompani nga 130 vende të ndryshme të botës. Opinionet e Dhomës kanë determinuar zhvillime të konsiderueshme nga organizatat ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, Organizata Botërore e Tregtisë etj, në lidhje me fushën e tregtisë ndërkombëtare: website - http://International_Chamber_of_Commerce

²⁰⁰ Raporti i Komitetit "ad hoc" për Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar, dokument zyrtar i Këshillit Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara, sesioni 19, nr.E/2704, E/AC.42/4/Rev.1, f.1, par.1, 2: siguruar on line në website http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/arbitration/NYConvention.html.

²⁰¹ Rezoluta e Kombeve të Bashkuara nr.520, datë 6 prill 1954

²⁰² Komiteti u formua me përfaqësues të Australisë, Belgjikës, Ekuadorit, Egjiptit, Indisë, Suedisë, Bashkimit të Republikave Sovjetike dhe Mbretërisë së Bashkuar.

²⁰³ Protokollin për Klauzolat e Arbitrazhit i 24 shtatorit 1923 (ratifikuar nga 30 shtete) dhe Konventa e Gjenevës për ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj e 26 shtatorit 1927 (ratifikuar nga 24 shtete), e cila shtonte dhe zgjeronte qëllimin e Protokollit.

²⁰⁴ Raporti i Kom. për Zbatimin e Vend.Arbitrazhit Ndërkombëtar, nr.E/2704, E/AC.42/4/Rev.1, f.5, par.13.

²⁰⁵ *Id.* f.4, par.12.

Duke marrë në konsideratë aspektin e përgjithshëm të çështjes, komiteti konkludoi se do të ishte e kënaqshme të miratohej një Konventë e re. Kjo e fundit do të shkonte më larg se Konventa e Gjenevës në lehtësimin e zbatimit të vendimeve të arbitrazhit të huaj, por njëkohësisht do të ruante parimet e njohura gjerësisht të së drejtës dhe do të respektonte sovranitetin e shteteve. Panvarësisht se komiteti nuk ishte dakort me disa nga propozimet e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, ai vendosi të përdorte draftin e paraqitur si fletë pune për diskutimet e tij, duke bërë gjatë rrugës disa ndryshime dhe modifikime. Në takimin e tij të 13^{të}, më 15 mars 1955, komiteti "ad hoc" miratoi²⁰⁶ një draft-Konventë "Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj"²⁰⁷.

Pas hartimit të draftit dhe pas miratimit të dy rezolutave të njëpasnjëshme²⁰⁸, Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara vendosi thirrjen e një konference të plotfuqishme, e cila do të kishte si qëllim kryesor miratimin e një Konvente të re. Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar u zhvillua nga data 20 maj deri në datë 10 qershor 1958²⁰⁹, në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, nga ku mori edhe emrin Konventa e re. Pas negociatave, në konferencë u pranua të përdorej drafti i paraqitur nga komiteti "ad hoc", duke marrë në konsideratë komentet dhe sugjerimet e bëra nga qeveritë dhe organizatat joqeveritare. Në përfundim të konferencës, më datë 10 qershor 1958²¹⁰, pas 4 vitesh përpjekje²¹¹ lindi Konventa e Nju Jork-ut²¹², ç'ka do të shënonte fundin e Protokollit dhe Konventës së Gjenevës dhe fillimin e një fryme të re për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar.

Dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut nuk kanë fuqi prapavepruese. Ato nuk çënojnë vlefshmërinë e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe në lidhje me njohjen dhe zbatimin

²⁰⁶ Drafti u miratua me 7 vota pro, asnjë kundër dhe 1 abstenim.

²⁰⁷ Raporti i Kom. për Zbatimin e Vend.Arbitra.Ndërkombëtar, nr.E/2704, E/AC.42/4/Rev.1, f.5, par.14-16: Ky draft, i cili u miratua si aneks i raportit të komitetit "ad hoc", nuk është ai që mishërohet në dispozitat finale të Konventës së Nju Jork-ut. Në lidhje me këtë draft Konventë shtete të ndryshme paraqitën objeksionet e tyre dhe opinionet, të cilat u materializuan në dispozita të veçanta të tekstit final të Konventës.

²⁰⁸ E para ishte Rezoluta nr.570 (XIX) e datës 20 maj 1955, e cila ngarkonte S.Përgjithshëm t'u shpërndante draft Konventën dhe raportin e komitetit "ad hoc", shteteve anëtare dhe jo anëtare të OKB-së, ICC-së, etj, për të shprehur komentet e tyre dhe opinionin për mbajtjen e një konference. Për të marrë në shqyrtim komentet, Këshilli vendosi mbajtjen e një konference ndërkombëtare, që u bë e mundur nëpërmjet Rezolutës së dytë nr.604 (XXI), datë 3 maj 1956.

²⁰⁹ Konferenca u zhvillua në pajtim me Rezolutën 604 të Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB-së.

²¹⁰ Konventa qëndroi i hapur për nënshkrime deri në 31 dhjetor 1958 dhe hyri në fuqi më 7 qershor 1959.

²¹¹ Komiteti draftues "ad hoc" u krijuar më 6 prill 1954.

²¹² Statusi zyrtar: *Titulli i Konventës* - "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit"; *Vendi, data e miratimit* - Nju Jork, 10 qershor 1958; *Hyrja në fuqi* - 7 qershor 1959, në përputhje me nenin 12 të vetë Konventës; *Regjistruar si akt* - 7 qershor 1959, me nr.4739; *Statusi aktual* - Firmëtar 24 shtete; Palë 149 shtete; *Teksti zyrtar* - Seria e Traktateve të Kombeve të Bashkuara, vol.330, p.3; *Autoriteti miratues* - Konferenca e K.Bashkuara mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar – informacion i siguruar në website - http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/arbitration/NYConvention_travaux.html

e vendimeve të arbitrazhit, që ishin në fuqi midis shteteve miratuese të Konventës para hyrjes në fuqi të saj. Këtu përjashtohen dispozitat e dy Konventave Ndërkombëtare të cilat ishin në fuqi në fushën e arbitrazhit ndërkombëtar²¹³. Gjithashtu dispozitat e Konventës nuk i heqin të drejtën palës së interesuar për të përfituar nga ndonjë vendim arbitrazhi, në mënyrën që parashikohet nga kuadri ligjor i shtetit ku kërkohet të zbatohet një vendim i tillë²¹⁴.

Konventa parashikon mekanizimin e miratimit dhe të hyrjes së saj në fuqi për shtetet që pranuan ta nënshkruanin menjëherë, si dhe për çdo shtet që do ta ratifikonte atë më vonë²¹⁵. Hyrja në fuqi e dispozitave të Konventës është bërë ditën e 90-të pas datës së dorëzimit të instrumentit të tretë të ratifikimit ose aderimit²¹⁶ dhe kjo përkon me datën 7 qershor 1959²¹⁷. Rëndësia e Konventës së Nju Jorkut në zhvillimin e tregtisë globale ka kërkuar vazhdimisht vëmendjen e faktorit ndërkombëtar për të monitoruar implementimin e saj, duke vlerësuar mekanizmat proceduralë, që shtetet e ndryshme kanë zbatuar për të bërë dispozitat e Konventës funksionale²¹⁸.

IV.1.2. Risitë që përcolli Konventa për fuqizimin e arbitrazhit ndërkombëtar.

Krahasuar më pararendëset e saj, Konventës së Nju Jork-ut i atribuohet një përqsaje e ndryshme në disa apekte, që konsiderohen risi në lëmin e njohjes së vendimeve të arbitrazhit dhe të cilat justifikojnë miratimin e saj. Ato mund të përmbliidhen si më poshtë:

i). Eliminimi i kërkesës së “udhërit të ekzekutimit të dyfishtë”. Qëllimi primar i Konventës së Nju Jork-ut (1958) ishte të liberalizonte procedurën për zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj²¹⁹. Sikurse e përmendëm më sipër, pas luftës së parë botërore, u

²¹³ Konventa e Nju Jorkut (1958), neni 7, par.2: *Protokolli i Gjenevës i vitit 1923 dhe Konventa e Gjenevës e vitit 1927 do të pushojnë efektin e tyre për shtetet që e pranojnë Konventën e Nju Jorkut, që nga dita që ata lidhen dhe në masën që lidhen me këtë Konventë.*

²¹⁴ *Id.*, neni 7, par.1 - klauzola e “dispozitës më të favorshme”.

²¹⁵ Konventa e Nju Jorkut (1958), neni 8 dhe 9: *Dokumenti i Konventës qëndroi i hapur deri më datën 31 dhjetor 1958 për nënshkrim nga çdo shtet anëtar i OKB-së apo agjencive të specializuara të saj. Gjithashtu ai ka qëndruar i hapur për aderim, për të gjitha shtetet, edhe pas datës 31 dhjetor 1958. Aderimi mund të bëhet duke depozituar një instrument të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.*

²¹⁶ *Id.*, neni 12, par.1.

²¹⁷ *Id.*, neni 12, par.2: *Për çdo shtet që do të ratifikojë Konventën pas hyrjes së saj në fuqi (pas depozitimit të instrumentit të tretë), kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së depozitimit nga ana e këtij shteti të instrumentit të ratifikimit ose aderimit.*

²¹⁸ Sekretariati i UNCITRAL përgatiti një pyetësor, qëllimi i të cilit ishte monitorimi i zbatimit të Konventës, duke përfshirë identifikimin e tendencave për interpretimin e dispozitave të saj në gjykatat nacionale. Në fund të shkurtit 2008, gjithsej 108 shtete, kishin paraqitur përgjigjet për pyetësorin, të cilat u përmbledhën në një raport (shiko Raportin e UNCITRAL për studimin në lidhje me zbatimin legjislativ të Konventës "Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", Nju Jork, sesioni 41 (16 qershor - 3 korrik 2008), dokument A/CN.9/656).

²¹⁹ Tibor Varady, John J.Barcelo - “Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Një “Perspektivë Transnacionale” (American Casebook Series), botimi i katërt, 2009, f.850.

konstatua se kishte një problem të rëndësishëm me Konventën e vitit 1927. Konkretisht problem lidhej me dispozitën që parashikonte se pala, e cila kishte kërkuar zbatimin e vendimit të arbitrazhit, kishte barrën për të provuar që kushtet për njohjen e këtij vendimi ishin përmbushur, veçanërisht kërkesa për të provuar karakterin final të vendimit në vendin e tij të origjinës²²⁰.

Mënyra e vetme për të plotësuar këtë kërkesë ishte që paraprakisht të procedohej me njohjen e vendimit në vendin ku ishte zhvilluar procesi i arbitrazhit, duke lëshuar një urdhër-ekzekutimi. Kësisoj, e gjitha fryma e Konventës konsistonte në detyrimin për njohjen dhe ekzekutimin e një urdhëri ekzekutimi, apo në të ashqtuajturen teorinë e “udhërit të ekzekutimit të dyfishtë” (“double exequateur²²¹”). Kërkesa e “udhërit të ekzekutimit të dyfishtë” në fakt kishte ulur ndjeshëm dobishmërinë e vetë Konventës, prandaj u kërkuar nga disa shtete, anëtare në konferencë, heqja e kësaj kërkesë²²². Si rezultat, një ndryshim cilësor i garantuar nga Konventa e Nju Jork-ut, ishte parashikimi se vetëm vendimi i arbitrazhit, në formën e kërkuar nga Konventa, i shoqëruar nga marrëveshjen e arbitrazhit duhet të konsideroheshin si prova të mjaftueshme që kërkesa e paraqitur për njohjen e vendimit të shqyrtohej dhe të pranohej²²³.

ii). *Kapërcimi, prej Konventës së Nju Jork-ut, i parimit absolut të reciprocitetit.* Qëllimi i Konventës është që çdo shtet, që e ka pranuar atë (shteti që e ka nënshkruar ose që aderon më vonë pas hyrjes së Konventës në fuqi), është i detyruar në bazë të parimeve të së drejtës ndërkombëtare (*inter alias*, parimi i *pacta sunt servanda*), të njohë dhe të zbatojë të gjitha llojet e vendimeve të arbitrazhit që në kuptim të Konventës cilësohen si vendime arbitrazhi të huaja. Konventa parashikon edhe kufizime të këtij detyrimi, pasi që në momentin që e pranon Konventën, çdo shtet gëzon të drejtën e rezervës, në lidhje me dy kritere²²⁴: kriterin e shtetit ku

²²⁰ Neni 4 i Konventës së Gjenevës 1927: Pala e cila ka pretenduar ekzekutimin e vendimit duhet të paraqesë, në veçanti (1) vendimin origjinal ose një kopje të tij të autentifikuar si duhet, sipas kërkesave të ligjit të vendit në të cilin vendimi është marrë; (2) prova dokumentare apo të tjera për të provuar se vendimi është bërë përfundimtar, në kuptimin e përcaktuar në nenin 1(d), në vendin në të cilin është miratuar; (3) Kur është e nevojshme, provat dokumentare apo të tjera për të provuar se kushtet e përcaktuara në nenin 1, paragrafi 1, paragrafi 2 (a) dhe (c), janë përmbushur.

²²¹ *exequateur* – nga latinishtja “Për tu ekzekutuar”; Në të drejtën ndërkombëtare private termi “exequatur” është përkufizuar si procedura, sipas të cilës një palë i kërkon një gjykatë nacionale ekzekutimin e një vendimi ligjor të huaj.

²²² Sanders Pieter, “Bërja e Konventës” *Zbatimi i vendimeve të arbitrazhit, sipas Konventës së Nju Jorkut-Eksperiencë dhe Prospektë*, Nju Jork në 10 qershor 1998, Publikimi i KB, Nr.E.99.V.2, f.4: “Elementet kryesore të “propozimit” Holandez ishin, para së gjithash, eliminimi i dopio- ekzekuturës, një në vendin ku është marrë vendimi dhe një tjetër në vendin e zbatimit të vendimit. Sipas Konventës së Gjenevës 1927 gjithmonë ishin kërkuar të dy”.

²²³ Konventa e Nju Jorkut (1958), neni 4, par.1.

²²⁴ *Id.*, neni 1, pika 3.

janë marrë vendimet (*Rezerva e reciprocitetit*)²²⁵ dhe kriterin e natyrës së mosmarrëveshjeve që zgjidhin vendimet e arbitrazhit (*Rezerva tregtare*)²²⁶.

Përfshirja e Rezervave në draftin final të Konventës ishte një problem i diskutuar gjatë, nga komiteti draftues. Kështu paraqitej shumë i vështirë tejkalimi i parimit absolut të reciprocitetit të manifestuar në Konventën e Gjenevës (1927), sipas të cilit parashikohej njohja dhe zbatimi vetëm i atyre vendimeve të arbitrazhit, të cilat ishin marrë në një shtet tjetër kontraktues, pra në një shtet i cili nga ana e tij njihte të njëjtin detyrim. Ndërkohë që projekti i propozuar nga ICC, sugjeronte njohjen e vendimeve të arbitrazhit, të cilat ishin marrë në një shtet tjetër, panvarësisht nëse ky i fundit ishte apo jo i lidhur me detyrimet e Konventës. Por një propozim i tillë kishte shumë mundësi të kundërshtohej nga shtetet, të cilët ndiheshin me komod me variantin e reciprocitetit. Komiteti konkludoi kështu në një dispozitë të ndërmjetëme, sipas të cilit çdo shtet do t'i njihej e drejta të deklaronte se do të aplikonte Konventën vetëm për vendime të marra në një shtet tjetër kontraktues²²⁷. Por nëse nuk do të bëhej një deklaratë e tillë, atëherë zbatimi i Konventës do të ishte i vlefshëm për çdo vendim arbitrazhi të huaj, pavarësisht shtetit ku ishte marrë ai²²⁸.

iii). Reduktimi i shkaqeve refuzuese të njohjes së vendimeve të arbitrazhit. Gjykata (ose autoriteti tjetër kompetent) duhet të njohë dhe të zbatojë vendimin e arbitrazhit, me përjashtim të rastit kur pala që kundërshton njohjen dëshmon se ekziston një numër i kufizuar shkaqesh përjashtimore, të parashikuara në mënyrë shteruese në nenin V të Konventës. Këto përjashtime në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin, të parashikuara në nenin V(1), janë të kufizuara vetëm për shkelje të rregullave të natyrës procedurale që rregullojnë arbitrazhin, si dhe janë të dizenuara për të mbrojtur palët dhe integritetin e procesit të arbitrazhit. Në këtë mënyrë, autoriteti që vendos njohjen dhe zbatimin është i privuar nga mundësia që të marrë në shqyrtim nëse vendimi i arbitrazhit është i drejtë apo jo në themel.

Ndërkohë që neni V(2) është projektuar për të mbrojtur integritetin e ligjit të vendit ku kërkohet zbatimi, duke i lejuar autoritetit, ku është paraqitur kërkesa, të refuzojë të zbatojë

²²⁵ Çdo shtet mundet në bazë të parimit të reciprocitetit, të deklarojë se do të zbatojë dispozitat e Konventës për njohjen dhe ekzekutimin vetëm të atyre vendimeve, që janë dhënë në territorin e një shteti tjetër miratues të Konventës. Pra në këtë rast kufizimi nga detyrimi i përgjithshëm ka të bëjë me faktin se pranohen të zbatohen vetëm ato vendime arbitrazhi të marra në një shtet tjetër, i cili nga ana e tij njehtë të njëjtin detyrim reciprok ndaj shtetit të parë.

²²⁶ Çdo shtet mund të deklarojë se do ta zbatojë Konventën vetëm për vendimet e arbitrazhit të huaj, që dispojnë për mosmarrëveshje të lindura nga marrëdhëniet juridike, kontraktore ose jokontraktore, të cilat konsiderohen si marrëdhënie tregtare nga legjislacioni kombëtar i shtetit deklarues.

²²⁷ Rezerva e Reciprocitetit e parashikuar në nenin 1, paragrafi 2 të draftit zyrtar final të Komitetit ad hoc, ndërsa në tekstin final të Konventës parashikohet në nenin 1, paragrafi 3.

²²⁸ Raporti i Kom. për Zbatimin e Vend.Arbitrazhit Ndërkombëtar, nr.E/2704, E/AC.42/4/Rev.1, f.7, par.22.

vendimin e arbitrazhit në qoftë se “konflikti nuk është i aftë të zgjidhet me arbitrazh sipas ligjit të atij vendi”²²⁹, ose në qoftë se “njohja ose ekzekutimi i vendimit do të jetë në kundërshtim me politikën publike të atij vendi”²³⁰. Kjo dispozitë e fundit ndoshta ishte e nevojshme, por mund të përbente rrezik për frymën e Konventës. Lehtësisht, një parashikim i tillë mund të ishte parë si një ftesë ndaj gjykatës për të gjetur se zbatimi i një vendimi arbitrazhi, nga shteti ku zbatimi i ligjit është kërkuar, do të jetë në një farë mënyre kundër politikës së tij publike. Për fat të mirë, kjo dispozitë rrallë herë është përdorur për të refuzuar njohjen dhe zbatimin e një vendimi²³¹.

Ka një tjetër aspekt tjetër të rëndësishëm, që ia vlen të përmendet në këtë përshkrim të risive të Konventës. Drafti i përgatitur nga ICC parashikonte një vendim arbitrazhi “ndërkombëtar”, që nuk do të ishte subjekt i kontrollit të asnjë gjykate kombëtare. Është e lehtë të kuptohet se burimi i një vendimi të tillë “ndërkombëtar” do të kishte qenë ICC-ja vetë, edhe pse drafti natyrisht nuk shprehej kështu. Gjatë procesit të rishikimit të draftit në Kombet e Bashkuara, teksti u kthye në formulën më të familjarizuar dhe më të pranueshme për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit “të huaj”. Që nga ai moment, roli i shteteve dhe i juridiksioneve kombëtare në rregullimin e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar u afirmua dhe nuk u vu më asnjëherë në diskutim²³². Megjithatë, internacionalistët që besonin në nxjerrjen e arbitrazhit ndërkombëtar jashtë kufijve shtetëror, panvarësisht se mund të kishin humbur betejën, nuk kishin humbur luftën. Sikurse bëhet e qartë, kur konsiderohen zhvillimet e mëvonshme, perceptimi se ekziston një dukuri e tillë si “arbitrazhi ndërkombëtar tregtar” me një tendencë drejt rregullimeve uniforme, ka vazhduar të rritet²³³.

²²⁹ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5, par.2(a).

²³⁰ *Id.*, neni 5, par.2(b).

²³¹ Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë dhe Zhvillimin, “Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve – Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar”, Nju Jork dhe Gjenevë 2005; (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38), f.22

²³² *Id.*, f.23; Ndryshimi emërtimit të draftit në “vendimet e huaja të arbitrazhit”, është bërë pikërisht për shkak të lidhjeve që vendimi i arbitrazhit ka me juridiksionet nacionale. Kjo lidhje del qartë, psh., në nenet 3 dhe 5 e Konventës (neni 3 ...zbatimi në përputhje me rregullat e procedurës në territorin e shtetit ku vendimi është kërkuar të zbatohet; neni 5, pika 1(a) refuzimi sepse palët ... ishin të paafta për të vepruar, ose marrëveshja në fjalë nuk është e vlefshme sipas ... ligjit të vendit ku është dhënë vendimi; 1(d) përbërja e autoritetit të arbitrazhit ose e procedurës së arbitrazhit nuk ishte në përputhje ... me ligjin e vendit ku është zhvilluar; 1(e) vendimi ... është anuluar ose pezulluar nga organi kompetent i vendit në të cilin, ose sipas ligjit të të cilit është dhënë vendimi; 2(a/b) refuzim i njohjes kur objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi, ose njohja ose ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me rendin publik të vendit ku kërkohet njohja).

²³³ *Id.*, f.23.

IV.2. Barrierat ligjore të zbatimit të vendimeve të arbitrazhit të huaj përball instrumentave të Konventës - analizë teorike.

IV.2.1. Rregullat e procedurës dhe kushtet për zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj - kërkesa e palës së interesuar si kusht i domosdoshëm.

Fakti se arbitrazhi është detyruar dhe final për palët, mund të konfirmohet vetëm nga gjykatat shtetërore. Referuar dispozitave të Konventës, njohja dhe zbatimi i një vendimi arbitrazhi të huaj në një shtet që e ka miratuar konventën, bëhet nga një autoritet kompetent i këtij shteti (përgjithësisht organ gjyqësor²³⁴), i caktuar nga ligji i tij i brendshëm. Neni 3 i Konventës²³⁵ cilëson një ndarje shumë të rëndësishme midis *rregullave të procedurës dhe kushteve*, që duhet të aplikojë ky autoritet për njohjen e një vendimi arbitrazhi, që është objekt i Konventës së Nju Jork-ut. Rregullat e procedurës do të jenë ato të shtetit, ku kërkohet të njihet dhe të zbatohet vendimi i arbitrazhit. Neni 3 i Konventës konsiderohet si një bazë ligjore e mjaftueshme që mundëson ligjin e forumit të ndërhyrjës në rregullimin vetëm të atyre aspekteve që nuk janë rregulluar specifikisht nga Konventa, si psh. zbulimi i provave, koha limit për paraqitjen e kërkesës për njohje, heqja dorë nga kërkesa, etj. Por, këto rregulla procedurale nuk duhet të çenojnë në asnjë rast *kushtet* e njohjes, të cilat janë të përcaktuara ekskluzivisht në Konventën e Nju Jork-ut, në nenet 4, 5 dhe 6 të saj²³⁶.

Një kusht esencial, i parashikuar prej nenit 4 të Konventës, është ai që autoriteti kompetent i shtetit ku kërkohet njohja e vendimit të arbitrazhit, nuk mund të veprojë "kryesisht". Është e domosdoshme kërkesa e palës së interesuar, e cila ka gjithashtu barrën e provës për të provuar para autoritetit kompetent, ekzistencën e një vendimi arbitrazhi të huaj i cili disponon për palët, që janë të lidhura midis tyre me një marrëveshje arbitrazhi²³⁷. E njëjta dispozitë parashikon detyrimin e palës së interesuar të paraqesë vetëm dy dokumenta specifike, që kanë lidhje organike me çështjen: (a) vendimin e arbitrazhit që kërkohet të zbatohet dhe (b)

²³⁴ Konventa e Nju Jork-ut përdor termin "*autoriteti kompetent*", në neni 5 të saj. Ligji model, për këtë qëllim, specifikon një gjykatë, si organin kompetent që autorizon njohjen: (neni 35(1) i ligjit model - Një vendim arbitrazhi, pavarësisht nga vendi në të cilin është marrë, duhet të njihet si i detyrueshëm dhe, nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar *gjykatës kompetente*, do të ekzekutohet forcërisht). Në fakt, organi kompetent, ku paraqitet kërkesa për njohje, përcaktohet nga dispozitat e ligjit të brendshëm të çdo shteti, i cili rregullon njohjen e vendimeve të huaja të arbitrazhit (psh. Gjykata e Apelit në Shqipëri – nenet 395 dhe 399 të K.Pr.C).

²³⁵ Konventa e Nju Jork-ut, neni 3, fjalë e parë citon: Secili shtet kontraktues do të njohë vendimet e arbitrazhit si vendime, që i lidhin ato dhe do t'i zbatojnë ato në përputhje me rregullat e procedurës në territorin ku vendimi është kërkuar të zbatohet, sipas kushteve të përcaktuara në nenet vijuese.

²³⁶ Albert Jan van den Berg – "Konventa e Arbitrazhit të Nju Jork-ut e 1958: Drejt një interpretimi gjyqësor uniform", bot.Kluwer Law and Taxation, 1981, f.245.

²³⁷ Konventa e Nju Jork-ut, neni 4/1, para.(a) dhe (b): "*Për të siguruar njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit të huaj, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin duhet të paraqesë, në të njëjtën kohë me kërkesën: origjinalin e vendimit të arbitrazhit, të vërtetuar rregullisht ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur dhe origjinalin e marrëveshjes së arbitrazhit, ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur*"

marrëveshjen e arbitrazhit²³⁸ që përcakton juridiksionin e gjykatës së arbitrazhit. Këto janë të vetmet kërkesa, që pala e interesuar duhet të përmbushë dhe që duhet të mbahen mirë parasysh nga gjykata shtetërore, që autorizon njohjen. Edhe në rast se ndonjë prej dokumentave të mësipërm nuk mund të paraqitet në momentin e paraqitjes së aplikimit, kjo nuk çon automatikisht në rënien e kërkesës për njohje, sepse pala aplikuese mund t'i plotësojë ato më vonë gjatë procedimit²³⁹.

Në këtë këndvështrim, neni 4 i Konventës është miratuar për të lehtësuar procesin e njohjes dhe zbatimit të një vendimi arbitrazhi, duke parashikuar një minimum kërkesash që duhet të përmbushen nga pala e cila e kërkon këtë njohje²⁴⁰. Duke përmbushur këto kërkesa, pala e interesuar për zbatimin, krijon *prima facie*²⁴¹ një premisë që vendimi i arbitrazhit të njihet dhe zbatohet në të gjitha shtetet e tjera anëtare të Konventës. Pas tejkalimit të këtij momenti i takon tashmë palës tjetër (palës kundër të cilës drejtohet vendimi i arbitrazhit), të vërtetojë ekzistencën e një prej parashikimeve “penguese të njohjes”, sipas Konventës, me qëllim që të parandalojë njohjen ose zbatimin e vendimit të arbitrazhit.

Nëse do t'i referohemi dispozitave të Ligjit Model UNCITRAL "Për Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar"²⁴², mund të vërejmë se orientimi i tij në lidhje me dokumentacionin shoqëruar të kërkesës për njohje të një vendimi arbitrazhi të huaj, ka evoluar në drejtim të lehtësimit të procedurave. Dispozita e Ligjit Model²⁴³ fillimisht kërkonte, njëllor si Konventa e Nju Jork-ut, paraqitjen e vendimit të arbitrazhit dhe marrëveshjes së arbitrazhit si dokumenta të domosdoshëm shoqëruar të kërkesës për njohje. Amendimi i bërë kësaj dispozite në vitin 2006, pranonte si të vlefshme kërkesën për njohje, mjafton të shoqërohej

²³⁸ Konventa e Nju Jork-ut, në nenin 2, pika 1 bën këtë përkufizim: "*Marrëveshje arbitrazhi është marrëveshja e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër t'ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre, lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jokontraktore, që ka lidhje me një çështje e cila mund të rregullohet me arbitrazh*". Një përkufizim i tillë tenton të theksojë rëndësinë e vullnetit të palëve, për t'i nënshtuar arbitrazhit qoftë një mosmarrëveshje ekzistuese midis tyre (*kompromis*), sikundër dhe një mosmarrëveshje të ardhme, që ende s'ka lindur (*klauzolë kompromisi*).

²³⁹ Albert Jan van den Berg – “Konventa e Arbitrazhit të Nju Jork-ut e 1958: Drejt një interpretimi gjyqësor uniform”, bot.Kluwer Law and Taxation, 1981, f.262-263.

²⁴⁰ Albert Jan van den Berg – “Konventa e Nju Jork-ut e 1958: Një përmbledhje”; “Zbatimi i Marrëveshjeve të Arbitrazhit dhe Vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar”, ed.Emmanuel Gaillard & Domenico Di Pietro, (bot.Londër: Cameron May) 2008, f.12-13.

²⁴¹ Çështje prima facie - *Një çështje në të cilën provat e paraqitura bashkë më kërkesën janë të nevojshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e një gjykimi, me përjashtim të rastit nëse prova/provat është kontestuar; prima facie - Një fakt i cili supozohet të jetë i vërtetë, me përjashtim të rastit nëse është përgënjeshtuar.*

²⁴² Ligji Model UNCITRAL “Për Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar”, miratuar nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare më 21 qershor 1985, amenduar në 7 korrik 2006 (dokument nr.A/40/17 dhe nr.A/61/17, annex I).

²⁴³ Ligji Model UNCITRAL, neni 35, paragrafi 2, sikurse është miratuar fillimisht në 1985.

me vendimin e arbitrazhit, duke eliminuar kërkesën për paraqitjen domosdoshmërisht të marrëveshjes së arbitrazhit.

IV.2.2. Pengesat lëndore të zbatimit të vendimeve dhe veçoritë e aplikimit të tyre - analizë e tipareve të shkaqeve refuzuese të zbatimit, sipas Konventës së Nju Jork-ut.

Në vijim të shpjegimit të kushteve të njohjes, neni 5 i Konventës, i cili është i ndarë në dy paragrafe, përfshin bazat apo shkaqet që justifikojnë refuzimin e njohjes dhe zbatimit të një vendimi arbitrazhi të huaj. Paragrafi i parë liston shkaqet e refuzimit, të cilat duhet të provohen nga i padituri (pala kundër të cilës drejtohet njohja e vendimit)²⁴⁴. Kjo palë në këtë rast ka barrën e të provuarit të ekzistencës së një apo disa shkaqeve penguese të njohjes, për rastin prezent. Kjo listë shteruese e shkaqeve refuzuese të njohjes, paraqitet si më poshtë:

- a. Pazotësi e palëve apo pavlefshmëri e marrëveshjes së arbitrazhit.
- b. Dhunim i parimit të një procesi të drejtë dhe të ndershëm.
- c. Kapërcim i autoritetit të forumit të arbitrazhit.
- d. Parregullsi në kompozimin e forumit, apo në procedurën e arbitrazhit.
- e. Vendimi i arbitrazhit nuk është bërë detyrues, është anuluar apo pezulluar²⁴⁵.

Grupi i dytë i kushteve “penguese” të zbatimit, të cilat mund të ngrihen apo të pretendohen në gjykim edhe nga vetë organi gjyqësor i investuar për njohjen dhe zbatimin e vendimit të arbitrazhit, me inisiativën e tij (ex officio), përbëhet nga dy kritere si më poshtë:²⁴⁶

- a. Arbitrueshmëria e objektit të mosmarrëveshjes.
- b. Çështje të tjera të politikës publike²⁴⁷.

IV.2.2.1. Tiparet e përgjithshme që paraqesin kushtet e njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit, në kuadër të efektit të Konventës.

Në përgjithësi, fryma e manifestuar në praktikë nga implementimi i dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut, ka qenë lehtësimi në tërësi i procedurave të zbatimit të një vendimi arbitrazhi, çka përputhet me qëllimin kryesor të Konventës, i cili është të sigurojë efikasitetin

²⁴⁴ Konventa e Nju Jorkut, neni 5, par.1.

²⁴⁵ Shiko *infra* nënseksionin III.2.b.2; III.2.b.3 dhe III.2.b.4, mbi analizën e nenit 5, par.1, pika (a)(b)(c)(d)(e)

²⁴⁶ Konventa e Nju Jorkut, neni 5, par.2.

²⁴⁷ Shiko *infra* nënseksionin III.2.b.5, mbi analizën e nenit 5, par.2, pika (a)(b).

e vendimeve arbitrale, duke limituar shkaqet për të cilat një gjykatë shtetërore mund të refuzojë njohjen e tyre²⁴⁸. Formulimi i këtyre dispozitave²⁴⁹, favorizon opinionin pro-zbatueshmërisë së vendimeve të arbitrazhit, duke garantuar kufizimin e pengesave të zbatimit. Në fakt kjo ka qenë edhe mënyra sesi këto dispozita janë vlerësuar përgjithësisht nga gjykatat në praktikë. Kështu në çështjen “American Construction Machinery & Equipment Corp.Ltd. kundër Mechanised Construction of Pakistan Ltd”²⁵⁰, Gjykata konstatoi se *ekziston një frymë apo një paragjykim i përgjithshëm pro zbatueshmërisë së vendimeve të arbitrazhit, i manifestuar në Konventën e Nju Jork-ut*. Po kështu, Gjykata Supreme e SHBA, është shprehur se: *qëllimi i Konventës së Nju Jork-ut ishte të inkurajonte njohjen dhe zbatimin e marrëveshjeve të arbitrazhit tregtar në kontratat ndërkombëtare, si dhe të unifikonte standartet, sipas të cilave marrëveshjet e arbitrazhit mbikqyren dhe vendimet e arbitrazhit zbatohen në shtetet anëtare të Konventës*.²⁵¹

Tiparet kryesore të shkaqeve refuzuese të njohjes dhe zbatimit të një vendimi arbitrazhi, sipas parashikimeve të nenit 5 të Konventës, te cilat janë pothuajse unanimisht të pranuar nga gjykatat nacionale, paraqiten si më poshtë: *Së pari*, lista e shkaqeve refuzuese të zbatimit të një vendimi arbitrazhi, është shteruese dhe nuk mund të pranojë shkaqe të tjera²⁵². *Së dyti*, gjykata, para të cilës është kërkuar njohja dhe zbatimi, nuk mund të vlerësojë themelin e vendimit të arbitrazhit, sepse një gabim në faktet apo në bazën ligjore të vendimit nga forumi i arbitrazhit, nuk është parashikuar si një shkak për refuzimin e vendimit, sipas nenit 5. *Së treti*, pala, kundër të cilës është kërkuar zbatimi i vendimit, ka barrën e provës për të vertetuar ekzistencën e shkaqeve refuzuese, të listuara në menyre shteruese në paragrafin e parë të nenit 5. *Së katërti*, një tipar i rëndësishëm është interpretimi ngushtësisht prej gjykatave të shkaqeve refuzuese të zbatimit, të parashikuara në nenin 5 të Konventës. *Së fundmi*, është i debatueshëm fakti se, në çështjet ku një nga shkaqet për refuzimin e zbatimit të vendimit është prezent, gjykatës kompetente gjithsesi i njihet pushteti diskrecional për të njohur dhe

²⁴⁸ Tibor Varady, John J.Barcelo - “Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Një “Perspektivë Transnacionale” (American Casebook Series), botimi i katërt, 2009, f.840-841.

²⁴⁹ Veçanërisht nenet 4, 5 dhe 6, që rregullojnë kushtet e njohjes dhe shkaqet ligjore që e pengojnë atë.

²⁵⁰ Çështja e referuar: 659 F. Supp. 426 (S.D.N.Y.), 828 F.2d 117 (2d Cir. 1987).

²⁵¹ Çështja e referuar: Scherk kundër Alberto-Culver Co., 417 U.S. 506, 520 n. 15 (1974).

²⁵² Qëllimi kryesor i Konventës së Nju Jork-ut, në këtë kuadër, është të sigurojë efikasitetin e vendimit të arbitrazhit, duke limituar bazat apo shkaqet mbi të cilat një gjykatë nacionale mund të refuzojë të njohë dhe të zbatojë një vendim arbitrazhi. Zbatimi i një vendimi mund të refuzohet “vetëm nëse” pala e interesuar provon ekzistencën e një prej shkaqeve të refuzimit, ose “vetëm nëse” gjykata konstaton se zbatimi në vetvete dhuron politikën publike kombëtare apo ndërkombëtare të atij shteti.

zbatuar vendimin e arbitrazhit në ato çështje ku ajo gjykon se pesha e këtij shkak është minimale²⁵³.

IV.2.2.2. Pavlefshmëria e marrëveshjes, procesi i parregullt dhe mos-respektimi i kufirit të autoritetit të arbitrit - shkaqe qër për ligjin refuzimin e njohjes.

*i). Pazotësia e palëve dhe pavlefshmëria e marrëveshjes së arbitrazhit - Palët në marrëveshjen e arbitrazhit, në baze të ligjit të zbatueshëm për to, ishin të pa afta për të vepruar, apo marrëveshja e arbitrazhit nuk është e vlefshme sipas ligjit, të cilit ia kanë nenshtuar palët, ose kur mungon përcaktimi i mësipërm, sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi*²⁵⁴.

Paaftësia e palëve, si kusht për të refuzuar zbatimin e vendimit të arbitrazhit, ka një histori të sajën. Sipas Konventës së Gjenevës (1927), paaftësia ligjore shtrihej deri në pasojën e përfaqësimit jo të duhur në procesin e arbitrazhit të palës “humbëse”²⁵⁵. Ndërkohë që, në kuptim të Konventës së Nju Jork-ut, paaftësia ligjore e një pale si kriter refuzimi, ka të bëjë me paaftësinë e kësaj pale për të përfunduar një marrëveshje arbitrazhi. Në këtë pikë duhet theksuar se Konventa e Nju Jork-ut, nuk përjashton faktin që një shtet apo një organ publik të jetë palë në një marrëveshje arbitrazhi apo në një vendim arbitrazhi me një palë private, në lidhje me një marrëdhënie të së drejtës private që ka të bëjë me një akt *jure gestionis*²⁵⁶. Ndërsa, përfaqësimi jo i duhur i një pale në procedimin arbitral, mund të pretendohet si një shkak për refuzimin e zbatimit të vendimit, por duke i’u referuar dispozitës së nenit 5/1(b) të Konventës, për të cilën flitet më poshtë.

Përsa i përket shprehjes “*marrëveshja e arbitrazhit nuk është e vlefshme*”, kjo mund të përdoret si shkak për refuzimin e zbatimit të një vendimi arbitrazhi, në referencë të nenit 5/1(a), vetëm në disa raste, psh. kur *mungon pëlqimi palëve për të lidhur marrëveshje*, apo kur sipas ligjit të aplikueshëm *kërkohen disa kushte specifike të elementëve të marrëveshjes së arbitrazhit*. Ndërsa disa raste të tjera, që në kuptimin e përgjithshëm bien në sferën e konceptit të *pavlefshmërisë ligjore së marrëveshjes*, trajtohen specifikisht dhe drejtëpërdrejt nga dispozita të tjera të Konventës së Nju Jork-ut. Kështu psh. rasti kur *marrëveshja e*

²⁵³ Albert Jan van den Berg, “Konventa e Nju Jork-ut e 1958: Një përmbledhje”, f.13-14.

²⁵⁴ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(1)(a).

²⁵⁵ Konventa e Gjenevës “Për ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit” (1927), neni 2(b): “*njohja dhe zbatimi i vendimit do të refuzohen...nëse pala, kundër të cilës është dhënë vendimi, e ndodhur në paaftësi ligjore, nuk ka mundur të përfaqësohet në proces saktësisht...*”.

²⁵⁶ Acta jure gestionis – term latin për “të vepruar sipas të drejtës për të manaxhuar”. Përdoret shpesh në të Drejtën Ndërkombëtare Private, duke iu referuar akteve apo aktiviteteve të një natyre tregtare që ndërmerren nga një shtet i huaj apo agjensitë e tij vartëse. Këto akte nuk janë imune prej juridiksionit dhe procedimit të gjykatave lokale (kombëtare), sipas doktrinës moderne të imunitetit të kufizuar të sovranitetit të huaj.

arbitrazhit nuk ka formën e shkruar, çka sjell pavlefshmërinë e saj, mund të pretendohet si një shkak për refuzimin e zbatimit të vendimit të arbitrazhit, por duke i'u referuar shkeljes së rregullit të nenit 2/2 të Konventës²⁵⁷, i cili specifikisht rregullon formën e marrëveshjes së arbitrazhit. Po kështu, mosarbitrueshmëria e çështjes në themel të mosmarrëveshjes mund të pretendohet si një shkak refuzues, por mbulohet nga parashikimi i nenit 5/2(a) i Konventës. Ndërsa çështja e përbërjes së forumit të arbitrazhit, për t'u trajtuar si shkak refuzues duhet t'i referohet nenit 5/1(d)²⁵⁸.

ii). Cënimi i një procesi të drejtë dhe të ndershëm - Palës kundër së ciles jepet vendimi nuk i është dhënë njoftimi i duhur për caktimin e arbitrit ose të procedurës së arbitrazhit, ose, ka qenë e paaftë për të paraqitur rastin e saj²⁵⁹.

Në këtë rast parashikohet kundërshtimi i njohjes dhe zbatimit të vendimit të arbitrazhit të huaj për shkak të shkeljes së parimit të "procesit të rregullt", i cili konsiderohet si një e drejtë themelore për palët. Në lidhje me këtë shkak refuzues, Gjykata e Apelit e SHBA ka deklaruar se *“ky parashikim esencialisht sanksionon aplikimin e standarteve të shtetit të forumit për një proces të rregullt”²⁶⁰*. Parashikimi i kësaj dispozite i referohet parimeve themelore të procedurës së gjykimit, të referuara ndryshe si *“audi et alteram partem”²⁶¹*.

Pavarësisht se pretendimi i dhunimit të parimit të procesit të rregullt gëzon një popullaritet të madh, midis shkaqeve kundërshtuese të njohjes, ky kundërshtim i referuar në këtë dispozitë, rrallë herë ka rezultuar i suksesshëm. Kjo për faktin se gjykatat kanë zbatuar parimin e përgjithshëm të interpretimit të nenit 5 të Konventës, sipas të cilit *shkaqet e refuzimit të njohjes duhet të interpretohen ngushtësisht*. Interpretimi “i ngushtë” i shkakut refuzues të mësipërm, parashikuar nga neni 5/1(b), bëhet evident kur gjykatat deklarojnë se shkelja e parimit të “procesit të rregullt” në nivel të brendshëm apo kombëtar nuk përbën domosdoshmërisht shkelje të parimit të “procesit të rregullt” në një çështje ku vendimi objekt gjykimi është i huaj²⁶².

²⁵⁷ Konventa e Nju Jork-ut, neni 2(2): *Termi “marrëveshje e shkruar” do të përfshijë një klauzolë arbitrazhi në një kontratë, ose një marrëveshje arbitrazhi e nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash ose telegramesh.*

²⁵⁸ Albert Jan van den Berg, “Konventa e Nju Jorkut 1958: Një përmbledhje”, f.14.

²⁵⁹ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(1)(b).

²⁶⁰ Gjykata e Apelit të SHBA, 23.12.1974, çështja “Parsons & Whittemore Overseas Co., Inc.(shkurt Overseas)” një kompani amerikane kundër “Societe Generale de L’industrie du Papier (shkurt RAKTA)” një kompani Egjiptiane.

²⁶¹ Audi alteram partem (ose audiatur et altera pars) – shprehje latine: “duhet të dëgjohet edhe pala tjetër”. Kjo shprehje përdoret shpesh për t’iu referuar parimit se “asnjë person nuk duhet të gjykohet pa patur një dëgjim të ndershëm, në të cilën sejcilës palë i jepet mundësia për t’iu përgjigjur provave kundër saj”.

²⁶² Albert Jan van den Berg, “Konventa e Nju Jorkut 1958: Një përmbledhje”, f.15.

iii). Kapërcim i autoritetit të forumit të arbitrazhit - Vendimi i arbitrazhit trajton një mosmarrëveshje të paparashikuar apo që nuk përfshihet brenda kushteve që i nënshtrohen arbitrazhit, ose ai përmban vendime për çështje që kalojnë fushën që i nënshtrohet arbitrazhit, me kusht që, nëse vendimet për çështjet që i nënshtrohen arbitrazhit mund të ndahen nga ato që nuk i nënshtrohen, ajo pjesë e vendimit që përmban çështje që i nënshtrohen arbitrazhit mund të njihet dhe të ekzekutohet²⁶³.

Shkaku i refuzimit, i parashikuar në klauzolën e mësipërme, mund të ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë i referohet atij vendimi arbitrazhi i konsideruar si *ultra apo extra petita*²⁶⁴, që përmban disponime përtej kërkesave të parashtruara prej palëve, pra, që tejkalojnë autoritetin e arbitrit, çka përbën shkak për refuzimin e zbatimit të tij. Ndërsa pjesa e dytë e klauzolës ka të bëjë me mundësinë për zbatueshmërinë pjesore të vendimit të arbitrazhit, vetëm për atë pjesë përmbajtja e të cilës nuk tejkalon në disponim autoritetin e arbitrit.

Rastet e trajtuara nga kjo dispozitë nuk përfshijnë rastin e mungesës së kompetencës së arbitrit për shkak të një marrëveshjeje të pavlefshme arbitrazhi, pasi kjo çështje rregullohet posaçërisht nga neni 5/1(a) i Konventës. Sikundër shkaqet e tjera refuzuese, të parashikuara në nenin 5, edhe shkaku i parashikuar nga paragrafi 1(c) i tij, i nënshtrohet parimit të interpretimit në mënyrë të ngushtë të aplikimit. Në çdo rast ky shkak nuk mund të çojë në rivlerësim, nga ana e gjykatës ku është kërkuar njohja, të themelit të vendimit të arbitrazhit që është kërkuar të njihet dhe zbatohet²⁶⁵.

IV.2.2.3. Veçoritë e shkakut refuzues të parregullsive në kompozimin e forumit, apo në procedurën e arbitrazhit - Përbërja e autoritetit të arbitrazhit ose e procedurës së arbitrazhit nuk është në përputhje me marrëveshjen e palëve, ose kur mungon një marrëveshje e tillë, nuk është në përputhje me ligjin e vendit ku është zhvilluar arbitrazhi²⁶⁶;

Parashikimi i këtij shkakut refuzues nga draftuesit e Konventës së Nju Jork-ut ka patur si qëllim kryesor të reduktojë rolin e ligjit të vendit ku zhvillohet arbitrazhi, në procedurën e njohjes dhe zbatimit të tij. Ky qëllim del në pah nëse krahasojmë dispozitën e mësipërme (neni 5/1(d) i Konventës) me parashikimin që bënte për të njëjtën çështje Konventa e Gjenevës, e vitit 1927. Sipas kësaj të fundit, zbatimi i vendimit të arbitrazhit mund të

²⁶³ Konventa e Nju Jorkut, neni 5(1)(c).

²⁶⁴ *ultra (extra) petita partium* - vendim i cili diponon përtej kërkesave të bëra nga palët.

²⁶⁵ Albert Jan van den Berg, "Konventa e Nju Jorkut 1958: Një përmbledhje", f.15.

²⁶⁶ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(1)(d).

refuzohej nëse *përbërja e autoritetit të arbitrazhit ose e procedurës së arbitrazhit nuk ishte në përputhje me marrëveshjen e palëve dhe me ligjin e vendit ku ishte zhvilluar arbitrazhi (që rregullon procedurën)*²⁶⁷. Pra, edhe kur kishte marrëveshje midis palëve për çështjet e mënyrës së kompozimit të forumit, apo rregullimit të procedurës së arbitrazhit, nëse këto çështje nuk ishin në përputhje (sado e vogël dhe e parëndësishme të ishte mospërputhja) me dispozitat e ligjit të brendshëm të vendit të arbitrazhit, atëherë vendimit të arbitrazhit rrezikohej t'i refuzohej zbatimi. Ndërkohë që draftuesit e Konventës së Nju Jork-ut gjykuan t'i lënë autoritet ligjit të vendit të arbitrazhit mbi këto çështje, vetëm atëherë kur mungon një marrëveshje për këtë qëllim midis palëve. Supremacia e marrëveshjes së palëve mbi ligjin e vendit të arbitrazhit, nënkupton se edhe në rastin kur normat e aplikimit të detyrueshëm (mandatory rules) të vendit të arbitrazhit janë cënuar nga mënyra e kompozimit të forumit apo rregullimi i procedurës së arbitrazhit, përsëri kjo nuk konsiderohet një shkak për refuzimin e zbatimit të vendimit të arbitrazhit në një shtet tjetër²⁶⁸.

IV.2.2.4. Rrëzimi i vendimit të arbitrazhit në vendin e origjinës – shkak për mosnjohjen e tij²⁶⁹.

i. Vendimi i arbitrazhit nuk është bërë i detyrueshëm për palët.

Përsa i përket termit “i detyrueshëm”, duhet përmendur fakti se debati në këtë pikë, në momentin e draftimit të Konventës, ka qenë i gjerë përsa i përket përdorimit të termave analogë si “final” (termi i përdorur nga Konventa e Gjenevës 1927), “i formës së prerë”, “operativ”, “i mundshëm për tu zbatuar”, etj. Në fakt interpretimi i bërë nga shumë gjykata, deri në atë kohë, për termin “final” të parashikuar nga Konventa e Gjenevës, ishte i tillë që kërkonte, për zbatimin e vendimit të arbitrazhit të huaj, një *exequatur* (akt ekzekutimi) të leshuar nga gjykata e shtetit të origjinës. Në kushtet kur autoriteti kompetent i shtetit, ku kërkohet ekzekutimi i vendimit, kërkonte për këtë qëllim një tjetër akt ekzekutimi, interpretimi në praktikë i referohej sistemit të ashtuquajtur “akt ekzekutimi i dyfishtë” apo “double-exequatur”. Për të shmangur këtë gjë, draftuesit e Konventës së Nju Jork-ut përdoren termin “i detyrueshëm” apo “detyrues”, në vend të termit “final”. I njëjti qëndrim është afirmuar unanimisht edhe nga gjykatat shtetërore, në interpretimet e bëra pas miratimit të Konventës së Nju Jork-ut. Sipas tyre termi “i detyrueshëm” për vendimin e arbitrazhit

²⁶⁷ Konventa e Gjenevës (1927), neni 1, pika (c).

²⁶⁸ Albert Jan van den Berg, “Konventa e Nju Jork-ut e 1958: Një përmbledhje”, f.16.

²⁶⁹ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(1)(e): *vendimi nuk është bërë ende i detyrueshëm për palët, ose është anuluar ose pezulluar nga organi kompetent i vendit në të cilin, ose sipas ligjit të të cilit është dhënë vendimi.*

duhet interpretuar se eleminon të ashtuquajturën kërkëse për “*double exequatur*”. Në këtë mënyrë nuk mund të kundërshtohet zbatimi i një vendimi arbitrazhi të huaj, në një shtet të caktuar, me pretendimin se në vendin e origjinës së vendimit nuk është miratuar për të, një urdhër ekzekutimi nga një gjykatë kompetente²⁷⁰.

ii. Vendimi i arbitrazhit është anuluar në vendin e origjinës.

Gjithnjë është shtruar pyetja nëse rrethana, që vendimi i arbitrazhit është anuluar në vendin e origjinës, duhet të çojë në një refuzim të zbatimit të këtij vendimi. Pikëpamja franceze është se një anulim në vendin e origjinës duhet të injorohet krejtësisht. Gjykatat Franceze arrijnë në këtë rezultat pasi mbështeten në të drejtën e tyre të brendshme, duke i'u referuar për zbatimin e vendimeve të huaja (ndërkombëtare) të arbitrazhit parimit të "dispozitës më të favorshme" të ofruar si mundësi prej nenit 7/1 të Konventës së Nju Jork-ut²⁷¹. Në fakt ligji Francez për zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit nuk përfshin si bazë për refuzimin e zbatimit rastin kur vendimi është anuluar në një vend tjetër. Ndërkohë që shumica dërrmuese e gjykatave në shtetet e tjera, palë të Konventës, nuk zbatojnë vendimet e arbitrazhit të cilat janë anuluar në vendin e origjinës²⁷².

E ndryshme paraqitet situata, në rastin kur pala e interesuar ka aplikuar për anulimin apo pezullimin e vendimit të arbitrazhit në shtetin e origjinës dhe ky aplikim është në pritje për t'u shqyrtuar. Në këtë rast, sipas nenit 6 të Konventës, një gjykatë shtetërore ka të gjithë autoritetin të vlerësojë rastin dhe të shtyjë (pezullojë) ose jo vendimin e saj për zbatimin e vendimit të arbitrazhi të huaj²⁷³. Sikurse rezulton nga praktika, gjykatat kanë mbajtur qëndrimin se pezullimi jopërfundimtar i një vendimi arbitrazhi, për shkak të veprimit të ligjit

²⁷⁰ Një Gjykatë Franceze në shqyrtimin e kërkesës për zbatimin e një vendimi arbitrazhi të marrë në Gjermani, refuzoi objeksionin e ngritur nga i padituri Francez se nuk është lëshuar një mjet (akt, urdhër) ekzekutimi për këtë vendim arbitrazhi nga një gjykatë Gjermane. Gjykata Franceze argumentoi se Konventa e Nju Jorkut e ka hedhur poshtë sistemin e “double exequatur” (Tribunal de grande instance – Dhoma e Tregtise – e Strasburgut, 9 tetor 1970; çështja Animalfeeds International Corp. kundër S.A. A.Becker et Cie (France no.2)). Po kështu, Gjykata Supreme Italiane, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykes së Apelit të Firences, e hodhi poshtë pretendimin e të paditurit Italian se gjykata amerikane duhet të kishte miratuar një urdhër ekzekutimi për një vendim arbitrazhi të marrë në SHBA, në mënyrë që ky vendim të ekzekutohej në Itali (Gjykata e Kasacionit, 15 prill 1980, no.2448, çështja Lanificio Walter Banci S.a.S. kundër Bobbie Brooks Inc. (Italy no.40), duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit të Firences, 8 tetor 1977, (Italy no.29)).

²⁷¹ Konventa e Nju Jork-ut, neni 7(1) - Dispozitat e kësaj Konvente nuk do t'i heqin (mohojnë) çdo pale të interesuar të drejtën që ai mund të ketë në dobi të vet, nga një vendim arbitrazhi, në mënyrën dhe në masën e lejuar nga ligji apo traktatet e vendit ku një vendim i tillë është kërkuar të mbështetet.

²⁷² Albert Jan van den Berg, “Konventa e Nju Jork-ut e 1958: Një përmbledhje”, f.17.

²⁷³ Konventa e Nju Jork-ut, Neni 6: *Në qoftë se një kërkesë për anulimin ose pezullimin e vendimit është bërë pranë një organi kompetent në bazë të nenit 5(1)(e), autoriteti në të cilin kërkohet zbatimi, në rast se e konsideron me vend, e shtyn vendimin për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit dhe mundet gjithashtu që, me kërkesën e palës që kërkon ekzekutimin e vendimit, të urdhërojë palën tjetër të japë garancira të përshtatshme.*

të shtetit të origjinës së tij (psh. rasti kur ka nisur një praktikë anullimi në këtë shtet), nuk është i mjaftueshëm për refuzimin e zbatimit të këtij vendimi në një shtet tjetër²⁷⁴.

Shkaqet e anullimit të një vendimi arbitrazhi ndërkombëtar janë parashikuar, ndër të tjera, edhe në dispozitat e Konventës Europiane "Mbi arbitrazhin tregtar ndërkombëtar"²⁷⁵, apo në Ligjin Model UNCITRAL²⁷⁶. Në fakt, shkaqet e parashikuar nga Konventa Europiane për anullimin e një vendimi arbitrazhi ndërkombëtar janë thelbësisht të ngjashme me ato të parashikuara nga Konventa e Nju Jork-ut për refuzimin e zbatimit të një vendimi arbitrazhi të huaj, të parashikuar nga pika (a) deri në pikën (d) të nenit 5(1). E njëjta gjë mund të thuhet edhe për shkaqet e anullimit të parashikuara nga Ligji Model, të cilat janë një përsëritje e atyre të Konventës Europiane.

IV.2.2.5. Arbitrueshmëria dhe Politika Publike – mbrojtja më e mirë kundër njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj.

i) *Klauzola e arbitrueshmërisë*²⁷⁷ lejon një gjykatë nacionale të refuzojë zbatimin e një vendimi arbitrazhi, me inisiativën e saj, nëse themeli i çështjes nuk mund të zgjidhet në arbitrazh, sipas ligjit të shtetit ku kërkohet zbatimi. Mos-arbitrueshmëria e një çështje objekt mosmarrëveshje reflekton një interes specifik kombëtar për zgjidhjen gjyqësore më shumë sesa për zgjidhjen me arbitrazh të kësaj mosmarrëveshjeje.

Në fakt, arbitrueshmëria është konsideruar përgjithësisht si pjesë përbërëse e konceptit të politikës publike (rendit publik) dhe si e tillë ajo ka një trajtim të ndryshëm nga njëri shtet në tjetrin. Ende sot shtetet vazhdojnë të bëjnë dallimin midis fushave ku interesi dhe kontrolli publik janë të dobëta dhe atyre ku shoqëria (shteti) ka interesa të forta. Mosmarrëveshjet që i përkasin fushave të para konsiderohen të arbitrueshme, ndërsa ato që i përkasin fushave me interes të fortë publik i rezervohen për shqyrtim dhe zgjidhje gjykatave nacionale apo autoriteve të tjera publike. Çështja e arbitrueshmërisë bëhet kështu një nga pyetjet më të rëndësishme në procesin e arbitrazhit²⁷⁸. Kësaj pyetje i përgjigjen në mënyrë individuale sistemet juridike nacionale, ligj-bërësit e të cilëve (qofshin këto parlamente apo gjykata)

²⁷⁴ Albert Jan van den Berg, "Konventa e Nju Jork-ut e 1958: Një përmbledhje", f.18.

²⁷⁵ Konventa Europiane "Mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar", Gjenevë më 21 Prill 1961, Neni 9 "Anulimi i vendimit të arbitrazhit": *Anulimi një njërin shtet kontraktues i një vendimi të arbitrazhit, që është parashikuar nga kjo Konventë, do të përbëjë vetëm një bazë refuzimi të njohjes ose të zbatimit në një shtet tjetër kontraktues....*

²⁷⁶ Ligji Model UNCITRAL, neni 34.

²⁷⁷ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(2)(a).

²⁷⁸ Tibor Varady, John J.Barcelo - "Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Një "Perspektivë Transnacionale" (Seria Amerikane e librave të çështjeve), botimi i katërt, 2009, f.232.

përcaktojnë, sipas politikave të shteteve të tyre, se cilat janë fushat, konfliktet e të cilave mund t'i nënshtrohen arbitrazhit. Ndërkohë që, Konventa e Nju Jork-ut panvarësisht se, në mënyrë të eksplicite por dhe të nënkuptuar, parashikon se mos-arbitrueshmëria mund të rrëzojë një marrëveshje arbitrazhi²⁷⁹, apo mund të pengojë zbatueshmërinë e një vendimi arbitrazhi²⁸⁰, nuk merr përsipër të definojë konceptin.

Doktrina e mos-arbitrueshmërisë së konfliktit, përgjithësisht, reflekton mosbesimin ndaj arbitrave, apo institucioneve të përhershme të arbitrazhit, për zgjidhjen në mënyrën e duhur të mosmarrëveshjeve në fushat ku interesi publik është shumë i madh. Arsyet se ku bazohet ky mosbesim ndaj arbitrazhit janë disa: *Së pari*, arbitrat nuk ka nevojë të jenë juristë, çka do të thotë që arbitrat nuk është e nevojshme të vlerësojnë gjitha kuadrin ligjor që rregullon marrëdhënien (ndërkohë që për të mund të ketë shumë interes publik); *Së dyti*, arbitrazhi, përgjithësisht, nuk siguron një proces rishikimi (apelimi) të vendimit që prodhon, në mënyrë që të korrigjohen gabimet eventuale, të cilat mund të çënojnë marrëdhënien, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë shkaqet ligjore të kundërshtimit të vendimit; *Sw treti*, përgjithësisht, në arbitrazh mungon *procesi i detyrueshëm*, që zgjidh konfliktin bazuar vetëm në të drejtën pozitive. Edhe më domethënës nga arsyet e mësipërme, është “shqetësimi” që arbitrat deri në njëfarë mase, shumë më tepër sesa gjyqtarët e gjykatave të zakonshme, kushtëzohen nga palët, për faktin e thjeshtë se autoriteti i tyre legjitimohet prej marrëveshjes së palëve për arbitrazh. Kjo do të thotë se, përgjithësisht, pritet që arbitrat të jenë shumë të influencuar prej marrëveshjes së palëve, panvarësisht se bëhet fjalë për ato fusha të cilat rregullohen nga dispozita urdhëruese (imperative) dhe në të cilat prevalon shqetësimi publik për pabarazinë e palëve për të bërë marrëveshje. Në të njëjtat kushte, gjykatat kombëtare do të orientoheshin drejt mosrespektimit, apo respektimit më pak, të atyre marrëveshjeve të palëve që nuk respektojnë *politikën publike*, duke theksuar kështu rëndësinë e *mandatory rules* dhe të interesit publik²⁸¹.

Praktika gjyqësore tregon se pretendimi i mos-arbitrueshmërisë së themelit të konfliktit është ngritur në një numër të vogël çështjesh, bazuar në parashikimet e Konventës së Nju Jork-ut. Kjo ka çuar në refuzimin e njohjes së vendimeve të arbitrazhit në vetëm pak raste, si rezultat i këtij pretendimi²⁸². Në fakt, praktika gjyqësore e ka zgjerur sferën e arbitrueshmërisë, duke argumentuar dhe disponuar në vendimet e saj, se arbitrazhi mund të mbulojë edhe

²⁷⁹ Konventa e Nju Jork-ut, neni 2(3).

²⁸⁰ *Id.*, neni 5(2)(a).

²⁸¹ Tibor Varady, John J.Barcelo - “Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Një “Perspektivë Transnacionale”, 2009, f.234.

²⁸² Albert Jan van den Berg – “Konventa e Nju Jork-ut e 1958: Një përmbledhje”, f.18.

mosmarrëveshje në fushën e sigurisë dhe të së drejtës antitrust, të cilat tradicionalisht janë trajtuar si *politikë publike* e shtetit²⁸³. Kështu, në çështjen para Gjykatës Supreme të SHBA, të *Scherk* kundër *Alberto-Culver Co*, gjykata mbajti qëndrimin se në një çështje që involvon tregtinë ndërkombëtare, politikat e Aktit Federal të Arbitrazhit, do të prevalojnë mbi politikat e Aktit të Shkëmbimit të Sigurisë²⁸⁴. Për rrjedhojë, gjykata mbeshteti arbitrazhin për zgjidhjen e pretendimeve mbi mashtrimet në çështjet e sigurisë. Është e qartë se qëndrimi i gjykatave është influencuar nga nevoja për të promovuar tregtinë ndërkombëtare, sikurse edhe për të përfituar disa uniformitete në arbitrazhin ndërkombëtar tregtar.²⁸⁵ Kjo çështje themeloi qëndrimin e gjykatave amerikane se marrëveshjet e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare kërkonin një interpretim më të ngushtë të konceptit të mos-arbitrueshmërisë, në krahasim me kontekstin kombëtar²⁸⁶.

ii) *Klauzola e politikës publike*²⁸⁷ lejon një gjykatë, që me kërkesën e paditësit apo *sua sponte* (me inisiativën e saj), të refuzojë njohjen dhe zbatimin e një vendimi arbitrazhi të huaj, nëse zbatimi i vendimit do të ishte në kundërshtim me politikën publike të shtetit (të forumit) ku kërkohet njohja dhe zbatimi. Për shembull në çështjen *Soleimany* kundër *Soleimany*²⁸⁸, gjykata angleze refuzoi të zbatonte një vendim arbitrazhi, bazuar në shkakun e politikës publike, sepse kontrata e palëve ishte lidhur (mbështetur) në evazionin fiskal sipas legjislacionit Iranian, ndërkohë që kjo konsiderohej si cënim i politikës publike Angleze.

Historia e parashikimeve legjislative nuk ofron udhëzues të qartë të gjërësisë së kuptimit të termit "rend publik", apo "politikë publike". Ky dështim i Konventës së Nju Jork-ut, për të sqaruar më shumë konceptin e *politikës publike* dëshmon për një tendencë drejt ngushtimit të interpretimit të tij. Pra, "mbrojtja" ndaj njohjes së vendimeve të arbitrazhit, që siguron klauzola e *politikës publike*, duke kuptuar ngushtësisht. Kjo do të thotë që njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit të huaj mund të refuzohet, bazuar në klauzolën e politikës publike, vetëm nëse zbatimi i këtyre vendimeve do të dhunonte nocionet më themelore të moralit dhe drejtësisë së shtetit të forumit, ku kërkohet zbatimi²⁸⁹. Në fakt, bazuar në historinë legjislative

²⁸³ Buhning-Uhle, C., "Arbitrazhi dhe ndërmjetësimi në biznesin ndërkombëtar", Kluwer Law International, 1996, f.60

²⁸⁴ Çështja e referuar: 417 U.S. 506 (1974).

²⁸⁵ Redfern A. & Hunter M. "E drejta dhe praktika e arbitrazhit ndërkombëtar tregtar", botimi 4-tërt (Londër) Sweet and Maxwell, 2004, f.164.

²⁸⁶ Tibor Varady, John J.Barcelo - "Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Një "Perspektivë Transnacionale", 2009, f.861.

²⁸⁷ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(2)(b).

²⁸⁸ Shiko *supra* nënseksionin II.4.7.

²⁸⁹ Tibor Varady, John J.Barcelo - "Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Një "Perspektivë Transnacionale" (American Casebook Series), botimi i katërt, 2009, f.860-861.

të Konventës së Nju Jork-ut (*travaux préparatoires*), mund të themi se vetë teksti i klauzolës ka ardhur duke u reduktuar, përsa i përket formulimit të saj. Kështu, draft-Konventa e prezantuar nga Komiteti Ad-hoc i Këshillit Ekonomik dhe Social të OKB (ECOSOC), parashikonte shprehimisht definicionin “politikë publike dhe parimet themelore të së drejtës” (neni IV/h i draftit), duke i qëndruar puthuajse besnik parashikimit të Konventës pararendëse të Gjenevës (1927)²⁹⁰. Ndaj këtij formulimi, sidomos për “parimet e të drejtës”, kishte patur kritika nga organizma tregtare, pasi ishte keqpërdorur në disa raste, duke cënuar qëllimin e marrëveshjes së arbitrazhit. Për rrjedhojë nga përfaqësuesit e shteteve pjesëmarrëse në ECOSOC, u kërkua të hiqej patjetër, nga teksti i klauzolës, referenca tek “parimet e së drejtës”, duke mbetur vetëm termi “politika publike”. Përfshirja e këtij termi në nenin 5(2)(b) të Konventës së Nju Jork-ut²⁹¹ mundëson autoritetin kompetent (gjykatën ku kërkohet njohja) të refuzojë zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj, të cilat janë haptazi në mashtrim të ligjit, që janë shtypës apo ndrydhës të të drejtave themelore, apo skandaloz në përmbajtjen e tyre²⁹².

Nga praktika rezultojnë një numër çështjesh, në të cilat pretendimi për kundërshtimin e politikës publike është ngritur. Kështu, Gjykata supreme e SHBA-ve, në çështjen *Vimar Seguros S.A. kundër M/V Sky Reefer*²⁹³, ka mbrojtur pikëpamjen se palët duhet të respektojnë marrëveshjen e arbitrazhit, ndërkohë që çështja e politikës publike të shtetit, duhet të lihet për t’u vlerësuar nga gjykata, kur vjen çështja për zbatimin e vendimit të arbitrazhit, sipas dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut. Natyra e çështjeve gjyqësore, ku është pretenduar cënimi i klauzolës së *rendit publik*, është e larmishme, nga ku mund të përmendim:

a. Procesi i duhur ligjor (palët nuk kanë patur mundësi të barabarta për tu dëgjuar); Procesi i rregullt, i cili bën pjesë në “politikën publike”, si një parim themelor, nënkupton të drejtën e palëve për të patur efektivisht mundësi të barabarta për t’u degjuar. Por nëse, pas një njoftimi të rregullt, një palë refuzon të marrë pjesë apo qëndron inaktive ndaj arbitrazhit, atëherë do të

²⁹⁰ Konventa “Për ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj”, Gjenevë, 1927, neni 1(e): “Për të siguruar njohjen dhe zbatimin do të jetë e nevojshme që njohja dhe zbatimi i vendimit të mos jetë në kundërshtim me politikën publike ose parimet e së drejtës së vendit, në të cilin vendimi i arbitrazhit është kërkuar të zbatohet”.

²⁹¹ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(2)(b): “Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi të arbitrazhit mund të refuzohen gjithashtu në qoftë se autoriteti kompetent i vendit ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi konstaton se: b. njohja ose ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me rendin publik të këtij vendi”.

²⁹² Koment i Qeverisë së Britanisë së Madhe mbi draft-Konventën “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj”, dokument i OKB, ECOSOC, E/2822/Add.4. Annex I, 3 prill 1956, f.7, 8.

²⁹³ 115 S.Ct.2322 (1995): Në çështjen e njohur si “Sky Reefer”, Gjykata Supreme disponi që Akti mbi Transportin e Mallrave nëpërmjet Detit (“COGSA”) nuk anulon dispozitat e përmbajtura në faturat detare të ngarkesës, që kërkojnë arbitrazhin e huaj për zgjidhjen e kontesteve.

konsiderohet se ajo ka hequr dorë në mënyrë të vullnetshme nga kjo mundësi. Një rast i tillë përgjithësisht nuk përbën shkak për refuzimin e një vendimi arbitrazhit të huaj²⁹⁴.

b. Proçedurë e parregullt arbitrazhi; Parregullsitë në proçedurë kanë të bëjnë me pyetjen nëse një kërkesë themelore e *procesit të rregullt* po çënohet në procedurën e arbitrazhit. Një shembull është rasti kur emrat e arbitrave nuk i janë komunikuar palëve. Po kështu zhvillimi i procedurës së arbitrazhit mund të dhunojë parimin e “procesit të rregullt”, për shembull, nëse një letër e rëndësishme nga njëra palë nuk i është kaluar nga arbitrat palës tjetër²⁹⁵.

c. Paanshmëria e arbitrit kundrejt palëve; Paanësia e arbitrave është gjithashtu një kërkesë themelore për çdo arbitrazh. Ky kusht kërkon që arbitri të mos ketë asnjë interes personal në lidhje me çështjen në shqyrtim dhe të jetë njëlloj i pavarur nga të dy palët. Ndërkohë që konfirmojnë këtë parim, kur vendosin sipas dispozitave të Konventës, gjykatat bëjnë dallimin midis çështjes kur ka rrethana, të cilat mund të kenë krijuar mungesë paanshmërie tek arbitri (“dyshim i nënkuptuar”, ose “dyshim në dukje”) dhe çështjes kur arbitri nuk ka vepruar efektivisht në një mënyrë të paanshme (“dyshim aktual”). Si rregull, vetëm në rastin e dytë gjykatat mund të refuzojnë zbatimin e një vendimi arbitrazhi të huaj²⁹⁶.

d. Mungesa e arsytimit të vendimit të arbitrazhit. Ligjet e arbitrazhit të shumë vendeve e përshkruajnë si detyrues faktin që vendimet e arbitrazhit duhet të përmbajnë arsyetimin, në të cilin ky vendim është bazuar. Në këto shtete është konsideruar si themelore çështja që palët të informohen se si drejtësia është vendosur në çështjen e tyre. Në kontrast me to, në shtete të ndryshme të Common Law, është e zakonshme të mos jepet arsyetimi në vendimin e arbitrazhit.

Një shembull domethënës i interpretimit të klauzolës së *rendit publik* përbën arsyetimi që Gjykata e SHBA-ve ka bërë në çështjen *Overseas kundër RAKTA*²⁹⁷. Thelbi i pretendimeve

²⁹⁴ Albert Jan van den Berg – “Konventa e Nju Jork-ut e 1958: Një përmbledhje”, f.19.

²⁹⁵ *Id.*

²⁹⁶ *Id.*, f.19-20.

²⁹⁷ Çështja e referuar: *Gj. Apelit (US no.7)*, 1974, 508 F.2d 969: Midis palëve (*Overseas - merikane dhe RAKTA - egjiptiane*) ishte lidhur një kontratë për ndërtimin e një fabrike në Egjipt. Një plë e tretë ishte agjencia AID, që akordonte fonde për palën egjiptiane. Kontrata kishte parashikuar një klauzolë arbitrazhi në ICC dhe një klauzolë për “rastet fatkeq”, sipas të cilës do të justifikoheshin vonesat e palëve në performancën e kontratës, që ishin përtej kapacitetit të palëve për t'i kontrolluar. Në maj 1967 shpërtheu lufta 6 ditore midis vendeve arabe dhe Izraelit dhe në qershor u ndërprene lidhjet diplomatike midis Egjiptit dhe SHBA-ve dhe u urdhëruar deportimi i shtetasve amerikanë nga Egjipti, përveç atyre që merrnin një vizë të posaçme qëndrimi. Pas ndërprerjes së zbatimit të kontratës, si rezultat i largimit të punonjësve amerikanë, konflikti u zgjidh në një procedurë nga ICC, e cila dha vendim në favor të RAKTA-s, duke rrëzuar pretendimin e *Overseas* për rast fatkeq. ICC deklaroi se *Overseas* ishte e justifikuar vetëm për ndërprerje të kontratës vetëm për dy ditë dhe jo për ditët e tjera kur ekzistonte mundësia e marrjes së një vize për punojesit amerikanë, mundësi e cila ishte Brenda kontrollit dhe nuk u shfrytëzua. Vendimi i ICC u mor në shqyrtim nga Gjykata Amerikane kur RAKTA kërkoi njohjen dhe zbatimin e këtij vendimi në SHBA.

të Overseas kundër njohjes dhe ekzekutimit të vendimit të ICC-së në SHBA, ishte konsiderimi i këtij vendimi *kundër rendit publik* në SHBA. Argumentimi i sjellë nga Overseas ishte se ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike midis SHBA dhe Egjiptit dhe tërheqja e AID-së nga investimi, justifikonin tërheqjen e Overseas nga zbatimi i kontratës. Gjykata e rrëzoi këtë pretendim duke argumentuar se *politika apo strategjia kombëtare e një shteti, strategjitë e politikave të jashtme, nuk janë pjesë e rendit publik, por të politikës publike. Rendi publik përfshin një gamë shumë më të vogël pretendimesh, ku përfshihen nocionet bazike të moralit dhe drejtësisë*. I njëjti argument u përdor nga Gjykata edhe për pretendimin e dytë të Overseas se çështja ishte e *pa-arbitrueshme* në SHBA (për pasojë vendimi i ICC nuk duhej njohur) në sensin që një çështje e politikave nacionale (politikës së jashtme) dhe relatave diplomatike nuk mund të jetë e aftë të arbitrohet. Gjykata në lidhje me këtë pikë u shpreh se *fakti që çështje të interesit kombëtar prekin (efektojnë) mbi relacione kontraktuale nuk e bën relacionin të pa-arbitrueshëm në vetvete*. Në fund të fundit bëhet fjalë për një marrëdhënie tërësisht kontraktore, ku nuk duhet të involvoheshin konsiderata të politikave të jashtme.

Si konkluzion, në të gjitha rastet e parashikuara nga nënparagrafi 2 i nenit 5 të Konventës (në çështjet e arbitrueshmërisë dhe politikës publike), gjykata ku kërkohet zbatimi do të zbatojë ligjin e saj (*lex fori-n*) për të vlerësuar arbitrueshmerinë apo përputhshmërinë e vendimit të arbitrazhit me politikën publike, panvarësisht ligjit ku janë mbështetur arbitrat kur kanë dhënë vendimin. Por, në çdo rast, gjykata duhet të marrë gjithashtu në konsideratë edhe dallimin midis politikës publike të brëndshme dhe politikës publike ndërkombëtare.

iii. Dallimi midis konceptit të politikës publike të brëndshme dhe asaj ndërkombëtare, në kuadër të refuzimit të zbatimit të vendimeve të arbitrazhit.

Dallimi midis politikës publike të brëndshme dhe asaj ndërkombëtare presupozon faktin se ajo çfarë konsiderohet si çështje e inkuadruar në politikën publike, në marrëdhëniet e brëndshme të një shteti, nuk përbën domosdoshmërisht politikë publike në marrëdhëniet ndërkombëtare. Dallimi justifikohet me ndryshimin e qëllimit të marrëdhënieve të brëndshme ndaj atyre ndërkombëtare²⁹⁸.

Në çështjet, që i nënshtrohen Konventës së Nju Jorkut, një dallim i tillë është pranuar gjerësisht nga gjykatat. Ato e aplikojnë këtë dallim si në lidhje me çështjen e arbitrueshmërisë ashtu dhe në çështjet e tjera të politikës publike, kjo edhe si pasojë e

²⁹⁸ Albert Jan van den Berg – “Konventa e Nju Jork-ut e 1958: Një përmbledhje”, f.18.

aplikimit të parimit të interpretimit ngushtësisht të shkaqeve refuzuese të zbatimit, të parashikuara në nenin 5 të Konventës. Kështu në çështjen e *arsyetimit* të vendimit të arbitrazhit (e konsideruar si çështje e politikës publike) nga gjykatat aplikohet parimi i dallimit midis asaj çfarë konsiderohet politikë publike kombëtare dhe politikë publike ndërkombëtare. Duke aplikuar këtë dallim, rezulton se gjykatat e shteteve, ligjet e të cilëve e kërkojnë arsyetimin si të detyrueshëm, priren të njohin dhe zbatojnë vendimet e arbitrazhit të pa-arsyetuara me argumentimin se ata janë marrë në shtete ku mosarsyetimi tolerohet²⁹⁹. Nga gjykatat, në këto raste, prevalon interesi i politikës publike ndërkombëtare, panvarësisht se mund të çenohet politika publike kombëtare e shtetit të tyre.

Për më tepër, cënimi i politikës publike kombëtare të shtetit të origjinës së vendimit, nuk konsiderohet nga gjykatat se, domosdoshmërisht, dhunon edhe politikën publike ndërkombëtare. Sikurse ka konstatuar Gjykata e Apelit e SHBA, në çështjen *Parsons & Whittemore kundër RAKTA*³⁰⁰, “*vendimeve të arbitrazhit duhet t’u mohohet zbatueshmëria vetëm atëherë kur politika publike e deklaruar dhe e vërtetuar (e cënuar prej vendimit) do të dhunonte nocionet më themelore të moralit dhe drejtësisë të shtetit të forumit*”.

Në disa çështje, edhe në rastin kur politika publike çenohet nga mungesa e pa-anshmërisë së arbitrave, përsëri politika publike ndërkombëtare prevalon në favor të zbatimit të vendimit të arbitrazhit. Kështu, në një çështje, gjykata e SHBA, vendosi zbatimin e detyruar të vendimit të arbitrazhit, megjithëse arbitri i caktuar nga paditësi kishte qënë konsulenti i tij, në të paktën dy procedime ligjore të tjera. Gjykata argumentoi se “*megjithëse politika publike përgjithësisht favorizon zbulimin e plotë të çdo interesi apo paragjykimi të mundshëm të arbitrave, politika publike më e fortë në favor të arbitrazhit ndërkombëtar, duhet të prevalojë për zbatimin e vendimit të arbitrazhit*”³⁰¹.

IV.3. Kundërshtimi i njohjes dhe zbatimit përball ankimimit të një vendimi arbitrazhi të huaj - analizë teorike mbi dallimet ndërmjet këtyre dy proceseve.

Ankimimi i vendimit të arbitrazhit bëhet nga pala e interesuar deri në momentin që vendimi i arbitrazhit merr formë të prerë. Si objekt të kërkesës së saj, pala e interesuar ka anullimin e vendimit të arbitrazhit, pra ajo kërkon që vendimi të bëhet nul dhe të mos prodhojë asnjë

²⁹⁹ *Id.*, f.20.

³⁰⁰ Çështja “Parsons & Whittemore Overseas Co., Inc. (shkurt Overseas)” një kompani amerikane kundër “Societe Generale de L’industrie du Papier (shkurt RAKTA)” një kompani Egjiptiane (US no.7, raportuar në Vjetarin Vol.I, f.205).

³⁰¹ Çështja: Fertilizer Corporation of India kundër. IDI Management Inc., 517 F Supp. 948; shiko: Angualia Daniel “Roli i gjykatave nacionale në Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar”, f.22-23.

efekt juridik. Referuar në Konventën Europiane "Mbi arbitrazhin tregtar ndërkombëtar" (1961), anulimi i një vendimi arbitrazhi ndërkombëtar mund të bëhet vetëm për shkaqe të përcaktuara shprehimisht në këto dispozita³⁰², të cilat janë vetëm të karakterit procedural dhe nuk kanë të bëjnë me thelbin e mosmarrëveshjes, që zgjidhet në këtë vendim. Kërkesa ankimore me objekt anulimin e vendimit të arbitrazhit, në rastet kur lejohet ankimi, shqyrtohet vetëm nga autoriteti kompetent i vendit të arbitrazhit. Referuar në dispozitat e Konventës Europiane "Mbi arbitrazhin tregtar ndërkombëtar"³⁰³, anulimi i vendimit të arbitrazhit bëhet nga autoriteti kompetent i shtetit në të cilin, ose sipas ligjit të të cilit vendimi i arbitrazhit është marrë³⁰⁴.

Kundërshtimi i njohjes dhe zbatimit të vendimit të arbitrazhit të huaj, sipas Konventës së Nju Jork-ut³⁰⁵, kërkohet nga pala e interesuar, në momentin pasi është paraqitur kërkesa për njohjen dhe zbatimin e vendimit të arbitrazhit, në një shtet të caktuar. Kundërshtimi i njohjes paraqitet dhe shqyrtohet nga autoriteti kompetent i çdo vendi ku kërkohet njohja dhe zbatimi i vendimit të arbitrazhit. Në këtë rast pala e interesuar (kundër të cilës drejtohet vendimi) nuk ka si objekt të kërkesës së saj, anulimin apo shfuqizimin e vendimit të arbitrazhit të huaj, por kërkon që ky vendim arbitrazhi të mos njihet dhe të mos zbatohet në territorin e atij shteti. Pra në thelb kundërshtimi i njohjes nuk tenton të zhvleftësojë aktin (vendimin e arbitrazhit), por të pamundësojë ligjërisht zbatimin e tij. Në këto kushte, kundërshtimi i njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj në një shtet të caktuar, nuk ka efekt mbi fuqinë që ky vendim arbitrazhi mund të ketë në një shtet tjetër. Në një rast hipotetik, nëse një vendim arbitrazhi ndërkombëtar i shtrin efektet në më shumë se një shtet, kundërshtimi i njohjes të tij, në kuptim të dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut, duhet të bëhet në secilin prej këtyre shteteve.

Sa më sipër, një vendim arbitrazhi ndërkombëtar mund të "goditet" dy herë për të njëjtat arsye. Fillimisht mund të kërkohet anulimi i tij pranë autoritetit të vendit të arbitrazhit dhe

³⁰² Konventa Europiane "Mbi arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar", neni 9, pika 1, paragrafi "a", "b", "c", "d" - Për anulimin e një vendimi arbitrazhi, duhet të provohet që: *palët në marrëveshjen e arbitrazhit ishin sipas ligjit të zbatueshëm të tyre, në pazotësi për të vepruar, ose marrëveshja në fjalë nuk është e vlefshme sipas ligjit, që palët i janë nënshtruar ...; pala që kërkon anulimin e vendimit nuk është informuar rregullisht me caktimin e arbitrit ose me procedurën e arbitrazhit, ose ajo nuk ka pasur zotësi të paraqesë rastin e saj; vendimi ka lidhje me një mosmarrëveshje të paparashikuar në marrëveshjen për arbitrazh ose përmban vendime për çështje, që i kalojnë ato që mund t'i nënshtrohen arbitrazhit ...; formimi i gjykatës së arbitrazhit ose i procedurës së arbitrazhit nuk ka qenë në përputhje me marrëveshjen dhe kur mungon marrëveshja, me dispozitat e nenit 4 të kësaj Konvente.*

³⁰³ Konventa Europiane, neni 9, pika 1.

³⁰⁴ Psh. në rastin e Shqipërisë, K.P.Civile, neni 434, parashikon se në Republikën e Shqipërisë vendimet e arbitrazhit mund të ankimohen dhe të anulohen vetëm në një gjykatë shqiptare (Gjykatën e Apelit).

³⁰⁵ Në kuptim të nenit 4 dhe 5 të Konventës së Nju Jork-ut.

nëse anulimi nuk miratohet, për të njëjtat arsye mund të kërkohej mosnjohja dhe moszbatimi i këtij vendimi në shtetin ku ai i shtrin efektet. Një ilustrim të këtij konstatimi e paraqet shumë mirë situata në Ligjin Model UNCITRAL, ku shkaqet e anulimit të një vendimi arbitrazhi (të parashikuara në nenin 34/2), janë identike me shkaqet për refuzimin e njohjes dhe zbatimit të një vendimi të tillë (të parashikuara në nenin 36/1). Megjithatë në praktikë vërehet një ndryshim. Një kërkesë anulimi mund të parashtrohet para një gjykate të shtetit ku vendimi i arbitrazhit është marrë (gjykata e shtetit të origjinës), ndërkohë që kërkesa për refuzimin e zbatimit duhet të paraqitet para një gjykate kompetente të atij shteti ku kërkohej njohja. Për këtë arsye shkaqet që lidhen me politikën publike apo mos-arbitrueshmerinë e çështjes, mund të variojnë në thelb sipas ligjit që do të zbatohet gjykata: ligjin e shtetit ku kërkohej anulimi, apo ligjin e shtetit ku kërkohej të refuzohet zbatimi³⁰⁶.

IV.4. Vendimi i arbitrazhit në fokusin e Konventës së Nju Jork-ut.

IV.4.1. Llojet e vendimeve dhe efekti i Konventës mbi ta.

Koncepti gjerësisht i njohur për “vendimin” e arbitrazhit është se ai është disponimi final i arbitrave mbi të gjitha pretendimet e palëve për çështjen në konflikt. Forumet e arbitrazhit mund gjithashtu të nxjerrin *vendime të pjesëshme, vendime të përkohëshme, apo urdhëra gjatë procedimit arbitral*, por që nuk përbëjnë “vendim arbitrazhi”. Urdhërat përgjithësisht i shërbejnë çështjeve procedurale, të cilat duhet të zgjidhen me qëllim që procesi i arbitrazhit të shkojë përpara, si për shembull për çështjet e provave, vendit dhe kohës së seancave, etj. Ndërkohë që vendimet finale të arbitrazhit i japin zgjidhje të drejtave substanciale të palëve në proces. Sipas Konventës së Nju Jork-ut, vetëm këto të fundit gëzojnë statusin për të qënë objekt i një shqyrtimi gjyqësor, mbi bazën e një liste të kufizuar arsyesh, në vendin e origjinës së arbitrazhit apo në vendin e zbatimit.

Dallimi kryesor midis “urdhrave të arbitrit” dhe “vendimeve të arbitrazhit” është që urdhërat zakonisht nuk mund të shqyrtohen nga një gjykatë shtetërore edhe pse ato mund të jenë objekt i rishikimit nga vetë tribunali i arbitrazhit. Megjithatë, ka raste kur edhe urdhërat e arbitrave janë të ankimeshëm në gjykatë për shkak të karakterit final të tyre. Në veçanti,

³⁰⁶ Shenime Shpjeguese të Sekretariatit të UNCITRAL mbi Ligjin Model 1985 “Për arbitrazhin ndërkombëtar tregtar”, par.48 (United Nations Publication Sales No.E.08.V.4, Part II) .

urdhërat për të siguruar padinë para zhvillimit të seancave të arbitrimin, janë konsideruar si të mundshëm për t'u shqyrtuar nga disa gjykata për shkak të karakterit final të tyre³⁰⁷.

Nëse një palë nuk mund të apelojë një urdhër të arbitrit në gjykatë, por gjithsesi mendon se urdhëri është i parregullt, ajo duhet të shprehë menjëherë kundërshtimin e saj para tribunalit të arbitrazhit. Një gjë e tillë duhet bërë me qëllimin për të garantuar më vonë të drejtën për të kundërshtuar vendimin e arbitrazhit me argumentin se urdhëri në fjalë ishte shkak i një procedure të padrejtë, të parregullt apo paragjykuese që i ka mohuar palës të drejtën për të prezantuar dhe mbrojtur ndershmërisht çështjen³⁰⁸. Nëse një palë nuk kundërshton një urdhër në momentin e lëshimit të tij, ajo mundet që më vonë të konsiderohet se ka hequr dorë nga kundërshtimi i vendimit final të arbitrazhit duke ngritur si pretendim arsyet e kundërshtimit të urdhërit³⁰⁹.

Raporti midis llojeve të vendimeve që mund të marrë arbitri, apo paneli i arbitrazhit dhe sferës së veprimit të autoritetit të Konventës së Nju Jork-ut, paraqitet si më poshtë:

i. Vendimet finale - Termi “vendim final” arbitrazhi i referohet vendimit të tribunalit që zgjidh të gjitha mosmarrëveshjet midis palëve. Ka disa pasoja që rrjedhin nga një vendim final. Në rradhë të parë është kundërshtueshmëria e vendimit final nga pala humbëse, e cila mund të mundohet të anulohet këtë vendim sipas ligjeve të vendit të arbitrazhit. Po kështu vendimi final i arbitrazhit mund të zbatohet forcërisht nëpërmjet ndërhyrjes së një rendi juridik nacional të caktuar, sipas parashikimeve të Konventës së Nju Jork-ut (me supozimin se vendimi është marrë në një vend anëtar të Konventës). Dhe në fund, marrja e një vendimi

³⁰⁷ Shiko çështjen “*Banco de Seguros del Estado kundër Mutual Marine Offices, Inc.*”, 344 F.3d 255 (Gjykata e Apelit të SHB, 18 shtator 2003); “Paneli i arbitrazhit lëshoi një urdhër të përkohëshëm duke e detyruar paditësin të depozitonte si garanci paradëgjimore një letër garanci në shumën ... Paditësi kundërshtoi urdhërin në Gjykatën e Distriktit Jugor të Nju Jork-ut në SHBA. Gjykata e konfirmoi urdhërin e panelit të arbitrave, duke u shprehur se: “urdhërat e përkohëshëm konsiderohen “vendime arbitrazhi” dhe për rrjedhojë janë të rishikueshëm nga gjykata”.

³⁰⁸ Shiko Aktin Anglez të Arbitrazhit, neni 73 - Shumë rregulla arbitrazhi kërkojnë që një palë të ngrejë një kundërshtim në kohën kur del urdhëri, ose në rast të kundërt ajo do të konsiderohet të ketë hequr dorë nga e drejta e saj për të kundërshtuar (shiko gjithashtu, Rregulloren e ICC, neni 33; Rregulloren UNCITRAL, neni 30; Rregulloren e LCIA, neni 32.1; Rregulloren ICSID, neni 27; Rregulloren WIPO, neni 58).

³⁰⁹ Shiko çështjen “Gjykata e Apelit të Parisit: SA Caisse Federale de Credit Mutuel du Nord de la France kundër Banque Delubac et Compagnie, 2001”, përmbledhje e arbitrazhit 918: *Pala e cila nuk ngriti si pretendim mungesën e paanësisë së arbitrit gjatë procedimit arbitral, në mënyrë implicite ka hequr dorë nga e drejta për ta ngritur këtë pretendim më vonë*; Shiko çështjen “Republika e Kazakistanit kundër Istil Group Inc. [2006] 2 Lloyd’s Rep.370”: *Duke mos kundërshtuar një parregullsi të perceptuar në kohën e duhur, pala humb të drejtën për ta kundërshtuar në një kohë të mëvonëshme*; Shiko Rregulloren UNCITRAL, neni 4: *pala që nuk kundërshton në kohë humbet të drejtën për të bërë këtë më vonë*.

arbitrazhi përfundon detyrën e tribunalit, i cili bëhet *functus officio* (pa asnjë juridiksion të mëtejshëm)³¹⁰.

ii. Vendimet e pjesshme dhe vendimet e përkohshme - Termi “vendim i pjesshëm” arbitrazhi është hera herës i përdorur si sinonim i termit “vendim i përkohshëm” arbitrazhi. Megjithatë disa autor dallojnë veçori ndërmjet këtyre dy termave. Sipas tyre, “vendimet e pjesshme” i referohen pretendimeve substanciale, ndërkohë që “vendimet e përkohshme” i referohen çështjeve të tilla si juridiksioni apo ligji i aplikueshëm³¹¹. Të tilla vendime arbitrazhi nuk i japin zgjidhje të gjitha çështjeve në konflikt midis palëve. Megjithatë, në varësi të juridiksionit, palët në disa raste mund të kudërshtojnë apo kërkojnë të konfirmojnë vendimet e pjesshme apo të përkohëshme në një gjykatë shtetërore, pa pritur për vendimin final të arbitrazhit që zgjidh të gjithë mosmarrëveshjen.³¹² Kështu psh. Rregulloja UNCITRAL parashikon se tribunali mund të marrë “masa të përkohshme”, për shembull masat për ruajtjen e mallrave, të tilla si urdhërimi për depozitimin e tyre tek një person i tretë ose shitjen e mallrave që prishen³¹³. Këto disponime të tribunalit përgjithësisht marrin trajtën e një “urdhëri”, por mund të kenë edhe trajtën e një vendimi arbitrazhi në varësi të karakterit final të tyre. Madje, në disa raste, gjykata ka vlerësuar se pavarësisht se masa e përkohëshme e dhënë është emërtuar si “urdhër”, në fakt tribunal ka dhënë një vendim final arbitrazhi. Kështu psh. në çështjen “*Publicis Communication kundër True North Communications*”³¹⁴, Gjykata e Apelit në SHBA u shpreh se: *një urdhër i lëshuar nga një tribunal arbitrazhi, për të kthyer regjistrimet e taksave, pavarësisht se ishte përshkruar si “urdhër”, ishte në fakt një vendim final arbitrazhi, që plotësonte kushtet për konfirmim. Disponimi i tribunalit të arbitrazhit nuk ishte thjesht një urdhër mbi disa çështje procedurale, por ishte në fakt vetë çështja (pretendimi) që paditësi kishte paraqitur. Pavarësisht se kishte ende çështje për t’u trajtuar dhe zgjidhur nga arbitrat dhe pavarësisht se disponimi i tribunalit ishte emërtuar si “urdhër”, substanca dhe impakti i këtij disponimi demonstronin karakter final, duke e kthyer atë në një vendim final arbitrazhi.* Argumentimi i mësipërm i gjykatës konfirmon

³¹⁰ “*functus officio*”: (term latin) të ketë përmbushur funksionin apo qëllimin, i shkarkuar nga detyra, dhe për rrjedhojë pa asnjë forcë apo autoritet të mëvonshëm: Black’s Law Dictionary 673 (6th ed.1990).

³¹¹ Shiko “Raportin Final mbi Vendimet e Përkohëshme dhe të Pjesëshme”, 2, Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit (ICC), Buletini 26 (1990).

³¹² Një vendim i pjesshëm mund të konfirmohet në SHBA, nëse ai zgjidh në mënyrë përfundimtare një çështje diskrete ndërmjet atyre brenda mandatit të tribunalit; Shiko çështjen “*Metalgesellschaft kundër M/V Capitan Constante*”, 790 F.2d 280, 283 (2d Cir. 1986): vendimi i pjesshëm për pagesat e transportit konfirmohet nga gjykata sepse ai ishte një pretendim i veçantë dhe i pavarur.

³¹³ Rregullorja e Arbitrazhit UNCITRAL, neni 26(1).

³¹⁴ “*Publicis Communication & Publicis SA kundër True North Communications Inc*”, 206 F.3d 725 (7th Cir. 2000). Gjykata e Apelit në SHBA e la në fuqi vendimin e një gjykate më të ulët, e cila kishte bërë të zbatueshëm, në mbështetje të Konventës së Nju Jork-ut, një urdhër të lëshuar nga një tribunal arbitrazhi.

qëndrimin se janë pikërisht përmbajtja substanciale dhe efekti që prodhon disponimi i arbitrave ato që duhen konsideruar si faktorë determinant në përcaktimin e karakterit final të vendimit të arbitrazhit, duke i dhënë këtij të fundit mundësinë për t'iu nënshtruar ose jo efektit të Konventës së Nju Jork-ut³¹⁵.

Sa më sipër, pavarësisht se në frymën e Konventës, një vendim arbitrazhi i përkohshëm nuk konsiderohet përgjithësisht si vendim forcërisht i zbatueshëm³¹⁶, në disa juridiksione, një vendim i përkohshëm mund të konfirmohet nën orientimin e ligjit lokal, nëse disponon në mënyrë përfundimtare mbi një çështje të veçantë dhe të pavarur³¹⁷.

iii. Vendimet e pajtimit - Palët, në çdo moment gjatë procedimit arbitral, mund të vendosin të zgjidhin çështjen me pajtim, duke evituar procedurën e arbitrazhit. Shumë rregullore arbitrazhi shprehen për një gjë të tillë, duke lejuar palët që, kundrejt kërkesës së tyre, të sigurojnë një vendim arbitrazhi që do të ketë si dispozitiv termat e marrëveshjes pajtuese midis palëve³¹⁸. Nëse palët arrijnë një marrëveshje pajtuese për çështjet në konflikt, ato më tej mund të ndjekin dy rrugë: (a) mund të trupëzojnë marrëveshjen në një vendim arbitrazhi (vendim pajtues), ose (b) mund të mjaftohen vetëm me marrëveshjen.

Palët mund të mos kenë nevojë të trupëzojnë marrëveshjen e tyre në një “vendim pajtimi”, nëse, në momentin që ato nënshkruajnë marrëveshjen pajtuese, të gjitha detyrimet midis tyre janë plotësuar (të gjitha pagesat janë realizuar, etj). Por, nëse ndonjë detyrim midis palëve ka ngelur i paplotësuar, pas nënshkrimit të marrëveshjes, është më oportune për palët të konvertojnë marrëveshjen e tyre në një *vendim pajtues* arbitrazhi. Kjo sepse, nëse nuk e bëjnë një gjë të tillë dhe njëra nga palët nuk përmbush vullnetarisht detyrimin e saj, sipas marrëveshjes pajtuese, kjo do të konsiderohej thjesht si shkelje e një “detyrimi kontraktor” dhe jo si moszbatim i një vendimi. Në një rast të tillë palës tjetër do t'i duhet të shkojë në gjykatë dhe të provojë shkeljen e kontratës (marrëveshjes pajtuese) përpara se të mund të fillojë procedurën e ekzekutimit të detyrimit të shkelur. Përkundrazi, nëse marrëveshja pajtuese është konvertuar në një vendim arbitrazhi, ekzekutimi i të drejtave dhe detyrimeve,

³¹⁵ Margaret L. Moses, “Parimet dhe Praktika e Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar”; Cambridge University Press, 2008, f.182.

³¹⁶ Shiko çështjen “Resort Condominiums Int’l, Inc. kundër Ray Bolwell et al. (S. Ct. Queensland)”, Vjetari i Arbitrazhit Tregtar XX 628, 642 (1995): “Nuk duket se Konventa i referohet (ka si objektiv) ndonjë lloj vendimi apo urdhëri të arbitrit, përveç atij vendimi që përcakton të gjitha apo të paktën disa nga çështjet e referuara arbitrave për gjykim”.

³¹⁷ Shiko çështjen “Island Creek Coal Sales kundër City of Gainesville, Florida”, 729 F.2d 1046, 1049 (6th Cir.1984): (Gjykata pranoi një vendim arbitrazhi të përkohshëm që kërkonte që i padituri të vazhonte zbatimin e kontratës derisa paneli i arbitrazhit të lëshonte vendimin final).

³¹⁸ Shiko Rregulloren UNCITRAL, neni 34(1); Rregulloren ICC, neni 26; Ligjin model UNCITRAL, neni 30.

për të cilat palët kanë rënë dakort, të materializuara në dispozitivin e një vendimi, do të jetë më efektiv nëpërmjet mekanizmit të Konventës së Nju Jork-ut.

Një tjetër arsye që justifikon nevojën e konvertimit të marrëveshjes në një vendim pajtues është statusi juridik i palëve, veçanërisht në rastin kur një nga palët është një shtet sovran apo agjenci shtetërore. Nga një perspektivë politike, sanksionimi i institucionit të arbitrazhit dhe nënshkrimet e arbitrave mund të bëjnë që një sistem shtetëror të jetë më i gatshëm të zbatojë detyrimin, nga sa do të ishte në qoftë se detyrimi do të përcaktohej vetëm në një marrëveshje të arritur mes palësh³¹⁹. Interesant për konkretizim, në këtë pikë, është rasti i Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC'A), për çështjen "La Petrolifera Italo-Rumena" Spa. dhe "La Petrolifera Italo-Albanese" Sha. kundër Republika e Shqipërisë" (2007)³²⁰. Dispozitivi i vendimit final të arbitrazhit të huaj konstaton se *palët e kanë zgjidhur plotësisht mosmarrëveshjen midis tyre, sipas Marrëveshjes së Zgjidhjes me Mirëkuptim, duke hequr dorë nga të gjitha pretendimet e tyre në këtë procedurë arbitrazhi dhe gjithashtu urdhëron palët të zbatojnë kushtet e Marrëveshjes së Zgjidhjes me Mirëkuptim*³²¹. Vendimi i mësipërm, i dhënë nga gjykata e arbitrazhit për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjes, është kërkuar të njihet dhe të zbatohet në Republikën e Shqipërisë, nga pala e interesuar ("La

³¹⁹ Redfern & Hunter, "E Drejta dhe Praktika e Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar", (2004), f.377.

³²⁰ Më datë 24.05.2004, bazuar në ligjin nr.9231 datë 13.05.2004, ndërmjet shoqërisë "La Petrolifera Italo-Rumena" Spa. ("konçesionari") dhe Qeverisë së RSh ("shteti") u nënshkruan dy marrëveshje konçesioni dhe konkretisht: marrëveshja BOO "Për ndërtimin dhe dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar", për depozitimin e naftës dhe nënprodukteve të saj, në gjirin e Vlorës" dhe marrëveshja BOT "Për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në gjirin e Vlorës". Ligji nr.9231 për miratimin e këtyre dy marrëveshjeve hyri në fuqi më datë 21.06.2004, që është edhe data e hyrjes në fuqi të marrëveshjeve të konçesionit. Sipas këtyre dy marrëveshjeve, palëve u lindi disa të drejta për të përmbushur brenda afateve të përcaktuara. Konçesionari kishte detyrimin të përfundonte projektin përfundimtar, brenda 9 muajsh, detyrim të cilin ai e përmbushi disa muaj para afatit. Pas dorëzimit të projektit, shteti i lindi detyrimi që, brenda 60 ditëve, të pajiste konçesionarin me të gjitha konçesionet, lejet dhe autorizimet përkatëse, si dhe të transferonte titullin e pronësisë nga shteti tek konçesionari, me qëllim që ky i fundit të fillonte ndërtimin e terminalit dhe infrastrukturës portuale. Por këto detyrim shteti nuk arriti t'i përmbushte për një kohe prej rreth dy vjetesh dhe nga kjo mospërmbushje e detyrimeve të Marrëveshjes BOO, konçesionarit i'i shkaktuan dëme të konsiderueshme. Në këto kushte konçesionari, në zbatim të nenit 17 të Marrëveshjes BOO, iu drejtuar më datë 12.06.2006 Arbitrazhit Ndërkombëtar në Paris.

³²¹ Pas shumë negociatash, palët ranë dakort të zgjidhin me pajtim mosmarrëveshjet midis tyre, të cilat ishin bërë shkak për fillimin e procedimit arbitral. Kështu, ndërmjet shtetit dhe konçesionarit u arrit të nënshkruhej Marrëveshja e Zgjidhjes me Mirëkuptim, e cila u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.235 datë 27.04.2007. Sipas kësaj marrëveshje të fundit, shteti njohu mospërmbushjen detyrimeve nga ana e tij, dëmet e shkaktuara konçesionarit për pasojë, si dhe mori përsipër t'i kompensonte këto dëme, sipas shumave të rena dakort. Gjithashtu shteti pranoi të përmbushte detyrimet e tij brenda një afati të caktuar në Marrëveshjen e Zgjidhjes me Mirëkuptim. Nga ana e tij, konçesionari ra dakort të hiqte dorë nga kompensimi i dëmeve (pjesë tjetër) në rast se shteti përmbushte detyrimet e papërmbushura. Marrëveshja e Zgjidhjes me Mirëkuptim, pas nënshkrimit dhe miratimit me VKM, iu paraqit Arbitrazhit Ndërkombëtar, i cili i dha kësaj marrëveshje formën e vendimit përfundimtar me vendimin nr.14420/FM datë 25.07.2007.

Petrolifera Italo-Rumena" Spa. dhe "La Petrolifera Italo-Albanese" Sha)³²².

iv. Vendim arbitrazhi në mungesë - Një vendim arbitrazhi në mungesë është një vendim i marrë pavarësisht mospjesëmarrjes së një pale në procedurën përkatëse. Nëse i padituri nuk merr pjesë, apo tërhiqet nga procesi, tribunali nuk mund automatikisht të japë një vendim në favor të paditësit³²³. Përkundrazi, forumi i arbitrazhit duhet të shqyrtojë me kujdes provat e paraqitura para tij dhe të sigurojë një vendimarrje mbi themelin e çështjes. Në një farë mënyre, mungesa e pjesëmarrjes së palës humbëse në procesi ngarkon një "barrë" gjykatës së arbitrazhit, e cila duhet të vërtetojë se në çdo fazë të procesit pala e humbur ka qenë njoftuar dhe ka pasur çdo mundësi për të marrë pjesë aktive. Në mënyrë që të japë një vendim të zbatueshëm, gjykata e arbitrazhi duhet të tregojë se ajo ka bërë përpjekje të arsyeshme dhe të vazhdueshme, madje edhe të konsiderueshme për t'i lejuar palës tjetër të paraqesë argumentat e saj dhe t'i mbrojë ato. Në rast të kundërt, zbatueshmëria e vendimit do të jetë lehtësisht e cënueshme, referuar shkaqeve refuzuese të njohjes dhe zbatimit, të parashikuara në nenin 5 të Konventës së Nju Jork-ut³²⁴.

IV.4.2. Autonomia e vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar nga rendi juridik i shtetit të origjinës – produkt i efektit të Konventës.

Pyetja më e rëndësishme në lidhje me arbitrazhin ndërkombëtar është burimi i fuqisë së arbitrave për të gjykuar. A buron një energji e tillë nga një sistem i vetëm ligjor kombëtar, apo arbitrazhi ndërkombëtar është një proces autonom, ku arbitrat e nxjerrin pushtetin e tyre nga shuma e të gjitha sistemeve ligjore nacionale, të cilët legjitimojnë fuqinë e marrëveshjes së arbitrazhit dhe të vendimit që rezulton nga ky proces?³²⁵ Në këtë aspekt, një nga çështjet më shumë të debatuar është ajo e ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit, të anuluar në shtetin ku vendimi është dhënë.

Ata që e shohin arbitrazhin ndërkombëtar si të varur në sistemin ligjor të shtetit të selisë së arbitrazhit, kuptohet që i njohin një peshë të konsiderueshme pozicionit të marrë nga ligji dhe gjykatat e këtij vendi mbi vlefshmërinë e vendimit arbitral. Për rrjedhojë do të presin që

³²² Kërkesa e regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me nr.1779 prot. datë 28.09.2007; Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.104 regj.themeltar, nr.106 i vendimit datë 08.11.2007 (shiko *infra* kap.V).

³²³ Ligji Model UNCITRAL, neni 25(b): *Në qoftë se, pa treguar shkak të mjaftueshëm dhe bindës i padituri nuk arrin te paraqesë mbrojtjen, gjykata e arbitrazhit do të vazhdojë procedimin pa e trajtuar një fakt të tillë në vetvete si një pranim të pretendimeve të paditësit.*

³²⁴ Margaret L.Moses, "Parimet dhe Praktika e Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar"; Cambridge University Press, 2008, f.183.

³²⁵ Emmanuel Gaillard, "Përfaqësuesit e Arbitrazhit Ndërkombëtar", Revista e Drejtësisë së Nju Jork-ut, vëllimi 238 - Nr.67, 4 Tetor 2007.

gjykatat e shteteve të tjera, ku është kërkuar njohja dhe zbatimi i vendimit të arbitrazhit, të pranojnë apriori një qendrim të tillë. Në të kundërtën, ata që e shohin arbitrazhin ndërkombëtar si një proces jo të rrënjësor në një sistem të caktuar të brendshëm ligjor, por që konsiderojnë forcën e tij të burojtë nga një tërësi sistemesh ligjore, do të konsiderojnë se çdo juridiksion kombëtar duhet të përcaktojë për vehten (nëpërmjet ligjit dhe gjykatave të tij) kushtet nën të cilat ky shtet do të njohë dhe zbatojë një vendim arbitrazhi.³²⁶

Rregullat e përcaktuara nga Konventa e Nju Jork-ut, sigurojnë përgjigje për pyetjet e mësipërme, duke parashikuar se çdo shtet do të njohë vendimet e arbitrazhit si të detyrueshme dhe do t'i zbatojë ato në përputhje me rregullat e procedurës të territorit (shtetit), ku vendimi është kërkuar të zbatohet³²⁷. Me fjalë të tjera, standardet, sipas të cilave një vendim arbitrazhi do të njihet dhe zbatohet, janë ato të përcaktuara nga sistemi ligjor i shtetit ku njohja dhe zbatimi kërkohen nga pala e interesuar. Në përputhje me këtë parim, dispozitat e Konventës³²⁸, *anullimin* apo *pezullimin* e vendimit të arbitrazhit nga shteti i origjinës, nuk e trajtojnë apriori si kusht të detyrueshëm për t'u marrë në konsideratë nga gjykatat e vendit ku është kërkuar njohja e këtij vendimi. Kjo sepse, Konventa parashikon që, në një situatë të tillë (kur vendimi i arbitrazhit është anuluar apo pezulluar nga autoriteti i shtetit të origjinës), njohja dhe zbatimi i vendimit *mund* të refuzohet nga gjykata e investuar për njohjen³²⁹. Fakti që hartuesit e Konventës posaçërisht zgjodhën për të përdorur fjalën "*mund*" (dhe jo psh. "*do të*") tregon qëllimin e tyre për të ruajtur diskrecionin e çdo sistemi ligjor për të vendosur, bazuar në standardet e veta, nëse një vendim i huaj arbitrazhi i plotëson apo jo kushtet për njohje dhe zbatim³³⁰.

Thelbi i këtyre rregullave është politika e Konventës në favor të zbatimit të vendimeve të arbitrazhit. Kjo filozofi "pro" zbatimit justifikon gjithashtu klauzolën e "dipozitës më të favorshme", të parashikuar në nenin 7 të Konventës³³¹, sipas të cilës, në rrethanat kur dispozitat e Konventës janë më kufizuese se rregullat e zbatueshme në shtetin ku vendimi është kërkuar të njihet, rregullat më të favorshme do të favorizojnë palën që ka kërkuar njohjen. Këto rregulla, së bashku me ato që minimizojnë kërkesat që duhet të plotësojë pala

³²⁶ *Id.*

³²⁷ Konventa e Nju Jork-ut, neni 3.

³²⁸ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(1)(e).

³²⁹ Shiko nenin 5, pika 1 të Konventës: "*Njohja dhe ekzekutimi i vendimit mund të refuzohen me kërkesën e palës kundër së cilës drejtohet, vetëm në qoftë se ajo.....*"

³³⁰ J.Paulsson, "Mund" apo "duhet" sipas Konventës së Nju Jork-ut: Një ushtrim në Sintaksë dhe linguistikë", Arbitrazhi Ndërkombëtar, 1998, f.227.

³³¹ Konventa e Nju Jork-ut, neni 7: "*Dispozitat e kësaj Konvente nuk ... i heqin të drejtën ndonjë pale të interesuar për të përfituar nga ndonjë vendim arbitrazhi në mënyrën, si dhe përsa parashikohet nga ligji ose traktetet e vendit ku kërkohet të zbatohet një vendim i tillë*".

që kërkon njohjen³³², përbëjnë një nga arritjet më të mëdha të Konventës së Nju Jork-ut, për faktin se garantojnë që Konventa të fokusohet vetëm tek vendimi i arbitrazhit si akt i pavarur prej juridiksionit të shtetit ku është dhënë. Në këtë mënyrë, vendimi i arbitrazhit ndërkombëtar prezantohet, prej Konventës, i “ankoruar” në të gjitha juridiksionet nacionale që pranojnë ta njohin atë dhe jo në një rend juridik të vetëm³³³.

Ky është, për shembull, konceptimi i pranuar prej kohësh nga praktika gjyqësore franceze³³⁴. Gjykatat franceze kanë mbrojtur vazhdimisht pikëpamjen se, edhe nëse një vendim arbitrazhi është anuluar nga gjykata e shtetit ku është dhënë vendimi, ai megjithatë mund të njihet dhe zbatohet në Francë nëse ai plotëson kushtet për njohjen, të përcaktuara nga legjislacioni francez.

Përfundime për kapitullin e katërt.

Neutraliteti i forumit dhe zbatimi i vendimeve në juridiksione të tjera janë dy arsytet mbizotëruese për zgjedhjen që palët i bëjnë arbitrazhit më shumë sesa gjykatave. E thënë ndryshe, shëndrimi i arbitrazhit ndërkombëtar në alternativën kryesore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tregtisë në mbarë botën, është ndër të tjera, pa diskutim, rezultat i efektit pozitiv që kanë luajtur rregullatorët e themeluar nga Konventa e Nju Jork-ut. Kjo Konventë garanton sot zbatimin e detyrueshëm të çdo vendimi arbitrazhi, që përfshihet në fokusin e saj, në 145 shtete të ndryshme botës, pavarësisht shtetësisë së vendimit.

Konventa e Nju Jork-ut ishte domosdoshmëri i kohës, pasi vihej në pikëpyetje efektiviteti i mekanizmit të arbitrazhit për shkak të vështirësive në praktikë në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve në shtete të ndryshme. Ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit në një shtet tjetër, deri në miratimin e Konventës së Nju Jork-ut, kërkonte që paraprakisht të procedohej me njohjen e vendimit në vendin ku ishte zhvilluar procesi i arbitrazhit. Në këtë mënyrë Konventa eliminoi të ashqtuquajturin “udhër-ekzekutimi të dyfishtë” (*double exequatur*), i cili në fakt kishte ulur ndjeshëm dobishmërinë e vetë mekanizmit të arbitrazhi ndërkombëtar. Fryma e ndërtimit të dispozitave të Konventës, por edhe ajo manifestuar në praktikë nga

³³² Shiko nenin 4 të Konventës, i cili kërkon nga pala që aplikon për njohjen, të depozitojë para gjykatës kompetente vetëm vendimin e arbitrazhit dhe marrëveshjen e arbitrazhit.

³³³ Emmanuel Gaillard, “Përfaqësuesit e Arbitrazhit Ndërkombëtar”, Revista e Drejtësisë së Nju Jork-ut, vëllimi 238 - Nr.67, 4 Tetor 2007.

³³⁴ Shiko: Vendimin *Norsolor*, Gjykata e Kasacionit, 9 Tetor 1984, Përmbledhëse e Arbitrazhit 1985, f.431; Vendimin *Hilmarton*, Gjykata e Kasacionit, 23 Mars, 1994, Përmbledhëse e Arbitrazhit 1994, f.327; Vendimin *Chromalloy*, Gjykata e Apelit të Parisit, 14 Janar, 1997, Përmbledhëse e Arbitrazhit 1997, f.395.

implementimi i tyre, ka qenë lehtësimi në tërësi i procedurave të zbatimit të një vendimi arbitrazhi.

Konventa e Nju Jork-ut parashikon në mënyrë shteruese shkaqet e refuzimit të zbatimit të një vendimi arbitrazhi, refuzim i cili nuk e shfletëson vendimin, por pamundëson shtrirjen e efekteve të tij në shtetin ku kërkohet zbatimi. Ndërkohë, vendimi i arbitrazhit mund të jetë i zbatueshëm në një shtet tjetër, rendi juridik i të cilit mund të jetë psh. më liberal në trajtimin e parimit të *arbitrueshmërisë* apo *rendit publik*, duke qënë kështu më favorizues ndaj efektit të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar. Gjithsesi, shtrirja përtej juridiksionit nacional të pasojave të një vendimi arbitrazhi të huaj, krijon mundësinë për ta “goditur” dy herë atë, duke kërkuar *anullimin* e vendimit, në shtetin e origjinës dhe *refuzimin e njohjes*, në shtetin ku kërkohet të zbatohet. Në të dy rastet, kundërshtimi para gjykatave nacionale bëhet duke invokuar të njëjtat pengesa ligjore, të cilat kuadri rregullator ndërkombëtar është kujdesur t’i parashikojë vetëm të natyrës procedurale dhe jo të themelit, ndërsa praktika gjyqësore është kujdesur që përgjithësisht t’i interpretojë ngushtësisht, duke favorizuar kështu një qasje *pro ekzekutueshmërisë* së këtyre vendimeve.

Kjo politikë e Konventës së Nju Jork-ut, për një *favor arbitratis*, kërkon gjithashtu, që qëndrimet e marra nga gjykatat e shtetit të selisë së arbitrazhit, në lidhje me vlefshmërinë e vendimit të arbitrazhit, të mos kenë efekt absolut mbi gjykatat e juridiksioneve të tjera, të cilat zgjedhin për të marrë në konsideratë apo jo këto qëndrime, në rastet kur ky vendim arbitrazhi është paraqitur para tyre për njohje.

Një vendim arbitrazhi duhet të jetë *final*, me qëllim që të mund të jetë objekt i një shqyrtimi gjyqësor. Instrumentat e Konventës së Nju Jork-ut zbatohen për vendimet finale të arbitrazhit, ndërsa një vendim arbitrazhi i quajtur “vendim i përkohshëm”, që trajton një masë të përkohshme, nuk konsiderohet përgjithësisht si vendim arbitrazhi i zbatueshëm forcërisht në kuadër të Konventës. Megjithatë në disa juridiksione, një vendim i përkohshëm mund të konfirmohet në zbatim të ligjit lokal të arbitrazhit, nëse vendimi disponon në mënyrë përfundimtare, mbi një çështje të veçantë dhe të pavarur.

KAPITULLI V

ARBITRAZHI NË JURIDIKSIONIN SHQIPTAR

Në kapitujt pararendës trajtuam elementë të rëndësishëm të arbitrazhit ndërkombëtar, veçanërisht ato të themeluar prej Konventës së Nju Jork-ut, si dhe interpretimin e tyre nga jurisprudenca ndërkombëtare. Është momenti të fokusohemi në trajtimin që juridiksioni Shqiptar i bën institutit të arbitrazhit. Sa i preferueshëm është arbitrazhi për zgjidhjen e kontesteve në ekonominë Shqiptare? Çfarë vendi zë në legjislacionin Shqiptar ky mekanizëm alternativ i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve? Cili është objekti i veprimit të tij në gamën e konflikteve të gjeneruar nga marrëdhëniet juridiko-civile? Si e dallon juridiksioni Shqiptar arbitrazhin e brendshëm nga ai ndërkombëtar? Të gjitha këtyre pyetjeve dhe të tjera si këto shpresoj t'u jepet përgjigje në këtë kapitull.

V.1. “Ftohtësia” e ekonomisë shqiptare ndaj mekanizmit alternativ të arbitrazhit.

Evolucioni i arbitrazhit në zgjidhjen e konflikteve të biznesit mbetet i një rëndësie kritike për bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar. Pa mënyra të besueshme për të zgjidhur kontestet ndërkufitare, shumë transaksione që krijojnë pasuri, ose do të mbeten të pakonsumuara, ose do të përfundojnë me kosto më të larta, duke reflektuar mungesën e mekanizmave të përshtatshëm për të vendikuar të drejtat që burojnë prej kontratës. Arbitrimi i mosmarrëveshjeve të fushës së biznesit siguron në këtë mënyrë përfitime neto si nga perspektiva e mirëqenies kombëtare ashtu edhe nga interesat e përbashkëta të komunitetit tregtar global³³⁵.

Sa më sipër, sikurse rezulton edhe nga sondazhet e zhvilluara, vihet re një tendencë e aktorëve të biznesit, veçanërisht atij ndërkombëtar, në favor të mekanizmit të arbitrazhit. Kështu nga një studim empirik i zhvilluar në vitin 2008, nga Shkolla e Arbitrazhit të Londrës, sponsorizuar nga shoqëria “PricewaterhouseCoopers”³³⁶, me fokus perceptimin mbi këtë fenomen të korporatave ndërkombëtare, rezultoi se për këto të fundit arbitrazhi ndërkombëtar mbetet mekanizmi i preferuar i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për transaksionet ndërkufitare. Një pjesë e madhe e korporatave pjesëmarrëse në sondazh (86%) deklarojnë se janë të kënaqur me arbitrazhin ndërkombëtar, duke vlerësuar si përparësi kryesore pikërisht: zbatueshmërinë e vendimeve të arbitrazhit, fleksibilitetin e procedurës dhe thellësinë e

³³⁵ William W.Park, “Arbitrazhi i Mosmarrëveshjeve të Biznesit Ndërkombëtar, Evoluimi Procedural në Arbitrazhin e Biznesit”, Oxford University Press, 2006, f.4.

³³⁶ “Queen Mary” University of London; PricewaterhouseCoopers; “Arbitrazhi Ndërkombëtar: Praktikata dhe qëndrimet e korporatave 2008”.

ekspertizës së arbitrave. Në përgjithësi, rreth 92% e konflikteve të shqyrtuara janë zgjidhur me sukses përmes procedurave të arbitrazhit³³⁷.

Por, fatkeqësisht fryma e një *favor arbitratis*, e konstatuar në nivel ndërkombëtar nuk rezulton të jetë përcjellë tek mjedisi i biznesit shqiptar. Në përgjithësi zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM), kryesisht arbitrazhi dhe ndërmjetësimi, nuk kanë qënë shumë atraktive për këtë mjedis. Ritmi i shpejtë i ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike në vendin tonë në këto dy dekadat e fundit, është karakterizuar nga rritja e numrit të konflikteve, të cilat përgjithësisht shohin ende si rrugën më të shkurtër për zgjidhjen e tyre atë drejt gjykatës shtetërore. Ndërsa jepen një mori argumentesh në favor të përdorimit të ZAM dhe rezultateve efektive të këtyre metodave, konstatohet lehtësisht se aktivitete të tilla për të zgjidhur informalisht mosmarrëveshjet, në realitetin shqiptar, janë të minimizuara³³⁸.

Një fakt domethënës, që flet shumë për natyrën e mjedisit të biznesit Shqiptar “jo në favor” të arbitrazhit, është veprimtaria e të vetmit forum të përhershëm Shqiptar të arbitrazhit, Qendrës “MEDART”. Në dhjetor të vitit 2002 në Shqipëri u krijua një forum arbitrazhi i përhershëm pranë Dhomës së Tregtisë Tiranë, Qendra Shqiptare e Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit Tregtar “MEDART”³³⁹, si një institucion i pavarur dhe privat, i themeluar me mbështetjen e Bankës Botërore. Kjo qendër ka administruar një numër të paktë rastesh dhe, pavarësisht qëllimit të saj, nuk ka arritur rezultate të ndjeshme në promovimin, në mjedisin shqiptar, të shërbimit të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve me arbitrazh³⁴⁰.

Ndjeshmëria e biznesit ndaj zgjidhjeve me arbitrazh të mosmarrëveshjeve, është një faktor i rëndësishëm, që në gjykimin tim, ndikon në sjelljen e legjislacionit dhe të jurisprudencës ndaj institutit të arbitrazhit. Kështu psh., “indiferenca” e legjislacionit Shqiptar për të miratuar

³³⁷ *Id.*, f.2: *Shumica dërrmuese e rasteve të arbitrazhit janë zgjidhur me sukses (92%): 25% e rasteve janë zgjidhur para se të jetë dhënë vendimi i arbitrazhit; 7% janë zgjidhur nëpërmjet në një vendimi arbitrazhi, të dhënë bazuar në pëlqimin e palëve; 49% e rasteve kanë përfunduar duke zbatuar vullnetarisht një vendim arbitrazhi; 11% e rasteve rezultojnë të zgjidhura, duke zbatuar procedurat e njohjes dhe zbatimit të një vendimi arbitrazhi (Konventa e Nju Jork-ut); vetëm në 8% të rasteve, të cilat janë përfshirë në procedura arbitrazhi, zgjidhjet e dhëna janë pasuar nga proceset gjyqësore.*

³³⁸ Arta Mandro, “Relativizmi” i lirisë së profesioneve të lira në funksion të një shërbimi “absolutisht” në të mirë të qytetarëve dhe në përputhje me ligjin: zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve: Ndërmjetësimi dhe Arbitrazhi”, Zgjidhjet Alternative të Mosmarrëveshjeve – RSHSL, Konferenca Vjetore 2008, f.1,2.

³³⁹ Qendra Shqiptare e Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit Tregtar “Medart” është i pari forum i përhershëm i arbitrazhit në Shqipëri, megjithëse nuk pati një jetë të gjatë. Nëpërmjet veprimtarisë së saj qendra krijoi një strukturë të qëndrueshme profesionale për ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit dhe arbitrazhit, për organizimin e zgjidhjes jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve tregtare dhe civile me ndërmjetësit dhe arbitrat e përfshirë në listën e saj.

³⁴⁰ Arta Mandro, “Relativizmi” i lirisë së profesioneve të lira në funksion të një shërbimi “absolutisht” në të mirë të qytetarëve dhe në përputhje me ligjin: zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve: Ndërmjetësimi dhe Arbitrazhi”, f.7: “...Nga veprimtaria e këtyre konstatohet se arbitrazhi i çështjeve tregtare është tepër i limituar”.

ligjin për arbitrazhin ndërkombëtar, ndoshta, mund të vijë edhe si pasojë e kësaj ndjeshmërie të ulët, apo e kësaj mungese presioni që biznesi duhet t'i bënte ligjvënësit për të përshpejtuar draftimin dhe miratimin e një kuadri ligjor bashkëkohor. Pavarësisht se në objektivin e këtij punimi nuk përfshihet evidentimi dhe vlerësimi i shkaqeve të kësaj “ftohtësie”, që manifeston sjellja e biznesit Shqiptar ndaj mekanizmit të arbitrazhit, e gjykoj me vend të përmend disa prej këtyre shkaqeve, të cilat në bindjen time janë të rëndësishme.

Së pari, sjellja tradicionale e biznesit, por dhe shoqërisë shqiptare në përgjithësi, për t'iu drejtuar gjykatave, në vend të zgjidhjes së konflikteve me mekanizma alternativë, është mbi të gjitha rezultat i një vetëdije të ulët juridike të shoqërisë³⁴¹. Vetëdija juridike është një përmbledhje e ideve, pikëpamjeve, ndjenjave dhe traditave, e cila pasqyron qëndrimin e njerëzve ndaj çështjeve ligjore në shoqëri. Hartimi dhe zbatimi i ligjeve në një shoqëri është i lidhur ngushtë me vetëdijen juridike të saj dhe kjo e fundit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e modelit të sjelljes së kësaj shoqërie³⁴². Gjatë kësaj periudhe 25 vjeçare, është evidentuar rëndom fakti që subjektet që zhvillojnë biznes përgjithësisht nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur aspekteve juridike që shoqërojnë biznesin e tyre. Në këtë kuadër, rregullimi paraprak i mënyrës se si do të zgjidhin konfliktet private eventuale, që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së këtij biznesi, në shumicën e rasteve nuk është pjesë e investimit fillestar të sipërmarrjes. Nga ana tjetër, arbitrazhi dhe në përgjithësi zgjidhja alternative e konflikteve është një fenomen i ri, ende i panjohur sa duhet për mjedisin e biznesit shqiptar. Doktrina e së drejtës e ka trajtuar pak të drejtën e arbitrazhit, e cila shpesh mungon si disiplinë edhe në kurrikulat universitare, ndërkohë që mund të ishte shumë e dobishme përfshirja e saj që në programet dhe tekstet shkollore të shkollave të mesme.

Së dyti, gjykoj se kjo vjen edhe si pasojë e mungesës së besimit të palëve në konflikt për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet e tyre në një gjykatë private³⁴³. Për shkak të ndikimit të faktorëve ekonomiko-politikë të tranzicionit shqiptar, bizneset shqiptare, pas vitit 1990, karakterizohen nga një mungesë e theksuar e besimit në sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe në drejtësinë e gjykatave shtetërore shqiptare, në veçanti. Për rrjedhojë, kanë qenë të pakta gjasat që këto biznese apo individë të mund të besonin se një gjykatës apo një gjykatë private do të mund t'i

³⁴¹ Emmond Paul, Zaka Tefta, Kalo Përparim, “Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi”, Shkolla e Magjistraturës së RSH, Tiranë 2007, f.183.

³⁴² Silvia Kaugia, “Struktura e vetëdijes ligjore”, *Juridica international*, I, 1996, f.16-20.

³⁴³ Emmond Paul, Zaka Tefta, Kalo Përparim, “Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi”, Shkolla e Magjistraturës së RSH, Tiranë 2007, f.300.

siguronte atyre drejtësinë, të cilën me vështirësi u'a siguron shteti³⁴⁴.

Së treti, një faktor i rëndësishëm duhet konsideruar edhe pamjaftueshmëria dhe paqartësia e kuadrit rregullator të brendshëm. Këtu duhet përmendur mungesa e një kuadri ligjor të plotë dhe bashkohor, veçanërisht për arbitrazhin, sikundër edhe mungesa e jurisprudencës në këtë fushë. Gjithashtu, nuk duhet lënë pa përmendur efekti i “transplantit” ligjor, që shkaktohet nga ratifikimi i dy konventave, asaj të Gjenevës dhe të Nju Jork-ut, pa u ndjekur nga plotësime normative kombëtare apo interpretime doktrinale dhe jurisprudenciale.

Së katërti, në këtë pikë jam i mendimit se duhet vlerësuar seriozisht edhe perceptimi negativ e kritik, madje deri stigmatizues, i biznesit shqiptar në fillim-vitet 90^{të} për veprimtarinë e institutit të arbitrazhit gjatë periudhës 45 vjeçare të sistemit socialist të ekonomisë së centralizuar. Në parantezë, duhet theksuar se vendi ynë, në drejtim të zgjidhjes së konflikteve nëpërmjet arbitrazhit, trashëgon një përvojë të pasur, kryesisht për shkak të veprimtarisë së institucionit të Arbitrazhit Shtetëror, gjatë periudhës 1947-1993.

Le të ndalemi shkurtimisht në atë çfarë parashikonte rendi juridik për institutin e arbitrazhit në Shqipëri, duke u fokusuar kryesisht në Arbitrazhin Shtetëror përpara reformave ligjore demokratike që shoqëruan fillimin e viteve 90^{të}.

V.2. Veçoritë e natyrës juridike të arbitrazhit në Shqipëri, deri në vitin 1993.

Në Shqipëri, si në shumë vende të tjera të botës, historia e zhvillimit të institutit të arbitrazhit daton shumë dekada më parë. Fillesat e trajtimit të këtij instituti procedural civil i gjejmë në periudhën e regjimit të Zogut (viti 1924-1939), periudhë në të cilën u ndërmorën një sërë reformash në legjislacion, përfshirë këtu fushën e të drejtës civile, tregtare dhe atë procedurale civile. Me hyrjen në fuqi të Shtojcës së Dytë të Procedurës Civile (01.04.1929), gjen rregullim për herë të parë ky institut, përkatësisht në nenet 412 deri 434, të cilët bëjnë rregullimin ligjor të arbitrazhit nën titullin “Procedimi i arbitruer”. Ndër të tjera, këto dispozita rregullojnë kushtet e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit³⁴⁵ (kompromeso), duke e përkufizuar atë si *“akordi mbas të cilit zgjidhja e një kontestimi duhet të bahet me anë të një, ose më shumë arbitrash, ka efekt ligjor, kur palët kanë zotësinë dhe munden ligjërisht*

³⁴⁴ Shiko Francis Fukuyama, “Besimi - Virtytet shoqërore dhe krijimi i prosperitetit”, 1996, ku argumentohet se niveli i besimit në një shoqëri formëson natyrën e marrëdhënieve ekonomike dhe institucioneve të saj. Individët e shoqërive me besim të ulët nuk janë të prirur të ndërtojnë marrëdhënie të forta jashtë strukturave të tilla si familja apo klani.

³⁴⁵ Shiko Flutura Tafaj, “Historik i zhvillimit të arbitrazhit në Shqipëri”, Cikël leksionesh pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, 2013, fq.2.

*me lidhë paqësim mbi objektin e kontestimit... Kompromesoja duhet të mbahet me shkrim*³⁴⁶. Sikurse shihet, kriteri kryesor i vlefshmërisë është parashikuar zotësia e palëve për të lidhur një marrëveshje arbitrazhi, kriter ky që edhe sot, në rendin juridik ndërkombëtar, trajtohet si një nga shkaqet ligjore (madje i pari) për anulimin e vendimit të arbitrazhit³⁴⁷ dhe për kundërshtimin e njohjes së tij³⁴⁸. Po kështu forma e shkruar ka qenë një tjetër element vlefshmërie i marrëveshjes së arbitrazhit (kompromeso), kriter ky që është ruajtur dhe parashikohet ende sot nga Kodi i Procedurës Civile³⁴⁹, panvarësisht se sikurse do të trajtohet në vijim, tendenca ndërkombëtare paraqitet më liberale, përsa i përket formës së marrëveshjes së arbitrazhit³⁵⁰.

Pas luftës së II botërore, Shqipëria, ashtu si pjesa më e madhe e vendeve të Europës Lindore, zbatoi sistemin e ekonomisë socialiste, duke u bazuar në teorinë marksiste dhe shembullin sovjetik të ndërtimit dhe funksionimit të ekonomisë. Në këtë këndvështrim, në të gjitha këto vende përfshirë Shqipërinë, me fillimin e ndërtimit të sistemit ekonomik, u krijua edhe institucioni i *Arbitrazhit Shtetëror*. Në Shqipëri, Arbitrazhi Shtetëror u krijua për të parën herë me dekret-ligjin nr.443 date 2 korrik 1947 “Mbi zgjidhjen e konflikteve pasurore me arbitrazh shtetëror”, i cili mund të konsiderohet si ligji organik i këtij instituti. Gjatë periudhës 50 vjeçare të ekonomisë së centralizuar komuniste, institucioni i Arbitrazhit Shtetëror pësoi disa ndryshime të rëndësishme organizative dhe procedurale³⁵¹. Zhvillimi i fundit ligjor në arbitrazhin shtetëror, ishte ligji nr.7424, datë 14.11.1990 “Për arbitrazhin shtetëror”³⁵² dhe rregullorja në zbatim të tij. Krahas Arbitrazhit Shtetëror, me dekretin

³⁴⁶ *Id.* fq.2.

³⁴⁷ Ligji model UNCITRAL “Për arbitrazhin ndërkombëtar tregtar”, 1985, i amenduar në vitin 2006, neni 34, pika 2, par.(a)/i: “Një vendim i arbitrazhit mund të anulohet nga gjykata kompetente e percaktuar në nenin 6 (e percaktuar nga shteti që e ka miratuar ligjin model) vetëm nëse: pala që ben ankimin siguron prova se: (i) një palë në marrëveshjen e arbitrazhit, të referuar sipas nenit 7 (të ligjit model), ishte e pazotë për të vepruar, ose marrëveshja e lartepërmendur nuk është e vlefshme sipas ligjit, të cilit palët i nënshtrohen ose, në mungesë të çfarëdo të dhene mbi të, sipas ligjit të këtij shteti...”;

³⁴⁸ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5, pika 1(a): “Njohja dhe ekzekutimi i vendimit mund të refuzohen me kërkesën e palës kundër së cilës drejtohet, vetëm në qoftë se ajo palë i paraqet autoritetit kompetent ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi, provën që: a.palët në marrëveshjen që i referohet nenit 2, në bazë të ligjit të zbatueshëm për to, ishin të paafta për të vepruar, ose marrëveshja në fjalë nuk është e vlefshme sipas ligjit, të cilit i janë nënshtruar palët ose mungon ndonjë përcaktim sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi, ose”.

³⁴⁹ K.Pr.C, neni 404 “Pavlefshmëria e marrëveshjes për arbitrazh”: “Është i pavlefshëm kushti për gjykimin e mosmarrëveshjes me arbitrazh, kur nuk pasqyrohet me shkrim në vet marrëveshjen kryesore të palëve ose me një dokument tjetër të shkruar që i referohet asaj, siç mund të jetë telegrami, teleksi e çdo mjet tjetër i saktë që përbën provë shkresore....”.

³⁵⁰ Shih *infra*, analizën krahasimore midis arbitrazhit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar (nënseksioni IV.3.2: Përkufizimi dhe forma e marrëveshjes së arbitrazhit).

³⁵¹ Dekreti nr.1872 dt.07.05.1954 “Mbi arbitrazhin shtetëror”; Dekreti nr.5009 dt.10.11.1972 “Mbi arbitrazhin shtetëror”, Fletorja Zyrtare: viti 1972, Nr.6, faqe 75; Dekreti Nr.6927, datë 14.11.1984 “Për disa ndryshime në Dekretin Nr.5009 “Për arbitrazhin shtetëror”, Fletorja Zyrtare: viti 1984, Nr.3, faqe 45.

³⁵² Ligj nr.7424, datë 14.11.1990 “Për arbitrazhin shtetëror”, Fletorja Zyrtare: viti 1990, Nr.7, Faqe 240, Data e aprovimit 14.11.1990, Data e botimit 30.11.1990.

nr.4359 dt.19.01.1968³⁵³, ishte krijuar edhe Arbitrazhi i Tregtisë së Jashtme. Ngritja e kësaj strukture pranë Dhomës së Tregtisë, kishte për qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, që lindnin nga marrëdhëniet tregtare midis një ndërmarrje, institucioni apo organizate shtetërore Shqiptare nga njëra anë dhe një personi fizik apo juridik të huaj, nga ana tjetër.

Sipas këtij kuadri ligjor, arbitrazhi shtetëror krijohej si institucion i përhershëm, me struktura të ngritura pranë këshillave popullore të nënprefekturave, pranë ministrive dhe pranë qeverisë. Arbitrazhi i shqyrtonte mosmarrëveshjet në kolegji, të përbërë nga një arbitër dhe dy ndihmës-arbitra, duke thirrur palët në konflikt. Juridiksioni i arbitrazhit shtetëror kishte një natyrë të dyfishtë (dualiste), që do të thotë se institucionet e arbitrazhit e vendosnin juridiksionin për mosmarrëveshjet në 2 (dy) raste:

i) arbitrazhi shtetëror kishte juridiksion të *detyrueshëm* kur shqyrtonte konfliktet pasurore-kontraktore, ose parakontraktore midis institucioneve dhe ndërmarrjeve shtetërore midis tyre (konfliktet “*shteti kundër shtetit*”),

ii) arbitrazhi shtetëror kishte juridiksion *vullnetar*, pra të bazuar në vullnetin e palëve në konflikt, kur shqyrtonte konfliktet pasurore-kontraktore, ose parakontraktore midis institucioneve e ndërmarrjeve shtetërore nga njëra anë dhe kooperativave ose ndërmarrjeve ekonomiko-private, apo personave privatë fizike e juridike, nga ana tjetër (konfliktet “*shteti kundër privatit*”), si dhe midis vetë këtyre të fundit (konfliktet “*privati kundër privatit*”). Në këto raste juridiksioni i arbitrazhit mund të vendosej, thënë ndryshe, konfliktet mund të shqyrtoheshin nga instancat e arbitrazhi shtetëror, vetëm në rast se palët në konflikt e kishin përcaktuar këtë në kontratë, ose nëqoftëse kishin arritur marrëveshje të veçantë me shkrim për arbitrazh.

Në rastin kur mosmarrëveshjet merreshin në shqyrtim nga arbitrazhi me kërkesë të palëve³⁵⁴, arbitrazhi shtetëror paraqiste karakteristika të ngjashme me arbitrazhin klasik, juridiksioni i të cilit, sikurse trajtohet nga doktrina, ka origjinë kontraktore. Teoria kontraktore thekson faktin se esenca e arbitrazhit është kontraktuale, sepse para së gjithash arbitrazhi themelohet bazuar tërësisht në marrëveshjen midis palëve. Atje ku nuk ka marrëveshje midis palëve, asnjëra prej palëve nuk mund të detyrojë palën tjetër për të referuar mosmarrëveshjen e tyre në arbitrazh³⁵⁵. Por, në arbitrazhin shtetëror, mosmarrëveshjet merreshin në shqyrtim edhe me

³⁵³ Dekret nr.4359, datë 16.01.1968 “Mbi arbitrazhin e tregëtisë së jashtme pranë Dhomës së Tregtisë të Republikës Popullore të Shqipërisë”; Fletorja Zyrtare: Viti 1968, Nr.1, Faqe 4, Data e aprovimit 16.01.1968, Data e botimit 25.01.1968.

³⁵⁴ Ligji nr.7424, datë 14.11.1990 “Për arbitrazhin shtetëror”, neni 11(a).

³⁵⁵ Shiko *supra* nënseksioni II.3.2. “Teoria Kontraktuale”.

iniciativën e vetë strukturave të përhershme të arbitrazhit, pra kryesisht, ose me kërkesën e organit pranë të cilit ishte krijuar (Këshilli Ministrave, Ministrinë, institucionet qendrore, etj), madje edhe të prokurorit³⁵⁶. Ky i fundit iniconte procedura arbitrazhit, në rolin e institucionit që vihej në mbojtje të interesave ekonomike të subjekteve shtetërore. Një parashikimi i tillë e poziciononte arbitrazhin shtetëror, si mekanizëm i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve pasurore, në epërsi të dukshme ndaj gjykatave shtetërore.

Roli i Arbitrazhit Shtetëror ishte mjaft aktiv. Përveç faktit që ai merrte me iniciativën e tij (*ex officio*) juridiksionin për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, ky institucion, edhe kur juridiksioni kishte si bazë vullnetin e palëve, mund të tejkalohte kufirin e kërkesave fillestare të ngritura nga palët. Pra vendimi final i arbitrazhit shtetëror mund të tejkalohte në disponimin e tij atë çfarë kishin kërkuar palët në aplikimin drejtuar arbitrazhit. Ndërkohë referuar kërkesave të Kodit të Procedurës Civile, që aktualisht rregullojnë arbitrazhin në Republikën e Shqipërisë, *tejkalimi i autoritetit që palët i kanë dhënë arbitrave* përbën një shkak ligjor të mjaftueshëm për rrëzimin e vendimit të arbitrazhit³⁵⁷. Këtë “super-pushtet” arbitrazhi shtetëror e gëzonte *de jure* falë misionit që ligji i atribuonte, mision i cili përfshinte mbrojtjen e ligjshmërisë në dobi të plotësimin të planit e të kontratave, të regjimit të kursimit, të bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve, institucioneve dhe kooperativave³⁵⁸. Në këtë kuadër, arbitrazhi kishte detyrë të nxirrte dhe analizonte shkaqet e mosrealizimit të kontratave madje edhe përgjegjësinë eventuale të punonjësve apo subjekteve shtetëror, qofshin këto palë në gjykim ose jo.

Përsa i përket kompetencës, Arbitrazhi Shtetëror impononte juridiksionin e tij si të vetmin juridiksion për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pasurore kontraktore, ose parakontraktore, si dhe mosmarrëveshjeve që lindnin nga ngjarje dhe veprime që sillnin pasoja juridike civile midis institucioneve, organizatave shoqërore dhe ndërmarrjeve shtetërore midis tyre. Pra në të ashtuquajturat konflikte “*shteti kundër shtetit*”, arbitrazhi shtetëror ishte alternativë e vetme dhe jo zgjidhje alternative, sikurse konsiderohet ky mekanizëm ligjor në ditët e sotme³⁵⁹. Në këtë kontest nuk ishte e nevojshme shprehja e vullnetit të palëve nëpërmjet

³⁵⁶ VKM nr.26, datë 04.01.1991 “Për miratimin e “Rregullores për shqyrtimin e çështjeve nga Arbitrazhi Shtetëror” (Fletore Zyrtare Nr.2, datë 28.02.1991, faqe 63), neni 4: “Kërkesëpadia që i drejtohet arbitrazhit, duhet të shqyrtohet me dokumentet e nevojshme, ... Kërkesat e ministrave e të institucioneve të tjera qendrore, të prokurorit dhe të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve pranohen pa këto dokumente. Në këto raste arbitrazhi përcakton vetë se çfarë dokumentesh duhet të merren e të administrohen”.

³⁵⁷ Kodi i Procedurës Civile, neni 434(c): “Vendimi i gjykatës së arbitrazhit mund të ankimohet në gjykatën e apelit kur... gjykata e arbitrazhit në vendimin e saj ka tejkuluar kërkesat për të cilat ka qenë investuar ose nuk është shprehur mbi një nga kërkesat kryesore të padisë”.

³⁵⁸ Ligji nr.7424, datë 14.11.1990 “Për arbitrazhin shtetëror”, neni 1.

³⁵⁹ Çështja Marini kundër Shqipërisë, Ankimi nr.3738/02, Vendim 18 Dhjetor 2007, Strasbourg, par.10: *Në një datë të papërcaktuar, për të përfutur dëmshpërblim, ankuesi u ankua në Arbitrazhin Shtetëror, i cili në atë kohë*

marrëveshjes së arbitrazhit, për të vendosur juridiksionin e arbitrazhit shtetëror, pasi ky i fundit ishte juridiksioni i vetëm i mundshëm³⁶⁰. Ndërkohë që rregullimi aktual i institutit të arbitrazhit, kërkon që për të patur juridiksion një gjykatë arbitrazhi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duhet të plotësohet kushti i domosdoshëm i shprehjes së vullnetit të palëve nëpërmjet marrëveshjes së arbitrazhit³⁶¹.

Kjo e fundit (marrëveshja) ishte e detyrueshme në arbitrazhin shtetëror, në rastet e shqyrtimit të mosmarrëveshjeve pasurore kontraktore, ose parakontraktore midis vetë kooperativave bujqësore (konfliktet “*privati kundër privatit*”), si dhe midis institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore nga njëra anë dhe kooperativave nga ana tjetër (konfliktet “*shteti kundër privatit*”). Gjithashtu me ndryshimet ligjore të vitit 1991, u parashikua që marrëveshja për arbitrazh ishte e domosdoshme në rastet kur njëra nga palët në konflikt ishte e huaj. Edhe kur nuk ishte parashikuar në kontratë zgjidhja e çështjes në arbitrazh, pas lindjes së mosmarrëveshjes, palët mund të binin dakord me shkrim që t’i drejtoheshin arbitrazhit, duke njohur kështu vlefshmërinë e *kompromisit* për arbitrazh³⁶².

Vendimi i arbitrazhit shtetëror ishte i formës së prerë dhe ndaj tij lejohej rekursi vetëm nga pak autoritete shtetërore të përcaktuara në mënyrë strikte me ligj, për mbrojtje të ligjshmërisë³⁶³. Rekursi bëhej para Mbledhjes së Përgjithshme (kolegjit) të Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave, vendimi i të cilit ishte përfundimtar³⁶⁴.

ishte organi kompetent për mosmarrëveshjet ku përfshiheshin ndërmarrjet me kapital shtetëror. Më 7 maj 1993, Arbitrazhi Shtetëror njohu vlefshmërinë e statutit të shoqërisë “Marini-Albplastik”. Për më tepër, ai urdhëroi shtetin t’i paguante ankuesit.....

³⁶⁰ Neni 1 i Rregullores “Për shqyrtimin e çështjeve nga Arbitrazhi Shtetëror”, miratuar me VKM Nr.26 datë 04.01.1991: “*Nërmarrjet, institucionet, organizatat shoqërore, kooperativat, personat juridik a fizikë të huaj a shqiptarë me seli jashtë territorit të RPSSH, kur nuk arrijnë t’i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet pasurore që lindin ndërmjet tyre nga mosekzekutimi ose ekzekutimi jo në mënyrën e duhur të detyrimeve kontraktore, i drejtohen arbitrazhit*”.

³⁶¹ Neni 403 i K.Pr.Civile: “*Mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm në qoftë se ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë t’ia nënshtrajnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre*”

³⁶² Neni 20 dhe 21 të Rregullores “Për shqyrtimin e çështjeve nga Arbitrazhi Shtetëror”.

³⁶³ Ligji nr.7424, datë 14.11.1990 “Për arbitrazhin shtetëror”, neni 29(2): *Kundër vendimeve të kolegjeve të arbitrazhit pranë komitetit ekzekutiv të rrethit, si dhe të kolegjeve të Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave, Ministri i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe kryetari i Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave, kanë të drejtë t’i bëjnë kërkesë për mbrojtje ligjshmërie mbledhjes së përgjithshme të arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave, brenda tre muajve nga data e dhënies së vendimeve.*

³⁶⁴ Shiko vendimin e Gj.K.nr.14, datë 08.11.1995, për çështjen “Vlash Marini kundër Këshillit të Ministrave”, ku Gj.Kushtetuese e RSh. shprehet: “*Nga shqyrtimi i çështjes u vërtetua se ish-kolegji i Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave me vendimin nr.382, datë 05.11.1993, ka vendosur përfundimisht detyrimin e NEFINK Tiranë t’i paguaj kërkuarit Vlash Marini shumën prej 6 milion lekë. Kërkuari, për të realizuar të drejtën e tij ka kërkuar nga Këshilli i Ministrave dorëzimin e kopjes së vendimit të sipërm. Por Këshilli i Ministrave nuk ia ka dhënë vendimin. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese e R.Sh, njëzëri, vendosi: “Detyrimin e Këshillit të Ministrave t’i dorëzojë kërkuarit Vlash Marini, një kopje të vendimit nr.382, datë 05.11.1993 të Kolegjit të ish-Arbitrazhit Shtetëror pranë Këshillit të Ministrave”.*

Vendimi i arbitrazhi ishte në vetvete titull ekzekutiv dhe i detyrueshëm për zbatim nga Banka e Shtetit, institucionet e tjera financiare, sikurse edhe për institucionin përbarimor. Ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit bëhej vullnetarisht nga vetë palët në afatin e caktuar, ose në të kundërt, vendimi vihej në ekzekutim të detyrueshëm, në bazë të *urdherit të ekzekutimit*, të lëshuar nga vetë arbitri që kishte marrë vendimin³⁶⁵.

Një fakt shumë interesant përse i përket procedurës së zhvillimit të gjykimit në arbitrazh ishte fakti që gjykimi parashikohej të bëhej, jo vetëm në selitë e arbitrazhit, por edhe në mënyrë popullore, psh. në prani të këshillit teknik të ndërmarrjes, kryesisë së kooperativës, në prani të punonjësve të tjerë, etj³⁶⁶. Ndërkohë që, një nga parimet kryesore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nëpërmjet arbitrazhit, të afirmuar sot nga shumë legjislacione kombëtare dhe ai ndërkombëtar³⁶⁷, është parimi i *konfidencialitetit* të procesit, duke e cilësuar këtë proces si një procedurë private gjykimi³⁶⁸.

Për ta mbyllur këtë panoramë të shkurtër të veçorive të institutit të arbitrazhit deri në vitin 1993 gjykoj që, panvarësisht se kuadri ligjor i kohës e emërtonte *arbitrazh* këtë mekanizëm, në fakt nuk kemi të bëjmë me të vërtetë me arbitrazh, të paktën në kuptimin klasik të termit, po më së shumti ky ishte një *sistem i posaçëm i gjykimit shtetëror* i ngritur në kuadër të një ekonomie të centralizuar shtetërore. Kësisoj, menjëherë pas viteve 90^{të}, aktorët e ekonomisë së lirë në Shqipëri u përballën me një sistem arbitrazhi, i cili për shkak të tipareve të mësipërme, nuk konsiderohej aspak një mekanizëm atraktiv për subjektet tregtare në përgjithësi. Ndoshta, pikërisht tek kjo “shije e hidhur” e eksperiencës së Arbitrazhit Shtetëror duhet kërkuar një nga arsyet e kësaj “ftohtësie” apo “anatemimi” që rëndom vihet re në mjedisin e biznesit shqiptar ndaj mekanizmit të arbitrazhit, për zgjidhjen e konflikteve tregtare, në këtë periudhë.

³⁶⁵ Ligji nr.7424, datë 14.11.1990 “Për arbitrazhin shtetëror”, neni 28.

³⁶⁶ Vendim Nr.178, datë 24.10.1973 “Mbi aprovimin e rregullores mbi shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nga arbitrazhi shtetëror”; Fletorja Zyrtare: Viti 1973, Nr.5, Faqe 79.

³⁶⁷ Ligji model UNCITRAL “Për arbitrazhin tregtar ndërkombëtar”, neni 20(1) “Vendi i arbitrazhit”: Palët janë të lira të merren vesh për vendin e arbitrazhit. Në rast mosarritjes së marrëveshjes, vendi i arbitrazhit do të përcaktohet nga forumi i arbitrazhit, duke marrë në konsideratë rrethanat e çështjes, përfshirë edhe nevojat e palëve.

³⁶⁸ Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin, Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar; UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38: “Karakteristikat kryesore të tij (arbitrazhit) janë: - arbitrazhi është një mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; - arbitrazhi është konsensual; - arbitrazhi është një procedurë private; - arbitrazhi con në një zgjidhje finale dhe të detyrueshme për të drejtat dhe detyrimet e palëve”.

V.3. Rregullimi aktual i institutit të arbitrazhit sipas Kodit të Procedurës Civile³⁶⁹ - vështrim krahasues me nivelin bashkohor të regjimit ndërkombëtar.

Në Shqipëri, procedura e arbitrazhit rregullohet nëpërmjet titullit IV “Arbitrazhi”, të pjesës së dytë “Gjykimi në shkallë të parë”, të Kodit të Procedurës Civile (nenet 400-438), i cili i dedikohet posaçërisht arbitrazhit të brendshëm. Në kuptim të këtij ligji, arbitrazhi është një institut i veçantë i së drejtës procedurale civile, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me karakter pasuror, jashtë veprimtarisë gjyqësore. Ai përfaqëson vullnetin e palëve për një zgjidhje të shpejtë e të drejtë të këtyre mosmarrëveshjeve, duke ia besuar këtë mision një ose më shumë personave, të cilët organizojnë dhe zhvillojnë gjykimin, duke i’u përmbajtur kufijve të misionit të ngarkuar, në lidhje me juridiksionin civil të zbatueshëm. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve pasurore nëpërmjet arbitrazhit bën të mundur mënjanimin e një pjesë të konsiderueshme të proceseve gjyqësore³⁷⁰.

Kapitulli i neneve 400-438 rregullon të gjitha konceptet që kanë të bëjnë me arbitrazhin, ku mund të përmendim për ilustrim rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me marrëveshjen e arbitrazhit, zgjedhjen e forumit të arbitrazhit (arbitrazh *ad-hoc* apo institucional), të ligjit të zbatueshëm për marrëveshjen e arbitrazhit, gjykatën e arbitrazhit dhe procedurën e tij, ndërhyrjet e gjykatave civile në një proces arbitral, dhënien dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit, e të tjera.

Ky punim, ndër të tjera, ka si qëllim të nxjerrë në pah stadin, në të cilin rregullohen në juridiksionin shqiptar disa elemente kryesore të arbitrazhit. Në këtë kuadër, le të trajtojmë në vijim disa aspekte të procesit të arbitrazhit, në një këndvështrim krahasues midis regjimit ndërkombëtar, ku referimi do të bëhet kryesisht tek Ligji model UNCITRAL dhe legjislacionit të brendshëm shqiptar.

V.3.1. Mundësia e një autoriteti shtetëror për t’iu nënshtruar arbitrazhit.

Një nga epërsitë e njohura ndaj arbitrazhit, veçanërisht, arbitrazhit ndërkombëtar, është perceptimi i tij si një forum më neutral, kur një nga palët në konflikt është një autoritet shtetëror. Legjislacionet nacionalë mund të tregohen të kujdesshëm, duke vendosur *pengesa* ndaj mundësisë që një ent shtetëror të jetë subjekt i juridiksionit arbitral. Në fakt, ekziston një

³⁶⁹ Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 (Flet.Zyrtare nr.9/1996, faqe 343) dhe ndryshuar me ligjin nr.8431, datë 14.12.1998; ligjin nr.8491, datë 27.5.1999; ligjin nr.8335, datë 18.10.1999; ligjin nr.8812, datë 17.5.2001; ligjin nr.9953, datë 14.07.2008; ligjin nr.10052, datë 29.12.2008; ligjin Nr.122/2013.

³⁷⁰ Jani Vasili, “Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2005 (Gervis), f.198.

rrezik, kur një palë në një kontratë është shtet apo ent shtetëror, që ky i fundit të pretendojë sovranitetin, apo imunitetin ndaj juridiskionit të një shteti tjetër³⁷¹. Një tjetër rrezik është që entiteti shtetëror të deklaronte imunitet nga zbatimit i një vendimi arbitrazhi kundër aseteve të tij. Përgjithësisht, gjykata kompetente shtetërore lejon ekzekutimi kundër pasurive tregtare të një sovrani të huaj. Megjithatë, ekziston edhe mundësia që gjykatat nacionale të respektojnë deklaratën e një shteti të huaj që asete të caktuara të tij janë *aktive jo-tregtare*³⁷².

Aplikimi i konventave nderkombëtare ka patur një impakt pozitiv në reduktimin e këtyre pengesave. Në këtë kontekst, neni 2 i Konventës Evropiane të Arbitrazhit³⁷³, parashikon detyrimin e një enti publik për t'iu nënshtruar procedurave të arbitrazhit³⁷⁴. I njëjti nen, në paragrafin e dytë njih të drejtën e çdo shteti nënshkrues të Konventës për të paraqitur një “rezervë” në këtë drejtim, me qëllim për të reflektuar kufizimet që ligji i tij i brendshëm parashikon përsa i përket mundësisë së entit publik për t'iu nënshtruar arbitrazhit³⁷⁵. Ndërkohë që ligji shqiptar i përjashton të tilla kufizime. Kodi i Procedurës Civile parashikon qartë se një organizatë shtetërore, nuk mund të refuzojë t'i nënshtrohet gjykimit në arbitrazh³⁷⁶. Në këtë mënyrë, ligji i brendshëm në Shqipëri, i pengon këto entitete të pretendojnë imunitet shtetëror ndaj juridiksionit arbitral, duke qënë kështu në koherencë me frymën bashkohore të regjimit ndërkombëtar.

V.3.2. Përkufizimi dhe forma e marrëveshjes së arbitrazhit.

Versioni fillestar i parashikimit që Ligji Model (1985)³⁷⁷ bënte në lidhje me formën e marrëveshjes së arbitrazhit, i ngjante parashikimit të bërë prej Konventës së Nju Jork-ut, e cila kërkonte që marrëveshja e arbitrazhit të ishte detyrimisht me shkrim³⁷⁸. Në amendimin që

³⁷¹ Margaret L.Moses, *Parimet dhe Praktika e Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar*; Cambridge University Press, 2008, f.51.

³⁷² *Shiko çështjen: “Alcom Ltd. kundër Republikës së Kolumbisë dhe të tjerë”* (1984) A.C. 580, ku një gjykatë Angleze pranoi deklaratën e një ambasadori të huaj, që një llogari bankare e veçantë nuk përdorej për qëllime tregtare. *Shiko gjithashtu çështjen: “AIG Capital Partners Inc. kundër Republikës së Kazakistanit dhe të tjerë”* (2005) EWHC2239 (Comm): Asetet në Londër që ishin pjesë e një fondi kombëtar, të menaxhuar nga Banka Kombëtare e Kazakistanit ishin immune nga procedurat e ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit, përsa i përket vendimeve të arbitrazhit kundër Republikës së Kazakistanit.

³⁷³ Konventa Evropiane mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar, Gjenevë, 21 Prill, 1961 (Seria e Traktateve të K.B., vol.484, f.364 No.7041).

³⁷⁴ Neni 2(1) i Konventës Evropiane: *Personat juridikë, për të cilët ligji që zbatohet për to, i cilëson si “persona juridikë të së drejtës publike”, kanë të drejtë të përfundojnë në mënyrë të vlefshme marrëveshje arbitrazhi.*

³⁷⁵ Neni 2(2) i Konventës Evropiane: *Në rastin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit në këtë Konventë, çdo shtet ka të drejtën të deklarojë se ai e kufizon këtë të drejtë me kushtet e parashikuara në deklaratën e vet.*

³⁷⁶ Neni 402(2) i K.Pr.C: *Kur njëra palë është shteti ose një ndërmarrje apo organizatë e kontrolluar prej tij, ajo nuk mund të pretendojë të drejtën për të mos qënë palë në një procedurë arbitrazhi.*

³⁷⁷ Neni 7 i Ligjit Model UNCITRAL 1985.

³⁷⁸ Neni 2(2) i Konventës së Nju Jork-ut.

Komisioni³⁷⁹ i bëri Ligjit Model, në vitin 2006, u miratuan dy opsione në lidhje me formën e marrëveshjes, të cilat reflektonin dy qasje të ndryshme. *Qasja e parë* i qëndron versionit klasik të "*formës me shkrim*" të marrëveshjes së arbitrazhit, por nga ana tjetër, njeh çdo formë të regjistrimit të përmbajtjes së marrëveshjes, si ekuivalente të formës tradicionale të shkruar. Kjo do të thotë se nuk kërkohet më firmosja e detyrueshme e palëve³⁸⁰. *Qasja e dytë* e Ligjit Model UNCITRAL bën përkufizimin e marrëveshjes së arbitrazhit, duke dhënë vetëm thelbin e saj, pa u shprehur fare për formën.³⁸¹ Qëllimi i parashikimit të dy qasjeve ishte të sigurohej sa më shumë të ishte e mundur zbatueshmëria e marrëveshjes së arbitrazhit në kuadër të Konventës së Nju Jork-ut³⁸².

Në këtë mënyrë dispozita e Ligjit Model, e amenduar në vitin 2006, nëpërmjet dy opsioneve të saj e lë të hapur, në zgjedhjen e lirë të shteteve, formën e marrëveshjes së arbitrazhit: a) versioni i formës me shkrim, por në kuptim shumë të zgjeruar ose b) versioni i formës së lirë të papërcaktuar. Një hap të metejshëm në modernizimin e konceptit për formën e marrëveshjes së arbitrazhit, ka bërë edhe Konventa e Gjenevës, e cila e lë të lirë formën e kësaj marrëveshje në varësi të parashikimeve që ligjet e shteteve, të cilëve u përkasin palët në mosmarrëveshje, kanë bërë për formën e marrëveshjes së arbitrazhit³⁸³.

Sipas dispozitave të K.Pr.C, për të patur juridiksion një gjykim arbitrazhi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duhet të plotësohet edhe kushti i domosdoshëm i shprehjes së vullnetit të palëve nëpërmjet marrëveshjes së arbitrazhit³⁸⁴. Pra kuadri ligjor i brendshëm përcakton se nuk mund të ketë procedurë arbitrazhi pa marrëveshje ose pa pranim/kompromis midis palëve, pasi gjykimi në arbitrazh ngrihet vetëm mbi bazën e vullnetit të palëve. Praktika

³⁷⁹ Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL).

³⁸⁰ Opsioni I i nenit 7 të Ligjit Model UNCITRAL, amenduar në 7 korrik 2006 "*Një marrëveshje arbitrazhi është me shkrim, nëse përmbajtja e saj është regjistruar në ndonjë formë, pavaresisht nëse marrëveshja e arbitrazhit ose kontrata është lidhur me gojë, nëpërmjet sjelljes, ose me mjete të tjera*".

³⁸¹ Opsioni II i nenit 7 nuk parashikon fare paragrafët që shpjegojnë kushtet e "*formës me shkrim*" të marrëveshjes së arbitrazhit, sikurse bën opsioni I: "*Marreveshja e arbitrazhit*" është një marrëveshje midis palëve për t'i nënshtruar arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre, lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jo kontraktore.

⁴⁶ Ligji Model UNCITRAL "Mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar", i miratuar nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare, më 21 qershor 1985, amenduar në 7 korrik 2006, (No.E.08.V.4) Pjesa e 2-të "Shënim shpjegues i Sekretariatit UNCITRAL mbi Ligjin Model".

³⁸³ Konventa Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, Gjenevë, 21 prill 1961, neni 1, pika 2/a: *termi "Marrëveshje Arbitrazhi", do të thotë qoftë klauzolë arbitrazhi në kontratë ose një marrëveshje arbitrazhi, kontratë ose marrëveshje arbitrazhi që janë nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash, telegramesh ose në një komunikim me teleshkruar dhe në marrëdhëniet ndërmjet shteteve, ligjet e të cilëve nuk kërkojnë formën e shkruar për marrëveshjen e arbitrazhit, çdo marrëveshje e përfunduar në format e lejuara prej këtyre ligjeve;*

³⁸⁴ K.Pr.C, neni 403: *Mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm në qoftë se ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë t'ia nënshtrorjnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre.*

gjyqësore, panvarësisht se e rrallë në raste, na përcjell të njëjtën situatë, pra parashikimin e detyrueshëm të marrëveshjes së arbitrazhit si kusht të vendosjes së juridiksionit të forumit të arbitrazhit. Kështu në vendimin e saj, Gjykata e Arbitrazhit pranë Qendrës Shqiptare për Ndërmjetësim dhe Arbitrazh Tregtar (MEDART), për çështjen "Shoqëria "CLASSIC" shpk kundër "Televizioni Arbëria" sha³⁸⁵, shprehet: "*Juridiksioni i arbitrazhit pranë Qendrës Shqiptare për Ndërmjetësim dhe Arbitrazh Tregtar, për gjykimin e kësaj çështjeve midis palëve ndërgjyqëse buron nga neni 7 i Kontratës së Sipërmarrjes së shërbimit të lidhur midis palëve, në data 01.02.2005 dhe 01.02.2006*". Po kështu, në çështjen "Artel" shpk kundër "Albanova" shpk³⁸⁶, Gjykata e Apelit Tiranë konstaton se: "*...në nenin 15.2 të kontratës së qirasë datë 11.10.2008, palët kanë përcaktuar se Qiradhënësi dhe Qiramarrësi do të përpiqen që mosmarrëveshjet ndërmjet tyre do t'i zgjidhin me bashkëbisedim dhe mirëkuptim. Në rast të kundërt, palët do t'i drejtohen për zgjidhje Arbitrazhit pranë Qendrës Shqiptare për Ndërmjetësim dhe Arbitrazh (MEDART), sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara nga kjo Qendër. Nga kjo dispozitë kontraktore, rezultojnë qartë dy fakte: a) Fakti që palët kanë përjashtuar juridiksionin e zakonshëm (gjyqësor) dhe vullnetarisht kanë zgjedhur juridiksionin e një Gjykate Arbitrazhi; b) Fakti që palët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre kanë përcaktuar si norma procedurale civile, rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Qendra MEDART*".

Legjislacioni Shqiptar nuk bën asnjë dallim për sa i përket efektit të këtyre dy formave të marrëveshjes së arbitrazhit, çka nënkupton se regjimi ligjor i brendshëm i shtrin efektet e tij në mënyrë të njëjtë për *klauzolën dhe marrëveshjen e veçantë* të arbitrazhit. Ligji i brendshëm që rregullon marrëveshjen e arbitrazhit përcakton edhe kriteret e një marrëveshjeje të vlefshme dhe kjo bëhet duke parashikuar rastet e kundërta, pra rastet kur marrëveshja është e pavlefshme (neni 404 i K.Pr.C). Ndër të tjera parashikohet edhe pavlefshmëria e marrëveshjes për shkak të mungesës së formës së shkruar³⁸⁷. Kështu, për sa i përket formës së marrëveshjes së arbitrazhit, kuadri ligjor i brendshëm shqiptar është konservator, duke mos përqaftuar frymën bashkohore që propozon regjimi ndërkombëtar i arbitrazhit (Ligji Model dhe Konventa e Gjenevës). Në praktikën shqiptare, marrëveshja e arbitrazhit ndeshet përgjithësisht në trajtën e klauzolës së arbitrazhit, si pjesë e kontratës "mëmë" të lidhur midis palëve. Një formë e paraqitjes së klauzolës së arbitrazhit, mund të jetë e tillë: "*Të gjitha*

³⁸⁵ Vendimi nr.3/2007 datë 24.09.2007 i Gjykatës së Arbitrazhit pranë Qendrës MEDART.

³⁸⁶ Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.123 akti dhe nr.186 vendimi, datë 10.10.2013.

³⁸⁷ K.Pr.C., Neni 404(1): "*Është i pavlefshëm kushti për gjykimin e mosmarrëveshjes me arbitrazh, kur nuk pasqyrohet me shkrim në vet marrëveshjen kryesore të palëve ose në një dokument tjetër të shkruar që i referohet asaj, siç mund të jetë telegrami, teleksi e çdo mjet tjetër i saktë që përbën provë shkresore*".

*mosmarrëveshjet që do të dalin apo rrjedhin nga kjo Marrëveshje e Konçesionit për, do të trajtohen e zgjidhen mëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar (siç parashikohet në nenin 17 të Ligjit nr.7973 datë 26.07.1995), në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, nga një ose më shumë arbitra, të caktuar në përputhje me Rregullat e sipërpërmendura. Arbitrat do të zbatojnë dhe marrin vendime duke u bazuar në të drejtën Franceze. Vendi i arbitrazhit do të jetë Parisi. Gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja. Vendimi i dhënë nga arbitri do të jetë detyrues dhe përfundimtar për palët"*³⁸⁸.

Sipas ligjit Shqiptar edhe numri i arbitrave dhe mënyra e përcaktimit të tyre është kusht për vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit. Kështu KPrC parashikon se marrëveshja e arbitrazhit është e pavlefshme, në rast se në të nuk parashikohet mënyra e caktimit të arbitrit ose arbitrave³⁸⁹. Në këtë mënyrë kjo dispozitë imponon palët për të caktuar arbitrat apo për të rënë dakort për mënyrën e përcaktimit të tyre. Në çështjen e sipërpërmendur "Shoqëria "CLASSIC" shpk kundër "Televizioni Arbëria" sha, Gjykata e Arbitrazhit pranë Qendrës MEDART shprehet: *Kjo dispozitë e kontratave (neni 7) parashikon se palët kanë rënë dakort që gjykimi i mosmarrëveshjes të bëhet me arbitrazh, nga një arbitër, i cili do të caktohet nga lista e arbitrave të Qendrës Shqiptare të Ndërmjetësimin dhe Arbitrazhit Tregtar (MEDART). Konkretisht kjo e fundit, pas paraqitjes së kërkesës nga paditësi, zgjodhi si arbitër të vetëm të çështjes, zj.Tefta ZAKA. Në të njëjtën optikë, neni 4 i Konventës Europiane të Arbitrazhit përcakton detyrimin e palëve për të caktuar arbitrat, si dhe sqaron mënyrën e caktimit të tyre, në rast se palët nuk e përmbushin në kohë këtë detyrim. Ligji Model UNCITRAL, nga ana tjetër, sugjeron që në rast mospërcaktimi të numrit të arbitrave, gjykata arbitrale do të formohet nga tre arbitra³⁹⁰, ndërsa ligji Shqiptar përcakton se nëse palët nuk bien dakort, mbi këtë çështje vendos gjykata e cila cakton një ose disa arbitra në numër tek³⁹¹.*

Sipas ligjit Shqiptar, qartësia e objektit të mosmarrëveshjes është gjithashtu kusht për vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit. K.Pr.C, në nenin 404, përcakton se *marrëveshja*

³⁸⁸ Klauzola e arbitrazhit parashikohet në nenin 17 të Marrëveshjes së Konçesionit të datës 24.05.2004, të lidhur midis palëve: "La Petrolifera Italo-Rumena" Spa. ("konçesionari") dhe Qeverisë së RSh ("shteti"), të formës BOO dhe BOT, të miratuara me ligjin nr.9231 datë 13.05.2004, i cili hyri në fuqi më datë 21.06.2004 (shiko *infra* çështjen "La Petrolifera Italo-Rumena" Spa. dhe "La Petrolifera Italo-Albanese" Sha. kundër Republika e Shqipërisë" - Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.106, datë 08.11.2007).

³⁸⁹ K.Pr.C., neni 404(2): *Marrëveshja e palëve.....është e pavlefshme, në rast se në atë nuk parashikohet mënyra e caktimit të arbitrit ose arbitrave, si dhe objekti i mosmarrëveshjes, kur ajo efektivisht ka lindur.*

³⁹⁰ Ligji Model, neni 10: "Numri i arbitrave": "(1) Palët janë të lira të përcaktojnë numrin e arbitrave. (2) Në mungesë të një përcaktimi të tillë, numri i arbitrave do të jetë tre".

³⁹¹ K.Pr.C., neni 405: *Palët mund të merren vesh në mënyrë të pavarur për numrin e arbitrave në një gjykatë arbitrazhi dhe për mënyrën e caktimit të tyre. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve dhe me pëlqimin paraprak të tyre, gjykata e arbitrazhit formohet nga një arbitër ose më shumë arbitra në numrin tek, që caktohen nga gjykata.*

e arbitrazhit është e pavlefshme, në rast se në atë nuk parashikohet objekti i mosmarrëveshjes, kur ajo efektivisht ka lindur. Pra, në rastin kur një konflikt është ngritur eventualisht dhe palët i drejtohen arbitrazhit për ta zgjidhur atë, kompromisi midis palëve duhet të identifikojë qartësisht objektin e këtij konflikti. Një parashikimi i tillë nuk gjen vend shprehimisht në kuadrin normativ ndërkombëtar, por indirekt paqartësia e objektit të mosmarrëveshjes mund të përbëjë një shkak për anulimin e një vendimi arbitrazhi³⁹² sikurse edhe një arsye për refuzimin e njohjes dhe zbatimit të tij³⁹³. Qartësia si element i klauzolës së arbitrazhit ka të bëjë me hapësirën e marrëdhënieve kontraktuale, për të cilën palët bien dakort që t'i nënshtrohet arbitrazhit. Palët mund të vendosin që një pjesë të konflikteve, ose që të gjitha konfliktet në lidhje me kontratën kryesore midis tyre t'i nënshtrohen për zgjidhje arbitrazhit.

V.3.3. Ndërhyrja e gjykatës shtetërore në themelimin e forumit të arbitrazhit.

Prej kohësh regjimi ndërkombëtar pranon ndërhyrjen e një instance gjyqësore nacionale në mbështetje të kursit të rregullt të procesit të arbitrazhit. Ligji Model UNCITRAL parashikon se kur palët nuk kanë shprehur vullnetin e tyre për të hartuar rregullat procedurale, apo kanë dështuar në rrgullimin e një çështjeje të veçantë dhe si rezultat përballen me veshitësi përse i përket procesit të emërimit, kundërshtimit apo përfundimit të mandatit të një arbitri, një gjykatë shtetërore apo një autoritet tjetër kompetent mund të ndërhyjë dhe ofrojë asistencën e saj³⁹⁴. Nga ana tjetër, duke marrë në kosideratë emergjencën që shoqëron nevojën për themelimin dhe funksionimin e forumit të arbitrazhit dhe me qëllimin për të shmangur rrezikun e taktikave vonuese të qëllimshme, janë parashikuar gjithashtu kritere kufizuese ndaj ndërhyrjes gjyqësore, si psh. janë vendosur afate të shkurtra për mundësinë e ndërhyrjes gjyqësore, si dhe është sanksionuar pamundësia e apelimit të vendimeve gjyqësore që shprehen për çështje të ngritjes dhe funksionimit të procesit arbitral³⁹⁵.

³⁹² Ligji Model UNCITRAL, neni 34(2)(a): “Një vendim i arbitrazhit mund të anulohet nga gjykata kompetente ... vetëm nëse pala që bën ankimin siguron prova se : (iii) vendimi ka të bëjë me një mosmarrëveshje të paparashikuar ose jashtë kufijve të kushteve të parashtrimit të arbitrazhit, ose përmban vendime mbi çështje përtej qëllimit të parashtrimit të arbitrazhit, ...”;

³⁹³ Ligji Model UNCITRAL, neni 36(1)(a): “Njohja ose zbatimi i një vendimi arbitrazhi, pavarësisht nga vendi në të cilin është marre, mund të kundërshtohet me kërkesë të palës kundër të cilës jepet vendimi, në qoftë se ajo palë i siguron gjykatës kompetente ku kërkohet njohja dhe zbatimi, prova të qarta që: (iii) vendimi ka të bëjë me një mosmarrëveshje të paparashikuar ose jashtë kufijve të kushteve të parashtrimit të arbitrazhit, ose përmban vendime mbi çështje përtej qëllimit të parashtrimit të arbitrazhit, ...”;

³⁹⁴ Ligji Model UNCITRAL, neni 11, 13, 14.

³⁹⁵ Shënime shpjeguese të Sekretariatit UNCITRAL për Ligjin Model (No.E.08.V.4.), pjesa II, paragrafi 23, 24.

Legjislacioni i brendshëm Shqiptar e pranon ndërhyrjen gjyqësore për ngritjen e gjykatës së arbitrazhit. Sipas KPC, përsa i përket themelimit të forumit të arbitrazhit, pranohet ndërhyrja e gjykatës në rastet kur palët nuk arrijnë me marreveshje të zgjidhin të gjitha çeshtjet, veçanërisht a) në rastin e caktimit të numrit të arbitrave³⁹⁶ dhe b) në rastin e përjashtimit të arbitrit³⁹⁷. Por legjislacioni ynë i brendshëm nuk e kufizon në aspektin kohor ndërhyrjen gjyqësore, duke mos caktuar një afat maksimal, brenda të cilit, pala apo palët kanë detyrimin të caktojnë arbitrin ose arbitrat. “Neglizhenca” e ligjvënësit përsa i përket afatit operues, i lë hapësirë diskrecionit të palëve, të cilët mund të caktojnë një afat të tillë në marrëveshjen midis tyre për procedurën e formimit të gjykatës së arbitrazhit. Ndërsa referuar regjimit ndërkombëtar (psh. Ligji Model UNCITRAL³⁹⁸, apo Konventës Europiane të Arbitrazhit³⁹⁹) tendenca është të caktohet një afat, brenda të cilit palët duhet të kenë caktuar arbitrat dhe vetëm në rast të kundërt (në rast të mosrespektimit të këtij afati) pala e interesuar mund të kërkojë ndërhyrjen e organit gjyqësor apo organit tjetër kompetent sipas parashikimit të legjislacionit kombëtar përkatës.

V.3.4. Juridiksioni i gjykatës së arbitrazhit dhe problematika e saj (parimi i “Kompetencës për Kompetencë” dhe parimi i “Ndashmërisë”).

Kuadri ligjor ndërkombëtar e ka trajtuar mjaft mirë çështjen e juridiksionit të forumit të arbitrazhit dhe zgjidhjen e kontesteve ndaj tij. Në këtë pikë, është me vend të përmendet parashikimi që Ligji Model UNICTRAL⁴⁰⁰ bën për dy parime të rëndësishme në fushën e arbitrazhit ndërkombëtar, parimi i “Kompetencës për Kompetencë” (“*Kompetenz-Kompetenz*”) dhe parimi i “Ndashmërisë” (“*Separability*”) ose autonomisë së klauzolës

³⁹⁶ K.Pr.C, neni 405: Palët merren vesh në mënyrë të pavarur për numrin e arbitrave në një gjykatë arbitrazhi dhe për mënyrën e caktimit të tyre. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve dhe me pëlqimin paraprak të tyre, gjykata e arbitrazhit formohet nga një arbitër ose më shumë arbitra në numrin tek, që caktohen nga gjykata kompetente (që është gjykata e shkallës së parë).

³⁹⁷ K.Pr.C, neni 409, parashikon se në rast se arbitri për të cilin është kërkuar përjashtimi nuk tërhiqet nga misioni ose procedura e caktuar nga palët nuk i jep zgjidhje këtij kundërshtimi, vendos gjykata e arbitrazhit pa pjesëmarrjen e arbitrit për të cilin është kërkuar përjashtimi. Kur edhe kjo e fundit nuk i jep zgjidhje kërkesës për përjashtim, vendos gjykata e shkallës së parë, jo më vonë se 15 ditë nga dita e ardhjes për gjykim të kësaj mosmarrëveshjeje.

³⁹⁸ Ligji Model UNCITRAL, neni 11(3)(a): në një arbitrazh me tre arbitra, secila palë duhet të emërojë një arbitër, dhe dy arbitrat e emëruar në këtë mënyrë do të caktojnë arbitrin e tretë. Nëse një palë dështon në emërimin e arbitrit brenda tridhjetë ditëve nga marrja e kërkesës për ta bërë këte gjë nga pala tjetër, ose nëse dy arbitrat nuk bien dakord mbi arbitrin e tretë brenda tridhjetë ditëve nga emërimi i tyre, emërimi do të bëhet, me kërkesën e njerës palë nga gjykata shtetërore, ose nga një autoritet tjetër të specifikuar në ligjin e brendshëm të çdo shteti.

³⁹⁹ Konventa e Gjenevës, neni IV(2): Kur palët kanë rënë dakord që t’ia nënshtrojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre një arbitrazhi “ad hoc” dhe kur brenda 30 ditësh nga njoftimi i kërkesës për arbitrazh palës së paditur, njëra nga palët nuk e ka caktuar arbitrin e vet, ky i fundit do të caktohet, përveç kur parashikohet ndryshe, me kërkesën e palës tjetër, nga kryetari i dhomës kompetente të tregtisë.

⁴⁰⁰ Ligji Model UNCITRAL, neni 16(1).

arbitrale. Parimi “*Kompetenz-Kompetenz*” nënkupton autoritetin e forumit të arbitrazhit për të vendosur në mënyrë të pavarur mbi çështjen e juridiksionit të tij, përfshirë këtu edhe kundërshtimin e ekzistencës së marrëveshjes së arbitrazhit apo vlefshmërisë së saj, pa qenë nevoja për t’iu drejtuar një gjykatë shtetërore.

Ndërsa parimi *Separability* i referohet trajtimit të klauzolës arbitrale si një marrëveshje e pavarur nga termat e tjera të kontratës kryesore ku është përfshirë. Si pasojë, një vendim i gjykatës së arbitrazhit që kontrata kryesore midis palëve është nul nuk sjell ipso jure pavlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit⁴⁰¹. Kështu, në çështjen angleze të “*Heyman kundër Darwins Ltd.*”⁴⁰², gjykata argumentoi se klauzola e arbitrazhit do të mbijetojë (do të jetë e vlefshme) për të vendosur arbitrat në mënyrë të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, madje edhe kur vetë kontrata, ku përfshihet kjo klauzolë, dështon (zhvleftësohet).

Në të njëjtën perspektivë kuadri ligjor i brendshëm shqiptar parashikon autoritetin e gjykatës së arbitrazhit për t’u shprehur mbi juridiksionin e saj, duke pranuar kështu parimin “*Kompetenz-Kompetenz*”. Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile parashikojnë se me fillimin e veprimtarisë së saj, gjykata e arbitrazhit kryesisht ose me kërkesën e palëve, vendos për kompetencën e vet, duke përfshirë edhe vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit⁴⁰³. Kur ajo pranon me vendim se marrëveshja e arbitrazhit është e pavlefshme, quhet se ajo e ka përfunduar misionin e saj. Zbatimi i një parimi të tillë është shumë konvenient në praktikë pasi një verifikim jo në kohën e duhur të kompetencës dhe vlefshmërisë së marrëveshjes arbitrale, mund të sillte pavlefshmërinë e veprimeve procedurale që mund të ishin kryer deri në atë moment.

Ligji ynë i brendshëm nuk parashikon asgjë në lidhje me autonominë e klauzolës arbitrale nga pjesa tjetër e kontratës, duke mos adoptuar kështu parimin *Separability*. Mungon, kështu, në ligjin shqiptar një parashikim i ngjashëm psh. me nenin 808 të Kodit të Procedurës Civile Italiane⁴⁰⁴, apo me nenin 7 të Aktit Anglez të Arbitrazhit (1996)⁴⁰⁵, për *vlerësimin e klauzolës*

⁴⁰¹ Shënim shpjegues i Sekretariatit UNCITRAL mbi Ligjin Model (No.E.08.V.4), pjesa II, par.25.

⁴⁰² Çështja e referuar: “*Heyman kundër Darwins Ltd.*”. [1942] AC 356: Lord Macmillan shprehet: “...nuk është treguar vëmendje e mjaftueshme ndaj natyrës së vërtetë dhe funksionit të klauzolës së arbitrazhit në një kontratë. Ajo është mjaft e dallueshme nga klauzolat e tjera. Në një kontratë të zakonshme, nëse klauzolat që parashikojnë detyrimet e palëve ndaj njëra-tjetrës nuk do të zbatohen, pasoja që vjen përgjithësisht do të jetë shpërblimi i dëmit ndaj palës së dëmtuar. Por, nëse një klauzolë arbitrazhi nuk do të respektohet në mënyrë të njëanshme, atëherë pasoja do të jetë zbatimi forcërisht i saj nga makineria e akteve të arbitrazhit, ndërkombëtarë apo nacionalë. Pra zgjidhja më e përshtatshme për shkeljen e marrëveshjes së arbitrazhit nuk është zhdëmtimi i palës, por zbatimi forcërisht i saj”.

⁴⁰³ K.Pr.C, neni 417

⁴⁰⁴ Kodi i Procedurës Civile Italiane, miratuar me Dekretin Mbretëror të datës 28 tetor 1940 nr.1443, i ndryshuar; Libri IV “Procedurat e veçanta”; Titulli VIII “Mbi arbitrazhin”, Kreu I “Mbi marrëveshjen e

së arbitrazhit në mënyrë të pavarur nga kontrata në të cilën ajo bën pjesë. Një parashikim i tillë, i cili konsiderohet si një parim i pa vënë kurrë në diskutim nga doktrina dhe jurisprudenca, bën të qartë se marrëveshja për arbitrazh është e veçueshme dhe e pavarur nga kontrata kryesore, duke qënë kështu e pandjeshme ndaj veseve të marrëdhënies kontraktore⁴⁰⁶. Për këtë arsye, pretendimet për pavlefshmërinë e kontratës, të ngritura për kontratën kryesore, në princip, nuk do ta prekin klauzolën e arbitrazhit. Kuptohet që këtu bëjnë përjashtim shkaqe të “rënda” të pavlefshmërisë, siç mund të përmendim *shkakun e paligjshëm të kontratës* psh. si pasojë e korrupsionit, ku pavleshmëria e kontratës do të efetojë domosdoshmërisht edhe klauzolën e kompromisit⁴⁰⁷.

Një tjetër mungesë në parashikimet e ligjit të brendshëm është mos përfshirja e mundësisë që ka pala e interesuar për të kërkuar kontroll të menjëhershëm gjyqësor mbi kompetencën e forumit të arbitrazhit për të vendosur mbi juridiksionin e tij. Ndërkohë që, sipas kuadrit ligjor ndërkombëtar, një kompetencë e tillë është patjetër objekt i kontrollit gjyqësor nga një gjykatë shtetërore. Ligji Model UNCITRAL⁴⁰⁸ parashikon se nëse gjykata e arbitrazhit do të shprehet mbi juridiksionin e saj, kontrolli gjyqësor pranohet menjëherë me qëllim për të shmangur mundësinë e humbjes së kohës dhe të parave, në rastin e ndjekjes së një procedure arbitrazhi e cila më vonë, në një apelim të mundshëm, do të konsiderohej e pavlefshme për shkak të mungesës së juridiksionit të forumit. Nga ana tjetër, për të shmangur rrezikun e taktikave vonuese të qëllimshme, janë parashikuar “siguresa” procedurale, si psh. periudha e shkurtër e kërkesë-padisë në gjykatë (30 ditë), pamundësia e apelimit të vendimit gjyqësor, apo dhe diskrecioni i forumit të arbitrazhit për të vazhduar procedimin gjatë kohës që çështja

arbitrazhit”, neni 808 “Klauzola e Kompromisit”: “*Palët, në kontratën e tyre ose në një dokument të veçantë mund të parashikojnë që kontestet që dalin nga kontrata të zgjidhen nga arbitrat, me kusht që konteste të tilla të mund të jenë subjekt i marrëveshjes së arbitrazhit. Klauzola e arbitrazhit duhet të jetë në një dokument që përmbush formën e nevojshme për kompromis, të parashikuar në nenin 807. Vlefshmëria e klauzolës së arbitrazhit duhet të vlerësohet në mënyrë të pavarur prej kontratës së cilës i referohet; megjithatë, autoriteti për të lidhur kontratën përfshin autoritetin për të rënë dakord mbi klauzolën e arbitrazhit”.*

⁴⁰⁵ Akti Anglez i Arbitrazhit (1996) neni 7: *Më përjashtim të rastit kur është rënë dakord ndryshe nga palët, një marrëveshje arbitrazhi, e cila formon apo kishte për qëllim që të formojë pjesë të një marrëveshje tjetër (pavarësisht nëse janë apo jo me shkrim) nuk do të konsiderohet si e pavlefshme, jo-ekzistente apo e paefektshme për shkak se marrëveshja tjetër është e pavlefshme, nuk ekziston apo është bërë e paefektshme, dhe për këtë qëllim do të trajtohet si një marrëveshje e veçantë.*

⁴⁰⁶ F.Carpi, V.Colesanti, M.Taruffo “Komentari i shkurër i Kodit të Procedurës Civile dhe i dispozitave të Procesit të Korporatave”; bot.5 – Padova: CEDAM, 2006; f.2169.

⁴⁰⁷ *Id.*

⁴⁰⁸ Ligji Model UNCITRAL, neni 16(3): Në qoftë gjykata e arbitrazhit vendos, si një çështje paraprake, që ajo ka juridiksion, çdo palë mund t’i kërkojë, brenda tridhjetë ditëve pasi ka marrë njoftimin për atë vendim, gjykatës apo autoritetit përkatës të çdo shteti, të vendosë mbi çështjen e juridiksionit. Vendimi i këtij autoriteti të fundit nuk mund të jetë subjekt i asnjë ankese, ndërkohë që kur një kërkesë e tillë është lënë pezull (është në shqyrtim), gjykata e arbitrazhit mund të vazhdojë procedimin e arbitrazhit dhe të marrë një vendim.

e juridiksionit të tij është për shqyrtim para një gjykate shtetërore⁴⁰⁹. Megjithatë ligji ynë i brendshëm, sikurse edhe regjimi ndërkombëtar, pranon kontrollin gjyqësor të vendimit të arbitrazhit që shprehet pozitivisht mbi juridiksionin e vet, në procedimin e kundërshtimit (ankimimit) të vendimit final të arbitrazhit⁴¹⁰, ose gjatë procedimit për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit final të arbitrazhit⁴¹¹.

V.3.5. Masat e përkohshme dhe ndërhyrja e gjykatës shtetërore.

Regjimi ligjor ndërkombëtar i arbitrazhit, përta i përket masave të përkohshme në procedurat e arbitrazhit, parashikon ndërhyrjen e gjykatës shtetërore dy herë:

a) *së pari*, sipas Ligjit Model UNCITRAL gjykata ndërhyr për të njohur dhe zbatuar një masë të përkohshme të lëshuar nga një gjykatë arbitrazhi⁴¹². Kuptohet se gjatë këtij procesi gjykata ka në kompetencë edhe të refuzojë njohjen dhe zbatimin e një mase të përkohshme me kërkesën e palës kundër të cilës masa është dhënë, ose kryesisht (*ex officio*). Gjykata, në një rast të tillë, mund të refuzojë njohjen dhe zbatimin e masës së përkohshme vetëm nëse shkaqet ligjore të refuzimit janë plotësuar dhe në çdo rast gjykata nuk mund të ndërmarrë një kontroll në themel të vendimit për masën e përkohshme⁴¹³.

b) *së dyti*, gjykata shtetërore mund të ndërhyjë drejtpërdrejtë duke nxjerrë urdhëra gjyqësore për masa të përkohshme. Në këtë rast gjykata do të ketë të njëjtin autoritet sikurse edhe forumi i arbitrazhit në lidhje me procedimin arbitral dhe do të duhet t'a ushtrojë një pushtet të tillë në përputhje me procedurën e saj duke mbajtur në konsideratë edhe tiparet specifike të arbitrazhit ndërkombëtar⁴¹⁴. Në këtë mënyrë, ekzistenca e një marrëveshje arbitrazhi nuk bies ndesh me autoritetin e gjykatës shtetërore kompetente për të nxjerrë vendime për masa të përkohshme dhe sejcila palë e interesuar e marrëveshjes së arbitrazhit, është e lirë t'i drejtohet kësaj gjykate me kërkesën për të urdhëruar masa të përkohshme⁴¹⁵.

Ndërkohë, sipas legjislacionit të brendshëm shqiptar, përta i përket masave të përkohshme të

⁴⁰⁹ Shënim shpjgues i Sekretariatit UNCITRAL mbi Ligjin Model (No.E.08.V.4), pjesa II, par.25.

⁴¹⁰ K.Pr.C, neni 434(b): "...vendimi i gjykatës së arbitrazhit mund të ankohet në gjykatën e apelit vetëm kur: b) gjykata e arbitrazhit pa të drejtë ka deklaruar kompetencën apo moskompetencën e saj për gjykimin e mosmarrëveshjes".

⁴¹¹ *Id.*, neni 394(a): "Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur: a) sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin".

⁴¹² Ligji Model UNCITRAL, neni 17/H: (1) "Një masë e ndërmjetme e lëshuar nga një gjykatë arbitrazhi do të njihet si e detyrueshme dhe, me përjashtim të rastit kur është parashikuar ndryshe nga palët, do të zbatohet forcërisht nëpërmjet një kërkesë drejtuar gjykatës kompetente, panvarësisht shtetit ku masa është lëshuar, ...".

⁴¹³ *Id.*, neni 17/I "Shkaqet për refuzimin e njohjes dhe zbatimit".

⁴¹⁴ *Id.*, neni 17/J "Masat e përkohshme të urdhëruara nga gjykata".

⁴¹⁵ Shënim shpjgues i Sekretariatit UNCITRAL mbi Ligjin Model (No.E.08.V.4), pjesa II, par.30.

marra nga forumi i arbitrazhit, gjykata shtetërore ka autoritetin të ndërhyjë vetëm për ekzekutimin e tyre, si psh. në rastin kur kërkohet të ekzekutohet masa e sigurimit të padisë nëse pala, kundër të cilës është dhënë masa, nuk e zbaton vullnetarisht atë⁴¹⁶. Kuptohet që në këtë rast ndërhyrja e gjykatës i referohet vetëm *ekzekutimit forcërisht* të masës provizore të dhënë me vendim nga gjykata e arbitrazhit dhe jo shqyrtimit në themel, pra gjykata nuk verifikon nëse ka vend ose jo për marrjen e kësaj mase⁴¹⁷. Por ky legjislacion nuk parashikon autoritetin e gjykatës shtetërore, ashtu si një gjykatë arbitrazhi, për të urdhëruar masa të përkohshme. Në këtë mënyrë, sipas ligjit të brendshëm, nëse midis palëve është lidhur një marrëveshje arbitrazhi, asnjë prej tyre nuk mund t'i drejtohet gjykatës kompetente shtetërore për të marrë masa provizore në funksion të procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes objekt arbitrazhi.

V.3.6. Zhvillimi i procedurave të arbitrazhit.

Dispozitat e legjislacionit ndërkombëtar garantojnë të drejtat themelore procedurale të palëve në një proces arbitrazhi. Përmendim këtu parashikimin e parimit të njohur të barazisë së palëve në proces, duke garantuar që palët do të trajtohen me barazi dhe do t'u jepet mundësi e plotë për të prezantuar çështjen e tyre⁴¹⁸. Po kështu të rëndësishme janë garancitë ligjore për sa i përket lirisë së palëve për të rënë dakort mbi procedurën që do të ndiqet nga forumi i arbitrazhit, për vendin dhe gjuhën e procedurës, duke njohur njëkohësisht autoritetin e forumit të arbitrazhit për të vendosur mbi çështjet e mësipërme, në kushtet kur palët nuk arrijnë dot një marrëveshje⁴¹⁹.

Në të njëjtën mënyrë, Kodi i Procedurës Civile parashikon se palët mund të përcaktojnë vetë procedurën e punës të gjykatës së arbitrazhit. Nëse një rregullim i tillë nuk është bërë nga palët, gjykata e arbitrazhit i cakton vetë këto rregulla, qoftë edhe duke iu referuar një rregulloreje të një organizmi arbitrazhi⁴²⁰. Gjithashtu palët mund të caktojnë në marrëveshjen e arbitrazhit vendin se ku do të zhvillohet procedura e arbitrazhit dhe në mungesë të marrëveshjes, vendin e cakton gjykata e arbitrazhit⁴²¹. Përsa i përket procedurës së arbitrazhit, në të gjitha rastet gjykata e arbitrazhit është e detyruar të respektojë parimet drejtuese të procesit, të garantojë barazinë ndërmjet palëve dhe të drejtën e tyre për t'u

⁴¹⁶ K.Pr.C, neni 418.

⁴¹⁷ Jani Vasili, "Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë", Tiranë 2005 (Gervis), f.208.

⁴¹⁸ Ligji model UNCITRAL, neni 18.

⁴¹⁹ *Id.*, neni 19, 20, 22.

⁴²⁰ K.Pr.C, neni 416(1)(2).

⁴²¹ *Id.*, neni 419.

dëgjuar në një procedurë kontradiktore⁴²². Gjithashtu, në një procedurë arbitrazhi vlejné rregullat e përgjithshme të gjykimit, që rregullojnë parimin e disponibilitetit⁴²³, barrën e provës⁴²⁴, vlerësimin e lirë të provave, etj.⁴²⁵

Edhe në praktikë, konstatohet garantimi i vlerës që merr vullneti i palëve në këto aspekte proceduriale. Kështu, në çështjen e sipërpërmendur "Shoqëria "CLASSIC" shpk kundër "Televizioni Arbëria" sha, Gjykata e Arbitrazhit pranë Qendrës "MEDART" shprehet në vendimin e saj: "*Në datën 29.05.2007, Gjykata e Arbitrazhit u mblodh në seancë proceduriale, në të cilën: (a) Palët ranë dakort për përbërjen e trupit të gjykatës së arbitrazhit; (b) U verifikuan tagrat e përfaqësimit të palëve; (c) U procedua me përcaktimin e vendit dhe gjuhës së arbitrazhit. Palët ranë dakort që arbitrazhi të zhvillohej në Qendrën "MEDART" dhe gjuha e procesit të arbitrazhit të ishte gjuha shqipe*".

Referuar legjislacionit ndërkombëtar, procedimi arbitral mund të vazhdojë në kushtet e mungesës së një pale, me kusht që asaj t'i jetë dhënë njoftimi i duhur. Një parashikimi i tillë paraqitet me rëndësi të madhe praktike, pasi sikurse tregon eksperiencia, nuk është e pazakontë që një nga palët të mos bashkëpunojë në procedimin arbitral, për arsye personale. Në këtë mënyrë ky parashikim i garanton procedimit arbitral efektivitetin e nevojshëm, brenda limiteve të kërkesave fundamentale të drejtësisë proceduriale⁴²⁶. Legjislacioni i brendshëm shqiptar rregullon gjykimin në mungesë, duke parashikuar se kur paditësi ose i padituri nuk janë paraqitur në ditën e orën e caktuar të seancës gjyqësore pa ndonjë shkak të përligjur, gjykata e arbitrazhit zhvillon gjykimin në mungesë, por gjithmonë duke mos e trajtuar një mungesë të tillë si pranim apo pohim të pretendimeve të palës tjetër⁴²⁷. Kjo dispozite nuk bën dallim ndërmjet rastit kur mungon një palë dhe rastit kur mungojnë të dyja palët. Për pasojë, nisur nga natyra e procesit arbitral, që duhet të jetë i shpejtë dhe efektiv, nuk ka ndonjë arsye ligjore të ndalohej që gjykimi arbitral të vazhdojë në mungesë të të dy palëve, me kusht që marrëveshja e arbitrazhit të mos e ketë ndaluar një procedim të tillë (procedim në mungesë të dy paleve). Natyrisht ky fakt mund të dëmtonte debatin dhe kur materialet e paraqitura nga palët nuk sqarojnë plotësisht pretendimet apo prapësimet e

⁴²² *Id.*, neni 416(3).

⁴²³ *Id.*, neni 6: "*Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet*".

⁴²⁴ *Id.*, neni 12: "*Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj*".

⁴²⁵ Alban Brati, "Procedura Civile" (bot.I), Tiranë 2008 (Dudaj), f.424.

⁴²⁶ Shënim shpjegues i Sekretariatit UNCITRAL mbi Ligjin Model (No.E.08.V.4), pjesa II, par.37.

⁴²⁷ K.Pr.C., neni 422 "Gjykimi në mungesë".

palëve, gjykata e arbitrazhit ka të drejtë të kërkojë paraqitjen e palës apo palëve në proces⁴²⁸.

V.3.7. Ligji i aplikueshëm për themelin e mosmarrëveshjes.

Në mënyrë standarde, të gjitha llojet e kontratave përmbajnë dispozita që tregojnë se cili është legjislacioni që rregullon kontratën. Kjo dispozitë konsiderohet shprehje e vullnetit të palëve dhe përdoret si ligj material nga gjykata e arbitrazhit për të gjykuar konfliktin midis palëve, nëse palët nuk kanë caktuar në mënyrë specifike një sistem tjetër ligjor. Ligji Model UNCITRAL rregullon përcaktimin e ligjit material që do të menaxhojë zgjidhjen e konfliktit, duke i lënë në rradhë të parë terren vullnetit të lirë të palëve, për të caktuar ligjin e aplikueshëm⁴²⁹. Referimi nga palët tek një legjislacion nacional i caktuar do të kuptohet si aplikim i drejtpërdrejtë i ligjit të brendshëm të atij shteti, si ligj material dhe jo si referim tek rregullat e konfliktit të ligjeve (të njohura ndryshe si e drejta ndërkombëtare private) në fuqi, në sistemin ligjor të permendur. Vetëm nëse palët nuk kanë arritur një marrëveshje, atëherë gjykata e arbitrazhit do të zbatojë ligjin nacional, të përcaktuar nga rregullat e konfliktit të ligjeve, që vetë gjykata i konsideron relevante dhe të aplikueshme për rastin konkret⁴³⁰.

Arbitrat mund të gjykojnë edhe sipas parimit “*ex aequo et bono*” (në drejtësi dhe mirësi), por kërkohet autorizimi i shprehur i palëve. Kjo nënkupton pushtetin e arbitrave për të mos konsideruar ligjin, por për të konsideruar atë çka sipas tyre është e ndershme dhe siguron drejtësi dhe barazi për palët në çështjen në fjalë⁴³¹. Një gjykim i tillë i themelit të konfliktit prej arbitrave nuk njihet nga legjislacioni shqiptar.

Nëse i referohemi legjislacionit Shqiptar, K.Pr.C nuk e trajton në mënyrë të veçantë çështjen e ligjit material, pra ligjit që do të zbatojë gjykata për zgjidhjen e themelit të mosmarrëveshjes. Për rrjedhojë për përcaktimin e tij, kur palët nuk janë shprehur për një gjë të tillë, do të shërbejnë parimet e kuadrit ligjor në fuqi: Kodit Civil të RSH, K.Pr.C dhe ligjit nr.3920, datë 21.11.1964 “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj”. Bazuar mbi këto parime, rezultojnë dy zgjidhje të ndryshme në këto dy raste: *Së pari*, nëse palët nuk kanë zgjedhur ligjin material të zbatueshem, për konfliktet mbi kontratat që i nënshtrohen të drejtës shqiptare (kontrata të rregulluara nga ligji shqiptar), ku palët janë Shqiptare ose me banim në Shqipëri, atëherë do të zbatohet si ligj material legjislacioni Shqiptar; *Së dyti*, në rast se kontrata apo elemente të kontratës nuk rregullohen nga e drejta

⁴²⁸ Jani Vasili, “Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2005 (Gervis), f.207-208.

⁴²⁹ Ligji Model UNCITRAL, neni 28.

⁴³⁰ Shënim shpjegues i Sekretariatit UNCITRAL mbi Ligjin Model (No.E.08.V.4), pjesa II, par.39

⁴³¹ *Id.*, par.40

shqiptare, ose nëse palët në kontratë nuk janë të gjitha subjekte të së drejtës Shqiptare, atëherë do të zbatohen parimet e konfliktit të ligjeve, për të gjetur apo identifikuar se cili ligj do të rregullojë në thelb mosmarrëveshjen. Këto parime (të konfliktit të ligjeve) në të drejtën Shqiptare përcaktohen nga ligji “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj”⁴³².

E rëndësishme të theksohet, përsa i përket rregullimit të themelit të konfliktit, është dhe fakti që ligji i brendshëm Shqiptar nuk lejon që arbitrat, në gjykimin e tyre, të dalin jashtë kornizave të ligjit, të identifikuar prej palëve apo arbitrave (në mungesë të kompromisit midis palëve), si ligji kompetent për rregullimin e themelit. E thënë ndryshe, nuk pranohet që arbitrat të gjykojnë sipas parimit “*ex aequo et bono*” (në drejtësi dhe mirësi) dhe si “*amicable compositeur*” (rregullues shoqëror)⁴³³, ndërkohë që Ligji Model e parashikon një mundësi të tillë, përkundrajt një autorizimi paraprak të shprehur të palëve⁴³⁴. Megjithatë, vetë Ligji model⁴³⁵ parashikon se në të gjitha rastet kur konflikti lidhet me një kontratë, gjykata e arbitrazhit do të vendosë në përputhje me kushtet e kontratës dhe do të marrë parasysh rregullat e tregtisë, të zbatueshme për këtë transaksion⁴³⁶.

Arbitrazhi *amicable compositeur* shumë shpesh përkufizohet si sinonim i arbitrazhit të barabartë ose arbitrazhit *ex aequo et bono*. Në fakt është e vështirë të specifikosh dallimet midis këtyre dy formave të arbitrazhit, por përgjithësisht doktrina i dallon ata kështu: Një arbitër që vepron si *amicable compositeur* vendos mbi mosmarrëveshjen sipas ligjit dhe parimeve ligjore, por gjithsesi është i autorizuar të modifikojë efektin e disa parashikimeve ligjore jo-imperative (non-mandatory rules). Ndërkohë që zgjidhja *ex aequo et bono* e një konflikti është një zgjidhje e gjetur jo brenda ligjit, por sipas parimeve morale. Një arbitër që gjykon sipas parimit *ex aequo et bono* kuptohet se lejohet të mos konsiderojë jo vetëm rregullat jo-imperative, por gjithashtu edhe parashikimet imperative të ligjit, për sa kohë që respektohet politika publike ndërkombëtare⁴³⁷.

⁴³² Ligji Nr.3920, date 21.11.1964.

⁴³³ Jana Herboczková, “Parimi *amicable composition* Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar”, 2007, f.1: Koncepti i *amicable compositeur* e ka origjinën e tij historike në ligjin Francez, përkatësisht në *amicabilis compositor* (shqyrtuesin miqësor) të së drejtës kanunore, i cili ka vepruar më tepër si pajtues sesa si një vendim-marrës në një mosmarrëveshje. Koncepti u miratua për herë të parë në Kodin e Napoleonit dhe Kodin Francez të Procedurës Civile të 1806.

⁴³⁴ Ligji model UNCITRAL, neni 28(3): “Tribunali i arbitrazhit do të vendosë *ex aequo et bono* apo si *amicable compositeur* vetëm nëse palët shprehimisht e kanë autorizuar atë të veprojë kështu”.

⁴³⁵ *Id.*, neni 28(4).

⁴³⁶ Shënim shpjegues i Sekretariatit UNCITRAL mbi Ligjin Model (No.E.08.V.4), pjesa II, par.40.

⁴³⁷ Bühring-Uhle, Ch.: “Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi në Biznesin Ndërkombëtar”, Hollandë: Kluwer Law International, 2006, f.40.

Përgjithësisht pranohet se gjykimi si *amiable compositeur* dhe sipas parimit *ex aequo et bono* janë variante të arbitrazhit tregtar, në të cilët palët bien dakort, në mënyrë të shprehur, që arbitrat të mos jenë të lidhur nga rregulla strikte ligjore dhe të jenë të lirë të konsiderojnë barazinë dhe lojën e ndershme midis palëve (*fair play*), në një vendim të dhënë bazuar mbi mirëbesimin. Megjithatë, liria e arbitrave për të mos marrë në konsideratë ligjin dhe për të dhënë një vendim krejtësisht të “barabartë” ose “komercialisht të qëndrueshme”, nga disa autorë është konsideruar si dallim prej “arbitrazhit të vërtetë”, duke i nxjerrë këto mënyra gjykimi të arbitrave jashtë përkufizimit të arbitrazhit. Argumenti ngrihet mbi faktin se esenca e karakterit gjykues të arbitrazhit është aplikimi i ligjit, ndërkohë që qëllimi dhe natyra e arbitrimin si *amiable compositeur* janë të papajtueshëm me karakterin e arbitrazhit. Argumenti ka shkuar edhe më tej, kur sugjerohet se koncepti i *amiable compositeur* dhe *ex aequo et bono* mund të jenë të paparashikueshëm dhe subjektivë⁴³⁸. Megjithatë jam i mendimit se legjislacionin ynë duhet ta konsiderojë përfshirjen, në rregullimet ligjore, të këtyre formave specifike të gjykimit të arbitrazhit, si shprehje e lirisë kontraktore të palëve për të rregulluar mënyrën e zgjidhjes në themel të konfliktit prej forumit të arbitrazhit, që ka fituar juridiksionin për këtë konflikt.

V.3.8. Marrja e vendimit përfundimtar.

Përsa i përket aspekteve procedurale të vendimarrjes së arbitrave, parashikimet e legjislacionit të brendshëm përputhen me regjimin rregullator ndërkombëtar. Kodi Shqiptar i Procedurës Civile⁴³⁹, sikurse edhe Ligji Model UNCITRAL⁴⁴⁰, parashikojnë rregullim të veçantë për miratimin dhe hartimin e vendimit të arbitrazhit. Kështu, diskutimet për dhënien e vendimit zhvillohen nga gjykata e arbitrazhit pa praninë e palëve e të personave të tjerë. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit jepet me shumicë votash. Ai nënshkruhet nga të gjithë arbitrat. Arbitrat që kanë mendim të kundërt me shumicën, kanë të drejtë t'i parashtrojnë me shkrim mendimet e tyre. Vendimi i nënshkruar nga shumica e arbitrave ka të njëjtin efekt sikur të jetë nënshkruar nga të gjithë arbitrat e gjykatës së arbitrazhit. Ligji model nuk e kërkon por as nuk e ndalon mendimin e pakicës (*dissenting opinions*), por ndërkohë kërkon që të përcaktohet arsyeja për çdo firmë arbitri të munguar në vendim⁴⁴¹.

⁴³⁸ Gary B. Born, “Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar”, Kluwer Law International, (2009), f.420.

⁴³⁹ K.Pr.C, neni 429-430.

⁴⁴⁰ Ligji Model UNCITRAL, nenet 29-31.

⁴⁴¹ Shënim shpjegues i Sekretariatit UNCITRAL mbi Ligjin Model (No.E.08.V.4), pjesa II, par.41-43.

Nga pikëpamja formale, është theksuar në mënyrë eksplicite, si nga legjislacioni i brendshëm, ashtu edhe nga ai ndërkombëtar, se vendimi i arbitrazhit duhet të jetë me shkrim. Një formë e tillë është e nevojshme po të kemi parasysh faktin se ky vendim mund t'i nështrohet procedurave të ankimit, apo të njohjes dhe zbatimit të tij. Vendimi duhet të përmbajë detyrimisht të dhënat e kërkuara nga Kodi P.Civile, përndryshe ky vendim mund të bëhet objekt i goditjes për pavlefshmëri. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit duhet të përmbajë: përbërjen e trupit gjykues të arbitrave, datën dhe vendin e dhënies së vendimit⁴⁴², identitetin e palëve, vendbanimin, vendqëndrimin ose qendrën e tyre, emrin e avokatit ose të përfaqësuesit të palëve, objektin e mosmarrëveshjes, si dhe dispozitivin (pjesën vendimore). Vendimi i gjykatës së arbitrazhit duhet të arsyetojë zgjidhjet e pranuar dhe të shprehet qartë për pretendimet e palëve, nëse ato janë të bazuara në prova e në ligj.

V.3.9. Kundërshtimi i vendimit të arbitrazhit.

Pjesa më origjinale e Ligjit Model (të amenduar) është ajo që trajton ankimet e vendimeve të arbitrazhit. Sipas mjeteve të ankimit të lejuara për një vendim arbitrazhi, ndryshimet midis juridiksioneve nacionalë janë të dallueshme, si psh. përsa i përket afateve për ankimet ose arsyet që mund të sjellin prishjen e vendimeve, të cilat jo gjithmonë përputhen. Përballë këtyre paqartësive, Ligji Model parashikon vetëm një mjet ankimi kundër vendimeve të arbitrazhit, të ashtuquajturin *ankim për anulim*, duke siguruar njëkohësisht shkaqe uniforme mbi të cilat mund të bëhet ankimi. Dipozitat përkatëse parashikojnë kërkesën për të anuluar apo rrëzuar një vendim arbitrazhi, kërkesë e cila duhet të bëhet brenda tre muajve nga dita e marrjes së vendimit⁴⁴³. Kompetent për të shqyrtuar ankimin për anulim është autoriteti gjyqësor i shtetit, në territorin e të cilit vendimi i arbitrazhit është marrë. Në sistemin e Ligjit Model, nuk do të jetë më e mundur që një vendim i marrë nga një arbitrazh tregtar ndërkombëtar t'i shmanget ankimit direkt, vetëm pse konsiderohet “i huaj” nga shteti i origjinës.

Ligji Model, gjithashtu, liston në mënyrë shteruese, shkaqet ligjore mbi të cilat një vendim arbitrazhi mund të kundërshtohet⁴⁴⁴, të cilat janë krejtësisht të njëjta me ato të parashikuara nga Konventa e Nju Jork-ut, për kundërshtimin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të

⁴⁴² *Id.*, neni 31(3): “Vendimi duhet të deklarojë datën e tij dhe vendin e arbitrazhit. Vendimi do të konsiderohet se është marrë në atë vend”. Por *de facto* marrja e vendimit mund të kompletohet edhe në vende të ndryshme, nëpërmjet telefonit apo korrespondencës.

⁴⁴³ Ligji Model UNCITRAL, neni 34(1).

⁴⁴⁴ Ligji Model UNCITRAL, neni 34(2).

arbitrazhit⁴⁴⁵. Këto shkaqe ndahen në dy kategori:

-*Së pari*, shkaqet ligjore të kundërshtimit, për të cilat pala e interesuar ka barrën e provës, ku përfshihen:

(i) *pazotësi e palëve në marrëveshjen e arbitrazhit për të vepruar, ose marrëveshja e pavlefshme; ose,*

(ii) *shkelje e parimit të barazisë së palëve në proces (palës, që bën ankimin, nuk i është dhënë njoftimi i duhur për emërimin e një arbitri ose për procedurat e arbitrazhit ose nuk ishte në gjendje të paraqiste çështjen e saj, pra nuk i është dhënë mundësi të mbrohej); ose,*

(iii) *vendimi ka të bëjë me një mosmarrëveshje të paparashikuar ose jashtë kufijve të kushteve të parashtrimit të arbitrazhit, ose përmban vendime mbi çështje përtej qëllimit të parashtrimit të arbitrazhit, ...; ose*

(iv) *përbërja e gjykatës së arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ishte në përputhje me marrëveshjen e palëve,;*

-*Së dyti*, shkaqet ligjore të kundërshtimit, të cilat gjykata nacionale kompetente për shqyrtimin e ankimit, mund t'i konsiderojë me insiativën e saj, ku përfshihen:

(i) *mos-arbitrueshmëria e çështjes objekt konflikti*⁴⁴⁶ (*non-arbitrability*), ose

(ii) *dhunimi i politikës publike*⁴⁴⁷ (*public policy*)⁴⁴⁸.

Sikurse shohim, në rastet e parashikuara si shkaqe të mundshme për ankim, mungon rasti kur vendimi i arbitrazhit është nën efektin e asaj që në terminologjinë angleze shprehet me termin “padrejtësi procedurale” (*procedural injustice*), si p.sh. korrupsioni i arbitrave; vendime të formuara mbi bazë të provave, që në një moment të mëvonshëm janë deklaruar false; gjetja mbas disponimit të arbitrave të akteve dhe dokumenteve të rëndësishme për vendim-marrjen, etj. Por, pavarësisht nga kjo, gjykoj se është e mundur që klauzola e *rendit publik*, si shkak ankimi, mund të interpretohet aq gjerësisht sa të lejojë të përfshihen në të edhe rastet e sipërpërmendura të veseve në procesin e gjykimit.

Vihet re menjëherë ngjashmëria e këtyre shkaqeve të anulimit të vendimit me motivet e

⁴⁴⁵ *Shiko* nenin 5 të Konventës së Nju Jork-ut (1958).

⁴⁴⁶ Themeli i çështjes së mosmarrëveshjes nuk është e mundur të zgjidhet me arbitrazh, sipas ligjit të shtetit të gjykatës që shyrton ankimin.

⁴⁴⁷ Vendimi i arbitrazhit është në konflikt me politikën e përgjithshme të shtetit ku është dhënë vendimi (shtetit të gjykatës që shyrton ankimin).

⁴⁴⁸ Shënim shpjegues i Sekretariatit UNCITRAL mbi Ligjin Model (No.E.08.V.4.), Pjesa II, par.46.

refuzimit të njohjes dhe zbatimit të tij, që parashikohen nga Konventa e Nju Jork-ut. Panvarësisht nga kjo, një ndryshim praktik ekziston midis këtyre dy grup-shkaqeve, pikërisht përse i përket autoritetit kompetent para të cilit ato duhen provuar. Sikurse thamë, kërkesa për anulimin e vendimit mund t'i drejtohet vetëm një gjykate të shtetit ku është marrë vendimi, ndërsa një kërkesë për refuzimin e njohjes duhet të paraqitet para gjykatës kompetente të shtetit ku kjo njohje është kërkuar⁴⁴⁹. Rrjedhojë e drejtpërdrejtë e këtij ndryshimi është edhe ndryshimi i shtetësisë së klauzolës së “rendit publik” dhe “mos-arbitrueshmërisë”, interpretimi i të cilave është i ndryshëm në shtete të ndryshme (shteti ku kërkohet anulimi ndryshon nga shteti ku kërkohet refuzimi i njohjes)⁴⁵⁰.

Në mënyrë të ngjashme legjislacioni i brendshëm Shqiptar njih dhe rregullon procedurat e ankimit kundër vendimit të gjykatës së arbitrazhit. Sipas dispozitave të K.Pr.C⁴⁵¹, vendimi i gjykatës së arbitrazhit mund të ankimohet në Gjykatën e Apelit, brenda një afati të kufizuar⁴⁵², vetëm kur plotësohet një apo disa kushte, të natyrës procedurale dhe jo të themelit të çështjes, shumë të ngjashme në thelb me ato të parashikuara nga regjimi ndërkombëtar, si më poshtë:

(i) gjykata e arbitrazhit është formuar në mënyrë të parregullt;

(ii) gjykata e arbitrazhit pa të drejtë ka deklaruar kompetencën apo moskompetencën e saj për gjykimin e mosmarrëveshjes;

(iii) gjykata e arbitrazhit në vendimin e saj ka tejkalluar kërkesat, për të cilat ka qenë investuar ose nuk është shprehur mbi një nga kërkesat kryesore të padisë;

(iv) nuk është respektuar barazia e palëve dhe e drejta e tyre për t'u dëgjuar në një procedurë, mbështetur në parimin e Kontradiktoritetit⁴⁵³.

(v) vendimi i gjykatës së arbitrazhit vjen në kundërshtim me rendin publik në Republikën e Shqipërisë.

Gjykata e Apelit duhet të verifikojë vetëm nëse qëndron ndonjë nga rastet e parashikuara me sipër, kur pranohet ankimi. Nëse nuk vërtetohet ndonjë shkelje e tillë, Gjykata e Apelit nuk e

⁴⁴⁹ Konventa e Nju Jork-ut, neni V(1): *Njohja dhe zbatimi i vendimit të arbitrazhit mund të refuzohet, me kërkesën e palës kundër të cilës ai është dhënë, vetëm nëse kjo palë paraqet prova para autoritetit kompetent ku njohja dhe zbatimi është kërkuar.*

⁴⁵⁰ Shënim shpjegues i Sekretariatit UNCITRAL mbi Ligjin Model (No.E.08.V.4), pjesa II, par.48.

⁴⁵¹ K.Pr.C, neni 434.

⁴⁵² Ankimi në gjykatën e apelit bëhet brenda 30 ditëve nga dita që është shpallur vendimi i gjykatës së arbitrazhit.

⁴⁵³ K.Pr.C, neni 18 “Kontradiktoriteti”: *Asnjë palë nuk mund të gjykohet pa u dëgjuar ose pa u thirrur në gjykim.*

shqyrton në themel vendimin e arbitrazhit (nuk e shtrin kontrollin në tërësinë e fakteve të çështjes) por e lë në fuqi këtë vendim. Në këtë mënyrë, kuadri ligjor i brendshëm sanksionon kufizimin e shkaqeve të cënueshmërisë së një vendimi arbitrazhi, duke garantuar mosndërhyrjen gjyqësore në themelin e vendimit të arbitrazhit dhe për rrjedhojë ndikon në rritjen e efektivitetit të mekanizmit të arbitrazhit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Edhe jurisprudenca vërteton të njëjtën gjë, përse i përket mungesës së autoritetit të gjykatës nacionale për të vlerësuar gjykimin në themel, që kanë bërë arbitrat. Kështu Gjykata e Apelit, për çështjen e sipërpërmendur "Shoqëria "CLASSIC" shpk kundër "Televizioni Arbëria" sha, në vendimin e saj nr.111, datë 02.10.2008⁴⁵⁴, mban këtë qëndrim: *"Mosmarrëveshja e krijuar midis palëve është zgjidhur nga gjykata e arbitrazhit, në bazë të kompetencave të njohura kësaj gjykate në nenin 400 e vijues të K.Pr.C. Kërkimi i palës paditëse (përmbushje e detyrimit kontraktor dhe kamatat e arrira) është shqyrtuar nga gjykata e arbitrazhit, duke i 'u përmbajtur objektit të padisë, duke arsyetuar mbi natyrën e detyrimit, prejardhjen e tij dhe mbi bazën e provave ka rrëzuar padinë. Bazuar në nenin 432 të K.Pr.C, vendimi i gjykatës së arbitrazhit është i formës së prerë në lidhje me mosmarrëveshjen e shqyrtuar. Këto vendime nuk mund të ankimohen në Gjykatën e Apelit, vetëm nëse janë kushtet e përcaktuara në nenin 434 të K.Pr.C. Si përfundim, Gjykata e Apelit konkludon se, bazuar në nenin 430 të K.Pr.C, Gjykata e Arbitrazhit është shprehur qartë për natyrën e mosmarrëveshjes dhe nuk ekzistojnë asnjë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 434 të K.Pr.C, që ky vendim të jetë i cënueshëm e, për rrjedhojë, në bazë të nenit 432 të K.Pr.C, vendimi objekt kundërshtimi është i formës së prerë. Në rrethanat e mësipërme, kërkesa ankimore e Shoqërisë "CLASSIC" shpk nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka shkaqe ligjore për cënimin e vendimit të gjykatës së arbitrazhit".*

Po kështu, në çështjen tjetër "Artel" shpk kundër "Albanova" shpk⁴⁵⁵, Gjykata e Apelit shprehet: *"Ankuesi pretendon se Gjykata e Arbitrazhit nuk ka arsyetuar vendimin për*

⁴⁵⁴ Më datë 18.10.2007, brenda afatit 30 ditë, nga marrja e vendimit të arbitrazhit, Shoqëria "CLASSIC" shpk ka paraqitur një ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, nëpërmjet të cilit i kërkohet kësaj gjykate: të prishë vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit pranë Qendrës Shqiptare të Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit Tregtar nr.3/2007 dhe, duke i 'u përmbajtur "kufijve" të Gjykatës së Arbitrazhit, të vendosë për themelin e mosmarrëveshjes duke pranuar padinë e paditësit. Kështu në bazë të nenit 436, Gjykatës së Apelit i paraqitet një kërkesë me dy objekte: (a) të prishë vendimin e arbitrazhit dhe (b) të gjykojë edhe një herë çështjen në themel, duke e vënë vehten në rolin e një gjykate arbitrazhi. Gjykata e Apelit, me vendimin nr.111, datë 02.10.2008, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr.3/2007 datë 24.09.2007 të Gjykatës së Arbitrazhit pranë Qendrës Shqiptare të Ndërmjetësimit dhe Arbitrazhit Tregtar.

⁴⁵⁵ Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.123 akti dhe nr.186 vendimi datë 10.10.2013: Për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore të rrjedhura nga kontrata e qirasë datë 11.10.2008, palët i janë drejtuar Gjykatës së Arbitrazhit, e cila ka disponuar për pranimin pjesërisht të kërkesës së paditësit "Artel" shpk. Më pas, kjo shoqëri i ka kërkuar Gjykatës së Apelit Tiranë që të vendosë ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit të "Qendrës për Ndërmjetësim dhe Arbitrazh Tregtar-MEDART", të datës 30.04.2013. Paditësi pretendon se ndodhemi përballë rastit të parashikuar në nenin 434/c të K.Pr.Civile i cili përcakton se *vendimi i gjykatës së*

mospranimin e kërkesës për shtimin e objektit, përsa i përket kushtit penal 9-mujor. Nga kërkesa ankimore del qartë se synimi i ankuesit është që të investoië Gjykatën e Apelit që të shqyrtojë në themel ligjshmërinë e vendimit të arbitrazhit. Çmujmë se synimi i palës paditëse është haptazi i pabazuar, sepse shqyrtimi në themel i kësaj mosmarrëveshje ndalohet shprehimisht nga ligji dhe marrëveshja midis palëve. Prandaj, kërkesa ankimore e palës paditëse Shoqëria "Artel" shpk kundër vendimit dt.30.04.2013 të Gjykatës së Arbitrazhit duhet të rrëzohet pasi nuk plotëson asnjë nga kriteret e përcaktuara në nenin 434 të K.Pr.Civile".

Duke marrë në konsideratë konstatimet e dy çështjeve të mësipërme, mund të konkludohet se në praktikën gjyqësore Shqiptare (pavarësisht "përmasave" të saj) haset një frymë "konformizmi" apo mos-cënueshmërie ndaj vendimeve të gjykatave të arbitrazhit të brendshëm. Një frymë e tillë gjykoj se është produkt më së shumti i kuadrit ligjor Shqiptar, nëpërmjet parashikimit prej tij të kufizueshmërisë së shkaqeve për të cilat mund të godidet apo cënohet një vendim arbitrazhi (neni 434 i K.Pr.C). Këto shkaqe janë sanksionuar vetëm të natyrës procedurale dhe jo të themelit të çështjes, apo konfliktit në gjykim⁴⁵⁶.

Deri këtu parashikimet e legjislacionit të brendshëm janë në të njëjtën linjë me parashikimet e regjimit ndërkombëtar. Por Kodi i Procedurës Civile tejkalon parashikimet e Ligjit Model kur përcakton se nëse konstatohet dhe vërtetohet ndonjë nga shkaqet e sipërpërmendura, Gjykata e Apelit e prish ose e ndryshon vendimin e gjykatës së arbitrazhit dhe vendos për themelin e mosmarrëveshjes, brenda kufijve të misionit të caktuar gjykatës së arbitrazhit⁴⁵⁷. Një parashikim i tillë i KPC, sipas opinionit tim, cënon vullnetin legjitim të shprehur të palëve për të qëndruar larg dyerve të gjykatave shtetërore dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjen e tyre në rrugë private, nëpërmjet arbitrazhit. Situara "rëndohet" edhe më tej me parashikimin klauzolës së pamundësisë së rekursit (në Gjykatën e Lartë) kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, që shqyrton çështjen në themel⁴⁵⁸. Si përfundim i këtij argumenti, nëse dy palë do të

arbitrazhit mund të ankohet në gjykatën e apelit vetëm kur gjykata e arbitrazhit në vendimin e saj ka tejkalluar kërkesat për të cilat ka qenë investuar ose nuk është shprehur mbi një nga kërkesat kryesore të padisë. Pretendimet e ankuesit kanë të bëjnë me faktin se Gjykata nuk është shprehur për kushtet penale kontraktore, për rrjedhim ka cënuar parimin e disponibilitetit, të përcaktuar nga neni 6 i K.Pr.Civile.

⁴⁵⁶ Shiko çështjen civile me nr.63 regj.themeltar. datë 28.02.2008; Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.111 i vendimit, datë 02.10.2008: Paditësi, në rastin në fjalë (Shoqëria "CLASSIC" shpk), ka tentuar të argumentojë dhe të provojë para Gjykatës së Apelit një nga shkaqet (neni 434 i K.Pr.C) që mundëson rrëzimin e një vendimi arbitrazhi dhe pikërisht shkakun se: *gjykata e arbitrazhit në vendimin e saj ka tejkalluar kërkesat për të cilat ka qenë investuar ose nuk është shprehur mbi një nga kërkesat kryesore të padisë. Por, sikurse rezulton nga vlerësimi i Gjykatës së Apelit, paditësi nuk ka arritur të bindë këtë gjykatë (Gjykatën e Apelit) se një shkak i tillë ligjor është vërtetuar në vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit.*

⁴⁵⁷ K.Pr.C, neni 436.

⁴⁵⁸ *Id.*, neni 437.

zgjedhin legjislacionin shqiptar, si ligj për të administruar procesin privat të arbitrazhit për zgjidhjen e një mosmarrëveshje, duhet të mbajnë parasysh mundësinë që, pavarësisht vullnetit të tyre, kjo mosmarrëveshje mund “të bjerë” në duart e gjykatësve shtetërore për t’u zgjidhur përfundimisht dhe kundër tyre nuk ka asnjë mundësi ankimi.

Një tjetër moment i paqartë që gjen shprehje në dispozitat e ligjit kombëtar ka të bëjë me autoritetin kompetent ku mund të drejtohet ankimi kundër një vendimi arbitrazhi ndërkombëtar. Legjislacioni Shqiptar rregullon procedurën e apelit për vendimet e arbitrazhit të brendshëm, por jo për ato të arbitrazhit ndërkombëtar. Ligji Model i UNCITRAL sugjeron që ligji procedural i çdo vendi duhet të përcaktojë gjykatën ku mund të paraqitet ankimi kundër një vendimi arbitrazhi ndërkombëtar⁴⁵⁹. Por aktualisht, çështja e organit kompetent ku paraqitet ankimi kundër kësaj kategorie vendimesh arbitrazhi, nuk rregullohet në Shqipëri për shkak se mungon një ligj i posaçëm për arbitrazhin ndërkombëtar⁴⁶⁰. Nga ana tjetër, aderimi në Konventën Europiane të Arbitrazhit⁴⁶¹ e bën këtë instrument pjesë të së drejtës së brendshme të Republikës së Shqipërisë, duke lejuar kështu mundësinë teorike të apelit, në Shqipëri, kundër vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar. Konkretisht, Konventa Europiane e Arbitrazhit parashikon se me kërkesë të palës së interesuar, një vendim arbitrazhi mund të anulohet për një nga këto shkaqe: *a) palët në marrëveshjen e arbitrazhit ishin sipas ligjit të zbatueshëm të tyre, në pazotësi për të vepruar, ose marrëveshja në fjalë nuk është e vlefshme ... ose, b) pala që kërkon anulimin e vendimit nuk është informuar rregullisht me caktimin e arbitrit ose me procedurën e arbitrazhit, ose ajo nuk ka pasur zotësi të paraqesë rastin e saj ose, c) vendimi ka lidhje me një mosmarrëveshje të paparashikuar në marrëveshjen për arbitrazh ose përmban vendime për çështje, që tejkalojnë ato që i nënshtrohen arbitrazhit ose d) formimi i gjykatës së arbitrazhit ose i procedurës së arbitrazhit nuk ka qenë në përputhje me marrëveshjen e palëve për arbitrazh dhe kur mungon marrëveshja, me dispozitat e Konventës⁴⁶².*

Sa më sipër mund të themi se mungesa e ligjit të posaçëm për arbitrazhin ndërkombëtar krijon një situatë paradoksale. Kjo sepse, në kuadrin normativ të brendshëm Shqiptar ekziston e plotë baza ligjore apo arsytet, për të cilat një vendim arbitrazhi ndërkombëtar mund kundërshtohet. Por, ndërkohë që ekziston baza ligjore për apelimin nuk ekzistojnë mjetet procedurale për t’i vënë ato në zbatim, pasi nuk është përcaktuar formalisht autoriteti

⁴⁵⁹ Ligjin Model UNCITRAL, neni 6.

⁴⁶⁰ K.Pr.C, neni 439: “Arbitrazhi ndërkombëtar rregullohet me ligj të veçantë”.

⁴⁶¹ Ligji nr.8687, datë 09.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit”

⁴⁶² Konventa Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar (Gjenevë 1961), neni 9(1).

kompetent se ku duhet drejtuar apelimi. Kjo situatë me shumë gjasa do të gjejë sistemimin e saj me miratimin e dispozitave të reja të ligjit për arbitrazhin e brendshëm, sipas parashikimit që ka bërë ndryshimi i fundit i K.Pr.C⁴⁶³. Dispozitat e K.Pr.C që aktualisht rregullojnë arbitrazhin e brendshëm do të jenë në fuqi deri në miratimin e ligjit të ri për arbitrazhin vendas, i cili sikurse edhe ligji për arbitrazhin ndërkombëtar, pritet të paraqitet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim brenda vitit 2013⁴⁶⁴.

V.4. Statusi i vendimit të arbitrazhit – roli i tij në shtrirjen e efekteve të Konventës së Nju Jork-ut për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj. Aspekte thelbësore të rregulluara nga ligji i brendshëm.

V.4.1. Fusha e aplikimit të arbitrazhit si mekanizëm për zgjidhjen e konflikteve.

Le ta nisim analizën me shtrirjen e fushës së veprimit të normave ligjore të arbitrazhit, sipas legjislacionit lokal në Shqipëri, krahasuar me atë ndërkombëtar. Nëse do t'i referohemi dispozitave të Ligjit model UNCITRAL, nisur nga nga vetë emërtimi i tij⁴⁶⁵, kuptohet se ato aplikohen mbi arbitrazhin *tregtar ndërkombëtar*.

Përsa i përket gjerësisë së interpretimit të termit *tregtar*, vetë Ligji Model bën përpjekje për shpjegimin e tij. Interpretimi i bërë nga Ligji Model (shënimi sqarues i nenit 1/1⁴⁶⁶) në fakt ofron një listë të gjërë të marrëdhënieve që përshkruhen si marrëdhënie me natyrë "tregtare", kontraktore ose jo. Këtu përfshihet, ndër të tjera, *çdo transaksion tregtar per furnizimin dhe shkëmbimin e të mirave apo shërbimeve, marrëveshjet e shpërndarjes, përfaqësimit tregtar apo agjencisë, faktoringu, lizingu, punimet e ndërtimit, shërbimet e konsulencës, shërbimet inxhinierike, shërbimet e liçensimit, financimit, bankngut, sigurimet, marrëveshjet e konçesionit, joint-venture apo forma të tjera të bashkëpunimit të biznesit, transporti i mallrave ose pasagjerëve (ajror, detar, hekurudhor ose tokësor).*

⁴⁶³ Ligji Nr.122/2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; dt.Miratimit:18.04.2013, flet.zyrtare rr.67, faqe:2989.

⁴⁶⁴ Ligji Nr.122/2013; Neni 50: Ky ligj hyn në fuqi më 1 shtator 2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare; Neni 30: Titulli IV (*Arbitrazhi*) i pjesës së dytë (*Gjykimi në shkallë të parë*) shfuqizohet; Neni 49 "Dispozitë kalimtare": Neni 30 i këtij ligji hyn në fuqi pas miratimit të ligjit për arbitrazhin. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të paraqesë në Kuvend, për shqyrtim dhe miratim, projektligjin që rregullon arbitrazhin vendas dhe ndërkombëtar.

⁴⁶⁵ Ligji Model UNCITRAL "Mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar", i miratuar nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare, më 21 qershor 1985, amenduar në 7 korrik 2006.

⁴⁶⁶ Shënim sqarues i nenit 1/1 të Ligjit Model, dokument i Kombeve të Bashkuara nr.A/40/17, aneks I dhe nr.A/61/17, aneks I.

Situata nuk paraqitet e njëjtë në legjislacionin shqiptar, i cili shfaq tendencën e kufizimit të fushës së veprimit të institutit të arbitrazhit, duke parashikuar mundësinë e aplikimit të këtij mekanizmi alternativ të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve vetëm në mosmarrëveshjet pasurore, që burojnë nga një kontratë e lidhur midis palëve. E ashtuquajtura *arbitrueshmëri* e mosmarrëveshjeve në ligjin shqiptar rregullohet nga dy dispozita të K.Pr.C. Fillimisht dispozita e nenit 402⁴⁶⁷ na paraqet një fushë të gjerë të veprimit të arbitrazhit, duke parashikuar se *çdo pretendim pasuror ose kërkesë që rrjedh nga një marrëdhënie pasurore, mund të jetë objekt i një gjykimi të arbitrazhit*. Ligji nuk sqaron gjerësinë e interpretimit të termit *marrëdhënie pasurore*, por referuar përcaktimeve që bën doktrina e të drejtës civile, mund të themi se në termin *mosmarrëveshjeve me natyrë pasurore* përfshihen konflikte në “fushën civile” dhe “konflikte tregtare”. Konfliktet civile, janë konfliktet me natyrë pronësore (lidhen me pronën apo me të drejta të tjera reale si psh. posedimi), konfliktet që burojnë nga kontratat apo jashtë tyre si psh. nga shkaktimi i dëmit, etj. Ndërsa konfliktet me natyrë tregtare mund të kenë burimin tek mospërbushja e kontratave tregtare ose mund të jenë të natyrës së mbarëvajtjes dhe funksionimit të shoqërive tregtare. Ky interpretim i nenit 402 krijon idenë e një sfare të gjerë veprimi të arbitrazhit, e cila mund të themi se i përgjigjet madje edhe e tejkalon interpretimin e bërë nga Ligji Model, me ndryshimin se ky i fundit i liston shumë qartë marrëdhëniet konkrete, prej të cilave burojnë konfliktet që mund të konsiderohen si të arbitrueshme. Por spektri në dukje i “gjerë” i veprimit të arbitrazhit “ngushtohet” menjëhëre me parashikimin e nenit 403, i cili kufizon veprimin vetëm në konfliktet që burojnë nga një kontratë⁴⁶⁸, duke lënë jashtë objektit të veprimit të arbitrazhit mosmarrëveshjet jashtëkontraktore, si. psh ato të shkaktimeve të dëmit jashtëkontraktor.

Në këtë mënyrë, krahasuar me rregullimin ndërkombëtar, legjislacion shqiptar paraqet një problem përse i përket mos-arbitrueshmërisë të konflikteve jashtëkontraktore. Ndërkohë që legjislacioni ndërkombëtar nuk bën dallim përse i përket arbitrueshmërisë së mosmarrëveshjeve kontraktore ose jashtëkontraktore. Sikurse e përmendëm më sipër, Ligji Model sanksionon se termit “tregtar” do t’i jepet një interpretim i gjerë që mbulon të gjitha çështjet që ngrihen nga marrëdhëniet me natyrë tregtare, panvarësisht nëse janë kontraktore ose jo. Po kështu, legjislacione të tjera nacionale përfshijnë në sferën e konflikteve të *arbitrueshme* edhe ato jashtëkontraktore. Psh., ligji Italian, në rregullimin që i bën

⁴⁶⁷ K.Pr.C, neni 402 “Kompetenca lëndore”: *Çdo pretendim pasuror ose kërkesë që rrjedh nga një marrëdhënie pasurore, mund të jetë objekt i një gjykimi të arbitrazhit.*

⁴⁶⁸ K.Pr.C, neni 403 “Marrëveshja e arbitrazhit”: *Mund të gjykohej me procedurë arbitrazhi vetëm në qoftë se ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë t’ia nënshtrorjnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre.*

arbitrazhit, thekson se mosmarrëveshjet që mund të zgjidhen nëpërmjet tij mund të jenë me natyrë kontraktuale ose jo⁴⁶⁹.

V.4.2. Përcaktimi i statusit të vendimit të arbitrazhit: “i brendshëm” apo “i huaj”.

Në zbatim të detyrimeve që imponon Konventa e Nju Jork-ut⁴⁷⁰, legjislacionit tonë të brendshëm i del për detyrë, të përcaktojë statusin e një vendimi arbitrazhi, pra nëse kemi të bëjmë me një vendim arbitrazhi të brendshëm apo të huaj. Konventa e Nju Jork-ut u njeh statusin “vendim i huaj arbitrazhi”: (a) atyre vendimeve që janë marrë në një shtet të ndryshëm nga ai ku kërkohet njohja dhe (b) atyre vendimeve që nuk gëzojnë statusin e vendimit “të brendshëm”, apo vendimit “lokal” në shtetin ku kërkohet njohja⁴⁷¹. Në rastin tonë, përsa i përket kriterit të parë, është e qartë se çdo vendim arbitrazhi i marrë në një shtet të ndryshëm nga Shqipëria, nëse do të kërkohet të njihet dhe zbatohet në Shqipëri, do të konsiderohet si “vendim i huaj” arbitrazhi. Problemi qëndron tek aplikimi i kriterit të dytë të Konventës, pra tek vendimet e arbitrazhit që janë marrë në territorin shqiptar dhe tek përcaktimi i kriterëve për t’i cilësuar ato si vendime “lokale” apo “të huaja”, në kuptimin e detyrimeve që imponon Konventa.

Në fakt, sot nuk gjejmë një qëndrim të unifikuar, përsa i përket dallimit midis arbitrazhit ndërkombëtar dhe arbitrazhit të brendshëm. Vende të ndryshme kanë përdorur përjasje të ndryshme në legjislacionet e tyre ndaj këtij klasifikimi. Kryesisht këto përjasje bazohen tek kriteri *objektiv* (natyra e objektit të marrëveshjes) dhe ai *subjektiv* (cilësitë subjektive të palëve në marrëveshje)⁴⁷². Në të njëjtën linjë, Konventa Europiane e Arbitrazhit⁴⁷³ dhe Ligji

⁴⁶⁹ K.Pr.Civile të Italisë, neni 808-bis. (Marrëveshja e arbitrazhit për çështje jashtë-kontraktore): *Palët mund të bien dakort, në marrëveshjen përkatëse, që të shqyrtohen dhe zgjidhen nga arbitrat mosmarrëveshje të ardhshme, të lidhura me një apo disa marrëdhënie jashtë-kontraktore të përcaktuara...*(neni i shtuar me ligjin nr.40/2006).

⁴⁷⁰ Republika e Shqipërisë është bërë palë e Konventës nëpërmjet Ligjit nr.8688 datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit".

⁴⁷¹ Konventa e Nju Jork-ut, neni 1(1)

⁴⁷² Jean-François Poudret, Sébastien Besson, “E drejta e krahasuar e arbitrazhit ndërkombëtar”, Sweet Maxwell 2007: Në Francë, vendi tipik i klasifikimit të arbitrazhit sipas kriterit objektiv, klasifikimi i një marrëdhënieje bëhet në bazë të *objektit të kontrates*. Legjislacioni dhe gjykatat kanë përcaktuar se një marrëveshje është ndërkombëtare dhe për rrjedhojë, klauzola e saj e arbitrazhit do t’u nënshtrohet rregullave të arbitrazhit ndërkombëtar në rast se transaksioni përfshin një veprim ndërkufitar, edhe nëse palët janë ose jo shtetas apo rezidentë Francezë, madje dhe nëse ata kanë përcaktuar aplikimin e të drejtës Franceze si të drejtë që rregullon kontratën. Vende të tjera Europiane, si Zvicra apo Belgjika, aplikojnë kriterë subjektive për të klasifikuar një marrëveshje arbitrazhi si ndërkombëtare apo të brendshme. Këto kriterë nuk kanë të bëjnë me objektin e kontratës, por me *cilësi të caktuara të palëve si kombësia ose residenca*. Belgjika përdor kriterin e shtetësisë ose vendqëndrimit në Belgjikë për të paktën njëri nga palët për klasifikimin e një procedurë arbitrazhi si ndërkombëtare. Në mënyrë të njëjtë, legjislacioni Italian përdor kriterin e rezidencës ose qendrës së biznesit të palëve për klasifikimin e llojit të arbitrazhit.

⁴⁷³ Konventa Europiane e Arbitrazhit, Gjenevë 1961, neni 1(1)(a).

Model UNCITRAL⁴⁷⁴ bëjnë një kombinim të kriterit objektiv dhe subjektiv për të identifikuar mosmarrëveshjet që i nënshtrohen procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar.

Neni 1(1)(a) i Konventës parashikon se ajo zbatohet për marrëveshjet e përfunduara të arbitrazhit që kanë për qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lindin nga tregtia ndërkombëtare (*kriteri objektiv*) ndërmjet personave fizikë ose juridikë, të cilët në çastin e përfundimit të marrëveshjes e kanë selinë e tyre të zakonshme ose qendrën e tyre në shtete kontraktuese të ndryshme (*kriteri subjektiv*). Ndërsa interpretimi që bën Ligji Model UNCITRAL i jep një kuptim më të zgjeruar termit “ndërkombëtar”, duke tentuar të identifikojë si arbitrazh ndërkombëtar shumë më tepër raste. Neni 1(3) i këtij ligji parashikon se arbitrazhi është ndërkombëtar nëse plotësohet të paktën një nga tre kushtet e mëposhtëme:

(a) në kohën e përfundimit të marrëveshjes, palët e arbitrazhit kanë vendet e bizneseve të tyre në shtete të ndryshme (*kriteri subjektiv-rezidenca e palëve*); ose

(b) një nga vendet e mëposhtëme ndodhet jashtë shtetit, në të cilin palët kanë vendet e biznesit të tyre: *i)-vendi i arbitrazhit, nëse ai përcaktohet në marrëveshjen e arbitrazhit; ii)-çdo vend ku duhet të përmbushet çfarëdolloj pjese kryesore e detyrimeve të marrëdhënies tregtare, ose vendi me të cilin është më shumë i lidhur thelbi i mosmarrëveshjes (kriteri objektiv-objekti i transaksionit)*; ose

(c) palët kanë rënë dakort në mënyrë të shprehur që objekti i marrëveshjes arbitrale – mosmarrëveshja tregtare – të këtë lidhje me më shumë se një shtet. Ky rast i fundit është specifik, pasi nuk bazohet në kritere që kanë lidhje me objektin e marrëdhënies apo cilësitë e palëve, por vlerëson vullnetin e lirë të tyre duke i njohur këtij vullneti autoritetin të përcaktojë, përveç të tjerave, edhe karakterin nacional (lokal) apo ndërkombëtar të procesit të arbitrazhit.

Sa më sipër, konkludojmë se, për të përcaktuar nëse një vendim arbitrazhi do të cilësohet ose jo si vendim "lokal" (i brendshëm) në një shtet, ku kërkohet njohja dhe zbatimi i tij, do të vijmë në ndihmë kriteret e përcaktuar në legjislacionin e brendshëm të atij shteti. Në këto kushte, panorama paraqitet mjaft e larmishme. Le të ndalemi, në këtë pikë, në përcaktimet që legjislacioni shqiptar bën për t'i dhënë një vendimi arbitrazhi statusin e vendimit “lokal” (“të brendshëm”) apo “të huaj” në Republikën e Shqipërisë.

⁴⁷⁴ Ligji Model UNCITRAL, 1985, amenduar 2006, neni 1(3).

V.4.2.1. Analizë e kritereve të parashikuara nga neni 400 i K.Pr.C.

Përsa i përket dallimit midis arbitrazhit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar, legjislacioni Shqiptar bën dallimin midis këtyre dy instrumentave nëpërmjet nenit 400 të K.Pr.C i cili, kryesisht nëpërmjet kritereve subjektive (që lidhen me cilësitë e palëve), përcakton se seksioni i dispozitave mbi arbitrazhin e brendshëm do të zbatohet: “...për procedurën e gjykimeve të arbitrazhit, kur pjesëmarrësit në proces janë me banim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë dhe kur vendi i procedurës së arbitrazhit ndodhet në territorin e saj”. Sipas kuptimit strikt të kësaj dispozite, në Shqipëri, vendim i brendshëm arbitrazhi do të konsiderohet ai vendim final i miratuar në përfundim të një procedure gjykimi me arbitrazh, procedurë e cila nga ana e saj plotëson njëkohësisht dy kushte: a) palët në proces janë me banim ose vendqëndrim në Shqipëri; dhe b) vendi i procedurës së arbitrazhit ndodhet në territorin e shtetit Shqiptar.

E formuluar vetëm me këto dy kritere, dispozita e mësipërme fut nën të njëjtin regjim juridik, duke i cilësuar si vendime arbitrazhi të brendshëm, ato vendime arbitrazhi që i japin zgjidhje konflikteve që rrjedhin nga kontrata, subjekt i të drejtës shqiptare, sikurse edhe ato vendime që disponojnë mbi konflikte, të cilët burojnë nga kontrata, që i nënshtrohen të drejtës së një shteti tjetër apo të drejtës ndërkombëtare (mjafton që të plotësohet kushti i vendbanimit/vendqëndrimit të palëve dhe vendit të procedurës). Po kështu, me të drejtë, dispozita e mësipërme zhvleftëson kriterin e shtetësisë së palëve në konflikt dhe trajton si të brendshëm vendimin e arbitrazhi që i jep zgjidhje konflikteve midis palëve me shtetësi shqiptare dhe palëve me shtetësi mikse, me kusht që të plotësohen kriteri i vendbanimit ose vendqëndrimit në Shqipëri dhe që vendi i zhvillimit të procedurës të jetë Shqipëria. Në regjimin ndërkombëtar, me kohë shtetësia e palëve është lënë pas si kriter që determinon statusin e brendshëm apo ndërkombëtar të procesit dhe vendimit të arbitrazhit. Rikujtojmë Ligjin Model dhe Konventën e Gjenevës, të cilët theksojnë kriterin e vendbanimit (selisë) të palëve në konflikt kur sqarojnë statusin ndërkombëtar të arbitrazhit⁴⁷⁵.

Sikurse thamë më sipër, të dy kriteret duhet të plotësohen në mënyrë komplementare, çka do të thotë se psh. plotësimi vetëm i kriterit të vendbanimit të palëve nuk mjafton për të konsideruar arbitrazhin si të brendshëm. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata e Tiranës në shqyrtimin e çështjes “Shoqëria “Marko Tel & Hes Kablo Albania” shoqëri e thjeshtë kundër

⁴⁷⁵ Shiko nenin 1(3) të Ligjit Model dhe nenin 1(1) të Konventës së Gjenevës.

“ZTE Albania” shpk⁴⁷⁶, ku panvarësisht pretendimit të paditësit se *kemi të bëjmë me arbitrazh të brendshëm, për shkak se të dy palët kanë vendbanimin (selinë) në Shqipëri*, ka vendosur nxjerrjen e çështjes civile jashtë juridiksionit të saj gjyqësor, me argumentimin se në rastin konkret bëhet fjalë për arbitrazh ndërkombëtar, duke u shprehur se: *“Fakti që një arbitrazh konsiderohet si ndërkombëtar, vetëm nisur nga fakti që ai ndodhet në një vend të ndryshëm nga ai ku palët kanë qendrat e tyre të biznesit ose ushtrojnë veprimtarinë e tyre tregtare është përcaktuar shprehimisht në Notën Shpjeguese të Sekretariatit të UNCITRAL mbi Ligjin Model të Arbitrazhit Ndërkombëtar⁴⁷⁷....Gjithashtu referimi i personave të të njëjtit shtet në një arbitrazh ndërkombëtar nuk pengohet as nga Konventa Europiane mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar e Gjenevës (1961)... Palët e një mosmarrëveshje, pavarësisht faktit që mund të janë persona juridikë ose fizikë nga i njëjti shtet, mund ta referojnë çështjen e tyre në një arbitrazh ndërkombëtar në bazë të Konventës “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”, (Nju Jork me datë 10.06.1958).....”*.

Po në kuadër të plotësimit njëkohësisht të dy kriterëve, të parashikuara prej nenit 400 të K.Pr.C, në çështjen “Kundërshtim i Vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit pranë Qendrës Shqiptare për Ndërmjetësim dhe Arbitrazh Tregtar (MEDART) nr.3/2007, për çështjen "Shoqëria "CLASSIC" shpk kundër "Televizioni Arbëria"⁴⁷⁸, Gjykata e Apelit e ka analizuar në këtë mënyrë çështjen e statusit të vendimit të arbitrazhit, objekt kundërshtimi: *“Vendimi është dhënë në Republikën e Shqipërisë, mbi bazën e një procesi të zhvilluar në RSh, për zgjidhjen e një konflikti midis palëve të së drejtës Shqiptare me banim të përhershëm në RSH. Sa më sipër, në vështrim të kriterëve të nenit 400 të K.Pr.C, kemi të bëjmë me një vendim të brendshëm arbitrazhi e, për rrjedhojë, njohja dhe zbatimi i këtij vendimi arbitrazhi do të bëhet sipas neneve 432-438 të K.Pr.C”*.

V.4.2.2. Analizë e përbashkët e kriterëve të nenit 400 dhe 427 të K.Pr.C – përcaktimi i sferës së veprimit të arbitrazhit të brendshëm.

Në fakt, nga një analizë më specifike, situata ndërlikohet nëse do të bëjmë pjesë të analizës sonë dhe gjykimin mbi ligjin procedural të aplikuar nga gjykata e arbitrazhit. Sikurse e përmendëm më sipër, ligji Shqiptar, në lidhje me fushën e zbatimit të ligjit të brendshëm,

⁴⁷⁶ Çështja civile nr.11243-01441-2013, me palë: *paditës* - Shoqëria “Marko Tel & Hes Kablo Albania” shoqëri e thjeshtë”; i paditur - Shoqëria “ZTE Albania” shpk; person i tretë: “Albtelekom” sha; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.1460, datë 18.02.2013.

⁴⁷⁷ Shënime shpjeguese të Sekretariatit UNCITRAL për Ligjin Model (No.E.08.V.4.), f.26, par.11.

⁴⁷⁸ Çështja civile e regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me nr.63 regj.themeltar. datë 28.02.2008; Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.111 i vendimit, datë 02.10.2008.

parashikon se dispozitat procedurale të ligjit Shqiptar do të aplikohen për procedurën e arbitrazhit, kur pjesëmarrësit në proces janë me banim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë dhe kur vendi i procedurës ndodhet në territorin e shtetit Shqiptar (neni 400 i K.Pr.C). Por në të njëjtin kontekst duhet përmendur dhe neni 427 i K.Pr.C i cili parashikon se: *“Gjykata e arbitrazhit zbaton legjislacionin shqiptar”*. Neni 400, i lexuar së bashku me nenin 427 të shtyjnë drejt interpretimit se ligji Shqiptar mbi arbitrazhin⁴⁷⁹, do të gjejë zbatim si ligj procedural i arbitrazhit në rast se plotësohen në mënyrë kumulative dy kushtet: (a) palët janë me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë dhe (b) palët kanë zgjedhur Shqipërinë si vend të zhvillimit të procedurës së arbitrazhit.

Nëse analizën e mësipërme e kthejmë në funksion të gjykimit mbi arbitrazhin ndërkombëtar, mund të arrijmë në një konstatim të tillë: gjykata e arbitrazhit me seli në Shqipëri, nëse përmbushen dy kushtet e sipërpërmendura, duhet të aplikojë domosdoshmërisht legjislacionin Shqiptar si ligj procedural të arbitrazhit edhe kur vullneti i palëve për ligjin procedural ka një tjetër referim. E thënë ndryshe, gjykata e arbitrazhit nuk duhet të marrë në konsideratë rendin ligjor nacional apo ndërkombëtar të zgjedhur nga palët si ligj procedural, por pavarësisht nga ky vullnet duhet të zbatojë ligjin shqiptar.

Një argumentim i tillë hipotetik mund të ishte i drejtë për një gjykatë Shqiptare të investuar për të zgjidhur një konflikt të kësaj natyre, e cila mund të konstatonte si të pavlefshme zgjedhjen prej palëve dhe aplikimin nga gjykata e arbitrazhit të një ligji procedural të huaj kur palët në arbitrazh ishin Shqiptare dhe vendi i procedurës ishte Shqipëria, me argumentin se ndaj arbitrazhit lokal duhet të aplikohet K.Pr.C si ligj procedural. Megjithatë, në kushtet e mungesës së ligjit për arbitrazhin ndërkombëtar një pohim i tillë, ndonëse në dukje logjik do të ishte jo tërësisht i bazuar. Argumentimi tingëllon i pabazë pikërisht në vështrim të mënyrës liberale që doktrina e së drejtës ndërkombëtare përshkruan institutin e arbitrazhit ndërkombëtar, ku palët janë të lira të zgjedhin, ndër të tjera, edhe ligjin procedural, thënë ndryshe, ligjin që do të administrojë procesin⁴⁸⁰.

Teorikisht zgjedhja e palëve është përcaktuese për ligjin që do të rregullojë procedurën e krijimit të gjykatës së arbitrazhit dhe atë të zhvillimit të procesit të arbitrazhit. Palët mund të

⁴⁷⁹ Dispozitat e neneve 400 deri në 438 të K.Pr.C, që rregullojnë arbitrazhin e brendshëm.

⁴⁸⁰ Ligji procedural apo ligji i procedurës së arbitrazhit është kuadri ligjor që përcakton ato aspekte procedurale që jemi mësuar t'i shohim të rregulluara nga ligji i procedurës civile në një proces civil, si për shembull: vlefshmërinë e marrëveshjes së arbitrazhit e cila ndikon direkt në çështjen e juridiksionit të gjykatave; juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës arbitrale; mundësinë e ndërhyrjes së gjykatave publike në procesin e arbitrazhit; mundësinë e heqjes së arbitrave apo kontestimit të mandatit të tyre nëpërmjet gjykatave publike; mundësinë dhe bazat ligjore të apelimit të vendimit të arbitrazhit; strukturën dhe përmbajtjen e vendimit të arbitrazhit; njohjen dhe zbatimin e vendimit të arbitrazhit dhe çështje të tjera të natyrës procedurale.

zgjedhin një ligj të caktuar që të rregullojë menyrën e krijimit të gjykatës arbitrale dhe një sistem tjetër ligjor për të rregulluar procedurën e arbitrazhit. Kjo ndodh psh. kur palët i drejtohen arbitrazhit institucional dhe kërkojnë zbatimin e rregullave të tij për krijimin e gjykatës, por zbatojnë ligjin e një vendi tjetër në lidhje me procedurën. Për shembull, klauzola e arbitrazhit mund të parashikojë që palët do t'ia nënshtrojnë mosmarrëveshjet e tyre “...arbitrazhit të Gjykatës së Arbitrazhit të ICC. Vendi i arbitrazhit do të jetë Parisi. Ligji procedural i arbitrazhit do të jetë Kodi Italian i Procedurës Civile”. Në këtë rast, krijimi i gjykatës së arbitrazhit do të bëhet sipas rregullave të ICC, ndërsa procedura e gjykimit të arbitrazhit dhe dhënies së vendimit të tij do të bëhet sipas Kodit të Procedurës Civile Italiane. Për më tepër kjo është e pranuar në rastin e arbitrazhit *ad hoc* ku palët janë të lira të draftojnë vetë rregullat procedurale të administrimit të procesit të arbitrazhit, në mungesë të adresimit ndaj një institucioni të përhershëm arbitrazhi. Autoriteti i palëve për të miratuar me marrëveshje rregullat procedurale të veprimtarisë së forumit të arbitrazhit gjen parashikim në shumë legjislacione nacionale që rregullojnë arbitrazhin.⁴⁸¹

Është e vërtetë që, në praktikë, ligji procedural i arbitrazhit ndërkombëtar shpesh është ligji i vendit të zhvillimit të arbitrazhit (*lex loci arbitri*). Ky rregull ka gjetur zbatueshmëri të gjërë dhe arsyeja kryesore gjykoj se është për të lehtësuar marrëdhënien që ekziston midis procedimit të arbitrazhit dhe ndërhyrjes së gjykatave nacionale të vendit ku zhvillohet arbitrazhit. *Së pari*, gjykatat e vendit (shtetit) ku zhvillohet arbitrazhi kanë kompetencë për ndërhyrjen në procesin arbitral për çështje të ndryshme që mund të kërkojnë nga palët apo edhe *ex officio*. Në gjykimin e këtyre çështjeve gjykatat do të zbatojnë ligjin e tyre, ligjin e vendit ku zhvillohet arbitrazhi. *Së dyti*, vlefshmëria e vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar mund të kontestohet nga palët dhe ky kundërshtim bëhet në gjykatat e vendit ku është zhvilluar arbitrazhi. Për rrjedhojë, përzgjedhja e ligjit të vendit të zhvillimit të arbitrazhit si ligj procedural i arbitrazhit, do të lehtësonte vlerësimin nga ana e gjykatave publike të ankimeve të palëve. Përveç sa më sipër, në disa raste janë vetë ligjet e brendshme të vendeve ato që diktojnë zbatimin e tyre në mënyrë të detyrueshme në rast se ato janë vendi i zgjedhur

⁴⁸¹ Neni 816 i Kodit të Procedurës Civile Italiane: “Zhvillimi i Procedurës” - Palët mund të përcaktojnë në marrëveshjen e arbitrazhit ose në një akt shkresor të veçantë, me kusht që të jetë hartuar para fillimit të gjykimit në arbitrazh, rregullat që arbitrat duhet të respektojnë për procedurat e gjykimit dhe gjuhën e arbitrazhit. Në mungesë të këtyre rregullave arbitrat kanë autoritetin për të rregulluar procedurat e veta dhe për të përcaktuar gjuhën e arbitrazhit në mënyrë që ata e shohin më të përshtatshme.

për zhvillimin e arbitrazhit⁴⁸². Pra në disa legjislacione vihet re tendenca për t'i orientuar palët drejt legjislacioneve procedurale lokale;

Gjithsesi për efekt të analizës që kemi ndërmarrë, është me vend të mbetemi tek aspekti teorik i problemit, pra të fokusuar tek pyetja: a mundet që palët të involvuara në një proces arbitrazhi të zgjedhin si ligj procedural një ligj të ndryshëm nga ai i vendit ku zhvillohet procesi? Për t'i dhënë një përgjigjë përfundimtare kësaj pyetje, na vjen në ndihmë vetë Konventa e Nju Jork-ut, nga ku edhe nisi analiza. Sipas dispozitave të Konventës, konsiderohet një shkak refuzues për njohjen e vendimit fakti që *“përbërja e autoritetit të arbitrazhit ose e procedurës së arbitrazhit nuk është në përputhje me marrëveshjen e palëve, ose kur mungon një marrëveshje e tillë, nuk është në përputhje me ligjin e vendit ku është zhvilluar arbitrazhi”*⁴⁸³. Pra vetë Konventa njih, madje i jep përparësi, rregullimit të procedurës arbitrale sipas marrëveshjes së palëve, të cilët mund të zgjedhin për këtë rregullim një ligj të huaj. Një marrëveshje e tillë, për përcaktimin e një ligji të huaj si administrues të procedurës arbitrale do të prevalojë mbi ligjin procedural të vendit të arbitrazhit.

Kur teksti final i Konventës së Nju Jork-ut, u fut për miratim, në 9 qershor 1958, u bënë dy amendime të rëndësishme, që patën ndikim në shtrirjen e fushës së aplikimit të Konventës. Në respekt të marrëveshjes së arbitrazhit, teksti i draftuar parashikonte që zbatimi i vendimit të arbitrazhit të mund të refuzohej, nëse marrëveshja e arbitrazhit ishte e pavlefshme, sipas *“ligjit të aplikueshëm për të”*. Ky parashikim u ndryshua, duke fituar këtë formë: *“sipas ligjit të cilit palët e kanë nënshtruar atë (marrëveshjen), ose kur mungon ndonjë përcaktim i tillë, sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi”*⁴⁸⁴. Një tjetër amendim domethënës u bë në respekt të vendimit të arbitrazhit. Drafti parashikonte që zbatimi i vendimit të mund të refuzohej nëse vendimi ishte anuluar *“në shtetin ku ai ishte dhënë”*. Kjo u ndryshua duke marrë formë: *“në shtetin në të cilin, ose, sipas ligjit të të cilit, vendimi ishte dhënë”*⁴⁸⁵. Këto ndryshime garantuan mundësinë që një vendim arbitrazhi të mund të rregullohej nga një ligj arbitrazhi, i cili është i ndryshëm nga ligji i vendit të arbitrazhit.⁴⁸⁶ Të njëjtin qëndrim mban

⁴⁸² Akti i Arbitrazhit 1996 (Angli), neni 2(1) *“Fusha e zbatimit të dispozitave”*: *Dispozitat e kësaj pjese zbatohen kur selia e arbitrazhit është në Angli dhe Uells apo në Irlandën e Veriut.*

⁴⁸³ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(1)(d).

⁴⁸⁴ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(1)(a).

⁴⁸⁵ *Id.*, neni V(1)(e).

⁴⁸⁶ Albert Jan van den Berg, *“Konventa e Arbitrazhit të Nju Jork-ut e 1958”*, (T.M.C. Asser Institute – Instituti Ndëruniversitar për të Drejtën Ndërkombëtare dhe të Drejtën e Komunitetit Evropian - Hagë), bot.Kluwer Law and Taxation, 1981, f.23-24.

edhe Ligji model UNCITRAL përsa i përket autoritetit të vullnetit të palëve si determinues të rregullimit procedural të arbitrazhit.⁴⁸⁷

Për t'iu kthyer përsëri analizës sonë, nëse do të mbetemi në interpretimin e ngushtë të dispozitave të nenit 400 dhe 427 të K.Pr.C, me shumë gjasa, ky interpretim do të kufizonte efektin e veprimit të Konventës së Nju Jork-ut, sepse priret të zgjerojë rrethin e vendimeve të cilësuar si “vendime të brendshme arbitrazhi”. Për rrjedhojë gjykoj se duhet të orientohemi drejt një tjetër interpretimi, sipas të cilit, ligji procedural Shqiptar do të jetë ligji administrues i procedurës së arbitrazhit, kur palët janë Shqiptare dhe vendi i procedurës është Shqipëria, por duke përjashtuar rastin kur palët kanë zgjedhur një ligj tjetër për të administruar procedurën. E thënë ndryshe, procedura e arbitrazhit do të rregullohet nga ligji Shqiptar në rastin kur palët në konflikt kanë zgjedhur ligjin procedural shqiptar ose kur palët nuk janë shprehur fare për këtë qëllim dhe si rrjedhojë gjykata e arbitrazhit, në mungesë të marrëveshjes midis palëve, do të zbatojë ligjin shqiptar. Në këtë linjë arsyetimi qëndron edhe parashikimi i nenit 416 të K.Pr.C sipas të cilit palët kanë të drejtë të caktojnë vetë procedurën e funksionimit të gjykatës së arbitrazhit. Vetëm kur mungon marrëveshja e palëve, për këtë qëllim, është vetë gjykata që cakton procedurën e zbatueshme për punën e saj⁴⁸⁸.

Në këtë kuptim parashikimi i nenit 427 të K.Pr.C që *gjykata e arbitrazhit zbaton legjislacionin shqiptar* merr vlerën e një kriteri të ri shtesë, në funksion të identifikimit të kushteve se kur zbatohen dispozitat e K.Pr.C në një procedurë arbitrazhi, apo të kushteve që duhet të plotësojë procedura e arbitrazhit për t'u cilësuar si *arbitrazh i brendshëm (lokal)*. Në këtë optikë të re të analizës së kriterëve që përcaktojnë bashkërisht neni 400 dhe 427 i K.Pr.C, mund të themi se përcaktimi i një procedure arbitrazhi si “arbitrazh i brendshëm” bëhet me kushtin e përmbushjes njëkohësisht të tre kriterëve komplementare:

(a) *palet janë me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë,*

(b) *palet kanë zgjedhur RSH si vend të zhvillimit të procedurës së arbitrazhit,*

⁴⁸⁷ Ligji model UNCITRAL, neni 19 “Përcaktimi i rregullave të procedurës”: “Duke i'u nënshtruar parashikimeve të këtij ligji, palët janë të lira për të rënë dakord mbi procedurën që do të ndiqet nga gjykata e arbitrazhit në realizimin e procedimit. Në mungesë të një marrëveshjeje e tillë, gjykata e arbitrazhit mundet të drejtojë arbitrazhin në mënyrë të tillë që të konsiderohet e përshtatshme për çështjen. Autoriteti i akorduar në gjykatën e arbitrazhit përfshin pushtetin për të përcaktuar pranueshmërinë, lidhjen, rëndësinë dhe peshën e çdo prove”.

⁴⁸⁸ K.Pr.C, neni 416 “Përcaktimi i procedurës së punës”; “Palët mund të përcaktojnë vetë procedurën e punës të gjykatës së arbitrazhit, duke pranuar rregullat e vendosura për gjykatat ose duke iu referuar rregullave procedurale të një organizmi arbitrazhi të zgjedhur prej tyre. Nëse një rregullim i tillë nuk është bërë nga palët, gjykata e arbitrazhit i cakton vetë ato, qoftë edhe duke iu referuar një rregulloreje të një organizmi arbitrazhi. Pavarësisht nga sa u parashtrua në dy paragrafët e mësipërm, gjykata e arbitrazhit është e detyruar të respektojë parimet drejtuese të procesit, të garantojë barazinë ndërmjet palëve dhe të drejtën e tyre për t'u dëgjuar në një procedurë kontradiktore”.

(c) gjykata e arbitrazhit zbaton legjislacionin Shqiptar (kusht që, sikurse thamë më lart, rrëzohet në rastin kur palët kanë zgjedhur një ligj procedural të ndryshëm nga ai Shqiptar).

Për rrjedhojë, një procedurë arbitrazhi ku palët janë me vendbanim në Shqipëri dhe vendi i procedurës është kjo e fundit, nuk mund dhe nuk duhet të cilësohet si “arbitrazh i brendshëm” kur palët kanë zgjedhur një ligj procedural të ndryshëm nga ai Shqiptar për administrimin e procedurës. Në një situatë të tillë do të kishim të bënim me “arbitrazh ndërkombëtar” dhe vendimi i prodhuar nga kjo procedurë do të cilësohej si “jo lokal”, apo si vendim “i huaj” arbitrazhi, duke i’u nënshtruar rregullimeve të Konventës së Nju Jork-ut, përsa i përket njohjes dhe ekzekutimit të tij. Në favor të këtij konstatimi vjen dhe parashikimi që bën Ligji Model, i cili e definon një procedurë arbitrazhi si *ndërkombëtare* bazuar, ndër të tjera, edhe në vullnetin e palëve në konflikt, duke përcaktuar se “*arbitrazhi është ndërkombëtar nëse.....palët kanë rënë dakort në mënyrë të shprehur që objekti i marrëveshjes arbitrale të këtë lidhje me më shumë se një shtet*”⁴⁸⁹.

Sa më sipër, interpretimi i zgjeruar i kuadrit ligjor në fuqi, duke marrë në konsideratë edhe frymën dominuese të regjimit rregullator ndërkombëtar, duhet të çojë në përfundimin që, në Shqipëri, një vendim arbitrazhi duhet të cilësohet si “i huaj” apo si “jo lokal” dhe për njohjen e tij do të zbatohen dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut, kur:

- a) vendimi i arbitrazhit është marrë në një shtet të ndryshëm nga Shqipëria, ose
- b) vendimi i arbitrazhit është marrë në Shqipëri, por nuk cilësohet si vendim “lokal” për ligjin shqiptar, sepse konstatohet i plotësuar të paktën njëri prej tre kushteve të mëposhtëme:
 - i) pjesëmarrësit në proces nuk janë me banim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë (të paktën njëri prej tyre nuk është);
 - ii) vendi i procedurës së arbitrazhit nuk ndodhet në territorin e saj (*pavarësisht se vendimi është marrë në Shqipëri, pasi jo gjithmonë vendi i procedurës përputhet me vendin ku është marrë vendimi*);
 - iii) gjykata e arbitrazhit nuk ka zbatuar legjislacionin shqiptar.

Nga ana tjetër, bazuar po në këtë interpretim, një vendim arbitrazhi i dhënë në Shqipëri, nga një gjykatë arbitrazhi e cila ka zhvilluar procesin në territorin Shqiptar, bazuar në

⁴⁸⁹ Ligji Model, neni 1(3), shiko *supra* nënseksionin IV.4.2.

legjislaconin procedural Shqiptar, për të zgjidhur një konflikt midis dy palëve që janë me banim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë, do të konsiderohet vendim “i brendshëm” arbitrazhi. Një vendim i tillë, që nuk konsiderohet “i huaj” për Shqipërinë, del jashtë sferës së veprimit të Konventës së Nju Jork-ut, pasi nuk ka nevojë që ky vendim arbitrazhi të njihet në Republikën e Shqipërisë, në kushtet kur ai i prodhon drejtpërdrejtë efektet e tij për palët. Sipas përcaktimeve të K.Pr.C, vendimi i gjykatës së arbitrazhit, që konsiderohet “i brendshëm” sipas interpretimit të mësipërm, është i formës së prerë në lidhje me mosmarrëveshjen e shqyrtuar me të njëjtin efekt si një vendim i dhënë nga një gjykatë shtetërore, përveç rasteve kur ndaj tij do të bëhet ankim⁴⁹⁰. Nëse palët nuk do ta zbatojnë vendimin e arbitrazhit të brendshëm vullnetarisht, ky i fundit bëhet i ekzekutueshëm forcërisht në bazë të një urdhëri ekzekutimi të lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të vendit ku është dhënë vendimi i arbitrazhit⁴⁹¹.

Në përfundim të kësaj analize të kuadrit ligjor të brendshëm, do të ishte e arsyeshme të propozohej një ndryshim në K.Pr.C, sipas të cilit një nga kriteret e aplikueshme për të përkufizuar arbitrazhin (kuptohet dhe vendimin që ai prodhon) si *të brendshëm* apo *të huaj (ndërkombëtar)* të ishte ligji procedural i aplikueshëm në procesin e arbitrazhit (ligji i zgjedhur nga palët, apo ligji i aplikuar nga forumi kryesisht, në mungesë të shprehjes së vullnetit të palëve). Gjithashtu një dispozitë më specifike dhe më e drejtpërdrejtë në këtë drejtim, do t'i vinte në ndihmë këtij interpretimi për të bërë dallimin midis arbitrazhit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar (të huaj), sikurse është përkufizimi që bën ligji Anglez i arbitrazhit specifikisht për marrëveshjen e arbitrazhit të brendshëm, nga ku definohet statusi i procesit dhe më pas i vendimit të arbitrazhit të brendshëm.⁴⁹²

⁴⁹⁰ K.Pr.C, neni 432(1) - Urdhri i ekzekutimit të vendimit të gjykatës së arbitrazhit: “Vendimi i gjykatës së arbitrazhit është i formës së prerë në lidhje me mosmarrëveshjen e shqyrtuar, sapo shpallet, përveç rasteve të parashikuara nga neni 434 i këtij Kodi”.

⁴⁹¹ *Id.*, par.(2): “Ai bëhet i ekzekutueshëm forcërisht në bazë të një urdhri ekzekutimi të lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të vendit ku është dhënë vendimi. Për një qëllim të tillë, në sekretarinë e gjykatës depozitohet origjinali i vendimit me një kopje të marrëveshjes së arbitrazhit, nga një prej arbitrave ose nga pala e interesuar”.

⁴⁹² Akti i Arbitrazhit 1996 (Angli), neni 85(2) ... një “marrëveshje e arbitrazhit të brendshëm” nënkupton marrëveshjen e arbitrimin në të cilën asnjëra prej palëve nuk është (a) një individ me kombësi, ose rezident i zakonshëm në një shtet tjetër të ndryshëm prej Mbretërisë së Bashkuar, ose (b) një korporatë e cila është regjistruar, ose kontrolli qëndror dhe menaxhimi i të cilës ushtrohet në një shtet të ndryshëm prej Mbretërisë së Bashkuar dhe sipas të cilës selia e arbitrazhit (në qoftë se selia ka qenë përshkruar ose përcaktuar) është në Mbretërinë e Bashkuar.

V.4.3. Sfera e aplikimit të Konventës së Nju Jork-ut, në praktikën gjyqësore.

Nëse do të hedhim një vështrim në praktikën gjyqësore ndërkombëtare, përse i përket sferës së aplikimit të Konventës, një nga çështjet më tipike për interpretimin e termit “vendim i huaj” është çështja “Sigval Bergesen kundër Joseph Muller Corp.” e vitit 1983⁴⁹³. Çështja, që u shtrua për shqyrtim para Gjykata së Apelit të SHBA, ishte interpretimi i rregullave të aplikueshme për të dhënë definicionin e *vendimit të arbitrazhit të dhënë në territorin e një shteti tjetër* (kriteri i parë i nenit 1(1) për fushën e aplikimit të Konventës së Nju Jork-ut) dhe *vendimit jo-lokal apo jo të brendshëm të arbitrazhit* (kriteri i dytë i nenit 1(1) të Konventës). Çështja e parë ishte e thjeshtë, pasi vendimi i arbitrazhit ishte dhënë në territorin e shtetit Amerikan ku dhe kërkohet njohja. Pra, nëse do të aplikohet kriteri i parë, vendimi i arbitrazhit gëzonte statusin e një vendimi të brendshëm për gjykatën Amerikane, ku dhe ishte paraqitur kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit.

Kriteret lidhës për të bërë këtë vleresim u gjetën në ligjin e brendshëm, pra në ligjin e SHBA për arbitrazhin lokal⁴⁹⁴. Sipas këtij ligji, nuk aplikohet Konventa e Nju Jork-ut (pra kemi të bëjmë me arbitrazh lokal) nëse marrëdhënia është tërësisht ndërmjet palëve Amerikane, me përjashtim të rastit kur edhe pse palët janë Amerikane, relacioni përfshin një pronë që gjendet jashtë SHBA, apo performanca e kontratës midis palëve do të kryhet jashtë SHBA, apo kontrata ka një lidhje të rëndësishme me një shtet tjetër. Pra, edhe kur palët janë Amerikane, legjislacioni i brendshëm i SHBA bën përjashtime, për të konsideruar arbitrazhin si të huaj (jo-lokal), nëse plotësohet njëri prej tre kushteve të mësipërme. Për gjykatën ishte më se e arsyeshme dhe pa dyshim do të konsideronte vendimin e arbitrazhit si *të huaj* (jo-lokal) pasi kriteri primar i shtetësisë së palëve nuk plotësohet (palët nuk ishin Amerikane), përpos performacës së pjesëshme të kontratës jashtë SHBA dhe përpos pasurive të palëve të gjendura jashtë SHBA.

⁴⁹³ *Bergesen kundër Joseph Muller Corp.* (710 F.2^d 928, 2^d Cir.1983). Bergesen ishte pala Norvegjeze pronar anijesh, ndërsa Muller Corp. ishte një shoqëri zvicerane prodhuese e substancave kimike. Midis tyre ishin lidhur tre kontrata për transport mallrash dhe në të treja ishte përfshirë një klauzolë arbitrazhi, sipas të cilës, në rast konflikti palët do t'i drejtoheshin arbitrazhit në Nju Jork dhe kryetari i AAA (American Arbitration Association) do të realizonte zgjedhjen e arbitrave. Procedura e aplikueshme do të ishte ajo e AAA. Në vitin 1972 lindi një konflikt për mospërbushje detyrimesh kontraktore dhe arbitrazhi dha një vendim në favor të palës norvegjeze *Bergesen*. Kjo e fundit procedoi me kërkesën për njohje dhe ekzekutim të vendimit në Zvicër, ku kishte qendrën dhe pasurinë Muller Corp., e cila arriti të “zvarrisë” procedurën gjyqësore. Menjëherë, para mbarimit të afatit të parashkrimit për kërkimin e njohjes dhe akzekutimit të vendimit të arbitrazhit në SHBA, Bergesen paraqiti kërkesë para gjykatës amerikane për t'i akorduar këtë njohje. Pala tjetër (Muller) bëri rezistencë duke pretenduar se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një vendim “të huaj” arbitrazhi në sensin territorial (kriteri i parë i nenit 1(1) të Konventës), sikurse nuk kemi të bëjmë me vendim jo-lokal (kriteri i dytë i nenit 1(1) të Konventës).

⁴⁹⁴ Seksioni 202 i Kodit të Shteteve të Bashkuara (USC).

Gjykata e Apelit të SHBA konkludoi se vetëm *vendi i procedurës* dhe *ligji procedural* nuk mjaftojnë si kritere për të përkufizuar një vendim arbitrazhi si të brendshëm (lokal). Këto dy kritere nuk kanë shumë relevancë, sipas gjykatës, nëse konflikti apo marrëdhënia midis palëve ka lidhje të konsiderueshme me një shtet tjetër të ndryshëm nga SHBA. Një vendim arbitrazhi i marrë në shtetin e Nju Jork-ut, sipas legjislacionit Amerikan, midis dy palëve, marrëdhënia e të cilëve paraqitet me element të huaj relevant, do të konsiderohet si vendim jo i brendshëm (i huaj) sipas Konventës së Nju Jork-ut.

Çështja gjyqësore e mësipërme na ndihmon të kuptojmë standartin e vendosur nga jurisprudenca ndërkombëtare, përse i përket statusit të vendimit të arbitrazhit si vendim *i brendshëm* apo *i huaj*, një standart i cili nuk gjen vend në ligjin Shqiptar. Sikurse u përmend edhe më sipër, K.Pr.C fut nën të njëjtin regjim juridik, duke e cilësuar si vendim arbitrazhi të brendshëm edhe atë vendim arbitrazhi që disponon mbi konflikte të palëve, relacioni midis të cilave paraqet elementë të huaj (psh., performanca e kontratës jashtë RSH-së), mjafton që të plotësohet kriteri i vendbanimit ose vendqëndrimit në Shqipëri dhe që vendi i procedurës të jetë Shqipëria. Aktualisht, ligji Shqiptar trajton si vendim *të brendshëm* arbitrazhi edhe vendimin e dhënë nga një forum arbitrazhi, që ka zhvilluar procesin në Shqipëri midis dy subjekte me vendbanim/vendqëndrim në Shqipëri, pavarësisht se mund të bëhet fjalë për një konflikt i cili buron nga një marrëdhënie tregtare që mund të mos ketë asnjë lidhje me Shqipërinë. Jo vetëm kaq por, për t'iu kthyer edhe një herë diskutimit të mësipërm për ligjin procedural, interpretimi i ngushtë i nenit 427 K.Pr.C mund të çojë në një situatë paradoksale ku një gjykatë Shqiptare, në situatën hipotetike të mësipërme, të konsiderojë të pavlefshme marrëveshjen midis këtyre dy palëve (shqiptare ose jo) për të zgjedhur një ligj procedural të ndryshëm nga ligji shqiptar, për të administruar procesin e arbitrazhit.

Nëse do t'i referohemi praktikës gjyqësore Shqiptare, në asnjë prej rasteve të analizuara në këtë punim⁴⁹⁵, të kërkesave për njohje të vendimeve të arbitrazhit, të paraqitura para Gjykatës së Apelit, kjo e fundit nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka dhënë ndonjë vlerësim të shpehur për natyrën e vendimit të arbitrazhit, nëse ai konsiderohet vendim i huaj apo i brendshëm (lokal). Mesa duket, gjykata ka marrë të mirëqënë kërkesën, pra ka prezumuar se vendimin i

⁴⁹⁵ Shiko *infra*, të trajtuara në kapitullin pasardhës, çështjet e praktikës gjyqësore Shqiptare me objekt: Njohja dhe zbatimi në R.Sh. të Vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit të huaj për çështjet: “AEDP kundër Republika e Shqipërisë”; “BE-HA-SE” kundër Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve (DPRR-MPPTT), Shqipëri; “McKinsey & Comany Inc.Croatia kundër Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Agjencinë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja”; “La Petrolifera Italo-Rumena” Spa. dhe “La Petrolifera Italo-Albanese” Sha. kundër Republika e Shqipërisë”; “ROHDE NIELSEN” A/S kundër Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit të R.Shqipërisë”; “I.C.M.A” srl. në likuidim” dhe “AGRI.BEN” sas kundër Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të R.Shqipërisë”.

arbitrazhit objekt i kërkesës për njohje, e ka statusin e vendimit “të huaj” (jo të brendshëm) të arbitrazhit. Është e kuptueshme se një prezumim i tillë ka qenë i rrëzueshëm, por në asnjë rast pala, kundër të cilës paraqitej kërkesa për njohje, nuk e ka ngritur një pretendim të tillë për të konsideruar vendimin e arbitrazhit si *të brendshëm* dhe, kësaj, për të nxjerrë Gjykatën e Apelit jashtë juridiksionit. Në fakt, çdo pretendim i kësaj natyre do të ishte konsideruar i pabazë, në referim të nenit 1(1) të Konventës së Nju Jork-ut⁴⁹⁶, pasi statusin *e huaj* apo *të brendshëm* të vendimit të arbitrazhit e përcakton, në rradhë të parë, vendi (shteti) ku është dhënë vendimi i arbitrazhit, i cili në asnjë nga rastet e shqyrtuara, nuk ka qenë Shqipëria. Në këto kushte, kur vendi i dhënies së vendimit ka qenë, në çdo rast, i ndryshëm prej atij ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi (Shqipëria), atëherë statusi i vendimit të arbitrazhit, si *i huaj*, ka qenë evident në çdo rast.

Nëse abstragojmë për një situatë hipotetike, ku palët do të kishin rënë dakort që vendi i zhvillimit të arbitrazhit të ishte Shqipëria (të plotësohej, kështu, kriteri i *vendit të procedurës*, i parashikuar nga neni 400 i K.Pr.C), atëherë do të paraqitej interesante analiza që do të duhet të kishte bërë Gjykata e Apelit, për të provuar nëse plotësoheshin kushtet për ta trajtuar vendimin e arbitrazhit si “të brendshëm”, apo “të huaj”, në vështrim të parashikimeve të K.Pr.C (neni 400). Në këto kushte, analiza do të fokusohet vetëm tek *kriteri i vendbanimit*, pra në faktin nëse njëra nga palët në konflikt (sepse pala tjetër, në të gjitha rastet, ka qenë një shteti Shqiptar) kishte vendbanimin, ose vendqëndrimin në një shtet të ndryshëm prej Republikës së Shqipërisë. Në vështrim të këtij kriteri, situata për çështjet e trajtuara në këtë punim, do të paraqitej komplekse, pasi, në disa raste, pala tjetër (jo shtetërore) rezultonte me vendbanim në RSh⁴⁹⁷. Mbetet e diskutueshme çështja, në këtë situatë hipotetike (kur vendi i arbitrazhit do të ishte Shqipëria), nëse Gjykata e Apelit do të trajtonte kriterin e *nacionalitetit* të ligjit, që kishte administruar procedurat e arbitrazhit për çdo rast. Në të gjitha çështjet e hulumtuara, ligji procedural që ka rregulluar arbitrazhin, ka qenë jo ligji Shqiptar, pra një rend juridik i huaj për RSh-në. Kjo do të thotë, në dritën e analizës interpretuese të zhvilluar më sipër, se në të gjitha rastet, duke konsideruar edhe kushtet e abstragimit të mësipërm, Gjykata e Apelit nuk do të kishte asnjë mundësi tjetër veçse të konsideronte vendimet e arbitrazhit, të paraqitura për njohje, si vendime *të huaja* arbitrazhi.

⁴⁹⁶ Konventa e Nju Jorkut, neni 1, paragrafi 1: “Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, që janë dhënë në territorin e një shteti të ndryshëm prej atij ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi i vendimeve, dhe që u përkasin marrëveshjeve midis personave fizike ose juridikë.”.

⁴⁹⁷ Psh. në çështjen “Njohja dhe zbatimi në Republikën e Shqipërisë i Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006, me palë paditëse AEDP dhe palë të paditur Republika e Shqipërisë”, AEDP-ja (Programi Shqiptar për Edukim dhe Zhvillim) është regjistruar si person juridik, me Vendimin Nr.53 datë 16.7.2002 të Gjykatës së shkallës së parë Tiranë, pra është me vendbanim në RSh.

Panorama e mësipërme e konturimit ligjor shqiptar të konceptit të “kombësisë” së procesit të arbitrazhit dhe vendimit të tij, që i përcakton atyre statusin si *të brendshëm* apo *të huaj* do të paraqitej më e qartë nëse dispozitat e sipërpërmendura të K.Pr.C do ishin plotësuar me të tjera dispozita mbi arbitrazhin ndërkombëtar, por legjislacioni i posaçëm për arbitrazhin ndërkombëtar nuk është miratuar ende. Në fakt ligjvënësi shqiptar pritet të shqyrtojë dhe miratojë një ligj të veçantë për arbitrazhin ndërkombëtar, detyrim ky i parashikuar nga neni 439 i KPrC, dhe i marrë përsipër nga Kuvendi i Shqipërisë në muajin prill 2013 me ligjin Nr.122/2013⁴⁹⁸.

Përfundime për kapitullin e pestë.

Në kuadër të analizës historiko-legjislative të institutit të arbitrazhit në Shqipëri, Arbitrazhi Shtetëror (periudha 1947-1993) paraqitet si më i kompletuari në aspektin e rregullimit normativ. Për shkak të karakteristikave që paraqiste (juridiksion i vetëm dhe i detyrueshëm, shqyrtim i çështjeve kryesisht, etj.) gjykoj që, pavarësisht emërimit formal, Arbitrazhi Shtetëror përfaqëson, më së shumti, një *sistem të posaçëm të gjykimit shtetëror*.

Perceptimi i përgjithshëm për një frymë jo në favor të arbitrazhit, në mjedisin aktual të biznesit Shqiptar, manifestohet me faktin se arbitrazhi, si zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve, nuk ka qënë shumë atraktiv për këtë mjedis. Përpos vetëdijes së ulët juridike të shoqërisë Shqiptare në përgjithësi, kjo sjellje tradicionale e biznesit favorizohet edhe për shkak të një kuadri ligjor të brendshëm që nuk i përgjigjet nivelit të trajtimit të institutit të arbitrazhit në regjimi juridik ndërkombëtar. Kështu, ndër të tjera, një problem i rëndësishëm i konstatuar në ligjin Shqiptar (K.Pr.C), që rregullon aspektet procedurale të arbitrazhit të brendshëm, krahasuar me rregullimin ndërkombëtar, është ngushtimi i spektrit të arbitrueshmërisë, duke lënë jashtë tij konfliktet jashtëkontraktore.

Problemi më i rëndësishëm i konstatuar është pamundësia juridike për të kundërshtuar, në Republikën e Shqipërisë, një vendim arbitrazhi të marrë në Shqipëri, por të konsideruar si vendim arbitrazhi ndërkombëtar (jo të brendshëm). Në kuadrin normativ të brendshëm Shqiptar, si pasojë e aderimit të Shqipërisë në Konventën Evropiane të Arbitrazhit, ekzistojnë shkaqet ligjore, për të cilat një vendim arbitrazhi ndërkombëtar mund të kundërshtohet. Por,

⁴⁹⁸ Ligji Nr.122/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Neni 49 “Dispozitë kalimtare”: *Neni 30 i këtij ligji hyn në fuqi pas miratimit të ligjit për arbitrazhin. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të paraqesë në Kuvend, për shqyrtim dhe miratim, projektligjin që rregullon arbitrazhin vendas dhe ndërkombëtar.*

ndërkohë që ekziston kjo bazë ligjore nuk ekzistojnë mjetet proceduriale për t'i vënë ato në zbatim, pasi nuk është përcaktuar formalisht autoriteti kompetent se ku duhet drejtuar apelimi.

Gjithashtu, pavarësisht se nuk është evidentuar si problem në numrin e vogël të rasteve të praktikës gjyqësore, nga një analizë e mirëfilltë juridike, rezulton se ekziston një paqartësi në kuptimin që përcjell interpretimi i përbashkët i neneve 400 dhe 427 të K.Pr.C. Përveç kësaj, ky interpretim gjykoj se favorizon kufizimin e sferës së veprimit të Konventës së Nju Jork-ut, duke zgjeruar rrethin e vendimeve të arbitrazhit që fitojnë statusin e vendimit *të brendshëm*. Prandaj, do të ishte e arsyeshme të propozohej një amendim ligjor, sipas të cilit një nga kriteret e aplikueshme për të përkufizuar arbitrazhin (kuptohet dhe vendimin që ai prodhon) si *të brendshëm* apo *të huaj* të ishte edhe ligji procedural i aplikueshëm në procesin e arbitrazhit.

KAPITULLI VI

KONVENTA E NJU JORK-ut NË DIMENSIONET E LEGJISLACIONIT DHE PRAKTIKËS GJYQËSORE SHQIPTARE PËR NJOHJEN DHE ZBATIMIN E VENDIMEVE TË ARBITRAZHIT TË HUAJ

Deri tani kemi përshkruar ntyrën juridike të arbitrazhit ndërkombëtar dhe posaçërisht mekanizmat e themeluar prej Konventës së Nju Jork-ut, në këtë drejtim, si dhe kemi paraqitur një tablo të vendit që zë instituti i arbitrazhit, si alternativë e padisë gjyqësore, në legjislacionin e brendshëm Shqiptar, duke u fokusuar tek mënyra se si ky legjislacion e cilëson një vendim arbitrazhi si të brendshëm, apo të huaj. Për të përmbushur objektivin e punimit, mbetet të analizojmë se si juridiksioni Shqiptar e ka mundësuar bërjen efektive të vendimeve të arbitrazhit të huaj në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër, përgjatë këtij kapitulli do të evidentohen, në rradhë të parë, se cilët janë mekanizmat juridikë, që janë ndërtuar dhe funksionojnë në rendin juridik Shqiptar sa i përket njohjes së vendimeve të arbitrazhit të huaj. Gjithashtu do të mbetet në fokus edhe problematika që konstatohet nga interpretimi i dispozitave të kuadrit ligjor të brendshëm, karahasuar me parashikimet dhe frymën e Konventës së Nju Jork-ut.

Për të përcjellë një tablo të plotë dhe të qartë të trajtimit, që juridiksioni Shqiptar i rezervon zbatueshmërisë së vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar, nuk do të mjaftonte vetëm analiza e kuadrit ligjor. Në këtë aspekt domosdoshmërisht janë përcaktuese edhe veçoritë e praktikës gjyqësore të fushës, të cilat vijnë për shkak të natyrës së interpretimit jurisprudencial të ligjit. Në punim trajtohen përmbledhtazi aspekte procedurale, të konstatuara nga hulumtimi i disa çështjeve gjyqësore të Kolegjit Civil të Gjykatës së Apelit Tiranë, në lidhje me kërkesat e paraqitura për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj. Kryesisht në këto raste studimore⁴⁹⁹, njëra nga palët në mosmarrëveshje është shteti Shqiptar, i përfaqësuar nga një

⁴⁹⁹ Çështja - Njohja dhe zbatimi në R.Shqipërisë i Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006, për AEDP kundër Republika e Shqipërisë; Çështja - Njohja në R.Shqipërisë e Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC), për çështjen me nr.12016/ACS/FM datë 02.04.2008, për "BE-HA-SE" kundër Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (DPRR - MPPTT), Shqipëri; Çështja - Njohja në R.Shqipërisë të Vendimit të Arbitrazhit të huaj LCIA nr.5720 datë 04.06.2006, për "McKinsey & Comany Inc.Croatia kundër Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Agjencinë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja"; Çështja - Njohja në R.Shqipërisë e Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) nr.14420/FM datë 25.07.2007, për "La Petrolifera Italo-Rumena" Spa. dhe "La Petrolifera Italo-Albanese" Sha. kundër Republika e Shqipërisë"; Çështja - Njohja në R.Shqipërisë e Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC), të datës 19.10.2009, për çështjen nr.14869/A VH/JEM/GZ, për "Shoqëria "ROHDE NIELSEN" A/S kundër Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të R.Shqipërisë"; Çështja - Njohja në R.Shqipërisë e Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC), të datës 22.12.2005, që i

institucion apo ent tjetër publik. Duke marrë parasysh numrin e pakët të rasteve të kësaj natyre në jurisprudencën shqiptare⁵⁰⁰, prezumoj që aspektet tipike procedurale të këtyre çështjeve, i përkasin në fakt gjithë praktikës gjyqësore, në fushën e njohjes së vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar.

VI.1. Mjetet juridike që sigurojnë në Shqipëri njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj, në frymën e Konventës së Nju Jork-ut dhe perceptimi mbi efektivitetin e tyre.

Nga një vështrim i shpejtë i kuadrit ligjor në fuqi, mund të konstatohet lehtësisht fakti që njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit të huaj në Republikën e Shqipërisë rregullohet nëpërmjet dy instrumentave ligjor. Për njohjen e këtyre vendimeve zbatohen njëkohësisht dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut dhe ato të Kodit të Procedurës Civile⁵⁰¹. Për t'u vlerësuar mbetet efekti real i këtyre dy instrumentave në jurisprudencën shqiptare dhe sa ato i përgjigjen rëndësisë që merr implementimi i institutit të arbitrazhit ndërkombëtar tregtar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, çka përbën në vetvete edhe qëllimin e këtij kapitulli.

Duhet thënë se, pavarësisht rëndësisë prevalue që marrin në praktikë dy instrumentat e mësipërm, pjesë e kuadrit ligjor të brendshëm që rregullon në përgjithësi institutin e arbitrazhit janë edhe Konventa Europiane e Arbitrazhit (Gjenevë, 21 prill 1961)⁵⁰² dhe ligji shqiptar për të drejtën ndërkombëtare private⁵⁰³. Ky i fundit është relevant, në fushën e arbitrazhit, pasi është ligji bazë për rregullimin e aftësisë së personave të huaj për t'u paraqitur përpara gjykatave shtetërore apo arbitrale në Shqipëri, sikurse dhe aftësisë së personave shqiptar (fizikë apo juridikë, shtetërore apo private) për t'iu nënshtruar një juridiksioni të huaj publik apo arbitral. Gjithashtu, përsa i përket trajtimit të arbitrazhit në rendin juridik shqiptar, merr rëndësi edhe Konventa "Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve

përket çështjes nr.12112/ACS për "I.C.M.A" srl. në likuidim" dhe "AGRI.BEN" sas. kundër Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të R.Shqipërisë".

⁵⁰⁰ Guida ligjore krahasuese ndërkombëtare për "Arbitrazhin ndërkombëtar 2008", bot.Global Legal Group Ltd. Londër, me kontributin e "Kalo & Associates, Attorneys at Law", faq.86, par.14.1.

⁵⁰¹ Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 (Flet.Zyrtare nr.9/1996, faqe 343) dhe ndryshuar me ligjin nr.8431, datë 14.12.1998; ligjin nr.8491, datë 27.5.1999; ligjin nr.8335, datë 18.10.1999; ligjin nr.8812, datë 17.5.2001; ligjin nr.9953, datë 14.07.2008; ligjin nr.10052, datë 29.12.2008; ligjin Nr.122/2013 - Pjesa e dytë "Gjykimi në shkallë të parë"; titulli III "Gjykimet e posaçme"; kreu IX "Njohja e vendimeve të shteteve të huaja", nenet 393 – 399.

⁵⁰² Konventa ka hyrë në fuqi në 7 janar 1964, por zbatohet në Shqipëri pas hyrjes në fuqi të ratifikimit të saj nga Kuvendi i Shqipërisë me anë të ligjit nr.8687, datë 9.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit", Flet.Zyrtare nr.38/2000, faqe 1829.

⁵⁰³ Ligji nr.10428, datë 02.06.2011 "Për të drejtën ndërkombëtare private", Flet.Zyrtare nr.82/2011, faqe 3319, i mbështetur në Rregulloren (EC) nr.593/2008 të Parlamentit Europian dhe Këshillit "Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore", si dhe në Rregulloren (EC) nr.864/2007 të Parlamentit Europian dhe Këshillit "Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet jashtëkontraktore".

të huaja në fushën civile dhe tregtare” (Hagë, 1 shkurt 1971)⁵⁰⁴. Kjo Konventë nuk trajton në menyre të drejtpërdrejtë vendimet e arbitrazhit, por u referohet disa aspekteve dytësore që lidhen me procesin e arbitrazhit⁵⁰⁵.

Le të mbetemi tek analiza e vlerësimit që rendi juridik i brendshëm Shqiptar i bën parashikimeve të Konventës së Nju Jork-ut. Në këtë kuadër, forma e zgjedhur nga Republika e Shqipërisë për të bërë Konventën e Nju Jork-ut pjesë integrale të së drejtës së saj të brendshme është aderimi në këtë Konventë dhe instrumenti i aderimit është ligji. Parlamenti Shqiptar ka miratuar aderimin e Republikës së Shqipërisë në këtë Konventë, me ligjin nr.8688 datë 09.11.2000 "*Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit"*⁵⁰⁶. Shqipëria është kështu pjesë e armatës së madhe të atyre shteteve që vullnetarisht kanë zgjedhur të ndajnë vlerat e padiskutueshme që bart Konventa e Nju Jork-ut në lëmin e të Drejtës Ndërkombëtare Private në përgjithësi dhe arbitrazhit ndërkombëtar tregtar në veçanti. Pasojë e drejtpërdrejtë e aderimit është angazhimi i Republikës së Shqipërisë, në arenën ndërkombëtare, për të respektuar të gjithë mekanizmat e themeluar prej Konventës dhe konkretisht:

(a) Njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit të huaj - *Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, që janë marrë në territorin e një shteti të ndryshëm prej atij ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi i vendimeve, dhe që u përkasin marrëveshjeve midis personave fizike ose juridikë. Ajo zbatohet gjithashtu për vendimet e arbitrazhit që nuk konsiderohen si vendime të arbitrazhit në shtetin ku kërkohet dhe ekzekutimi i tyre*⁵⁰⁷.

Dispozita e mësipërme përshkruan vetë qëllimin e Konventës, që nuk është gjë tjetër veçse ndërkombëtarizimi i zbatueshmërisë së vendimeve të arbitrazhit të huaj. Referuar emërtimit dhe dispozitave të Konventës, del qartë se ajo ka si fushë të veprimit të saj njohjen dhe zbatimin e vendimeve përfundimtare arbitrale të huaja, që zgjidhin mosmarrëveshjet midis personave fizike ose juridikë. Për efekt të zbatimit të dispozitave të Konventës, statusin e

⁵⁰⁴ Konventa ka hyrë në fuqi më 20 gusht 1979. Konventa është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr.10194, datë 10.12.2009 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën "Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja në fushën civile dhe tregtare", Flet.Zyrtare nr.184/2009, faqe 8153.

⁵⁰⁵ Neni 12 dhe 15 i Konventës se Hages: neni 12: *Juridiksioni i gjykatës së shtetit të origjinës nuk ka nevojë të njihet nga autoriteti dërgues në rastet e mëposhtme:....(3). Nëse autoriteti dërgues e konsideron veten të detyruar, sipas ligjit të njohë një marrëveshje me anë të së cilës u jepet juridiksion i posaçëm gjyqtarëve të arbitrazhit. neni 15: Njohja ose zbatimi i një vendimi arbitrazhi në lidhje me kostot ose shpenzimet gjyqësore mund të jepet në bazë të kësaj Konvente, vetëm nëse kjo Konventë është e zbatueshme për vendimin në themel.*

⁵⁰⁶ Ligji Nr.8688 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", dt.aktit:09.11.2000, dt.miratimit:20.11.2000, Flet.Zyrtare nr.38, faqe:1836

⁵⁰⁷ Konventa e Nju Jork-ut (1958), neni 1(1).

"vendimit të huaj" e kanë dy grupe vendimesh arbitrazhi: (i) vendimet e forumeve të arbitrazhit që janë marrë në territorin e një shteti të ndryshëm prej atij ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi i vendimeve dhe (ii) vendimet e arbitrazhit që nuk konsiderohen si "vendime të brendshme" në shtetin ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi. Bashkë me kriterin e parë territorial, me insistimin e disa vendeve të Civil Law, në momentin e draftimit të saj (në vitin 1958), Konventa shtoi parashikimin e aplikimit të efekteve të saj edhe për vendimet jo të brendshme, apo jo-lokale (*non-domestic*). Sipas të ashtuquajturit "interpretim tradicional", i cili bazohet në historinë legislative (*travaux préparatoires*) dhe tekstin e Konventës, vendimet jo të brendshme të arbitrazhit janë vendimet të cilët janë dhënë në shtetin zbatues, por që, me marrëveshje të palëve në konflikt, rregullohen nga ligji i arbitrazhit të një shteti tjetër⁵⁰⁸. Në këtë mënyrë Konventa e zhvleftëson rëndësinë e "shtetësisë" së vendimit arbitral dhe atë të palëve⁵⁰⁹. Kjo sepse këto vendime arbitrazhi do të njihen dhe zbatohen pavarësisht vendit (shtetit) se ku është marrë vendimi konkret dhe pavarësisht shtetësisë së palëve në mosmarrëveshjen që zgjidh ky vendim.

Ndër interpretimet më tipike të çështjes së sferës së veprimit të dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut është arsyetimi i Gjykatës së Apelit të SHBA, në çështjen *Sigval Bergesen kundër Joseph Muller Corp.*⁵¹⁰ (e trajtuar në kapitullin pararendës), ku identifikohet si kriter prioritar *performanca e kontratës* midis palëve, pavarësisht *shtetësisë së palëve, vendit të procedurës së arbitrazhit dhe ligjit procedural* të aplikueshëm, të cilët, sipas Gjykatës, nuk janë mjaftueshmërisht relevantë si kriteret për të përkufizuar një vendim arbitrazhi si *të brendshëm*. E rëndësishme në këtë pikë është të theksojmë rëndësinë që marrin legjislacionet nacionale të vendeve anëtare të Konventës, në përcaktimin e kriterëve që definojnë një vendim arbitrazhi si "vendim të huaj", apo si vendim "jo të brendshëm", në kuptim të objektit të veprimit të dispozitave të Konventës.

(b) Njohja e marrëveshjes së arbitrazhit ndërkombëtar, të lidhur midis palëve - *Secila nga shtetet kontraktuese do ta njohë marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës, palët marrin përsipër t'ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të*

⁵⁰⁸ Albert Jan van den Berg; "Konventa e Arbitrazhit të Nju Jork-ut e 1958", bot.Kluwer Law and Taxation, 1981, f.23.

⁵⁰⁹ Komente të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për draft-konventën, dokument zyrtar i Këshillit Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara, sesioni 21, nr.E/2822, Add.4, 3 prill 1956, f.3, par.2, siguruar on line në: http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/arbitration/NYConvention.html

⁵¹⁰ Shiko çështjen *Bergesen kundër Joseph Muller Corp.* (710 F.2^d 928, 2^d Cir.1983). Shiko *supra* nënseksionin IV.4.3-Sfera e aplikimit të Konventës së Nju Jork-ut, në praktikën gjyqësore.

*lindin ndërmjet tyre lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jokontraktore, që ka lidhje me një çështje, e cila mund të rregullohet me anë arbitrazhi*⁵¹¹.

Vetë dispozitat e Konventës e përkufizojnë marrëveshjen e arbitrazhit si një “*marrëveshje të shkruar*”, e cila përfshihet në një klauzolë arbitrazhi në një kontratë, ose në një marrëveshje arbitrazhi të nënshkruar nga palët, ose që përmbahet në një shkëmbim letrash ose telegramesh⁵¹². Një përkufizim i tillë tenton të theksojë rëndësinë e vullnetit të përbashkët të palëve, për t’i nënshtruar arbitrazhit qoftë një mosmarrëveshje ekzistuese midis tyre (në këtë rast, marrëveshja e arbitrazhit merr trajtën e një marrëveshje të veçantë ose, siç quhet ndryshe, “*kompromis*”), sikundër dhe një mosmarrëveshje të ardhme, pra që ende s’ka lindur (marrëveshja e arbitrazhit merr trajtën e një “*klauzole kompromisi*”)⁵¹³. Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL) rekomandon që dispozita e mësipërme e Konventës së Nju Jork-ut të zbatohet duke patur parasysh që rrethanat apo kushtet që përshkruhen në të, nuk janë shteruese⁵¹⁴. Kjo presupozon faktin që si “formë e shkruar” e vlefshme (me të cilën mund të paraqitet marrëveshja e arbitrazhit) duhet të pranohet përveç sa parashikon tekstualisht dispozita e mësipërme e Konventës edhe çdo formë tjetër, që mund të faktohet me shkrim.

(c) Përjashtimi i juridiksionit të gjykatës kombëtare - *Gjykata e njërit shtet kontraktues*⁵¹⁵, kur është e angazhuar në një padi për një çështje për të cilën palët kanë bërë një marrëveshje sipas kuptimit të këtij neni⁵¹⁶, me kërkesën e një prej palëve ia referon palët arbitrazhit, përveç rasteve kur ajo gjen se marrëveshja në fjalë është nul dhe e pavlefshme, jooperative ose e pamundur për t’u zbatuar⁵¹⁷.

Parashikimi i kësaj klauzole të rëndësishme në fakt nuk bën gjë tjetër, veçse garanton vlerën juridike që ka shprehja e vullnetit të palëve për t’iu drejtuar arbitrazhit⁵¹⁸. Ky vullnet përjashton juridiksionin e një gjykate shtetërore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis palëve, duke e detyruar gjykatën të adresojë këtë mosmarrëveshje në forumin e zgjedhur të

⁵¹¹ Konventa e Nju Jork-ut (1958), neni 2(1).

⁵¹² *Id.*, neni 2(2).

⁵¹³ Shënim shpjegues, nga Sekretariati i UNCITRAL, mbi Ligjin Model për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, f.28, par.19.

⁵¹⁴ Rekomandime në lidhje me interpretimin e nenit 2/2 dhe nenit 7/1 të Konventës së Nju Jorkut, miratuar nga UNCITRAL, më 7 korrik 2006, në sesionin e tij të 39-të (rekomandimi nr.1).

⁵¹⁵ Termi *shtet kontraktues* i referohet çdo shteti që ka pranuar Konventën, duke e nënshkruar, apo e ka miratuar më vonë, nëpërmjet ratifikimit/aderimit.

⁵¹⁶ *Marrëveshje sipas kuptimit të këtij neni* i referohet *marrëveshjes së arbitrazhit*.

⁵¹⁷ Konventa e Nju Jork-ut (1958), neni 2(3).

⁵¹⁸ Shiko *supra* nënseksionin II.3.2. *Teoria Kontraktuale*: “Qëllimi i shprehur i të dy palëve për të hyrë në marrëveshjen e arbitrazhit është ekzistenca thelbësore e këtij procesi”.

arbitrazhit. Marrëveshja e arbitrazhit bëhet, kështu, premisë për përjashtimin e juridiksionit të gjykatës shtetërore, me përjashtim të rastit kur ajo ka mangësi apo parregullsi, që e bëjnë atë të paafte për t'u zbatuar. Një premisë e tillë është pranuar sot gjërësisht nga gjykatat shtetërore, të cilat luajnë një rol të madh në bërjen efektive të autonomisë së vullnetit të palëve, duke i kërkuar këtyre të fundit të referojnë mosmarrëveshjet në arbitrazh, kur midis tyre kanë një marrëveshje të vlefshme arbitrazhi. Atje ku ka një marrëveshje të vlefshme arbitrazhi dhe njëra nga palët i drejtohet gjykatës nacionale me kërkesë-padi, nëse pala tjetër invokon marrëveshjen e arbitrazhit në gjykatë, atehere gjykata nuk duhet të ndërmarrë asnjë veprim kur objekti i kërkesës është objekt i marrëveshjes së arbitrazhit⁵¹⁹. Në këtë mënyrë garantohet autonomia e forumit për të gjykuar konfliktin, duke limituar ndërhyrjen gjyqësore në zgjedhjen e palëve⁵²⁰.

(d) Mosaplikimi i procedurave diferencuese në zbatimin efektiv të vendimeve - *Secili shtet kontraktues do të njohë vendimet e arbitrazhit si vendime, që i lidhin ato dhe do t'i zbatojë ato në përputhje me rregullat e procedurës të së drejtës së brendshme të territorit (shtetit) ku zbatohet vendimi, sipas kushteve të përcaktuara në nenet vijuese (të Konventës). Nuk do të imponohen në thelb me shumë kushte pagese ose shpenzime e pagesa më të larta për njohjen ose zbatimin e vendimeve të arbitrazhit, për të cilat zbatohet kjo Konventë nga ato që imponohen për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit në vendin e tij (vendime të arbitrazhit të brendshëm)*⁵²¹. Pra, një shtet që e ka miratuar Konventën duhet t'i trajtojë njëllor dhe të mos diferencojë, përsa i përket burokracisë procedurale të njohjes dhe zbatimit, vendimet e arbitrazhit të brendshëm ndaj atij të huaj⁵²².

Nga një vlerësim i përgjithshëm i realitetit shqiptar (kuadrit ligjor dhe praktikës gjyqësore), në lidhje me plotësimin e detyrimeve të mësipërme, për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj, arrijmë në konkluzionin se situata e implementimit të Konventës për Republikën e Shqipërisë paraqitet, të paktën formalisht, konform standarteve që plotësojnë edhe vendet e tjera anëtare të saj. Një perceptim i tillë, mbi efektivitetin që kanë instrumentat juridike në Shqipëri për zbatimin e Konventës së Nju Jork-ut, rezulton edhe prej përgjigjeve

⁵¹⁹ Shiko *supra* nënseksionin II.4.1. "Gjykata nacionale dhe zbatueshmëria e marrëveshjes së Arbitrazhit", për shprehjen e gjykatës në çështjen "Fulgensius Mungereza kundër Pricewatercoopers Africa Central" (Gjykata e Apelit Kampala, Uganda, Nr.34, 2001) dhe në çështjen "Boart Sweden AB kundër NYA Stromnes AB" (1988), B.L.R 295 (Ont. H.C).

⁵²⁰ *Id.*, për çështjet: "Mitsubishi kundër Solar Chrysler Plymouth Inc." (473 U.S 614, 1985) dhe "Gulfstream Aerospace Corp kundër Mayacamas Corp." (485 U.S. 271, 1988).

⁵²¹ Konventa e Nju Jork-ut (1958), neni 3.

⁵²² Një parashikim i tillë përfshihej edhe në nenin 1 të Konventës së Gjenevës, të 26 shtatorit 1927.

të “pyetësorit” të UNCITRAL për monitorimin e Konventës⁵²³, të cilit i është përgjigjur edhe Shqipëria⁵²⁴.

Kështu, sikurse përmendëm më sipër, teksti i konventës është miratuar nga Parlamenti Shqiptar, duke fituar forcën e ligjit brenda sistemit të brendshëm të së drejtes⁵²⁵. Bazuar në regjistrimin e bërë nga seksioni i traktateve të Kombeve të Bashkuara⁵²⁶ në listën e traktateve shumëpalëshe, instrumenti i aderimit (ligji) është regjistruar i dorëzuar më datë 27 qershor 2001, ndërsa data e hyrjes në fuqi të Konventës së Nju Jork-ut për Shqipërinë, po sipas këtij regjistrimi, është 25 shtatori 2001⁵²⁷. Republika e Shqipërisë, në momentin e miratimit dhe dorëzimit të instrumentit të aderimit, nuk ka paraqitur zyrtarisht asnjë prej dy rezervave për zbatimin e dispozitave të konventës⁵²⁸, qoftë "rezervën e reciprocitetit" ashtu edhe "rezervën tregtare".

Legjislacioni implementues (ligji nr.8688, datë 9.11.2000) referon në Konventë dhe nuk e përfshin atë. E vetmja dispozitë e ligjit është parashikimi që *"Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit"*⁵²⁹. Teksti i plotë i Konventës së Nju Jork-ut përfshihet si shtojcë e tekstit të këtij ligji implementues, i cili qëndron veçantë. Për rrjedhojë, duke mos qenë pjesë e një teksti më të madh, interpretimi i dispozitave të Konventës duhet të bëhet më vete dhe të mos ndikohet, gjatë zbatimit praktik, nga kuptimi apo interpretimi i dispozitave të tjera. Gjithashtu, nuk krijohet përplasje midis legjislacionit zbatues dhe Konventës, pasi, sikurse u tha më sipër, Konventa është referuar nga ligji, pra në kuptimin e teknikës legjislative ajo qëndron si shtojcë e ligjit dhe nuk është pjesë e dispozitave të tij.

Kërkesat procedurale, ose kushtet për zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit janë përcaktuar në vetë dispozitat e Konventës, ku referon legjislacioni implementues. Nuk ka procedura specifike të vendosura me vendime të gjykatave Shqiptare, pasi në Shqipëri nuk vepron *case law*. Autoriteti kompetent për të vendosur mbi një kërkesë për zbatimin e një

⁵²³ Monitorimi i implementimit të Konventës u realizua nëpërmjet një pyetësori ndërkombëtar të përbërë nga 26 pyetje gjithsej. Pyetësori është botuar nga UNCITRAL, më datë 31 gusht 2010.

website - http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/arbitration/NYConvention_implementation.html

⁵²⁴ Përgjigja e Shqipërisë është dhënë më datë 16.01.2008:

website - <http://www.uncitral.org/pdf/english/texts/arbitration/NY-conv/NYCCompilation31August2010.xls>

⁵²⁵ Ligji nr.8688, datë 9.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", botuar në fletoren zyrtare nr.38, viti 2000, faqe 1836, me datë botimi 01.12.2000. Teksti i këtij ligji përbëhet nga 2 nene dhe 1 shtojcë.

⁵²⁶ website - http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/arbitration/NYConvention.html

⁵²⁷ Hyrja në fuqi e Konventës, në zbatim të nenit 12, pika 2 të saj, bëhet ditën e 90-të pas datës së depozitimit nga shteti të instrumentit të ratifikimit ose të aderimit.

⁵²⁸ Në kuptim të nenit 1, paragrafi 3 të Konventës.

⁵²⁹ Ligji nr.8688, datë 9.11.2000, neni 1.

vendimi të huaj arbitrazhi, nuk është një gjykatë e vetme apo autoritet i vetëm në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, por është një nivel i caktuar i sistemit gjyqësor. Gjykata kompetente për të vendosur mbi një kërkesë për njohje është Gjykata e Apelit, shkalla e dytë e sistemit gjyqësor. Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile parashikojnë, se përcaktimi i gjykatës kompetente, për të vendosur mbi një kërkesë për ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi, bëhet në bazë të parimit "*ratione loci*". Ky parim presupozon se juridiksioni i gjykatës së apelit përcaktohet sipas vendit (territorit të rrethit gjyqësor) ku kërkohet të zbatohet, apo t'i jepet efekt vendimit të arbitrazhit të huaj.

Ka dispozita legislative (dispozita të Kodit të Procedurës Civile⁵³⁰), që përcaktojnë në hollësi procedurat e zbatueshme për ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi të huaj. Kërkuesi duhet të paraqesë bashkëngjitur kërkesës, një kopje të vendimit dhe përkthimin e tij në gjuhën shqipe (të vërtetuar nga një noter), një vërtetim nga autoriteti lëshues se vendimi i arbitrazhit është i formës së prerë (i përkthyer dhe i legalizuar nga noteri), si dhe një prokurë nëse aplikanti është i përfaqësuar në procedurë nga një avokat⁵³¹. Kërkuesi duhet të paguajë një tarifë për veprimet dhe shërbimet e kryera nga administrata gjyqësore, e përcaktuar nga një akt nënligjor⁵³². Kjo tarifë është e zbatueshme, pavarësisht nga suksesi i aplikimit, pasi është një taksë për shërbimin e kryer. Aplikuesi mund të "kurojë" (korrigjojë) difektet në dokumentat e paraqitura për të kërkuar zbatimin e një vendimi arbitrazhi të huaj, gjatë kohës së aplikimit, sipas rregullave procedurale në fuqi në Republikën e Shqipërisë (K.Pr.C). Sipas këtyre rregullave, nuk është parashikuar një periudhë kohore limit për të aplikuar për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj.

Parashikohen procedura për ngritjen e kundërshtimeve ndaj veprimit të njohjes. Pala e interesuar, kundër të cilës drejtohet zbatimi i vendimit, mund të ngrejë kundërshtime bazuar mbi përcaktimet e listuara në dispozitat e Konventës, me qëllim për të parandaluar njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit të huaj⁵³³.

Për ankimin kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, që i ka dhënë ose jo fuqi një vendimi arbitrazhi të huaj, Kodi i Procedurës nuk parashikon ndonjë dispozitë të posaçme. Pra, në

⁵³⁰ Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 dhe i ndryshuar - Pjesa e dytë "Gjykimi në shkallë të parë"; titulli III "Gjykimet e posaçme"; kreu IX "Njohja e vendimeve të shteteve të huaja", nenet 393 – 399.

⁵³¹ *Id.* neni 396

⁵³² Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë nr.13, datë 12.2.2009 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", ndryshuar me udhëzimin nr.991/3, datë 02.03.2010.

⁵³³ K.Pr.C, neni 394, pika (a) deri (dh).

ketë rast, do të vlejë dispozitat e përgjithshme të Kodit të Procedurës Civile, që parashikojnë ankimin me recurs kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit në Gjykatën e Lartë⁵³⁴. Këto dispozita i njohin palës së interesuar të drejtën të paraqesë një recurs në Gjykatën e Lartë kundër refuzimit për të zbatuar një vendim të Konventës së Nju Jork-ut, pra kundër vendimit të Gjykatës Apelit, që ka refuzuar të zbatojë apo që nuk ka njohur një vendim arbitrazhi të huaj. Gjithashtu, pala e interesuar ka të drejtë të paraqesë një recurs edhe kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, që ka disponuar për njohjen dhe i ka dhënë fuqi një vendimi arbitrazhi të huaj. Duhet theksuar se ankimi (recursi) në Gjykatën e Lartë nuk e pezullon automatikisht ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit të huaj, të njohur nga Gjykata e Apelit. Një pezullim i tillë, deri në shqyrtimin e çështjes, mund të bëhet nga Gjykata e Lartë vetëm nëse pala, që ka paraqitur recurs, paraqet prova bindëse për pasojat e pariparueshme që mund të sillte ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit, si dhe paraqet garanci materiale për ekzekutimin e tij⁵³⁵. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nëse konstaton se ka bazë ligjore për të justifikuar pretendimet e palës paraqitëse të recursit, e dëgjon rastin dhe vendos për këtë çështje. Në qoftë se gjykata nuk ka gjetur bazë ligjore për dëgjimin e rastit, ajo e hedh poshtë recursin, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit.

Përmendim këtu psh. çështjen “I.C.M.A” srl. në likuidim dhe “AGRI.BEN” sas. kundër Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të R.Sh.”, ku pala paditëse gjyqfituese (“I.C.M.A” srl. në likuidim dhe “AGRI.BEN” sas.), në cilësinë e kërkuarit, i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesë për njohjen dhe dhënien fuqi të Vendimit, të datës 22.12.2005, të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC). Gjykata e Apelit, me vendimin nr.82, datë 07.09.2007, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj”. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, në bazë të nenit 472 të K.Pr.C, ka ushtruar recurs pala paditëse, duke kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe pranimin e kërkesës për njohje. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në përfundim të gjykimit, kanë vendosur “Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues”⁵³⁶.

⁵³⁴ Neni 472 e vijues të K.P.Civile: *Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit,mund të ankimohen me recurs në Gjykatën e Lartë vetëm kur: nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji; ka shkelje të rënda të normave procedurale (sipas nenit 467 të K.P.Civile); për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.*

⁵³⁵ Neni 479 i K.Pr.C: *Gjykata e Lartë pezullon ekzekutimin e vendimit kur: a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; b) pala që ka bërë recursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin e vendimit.*

⁵³⁶ Shiko Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.6, datë 01.06.2011 “Njohja e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC), të datës 22.12.2005 që i përket çështjes nr.12112/ACS, të dhënë nga arbitri i vetëm me qendër në Gjenevë, prof.Dr. Claudie B.Rouillier, për “I.C.M.A” srl. në likuidim” dhe “AGRI.BEN” sas kundër Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të R.Shqipërisë”; Flet.Zyrtare nr.171, datë 29 tetor 2013.

Ky përshkrim i shkurtër i situatës së implementimit të Konventës së Nju Jork-ut, në Republikën e Shqipërisë, i korrespondon perceptimit të faktorit ndërkombëtar, në lidhje me plotësimin nga shteti ynë të angazhimit të marrë përsipër, si rezultat i aderimit në Konventë⁵³⁷. Sipas këtij perceptimi, rezulton se, në aspektin formal të parashikimit ligjor, në Shqipëri zbatohet angazhimi për të njohur vendimet e arbitrazhit të huaj.

Gjithashtu, praktika gjyqësore është pozicionuar tashmë në njohjen e marrëveshjeve dhe vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar, diktuar nga parashikimi dhe fryma e Konventës së Nju Jork-ut. Përmendim këtu argumentimin e Gjykatës së Tiranës, në vendimin e dhënë për çështjen “Shoqëria “Marko Tel & Hes Kablo Albania” shoqëri e thjeshtë kundër “ZTE Albania” shpk”⁵³⁸, ku ajo shprehet se: “.....kjo klauzolë (arbitrazhi) është në përputhje me përcaktimin e Konventës “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”, New York me datë 10.06.1958, në nenin 2⁵³⁹ të saj.... Në rastin objekt shyrtimi gjyqësor, klauzola e përcaktuar në nenin 44, të amenduar të kontratës së sipërmarrjes Nr.371 Rep., 207 Kol., datë 16.01.2008⁵⁴⁰ është e vlefshme, sepse referimi i zgjidhjes së çështjes në arbitrazhin ndërkombëtar është pranuar nga palët, të cilat kanë firmosur kontratën përkatëse. Nga përmbajtja e nenit 2 të Konventës “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”, New York (1958), rezulton se palët në një marrëdhënie juridike kontraktore janë të lira që të zgjedhin që çështja e tyre të shyrtohet nga një arbitrazh ndërkombëtar. Në rastin në gjykim palët kanë zgjedhur që mosmarrëveshjet e tyre të gjykohen në një procedurë arbitrazhi ndërkombëtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Londrës. Palët kanë përcaktuar edhe vendin e zhvillimit të arbitrazhit, që do të jetë Anglia dhe që ligji i aplikueshëm është ligji i Anglisë, ligj ky i cili zbatohet në vendin e zhvillimit të

⁵³⁷ Bazuar në përgjigjet e pyetësorit të implementimit të Konventës, të botuar nga UNCITRAL më datë 31 gusht 2010.

⁵³⁸ Çështja civile nr.11243-01441-2013, me palë: paditës - Shoqëria “Marko Tel & Hes Kablo Albania” shoqëri e thjeshtë”; i paditur - Shoqëria “ZTE Albania” shpk; person i tretë: “Albtelekom” sha; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.1460, datë 18.02.2013.

⁵³⁹ Konventa e Nju Jork-ut, neni 2(1): *Secila nga shtetet kontraktuese do ta njohë marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër t’ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jokontraktore, që ka lidhje me një çështje, e cila mund të rregullohet me anë arbitrazhi.*

⁵⁴⁰ Ndërmjet Shoqërisë “Marko Tel & Hes Kablo Albania” shoqëri e thjeshtë dhe personit të tretë shoqëria “Albtelekom” sha. është lidhur kontratën e sipërmarrjes Nr.371 Rep., 207 Kol., datë 16.01.2008 me objekt realizimin e punimeve për rrjetin kabllor të shoqërisë “Albtelecom” Shqipëri. Me amendamentin nr.2, datë 18.04.2011 bërë kontratës Nr.371 Rep., 207 Kol., datë 16.01.2008 është përfshirë si palë edhe i padituri shoqëria “Z.T.E Albania” shpk, si dhe është ndryshuar neni 44 “Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve” në të cilin është parashikuar se: “Kjo kontratë Sipërmarrje do udhëhiqet nga ligjet e Anglisë dhe Wellsit, duke përjashtuar konfliktin ndërmjet ligjeve të aplikueshme. Çdo ndryshim ose mosmarrëveshje që do mund të lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë Sipërmarrje do të zgjidhet me marrëveshje miqësore nga ana e palëve. Në rast se këto mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen brenda dyzet e pesë ditëve pas dërgimit të njoftimit me shkrim nga njëra palë, e cila kërkon zgjidhjen, secila palë mundet që ta paraqesë mosmarrëveshjen në arbitrazhin e Gjykatës së Londrës për Rregulloren Ndërkombëtare të Arbitrazhit. Vendi i arbitrazhit është Anglia”.

Arbitrazhit. Në këtë kontekst gjykata çmon se klauzola e arbitrazhit e përcaktuar nga palët ndërgjyqëse është e vlefshme... ”.

Për t’iu kthyer përsëri analizës së Konventës së Nju Jork-ut si pjesë e të drejtës së brendshme Shqiptare, nuk duhet lënë pa përmendur fakti se, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë⁵⁴¹, dispozitat e Konventës, pas ratifikimit me ligj janë bërë pjesë e sistemit të brendshëm juridik të vendit tonë. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to. Pra dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut prevalojnë, në rast konflikti, edhe mbi dispozitat e Kodit të Procedurës Civile⁵⁴², përsa i përket rregullimeve ligjore që aplikohen për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj. Në të njëjtën mënyrë, në çështjen “Shoqëria “Marko Tel & Hes Kablo Albania” shoqëri e thjeshtë kundër “ZTE Albania” shpk”⁵⁴³, Gjykata e Tiranës është shprehur se: *“Referimi i çështjes në një arbitrazh ndërkombëtar nuk vjen në kundërshtim me nenin 37/2 të K.Pr.Civile⁵⁴⁴, për sa kohë që Konventa “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”, New York më datë 10.06.1958, përbën burim legjislativ të detyrueshëm për zbatim në Republikën e Shqipërisë, pas aderimit në të me ligjin Nr.8688, datë 09.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”.*

Pavarësisht panoramës së përgjithshme, të përcjellë më sipër, nëse do të analizohen me kujdes kuadri ligjor i brendshëm dhe veçanërisht praktika gjyqësore në këtë fushë, do të konstatohet se eksperiencia mbi 10 vjeçare e bashkëjetesës së juridiksionit Shqiptar me Konventën e Nju Jork-ut paraqitet problematike dhe e pakonsoliduar.

VI.2. Instrumentat proceduriale të njohjes dhe ekzekutimit të një vendimi arbitrazhi të huaj.

Mjeti i dytë ligjor, që rregullon njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj, janë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (K.Pr.C)⁵⁴⁵. Në Shqipëri duket qartë se ka pasur tendencë për ta

⁵⁴¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116, pika 1 dhe neni 122, pika 2.

⁵⁴² Alban Abaz Brati, “Procedura Civile” (bot.I), Tiranë 2008 (Dudaj), f.433, par.2.

⁵⁴³ Çështja civile nr.11243-01441-2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.1460, datë 18.02.2013.

⁵⁴⁴ K.Pr.C, neni 37(2): *Juridiksioni i gjykatave shqiptare nuk mund t’i kalohet me marrëveshje një juridiksioni të huaj, përveç kur gjykimi ka lidhje me një detyrim ndërmjet të huajve ose ndërmjet një të huaji e një shtetasi shqiptar, ose personi juridik pa banim ose qëndrim në Shqipëri, si dhe kur këto përjashtime janë parashikuar në marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.*

⁵⁴⁵ Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.03.1996 dhe ndryshuar me ligjin nr.8431, datë 14.12.1998; ligjin nr.8491, datë 27.05.1999; ligjin nr.8335, datë 18.10.1999; ligjin nr.8812, datë 17.05.2001; ligjin nr.9953, datë 14.07.2008; ligjin nr.10052, datë 29.12.2008; ligjin

rregulluar arbitrazhin ndërkombëtar me anë të një ligji të veçantë, të ndryshëm nga dispozitat e K.Pr.C mbi arbitrazhin. Aktualisht, pas amendimeve të vitit 2001, Kreu i VI i titullit të IV të K.Pr.C, i titulluar *Arbitrazhi Ndërkombëtar*, përmban vetëm një dispozitë (nenin 439), e cila përcakton se “*Arbitrazhi ndërkombëtar rregullohet me ligj të veçantë*”. Para këtyre ndryshimeve, kjo dispozitë rregullonte formimin e gjykatës së arbitrazhit ndërkombëtar, duke dhënë përkufizimin që *arbitrazhi ndërkombëtar është arbitrazhi që lidhet me interesat e tregtisë ndërkombëtare*⁵⁴⁶. Dispozitat vijuese mbi përcaktimin e procedurës dhe ligjin e zbatueshëm në arbitrazhin ndërkombëtar janë shfuqizuar⁵⁴⁷.

Aktualisht, synimi për të rregulluar arbitrazhin ndërkombëtar, në mënyre të veçantë, ka mbetur në tentativë pasi asnjë ligj i veçantë për këtë qëllim nuk është miratuar. Ndonëse ky detyrim nuk është plotësuar, efekti i kësaj dispozite është se e nxjerr arbitrazhin ndërkombëtar jashtë ndikimit të rregullimeve të neneve 400-438 të KPrC. Megjithatë, një nga dallimet që ekziston aktualisht midis arbitrazhit të *brendshëm* dhe atij të *huaj* ka të bëjë me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit. Njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit të brendshëm bëhet sipas neneve 432-438 të K.Pr.C ndërsa për vendimet e arbitrazhit të huaj zbatohen nenet 393-399 të K.Pr.C.

Specifikisht në këtë kapitull, në funksion të plotësimit të misionit të punimit, do t'i referohemi dhe analizojmë grup-nenet 393-399, që rregullojnë njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj në Republikën e Shqipërisë. Këto dispozita e trajtojnë njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj si një nga *gjkimet e posaçme në shkallë të parë*, të rregulluara nga Kodi i Procedurës Civile. Vendimet e gjykatave të shteteve të huaja dhe vendimet përfundimtare të një arbitrazhi të huaj njihen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë sipas të njëjtave rregulla⁵⁴⁸, sipas kushteve të parashikuara në Kod, ose në ligje të veçanta. Kur për këtë qëllim

Nr.122/2013 - Pjesa e dytë “Gjykimi në shkallë të parë”; titulli III “Gjykimet e posaçme”; kreu IX “Njohja e vendimeve të shteteve të huaja”, nenet 393 – 399.

⁵⁴⁶ Neni 439 “Formimi i gjykatës së arbitrazhit ndërkombëtar”, i K.Pr.C, në versionin e tij fillestar, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, ka patur këtë formë: *Në gjykimin e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, marrëveshja e arbitrazhit duhet të caktojë arbitrin ose arbitrat ose të parashikojë mënyrat e caktimit të tyre, qoftë edhe duke i'u referuar një rregulloreje arbitrazhi. Është ndërkombëtar arbitrazhi që lidhet me interesat e tregtisë ndërkombëtare. Për gjykimet e arbitrazhit që zhvillohen në Republikën e Shqipërisë, kur palët në marrëveshje kanë parashikuar zbatimin e ligjit procedural shqiptar për formimin e gjykatës së arbitrazhit dhe haset vështirësi në formimin e saj, pala e interesuar mund t'i drejtohet gjykatës së rrethit të Tiranës, përveç kur ato janë marrë vesh ndryshe.*

⁵⁴⁷ Kreu VI i K.Pr.C, “Arbitrazhi ndërkombëtar”, në versionin e tij fillestar, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.03.1996, ka patur në përmbajtjen e tij tre nene: Neni 439 “Formimi i gjykatës së arbitrazhit ndërkombëtar” është ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.05.2001, neni 67, duke marrë këtë formë: *Arbitrazhi ndërkombëtar rregullohet me ligj të veçantë*; Neni 440 “Përcaktimi i procedurës së arbitrazhit” është shfuqizuar me ligjin nr.8812, datë 17.05.2001, neni 68; Neni 441 “Ligji i zbatueshëm” është shfuqizuar me ligjin nr.8812, datë 17.05.2001, neni 68.

⁵⁴⁸ K.Pr.C, neni 399.

ka marrëveshje të posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj zbatohen dispozitat e marrëveshjes⁵⁴⁹.

Republika e Shqipërisë e merr në konsideratë efektin e vendimeve përfundimtare të huaja⁵⁵⁰ (gjyqësore apo të arbitrazhit), por këto vendime që të ekzekutohen në territorin e shtetit Shqiptar duhet të njihen, duke i'u dhënë atyre fuqi zbatuese. Zbatueshmëria e vendimeve të huaja i nënshtrohet procesit të njohjes nga autoritetet gjyqësore Shqiptare. Njohja, në një shtet, e vendimeve dhe veprimeve juridiksionale të një sovraniteti të huaj, nuk shpreh gjë tjetër veçse njohjen reciproke të vlerave juridike nga ana e vendeve shtetërore të veçanta⁵⁵¹. Nëse një njohje e tillë nuk do të ekzistonte, por do të mohohej vlera e gjykimeve të huaja (njëlloj sikur të mos ishin dhënë fare), atëherë do të ishte diçka e ngjashme me sistemin gjyqësor që ishte në fuqi në Angli deri në vitin 1933, sipas të cilit, vendimet e huaja formonin vetëm një bazë konkrete për të ndërtuar një vendim të ri gjyqësor. Një vendim i huaj (i një gjykate shtetërore apo arbitrazhi) njihet dhe bëhet i ekzekutueshëm në rendin juridik Shqiptar, duke i'u nënshtuar paraprakisht një lloj "gjykimi njohjeje"⁵⁵².

Mjeti procedural civil për të kërkuar njohjen dhe zbatimin e vendimit të arbitrazhit të huaj, në Republikën e Shqipërisë, është kërkesa për njohje apo padia e njohjes (padi vërtetimi apo deklarative), e parashikuar nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile⁵⁵³. Sipas këtyre dispozitave "*Padia mund të ngrihet.....për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin*". Si e tillë, kërkesa për njohjen e një vendimi arbitrazhi të huaj nuk parashkruhet, referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile⁵⁵⁴. E pa-parashkueshme është gjithashtu edhe kërkesa për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit, që ka njohur vendimin e arbitrazhit të huaj⁵⁵⁵. Nëpërmjet kësaj padie nuk pretendohet drejtpërdrejt përmbushja e një detyrimi nga pala tjetër (pala humbëse në vendimin e arbitrazhit), sikurse ndodh në paditë e rivendikimit, paditë e detyrimit kontraktor apo të shkaktimit të dëmit. Në fakt, kërkesa formale e njohjes paraqet vetëm *palën kërkuese* dhe nuk ka *palë të paditur*. Në të gjitha çështjet gjyqësore, të trajtuara në këtë punim, pala tjetër, kundër të cilës kërkohet njohja dhe zbatimi i vendimit të arbitrazhit të

⁵⁴⁹ *Id.*, neni 393.

⁵⁵⁰ Përgjigja e Shqipërisë dhënë Pyetësorit të UNCITRAL më datë 16.01.2008 (botuar nga UNCITRAL, më datë 31 gusht 2010).

⁵⁵¹ Ardian Kalia, "E drejta Ndërkombëtare Private", 2010, f.380.

⁵⁵² *Id.*, f.378.

⁵⁵³ *Id.*, neni 32, paragrafi "c".

⁵⁵⁴ *Id.*, neni 113 "Paditë që nuk parashkruhen", paragrafi "b": *Nuk parashkruhen: b) paditë e njohjes;*

⁵⁵⁵ *Id.*, neni 113: *..... Nuk parashkruhen edhe kërkesat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve që janë të lidhura me padi, për të cilat nuk zbatohet parashkrimi.*

huaj, është konsideruar si *Palë* apo *Person i Interesuar*. Nëpërmjet kësaj padie njohjeje kërkohet vetëm të njihet fuqia apo efektet juridike të vendimit të arbitrazhit të huaj, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Duke u njohur si detyrues nga autoritetet gjyqësore Shqiptare, një vendim arbitrazhi i huaj barazohet për nga efektet dhe fuqia me një vendim gjyqësor Shqiptar, ose mund të themi se ai transformohet në një vendim gjyqësor Shqiptar⁵⁵⁶. Ligjvënësi Shqiptar ia ka besuar këtë proces Gjykatës së Apelit, duke u mbështetur në parimet bazë të së Drejtës Procedurale Civile, sepse është pikërisht kjo Gjykatë e cila ka autoritetin procedural të gjykojë mbi vendimet e dhëna nga një gjykatë tjetër. Është pikërisht vendimi i Gjykatës së Apelit ai që mundëson, në mënyrë ekskluzive, ekzekutimin e një vendimi të huaj arbitrazhi në territorin e Republikës së Shqipërisë⁵⁵⁷. Në këtë formë, vendimi i arbitrazhit i njohur nga Gjykata e Apelit, fiton autoritetin ligjor të titullit ekzekutiv dhe, në mungesë të zbatimit vullnetar prej palës së detyruar, mund të zbatohet forcërisht nëpërmjet lëshimit të një urdhëri ekzekutimi, me ndërhyrjen e organeve përmbaruese të shtetit Shqiptar.

Të njëjtin qëndrim, për sa i përket autoritetit ekskluziv të gjykatës shqiptare për të akorduar njohjen dhe për t'i dhënë fuqi një vendimi arbitrazhi të huaj, mban edhe kuadri ligjor i brendshëm që rregullon të drejtën ndërkombëtare në Shqipëri. Ky i fundit e parashikon si *juridiksion ekskluziv*, juridiksionin e gjykatave shqiptare për gjykimin e çështjeve, të cilat lidhen me ekzekutimin në Republikën e Shqipërisë të titujve ekzekutivë⁵⁵⁸, ku bëjnë pjesë edhe vendimet e arbitrazhit të huaj⁵⁵⁹.

Nga interpretimi i dispozitave të K.Pr.C dhe analiza e rasteve të praktikës gjyqësore, arrihet në përfundimin se ekzekutimi forcërisht i një vendimi arbitrazhi të huaj në RSh bëhet në dy faza. *Faza e parë* përfshin paraqitjen e kërkesës për njohje dhe, në përfundim të procedimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit, njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj në RSh. *Faza e dytë* i përket një tjetër procedimi gjyqësor, që zhvillohet po nga Gjykata e Apelit, e cila ka akorduar njohjen, me objekt shqyrtimin e kërkesës për të lëshuar kjo gjykatë Urdhërin e Ekzekutimit⁵⁶⁰. Është pikërisht ky i fundit i cili mundëson ndërhyrjen e organeve përmbarimore në RSh, për të ekzekutuar përmbarajtjen (detyrimin konkret) e sanksionuar në vendimin e arbitrazhit të huaj, të njohur tashmë në RSh. Për të analizuar këtë moment

⁵⁵⁶ Alban Abaz Brati, "Procedura Civile", botimi i parë, (bot.Dudaj) 2008, f.413, par.3.

⁵⁵⁷ Ardian Kalia, "E drejta Ndërkombëtare Private", 2010, f.380.

⁵⁵⁸ Ligji nr.10428, datë 02.06.2011 "Për të drejtën ndërkombëtare private", neni 72, pika "dh".

⁵⁵⁹ Shiko K.Pr.C, neni 510: "... Janë tituj ekzekutivë:.....c)vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi".

⁵⁶⁰ Baza ligjore: K.Pr.C, neni 510 dhe neni 511.

procedural, në fokusin e praktikës gjyqësore, le të ndalemi në çështjen: “Njohja dhe dhënia fuqi në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Arbitrazhit të huaj LCIA nr.5720 datë 04.06.2006, për çështjen “McKinsey & Comany Inc.Croatia⁵⁶¹ kundër Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Agjencisë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja”⁵⁶².

faza e parë: Njohja e vendimit - Konflikti midis palëve është zgjidhur në themel nëpërmjet një procedure arbitrazhi ndërkombëtar. Pasi ka shqyrtuar mosmarrëveshjen⁵⁶³, Gjykata e Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar (LCIA) ka dhënë vendimin përfundimtar, të lëshuar nga arbitri i vetëm, duke njohur pretendimet e kërkuarit dhe duke detyruar të paditurin të paguajë shumat përkatëse. Është pikërisht ky vendim, që është paraqitur para Gjykatës së Apelit dhe për të cilin kërkohet njohje dhe dhënie fuqi ligjore, referuar kërkesave të neneve 393-399 të K.Pr.C, si dhe Konventës "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", të ratifikuar me Ligjin nr.8688 datë 09.11.2000. Gjykata e Apelit Tiranë, në mbështetje të kërkesave të nenit 393 e vijues të K.Pr.C, ka disponuar nëpërmjet Vendimit të saj nr.17 datë 28.02.2007 për pranimin e kërkesës së kërkuarit (McKinsey & Comany Inc.Croatia) dhe ka njohur e i ka dhënë fuqi ligjore Vendimit të Arbitrazhit të huaj LCIA nr.5720.

faza e dytë: Ekzekutimi i vendimit - McKinsey & Comany Inc.Croatia i është drejtuar për herë të dytë Gjykatës së Apelit me kërkesën për "Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të Vendimit të Arbitrazhit të huaj LCIA 5720, datë 04.06.2006, njohur me vendimin e Gjykatës së Apelit nr.17 datë 28.02.2007"⁵⁶⁴. Kjo kërkesë, e bazuar në nenin 511 të K.Pr.C, paraqitet e detajuar pasi kërkohet lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për shumat konkrete⁵⁶⁵, të përcaktuara

⁵⁶¹ McKinsey & Comany Inc.Croatia është një shoqëri e huaj, e regjistruar në shtetin Dalaware, SHBA, me zyrë të regjistruar në Rr."Centerville", nr.2711, Suite 400, Wilmington, Dalaware, 19808, USA.

⁵⁶² Çështja civile e regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me nr.93/1 të regj.themeltar datë 30.11.2006; Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.17 datë 27.02.2007.

⁵⁶³ Kërkuari McKinsey & Comany Inc.Croatia ka lidhur, më datë 24.03.2005, një akt-marrëveshje për shërbime konsulence me Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Agjencinë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja. Sipas kësaj akt-marrëveshje, pala kërkuare do të kryente shërbime konsulence nga data 04.04.2005 – 13.05.2005, duke u shpërblyer me një honorar prej 270.000 euro çdo muaj, plus 10% te honorareve (27.000 euro në muaj) për shpenzimet. Shërbimet e konsulencës konsistojnë në analizën dhe përmirësimin e strukturës së investimeve të huaja në Shqipëri, si dhe gjetjes së investitorëve të mundshëm. Duke pretenduar se ka përbushur të gjitha detyrimet e akt-marrëveshjes dhe në të kundërt nuk janë përbushur ato nga pala tjetër, pas disa kërkesave të herëpashershme, kërkuari i është drejtuar Arbitrazhit Ndërkombëtar, pranë LCIA në Londër, Britani e Madhe, forum i cili, sipas akt-marrëveshjes midis palëve, ishte caktuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve eventuale.

⁵⁶⁴ Çështja e regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me nr.55 të regj.themeltar datë 10.05.2007; Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.43, datë 10.05.2007:

⁵⁶⁵ Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Agjencia Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja përgjigjen së bashku dhe veçmas (debitore solidarë) për t'ia paguar kërkuarit (McKinsey

në vendimin e arbitrazhit të huaj (LCIA) si dëmshpërblim për palën kërkuese, ndaj palëve humbëse. Gjykata e Apelit ka konstatuar se: *Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.17 datë 28.02.2007, cili ka njohur Vendimin e Arbitrazhit LCIA nr.5720, në kuptim të nenit 510 të K.Pr.C, është titull ekzekutiv dhe prej tij lindin të drejta për kërkuesin, prandaj ai (kërkuesi) legjitimohet të kërkojë lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, bazuar në nenin 511 të K.Pr.C.* Për rrjedhojë gjykata, me vendimin e saj nr.43 datë 10.05.2007, ka disponuar për: *lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për Vendimin nr.17 datë 28.02.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë.*

Nga analiza e rastit studimor, evidentohen disa problematika përsa i përket procedimit të lëshimit të urdhërit të ekzekutimit. Kështu, sikurse përmendëm më sipër, Gjykata e Apelit ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit për një tjetër vendim të Gjykatës së Apelit (vendimi nr.17 datë 28.02.2007), ndërkohë që duhet të ishte shprehur drejtëpërdrejtë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit ndaj një vendimi arbitrazhi të huaj (vendimin e LCIA nr.5720), të njohur në Republikën e Shqipërisë. Është pikërisht ky vendim i arbitrazhit të huaj, objekt i kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit dhe jo vendimi i Gjykatës së Apelit, që e ka njohur atë. Pavarësisht se kjo e *metë* në shprehjen formale të gjykatës⁵⁶⁶ nuk çon në efekte negative, përsa i përket zbatueshmërisë *de facto* të vendimit të arbitrazhit të huaj, pasi përfundimi në të dy rastet mbetet i njëjtë, për të qenë plotësisht korrekt me kërkesat e dispozitave të K.Pr.C (neni 510⁵⁶⁷ dhe 511⁵⁶⁸), por dhe me vetë objektin e kërkesës së palës së interesuar, në një rast të tillë gjykoj se Gjykata e Apelit duhet të disponojë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit ndaj një vendimi arbitrazhi të huaj, të cilit i është dhënë fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu konstatohet, në rastin studimor, se urdhëri i ekzekutimit nuk specifikon shumat respektive që përbëjnë detyrimin konkret të vendosur nga forumi i arbitrazhit (LCIA), si dëmshpërblim për palën kërkuese (shuma 594.000 euro plus interesatetj.). Shprehja e

& Comany Inc.Croatia) shuma vijuese: 594.000 euro; interesat mbi shumën e parë, prej datës 20.06.2005 deri në datën e gjykimit të arbitrazhit, për shumën 21.018 euro; shumën £ (paund) 11.826,38 për shpenzimet e gjykatës së arbitrazhit; shumën £ (paund) 48.015,91 për shpenzimet dhe pagesat gjyqësore të kërkuesit gjatë arbitrazhit; interesat mbi këto shuma prej datës së vendimit të arbitrazhit deri në ditën e pagesës me përqindjen 1% (sipas LIBOR per euro).

⁵⁶⁶ Gjykata është shprehur: "*Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për Vendimin e Gjykatës së Apelit*" ndërkohë që duhet të shprehej: "*Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për Vendimin e Arbitrazhit të huaj, të njohur me vendim të Gjykatës së Apelit*".

⁵⁶⁷ K.Pr.C, neni 510 "Titujt ekzekutivë": "*Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë: ...c) vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi*".

⁵⁶⁸ K.Pr.C, neni 511 "Urdhri i ekzekutimit": "*Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit i cili jepet:b) për vendimet e gjykatave të shteteve të huaja e të gjykatave të arbitrazhit të huaj, që u është dhënë fuqi zbatimi sipas dispozitave të këtij Kodi, nga gjykata e apelit*";

gjykatës, në dispozitivin e vendimit nr.43 datë 10.05.2007, është thjesht "lëshimi i urdhërit të ekzekutimit për Vendimin nr.17 datë 28.02.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë", ndërkohë që vetë vendimi nr.17 datë 28.02.2007 shprehimisht citon "njohjen dhe dhënien fuqi ligjore të Vendimit të Arbitrazhit të huaj LCIA nr.5720 datë 04.06.2006". Pra, të dy këto vendime, qoftë ai i njohjes ashtu dhe ai i lëshimit të urdhërit të ekzekutimit, nuk specifikojnë se kush është detyrimi konkret i palës humbëse kundrejt palës që kërkon ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit të huaj. E njëjta situatë konstatohet pothuajse në të gjitha çështjet e tjera të shqyrtuara në këtë punim dhe të trajtuara në vijim (me përjashtim të një rasti⁵⁶⁹). Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, për sejcilin rast, shprehet në dispozitivin e tij vetëm se *njeh dhe jep fuqi ligjore Vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit të Huaj* (LCIA, ICC, etj, sipas rastit). Ndërkohë që, në pjesën e tij urdhëruese, madje në disa raste⁵⁷⁰ edhe në pjesën argumentuese, vendimi nuk shprehet fare se kush është detyrimi konkret që ka dhe duhet të përmbushë pala e paditur, kundër të cilës kërkohet njohja dhe zbatimi i vendimit të arbitrazhit.

Sa më sipër, në pamje të parë, krijohet premisa e një lloji "paqartësie" e natyrës objektive, përse i përket procesit të ekzekutimit praktik të vendimit të arbitrazhit të huaj. Kjo sepse, praktikisht, për zbatimin e vendimit të arbitrazhit të huaj në Republikën e Shqipërisë, organet përmbareuese do të duhet të referohen drejtpërdrejt në këtë vendim, i cili është në gjuhë të huaj dhe mund të krijojë vështirësi përse i përket të kuptuarit të plotë dhe të pagabueshëm të asaj që disponon. Është e kuptueshme se do të ishte më e thjeshtë për organin ekzekutues të zbatonte një vendim shqiptar, që shprehej konkretisht për detyrimet e palëve.

Le të imagjinojmë se çfarë rëndësie do të merrte çështja në një situatë hipotetike, kur subjekti i detyruar, që në të gjitha rastet studimore të trajtuara është një organ shtetëror, nuk do të zbatonte detyrimin me pretendimin e "paqartësisë" së vendimit të arbitrazhit të huaj. Edhe më tepër mund të agravohej situata, nëse vetë organi përmbareues do të haste vështirësi në të kuptuarin saktë të përmbajtjes së detyrimit konkret, të parashikuar në vendimin e huaj, në kushtet kur vendimi i ekzekutimit, i lëshuar prej një gjykate shqiptare, vetëm referon dhe nuk disponon konkretisht. Kujtoj këtu se *paqartësia* e vendimit që përbën titull ekzekutiv është trajtuar në tërësinë e tij si një çështje që i përket të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, duke u bërë kështu premisë për cënimin e një të drejte kushtetuese. Për pasojë Gjykata

⁵⁶⁹ Shiko më poshtë Vendimin e Gjykatës së Apelit nr.4 datë 30.03.1998.

⁵⁷⁰ Sikurse është çështja: "Njohja dhe zbatimi, në Republikën e Shqipërisë, i Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006, me palë paditëse AEDP dhe palë të paditur Republika e Shqipërisë".

Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në disa vendime⁵⁷¹, ka pranuar të legjitimojë pretendimin e *paqartësisë së titullit ekzekutiv si argument për mos-zbatimin e tij* si pretendim të mundshëm për t'u shqyrtuar nga kjo Gjykatë. Nga ana tjetër, duhet theksuar se, sikurse ka arsyetuar Gjykata Kushtetuese, vendimi për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit ka në thelb të tij jo konfirmimin e detyrimit të debitorit, por fillimin e procesit të ekzekutimit dhe vënien në lëvizje të organit kompetent për këtë qëllim⁵⁷².

Në rastin tonë, arsyeja e kësaj "*paqartësie*" të mundshme në procesin e ekzekutimit i atribuohet thjesht dhe vetëm natyrës procedurale "njohëse" të Vendimit të Gjykatës së Apelit, që bëhet drejtpërdrejt objekt i ekzekutimit nëpërmjet urdhërit të ekzekutimit. Natyra e vendimit "njohës", ndryshe nga vendimi i themelit (që gjykon mbi themelin e konfliktit), nuk lejon që akti, në pjesën e tij urdhëruese, të përsërisë detyrimin konkret të disponuar në vendimin e arbitrazhit të huaj, që është objekt i kërkesës për ekzekutim. Në çdo rast të kundërt, nëse Vendimi i Gjykatës së Apelit do të ridispononte detyrimin konkret të palëve, të parashikuar në vendimin e arbitrazhit, mund të krijoheshin premisa për cënimin e parimit të garantimit të efikasitetit të mekanizmit të arbitrazhit nëpërmjet mos-ndërhyrjes së gjykatave nacionale. Në këtë mënyrë, mund të vihej në pikëpyetje garancia e sanksionuar prej Konventës së Nju Jork-ut për mos-shqyrtimin e çështjes në themel nga gjykata që akordon njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj.

Një situatë krejt të ndryshme, nga të gjitha rastet e shqyrtuara, paraqet një tjetër vendim analog i Gjykatës së Apelit Tiranë, përsa i përket lëshimit të urdhërit të ekzekutimit për një vendim arbitrazhi të huaj. Konkretisht bëhet fjalë për vendimin e Gjykatës së Apelit nr.4 datë 30.03.1998, që ka disponuar mbi kërkesën për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të Vendimit të Arbitrazhit Ndërkombëtar të Romës nr.3546 prot. datë 09.06.1997, dhënë për çështjen "ACCA-1" shpk kundër Bashkisë së Tiranës⁵⁷³. Gjykata e Apelit, në vendimin e saj bazuar në nenet 510, 511 dhe 513 të K.Pr.C, shprehet se vendos lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për "*njohjen si pronë legjitime të shoqërisë "ACCA-1" shpk, terrenin të ndodhur në Tiranë... rreth 10.000 m²...., si dhe detyrimin e Bashkisë Tiranë të lejojë posedimin e menjëhershëm*

⁵⁷¹ Shiko vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë: nr.9 datë 15.03.2013, par.17: "*Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me pretendimin se vendimet e gjykatave që kanë gjykuar çështjen i kanë cenuar atij të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Sipas tij, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe ai i Gjykatës së Apelit Tiranë përmbajnë pasaktësi dhe paqartësi në atë masë sa të bëjnë vendimet objekt kërkesë jologjike dhe të paekzekutueshme*".

⁵⁷² Shiko vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë: vendimin nr.7 datë 27.02.2012, par.23, si dhe vendimin nr.2, datë 01.02.2011, par.9;

⁵⁷³ Vendimi i Arbitrazhit Ndërkombëtar të Romës nr.3546 prot. datë 09.06.1997, i cili është njohur dhe i është dhënë fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit nr.3 datë 19.02.1998.

për shoqërinë "ACCA-1" shpk të këtij terreni". Në këtë rast, shprehja e gjykatës është konkrete, duke saktësuar plotësisht detyrimin konkret, të përcaktuar në Vendimin e Arbitrazhit Ndërkombëtar, për palën humbëse kundrejt palës kërkuese. Gjithsesi, rasti në fjalë dëshmon për qëndrimin jo të unifikuar të jurisprudencës Shqiptare në këtë pikë.

Sa më sipër, pavarësisht problematikës së evidentuar, gjykoj se mund të arrihet në një konstatim të përgjithshëm, që dispozitat e K.Pr.C garantojnë njohjen dhe zbatimin e një vendimi arbitrazhi të huaj në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet forcës shtrënguese të shtetit, sikundër çdo vendim tjetër gjyqësor të formës së prerë. Brenda kuadrit të njohjes së vendimeve të huaja të arbitrazhit, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile marrin një karakter të dyfishtë, pasi përmbajnë norma juridike me natyrë materiale dhe procedurale. Materiale janë normat që parashikojnë kushtet apo rrethanat, në të cilat vendimet e huaja mund ose nuk mund të njihen dhe të zbatohen në Republikën e Shqipërisë. Përkundrazi, procedurale janë ato norma që parashikojnë procedurën e njohjes dhe të dhënies fuqi të një vendimi të huaj, sikurse dhe ato që dispijlojnë kompetencën e autoriteteve gjyqësore për njohjen dhe formën e aktit gjyqësor të njohjes⁵⁷⁴.

VI.3. Kodi i Procedurës Civile përball Konventës së Nju Jork-ut - vështrim analitik i problematikës së legjislacionit të brendshëm, përsa i përket njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit të huaj.

Konventa e Nju Jork-ut vlerësohet si një produkt i përpjekjeve të përbashkëta të shumë shteteve për të përafuar legjislacionet e tyre vendase, për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj, nëpërmjet inkorporimit të kriterëve ligjore, që marrin në konsideratë veçoritë e procesit të arbitrazhit. Në kuadër të përafritimit të ligjit të brendshëm Shqiptar me kërkesat e Konventës së Nju Jork-ut, krahasimi i detyrimeve që burojnë për Shqipërinë në kuadër të zbatimit të Konventës me parashikimet e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, nxjerr në pah një problematikë që meriton të analizohet me kujdes.

⁵⁷⁴ Alban Abaz Brati, "Procedura Civile", botimi i parë (bot.Dudaj) 2008, f.413.

VI.3.1. Aplikimi i dispozitave të K.Pr.C “mutatis mutandis” për vendimet e arbitrazhit të huaj – trajtim juridik mbi efektin e K.Pr.C në procedimet e njohjes së këtyre vendimeve.

Në nenin 399 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se rregullimet e Kreut 9 të Titullit III "Për njohjen e vendimeve të shteteve të huaja"⁵⁷⁵ do të zbatohen edhe për njohjen e vendimeve të arbitrazheve të shteteve të huaja. Një parashikim i tillë, i cili duhet thënë se nuk ka gjetur asnjëherë trajtim analitik të detajuar prej doktrinës apo praktikës gjyqësore, sikurse paraqitet në analizën e mëposhtëme, nuk rezulton të jetë ai i duhuri.

Në kuptimin e përgjithshëm, gjykoj se trajtimi në mënyrë të barabartë, prej të njëjtave dispozita ligjore, të dy procedimeve civile (procedimi i njohjes së vendimeve gjyqësore të huaja dhe ai i njohjes së vendimeve të arbitrazhit të huaj), të cilët sado të ngjashëm përsëri kanë dallime substanciale midis tyre, duhet të konsiderohet i tejkaluar. Kjo të paktën për dy arsye:

i) *Së pari*, pavarësisht se natyra juridike e vendimeve përfundimtare të arbitrazhit është e njëjtë me atë të vendimeve përfundimtare të gjykatave të zakonshme, proceset prej të cilave legjitimohen këto vendime kanë tipare mjaft të dallueshme. Kështu, natyra juridike dualiste, kontraktuale po aq sa dhe juridiksionale e procesit të arbitrazhit, i jep këtij të fundit specifika që domosdoshmërisht pasqyrohen edhe në vendimin final të arbitrazhit. Një tipar i rëndësishëm, ndër të tjera, është karakteri thellësisht publik i proceseve para gjykatave të zakonshme nga njëra anë dhe karakteri thellësisht privat i proceseve të arbitrazhit nga ana tjetër. Po kështu, eskuziviteti i marrëveshjes midis palëve në konflikt për përcaktimin e juridiksionit të një forumi arbitrazhi, fryma “liberale” e procedimit arbitral, e shoqëruar nga e drejta e palëve për të ndikuar mbi procesin në çdo fazë të tij, janë karakteristika dalluese të procesit të arbitrazhit kundrejt atij gjyqësor.

Në kushtet kur procesi i njohjes dhe zbatimit të vendimeve të huaja (gjyqësore apo të arbitrazhit) shtrun, para forumit kompetent, detyrën e domosdoshme për të mbikqyrur disa aspekte thelbësore të ligjshmërisë së këtyre dy proceseve, atëherë dallimet e sipërpërmenduar qoftë edhe apriori e justifikojnë miratimin e kriterëve të veçanta të njohjes për vendimet e dala nga secili proces. Me sa duket ligjvënësi ynë, pavarësisht prej sa më sipër, më shumë se tiparet dalluese të proceseve të arbitrazhit prej atyre gjyqësore ka patur në

⁵⁷⁵ Në fakt, nga përmbajtja e dispozitave të këtij kreu, emërtimi i tij kuptohet: “Për njohjen e vendimeve të gjykatave shtetërore të huaja”.

vëmëndje karakterin përfundimtar të vendimeve, si një produkt i njëjtë për të dy proceset dhe faktin që këto vendime janë dhënë në një shtet të ndryshëm nga Shqipëria.

ii) *Së dyti*, aplikimi i dispozitave njëtrajtësisht për të dy procedimet mund të krijojë një problem në interpretimin e nenit 393 të K.Pr.C, i cili parashikon se burimet ligjore formale të kushteve për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat shtetërore të huaja do të jenë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, ligjet e veçanta, apo marrëveshjet e posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj, madje këto të fundit (sikurse e përmendëm edhe më sipër) prevalojnë mbi dy burimet e para. Problemi që natyrshëm shtrohet është: po në rastin e procedimit të njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj, a do të zbatohen dhe çfarë efekti do të kenë dispozitat e një marrëveshje bilaterale midis RSH-së dhe një shteti tjetër, me objekt njohjen reciproke të vendimeve të dhëna nga gjykatat shtetërore të sejcilës palë? A do të “konvertohen” automatikisht këto marrëveshje ndërshtetërore, pavarësisht objektivit të tyre specifik vetëm për vendimet gjyqësore, në marrëveshje për njohjen reciproke të vendimeve të arbitrazhit? Mendoj se kësaj pyetje duhet t’i jepet një përgjigje negative.

Llogjika më e saktë në interpretimin e nenit 393 të K.Pr.C, duhet të na çojë në përfundimin se vetëm marrëveshjet e posaçme bilaterale, midis RSH-së dhe një shteti të huaj, me objekt njohjen reciproke të vendimeve të arbitrazhit të sejcilës palë, mund të prevalojnë mbi dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut dhe ato të Kodit të Procedurës Civile, përse i përket efektit në një rast konkret të njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj. Këtë përfundim duket se mbështet edhe vetë Konventa e Nju Jork-ut, sipas të cilës, klauzola e “dispozitës më të favorshme” e lejon palën e interesuar që kërkon zbatimin e vendimit të arbitrazhit, të mbështesë kërkesën e saj në ligjin e brendshëm të gjykatës apo në traktatet dypalëshe apo shumëpalëshe (me parashikime “më të favorshme”) në fuqi, në vendin ku ajo kërkon zbatimin⁵⁷⁶. Ky interpretim na çon në përfundimin se hierarkia e akteve normative që i shtrijnë efektet për rregullimin e një procedure njohjeve të një vendimi arbitrazhi të huaj, paraqitet si më poshtë:

- marrëveshjet e posaçme bilaterale, midis RSH-së dhe një shteti të huaj, me objekt njohjen reciproke të vendimeve të arbitrazhit;
- dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut;
- dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

⁵⁷⁶ Konventa e Nju Jork-ut (1958), neni 7(1).

Le të trajtojmë përmbledhtazi përparësinë e akteve të mësipërme në njohjen dhe zbatimin e një vendimi arbitrazhi të huaj, apo ndërkombëtar, në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër, autoriteti kompetent që akordon njohjen e vendimit të arbitrazhit (Gjykata e Apelit) mund të gjendet para dy situatave juridike të ndryshme, të cilat grupojnë në vetvete disa raste⁵⁷⁷:

a) *Situata e parë*: kur vendimi i arbitrazhit është marrë në një shtet të ndryshëm nga Shqipëria, do të kenë epërsi dispozitat e mëposhtëme:

i) Marrëveshja ndërshtetërore (me objekt të posaçëm për vendimet arbitrale), nëse ka të tillë;

ii) Konventa e Nju Jork-ut, apo Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, nëse nuk ka marrëveshje – zgjedhja midis Konventës dhe K.Pr.C i takon vetë palës së interesuar, falë efektit të klauzolës së “dispozitës më të favorshme” të Konventës⁵⁷⁸;

iii) Situatë hipotetike – nëse Republika e Shqipërisë do të kishte pranuar Konventën me rezervë, duke përfitur nga “rezerva e reciprocitetit”⁵⁷⁹ – atëherë për njohjen e një vendimi arbitrazhi të huaj, të marrë në territorin e një shteti jo miratues të Konventës dhe me të cilin RSH-ja nuk do të kishte marrëveshje bilaterale, do të zbatoheshin vetëm dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

b) *Situata e dytë*: kur vendimi i arbitrazhit është marrë në Shqipëri, por konsiderohet jo i brendshëm (jo-lokal), ose i huaj (ndërkombëtar), atëherë për njohjen e tij do të zbatohen vetëm dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut. Në një rast të tillë nuk mund të zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, sepse neni 399 parasheh aplikimin e dispozitave të K.Pr.C vetëm për njohjen e vendimit përfundimtar të një *arbitrazhi të shtetit të huaj*, duke mos patur mundësi aplikimi për të ashtuquajtur *vendim të arbitrazhit ndërkombëtar Shqiptar*.

⁵⁷⁷ Shiko Punimin e Doktoraturës me titull “Vendimi i arbitrazhit, kundërshtimi, njohja dhe ekzekutimi i tij”, me autor Dr.Flutura Kola (Tafaj); Udheheqës: Prof.Dr.Kudret Çela; dhjetor 2008; Biblioteka e Fakultetit të Drejtësisë së UT, nr.invent.14669.

⁵⁷⁸ Shiko Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë të R.Sh., nr.6, datë 01.06.2011 “Njohja e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC), për “I.C.M.A” srl. në likuidim” dhe “AGRI.BEN” sas kundër MBU”, par.17.1, ku Gjykata e Lartë konstaton se: “Gjykata e Apelit, në shqyrtimin e kërkesës për njohje të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, mbështetet në parimet dhe kriteret e Konventës së Nju Jork-ut ..., me kushtin që Kodi i Procedurës Civile ose ndonjë ligj i posaçëm të mos përmbajë një rregullim të ndryshëm, si edhe të mos rezultojë se janë të zbatueshme, për atë rast, dispozita të tjera të posaçme të parashikuara në një marrëveshje tjetër ndërkombëtare, me fuqi detyruese, si për palën kreditore, ashtu edhe për palën debitore”.

⁵⁷⁹ Rezerva e reciprocitetit: Çdo shtet mundet në bazë të parimit të reciprocitetit, të deklarojë se do të zbatojë dispozitat e Konventës për njohjen dhe ekzekutimin vetëm të atyre vendimeve, që janë dhënë në territorin e një shteti tjetër miratues të Konventës (Konventa e Nju Jork-ut, neni 1, pika 3) Pra në këtë rast kufizimi nga detyrimi i përgjithshëm ka të bëjë me faktin se pranohen të zbatohen vetëm ato vendime arbitrazhi të marra në një shtet tjetër, i cili nga ana e tij njih të njëjtin detyrim reciprok ndaj shtetit të parë.

Gjithashtu në këtë rast nuk mund të bëhet fjalë për marrëveshje bilaterale, për sa kohë vendi i origjinës së vendimit të arbitrazhit është vetë Shqipëria.

Si shembull të një marrëveshjeje bilaterale, me objekt njohjen reciproke të vendimeve të arbitrazhit, ku palë është Republika e Shqipërisë, përmendin "Konventën ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale", nënshkruar në Athinë, më 17 maj 1993⁵⁸⁰. Pjesë e rëndësishme e kësaj marrëveshjeje ndërshtetërore janë edhe dispozitat që rregullojnë njohjen reciproke të vendimeve të dhëna në territorin respektiv të sejcilës palë kontraktuese (Republika e Shqipërisë dhe Republika e Greqisë)⁵⁸¹. Sipas këtyre dispozitave parashikohet që: "...*Palët kontraktuese do të njohin dhe do të zbatojnë në tokën e tyre vendimet që vijojnë, të cilat janë publikuar në tokën e palës tjetër kontraktuese: (a) vendime të dhëna lidhur me çështje civile, familjare dhe tregtare; (b) vendime të dhëna lidhur me çështje penale, në çdo rast që ka të bëjë me kërkesat për dëmshpërblim; (c) vendime arbitrazhi*"⁵⁸².

Në cilësinë e një marrëveshjeje të posaçme bilaterale, me objekt specifik - njohjen reciproke të vendimeve të arbitrazhit - Konventa bilaterale në fjalë prevalon mbi dispozitat e K.Pr.C, në rastin e paraqitjes së kërkesës për njohje, në shtetin Shqiptar, të një vendimi arbitrazhi të marrë në shtetin Grek, sepse është vetë Kodi i Procedurës Civile, në nenin 393, që e sanksionon këtë "epërsi"⁵⁸³. Por, në të njëjtën kohë, sikurse e përmendëm më sipër, marrëveshja e posaçme bilaterale teorikisht ka epërsi edhe mbi Konventën e Nju Jork-ut, nëpërmjet aplikimit të klauzolës së "dispozitës më të favorshme". Themë *teorikisht* sepse, në rastin konkret, vetë Konventa ndërshtetërore (midis Shqipërisë dhe Greqisë) në një dispozitë të posaçme të saj⁵⁸⁴, parashikon aplikimin drejtpërdrejtë të dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut për rastet e njohjes dhe zbatimit të *vendimeve të arbitrazhit* të marra në tokën e sejcilës palë kontraktuese. Sa më sipër, mund të themi se në çdo rast të paraqitjes së kërkesës për njohje dhe ekzekutim në shtetin Shqiptar, të një vendimi arbitrazhi të marrë në shtetin Grek, nga Gjykata e Apelit ku është paraqitur kërkesa duhet të marrë prioritet aplikimi i

⁵⁸⁰ Ligj Nr.7760 datë 14.10.1993, "Për ratifikimin e "Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale"; dt.miratimit:29.10.1993; Flet.Zyrtare Nr.12, Faqe:787.

⁵⁸¹ Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale (ratifikuar me Ligjin Nr.7760 datë 14.10.1993), Kapitulli i Tretë "Njohja dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore" (neni 23-30).

⁵⁸² *Id.*, neni 23, pika 1.

⁵⁸³ K.Pr.C., neni 393: "*Kur për këtë qëllim ka marrëveshje të posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj zbatohen dispozitat e marrëveshjes*".

⁵⁸⁴ Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale, neni 25(1): *Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit zbatohen dispozitat e Konventës që u nënshkrua në Nju Jork me 10 Qershor 1958.*

dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut si rrjedhojë e referimit eskuziv të Konventës bilaterale të lidhur midis dy shteteve. Konventa bilaterale shkon edhe më tej në këtë drejtim, duke trupëzuar në dispozitat e saj⁵⁸⁵ parimin e përjashtimit të juridiksionit të gjykatës kombëtare, të themeluar nga Konventa e Nju Jork-ut (në nenin 2(3) të saj), në rastin kur palët kanë nënshkruar marrëveshje arbitrazhi.

Për t'iu kthyer përsëri dhe për ta mbyllur këtu argumentimin që nisëm pak më sipër, përsa i përket përmbajtjes së nenit 399 të Kodit të Procedurës Civile, duhet theksuar se ende nuk kemi një interpretim të unifikuar të kuptimit të tij. Dilema qëndron në atë që, zbatimi i dispozitave të Kreut "*Për njohjen e vendimeve të gjykatave të shteteve të huaja*" do të aplikohet edhe për vendimet e arbitrazhit të huaj, duke respektuar plotësisht dhe në mënyrë strikte parashikimet e këtij Kreu, apo vetëm për atë që sa përmbajtja e këtyre parashikimeve nuk bie ndesh, thënë ndryshe, për atë që sa pajtohen (*mutatis mutandis*) me veçoritë e procesit të arbitrazhit. Analiza e bërë më sipër, por edhe ajo vijuese, në fakt imponojnë llogjikën e dytë pra aplikimin e këtyre dispozitave për atë që mund të gjejnë vend dhe të legjitimohen në procesin e arbitrazhit, apo për atë që ato nuk bien ndesh me parashikimet dhe në përgjithësi me frymën e Konventës së Nju Jork-ut. Një përfundim i tillë mbështetet edhe prej Kushtetutës së RSH-së, neni 122(2) i të cilës përcakton se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, prevalojnë mbi legjislacionin e brendshëm.

Të njëjtin qëndrim, megjithëse jo të unifikuar, ka mbajtur edhe jurisprudenca Shqiptare përsa i përket efektit të normave të K.Pr.C në njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj. Kështu në çështjen "BE-HA-SE" kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (DPRR), Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT), Shqipëri⁵⁸⁶, Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit, në vendimin nr.34 dt.31.03.2009, ka bërë një interpretim të përgjithshëm, por që vlen edhe për çështjen në shqyrtim, në lidhje me kuadrin ligjor që duhet të zbatohet Gjykata e Apelit për njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj, duke arsyetuar në këtë mënyrë:

-Bazuar në nenin 399 të Kodit të Procedurës Civile, për njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj zbatohen dispozitat e kreut IX të K.Pr.C "Njohja e vendimeve të shteteve të huaja".

⁵⁸⁵ *Id.*, neni 25(2): Në rast zhvillimi të gjyqit, objektivi i të cilit, sipas vullnetit të palëve në gjyq, rregullohet me klauzolë arbitrazhi, gjykata urdhëron palët t'i drejtohen organit të arbitrazhit.

⁵⁸⁶ Çështja me nr.90006-00372-30-2009, e regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë më datë 19.02.2009, që i përket dosjes së vendimit me nr.23 i regj.themeltar dt.25.02.2009 dhe nr.34 i vendimi dt.31.03.2009: Njohja në Republikën e Shqipërisë e Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), për çështjen me nr.12016/ACS/FM datë 02.04.2008, me palë paditëse shoqërinë "BE-HA-SE" dhe palë të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (DPRR), MPPTT, Shqipëri.

-Sipas dispozitave të kreut IX të K.Pr.C, nenin 393, parashikohet se "Vendimet e gjykatave të shteteve të huaja njihen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë, në kushtet e parashikuara në këtë Kod ose në ligje të veçanta. Kur për këtë qëllim ka marrëveshje të posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj zbatohen dispozitat e marrëveshjes".

-Në Republikën e Shqipërisë është në fuqi ligji nr.8688, datë 09.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit". Neni 122, paragrafi 2 i Kushtetutës përcakton se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, prevalojnë mbi legjislacionin e brendshëm.

Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata e Apelit ka konkluduar se për njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj (ndërkombëtar), nga Gjykata e Apelit duhet të zbatohen dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, në qoftëse ato nuk bien në kundërshtim me të (me Konventën).

Pavarësisht autoritetit *de jure* që Konventa e Nju Jork-ut ka në rendin ligjor të brendshëm Shqiptar, Gjykata e Apelit, jo në pak raste, e injoron ekzistencën e kësaj Konvente, duke u fokusuar vetëm tek dispozitat e K.Pr.C. Konstatohen raste të praktikës gjyqësore, kur nga autoriteti kompetent për njohjen e vendimit të huaj të arbitrazhit (Gjykata e Apelit), nuk përmendet fare Konventa e Nju Jork-ut në vendimin përkatës të njohjes. Kështu psh. në çështjen "Njohja dhe zbatimi në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006: AEDP kundër Republikës së Shqipërisë"⁵⁸⁷, në gjithë procedurën dhe dokumentacionin e administruar në dosje nuk përmendet mbështetja apo referimi në dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut, 1958 "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj", e ratifikuar me Ligjin Nr.8688 datë 09.11.2000. Kërkesa formale e fondacionit "AEDP", me objekt njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit të huaj, ka si bazë ligjore vetëm dispozitat e neneve 393-397 të K.Pr.C dhe jo vetëm aty, por edhe në gjithë përmbajtjen e kërkesës së paraqitur, nuk bëhet asnjë referim në dispozitat e Konventës. Po kështu, vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.54, datë 29.05.2007, nuk përmend në asnjë rast detyrimin për të zbatuar dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut. Për më tepër, Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit, kur vlerëson elementet e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) dhe përmbushjen nga ana e tij të kriterëve të nenit 394 dhe 396 të K.P.C, nuk referon në asnjë moment në dispozitat

⁵⁸⁷ Çështja civile me nr.22 i Regj.Themeltar, datë 22.02.2007, që i përket Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.54, datë 29.05.2007.

e Konventës së Nju Jork-ut. Kjo mund të konsiderohet një mangësi formale e akteve dhe procedurës së njohjes dhe zbatimit të vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006.

Ndërkohë që, situata paraqitet e ndryshme në çështjen e njohjes së Vendimit të Arbitrazhit të huaj LCIA nr.5720 datë 04.06.2006: “McKinsey & Comany Inc.Croatia *kundër* Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Agjencisë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja”. Në aplikimin e tij, kërkuesi i referohet formalisht edhe Konventës së Nju Jork-ut. Po kështu, Gjykata e Apelit shprehet *"për vendimin e arbitrazhit kërkohet njohje dhe dhënie fuqi ligjore, referuar kërkesave të neneve 393-399 të K.Pr.C, si dhe Konventës "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", të ratifikuar me Ligjin nr.8688 datë 09.11.2000"*. Gjithashtu, në çështjen e njohjes së Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC): "BE-HA-SE" *kundër* DPRR dhe MPPTT, Shqipëri”, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesë formale me shkrim, të regjistruar më datë 19.02.2009⁵⁸⁸. Si bazë ligjore të kërkesës për njohje janë pretenduar dispozitat e neneve 393-399 të Kodit të Procedurës Civile, Konventa Evropiane "Mbi arbitrazhin tregtar ndërkombëtar", e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.8687 dt.09.11.2000, si dhe Konventa "Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.8688 dt.09.11.2000. Në këto dy çështje, në ndryshim nga çështja e parë e trajtuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit merr në shqyrtim dhe vlerëson, në mënyrë të shprehur, përmbushjen e kërkesave të Konventës së Nju Jork-ut, në momentin që janë analizuar "pengesat ligjore" të njohjes dhe zbatimit të vendimit të arbitrazhit të huaj.

Gjithsesi edhe në rastet e konstatuara, kur gjykata i referohet Konventës, përsëri nuk gjejmë interpretime të mirëfillta të saj, sepse në përgjithësi vihet re një "indiferencë" e Gjykatës së Apelit ndaj rregullave të interpretimit të Konventës, të përfshira në *"punën përgatitore"* (*"travaux préparatoires"*) të hartimit të Konventës. Interpretimi bazuar në *"travaux préparatoires"* presupozon interpretimin e dispozitave të Konventës, bazuar në shpjegimet e dokumenteve të ndryshme, raporte, komente, etj., që janë prodhuar para dhe gjatë hartimit të

⁵⁸⁸ Kërkesa e DPRR-së, shkresa nr.1528 prot. dt.17.02.2009, e protokolluar nga Gjykata e Apelit më datë 19.02.2009, dokument i dosjes të çështjes civile me nr.90006-00372-30-2009, datë 19.02.2009.

Konventës. Konventa e Nju Jork-ut duhet të lexohet natyrisht në mirëbesim dhe me një shkallë të arsyeshme të inteligjencës, në kontekstin dhe në kuptimin e saj të zakonshëm⁵⁸⁹.

Në dritën e analizës së mësipërme të kuadrit ligjor dhe vështimit mbi jurisprudencën, përforcohet bindja se parashikimi i nenit 399 të K.Pr.C⁵⁹⁰ tingëllon jo kontemporan përball frymës së përgjithshme të imponuar në regjimin juridik ndërkombëtar prej Konventës së Nju Jork-ut. Në fakt, ky model i ndjekur nga legjislacioni Shqiptar, i njohjes së vendimeve të arbitrazhit të huaj për analogji të vendimeve gjyqësore, nuk paraqet asnjë ngjashmëri me legjislacionet e vendeve, që konsiderohen me eksperiencë në fushën e arbitrazhit. Përmendim këtu ligjin Anglez të arbitrazhit⁵⁹¹, një ligj i veçantë, i cili në pjesën e tretë të tij rregullon njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj. Dispozitat e këtij ligji parashikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin e një vendimi përfundimtar në kuptim të Konventës së Nju Jork-ut, ç'ka nënkupton një vendim të dhënë sipas një marrëveshje arbitrazhi, në territorin e një shteti (të ndryshëm nga Mbretëria e Bashkuar), i cili është palë në Konventën e Nju Jork-ut⁵⁹². Një vendim i tillë, me miratim të gjykatës, zbatohet në Angli në të njëjtën mënyrë sikurse një vendim ose urdhër i gjykatës së zakonshme, duke patur të njëjtën vlerë⁵⁹³. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë më tej paraqitjen e provave nga palët që kërkojnë njohjen dhe zbatimin e vendimit të arbitrazhit, shkaqet për refuzimin e njohjes dhe përdorimin e vendimit përfundimtar në çështje të tjera, në sistemin e së drejtës "*common law*"⁵⁹⁴.

Eksperiencia e vendeve të zhvilluara evropiane përcjell edhe modele të tjera, ku njohja e vendimeve të arbitrazhit të huaj është pjesë e rregullimeve të legjislacionit procedural civil. Kështu psh., ligji Gjerman, për këtë qëllim, parashikon shprehimisht se "*Njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit të huaj do të bëhet konform Konventës "Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj", datë 10 Qershor, 1958. Parashikimet e marrëveshjeve të tjera për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj do të mbeten të paprekura*"⁵⁹⁵. Sipas këtij ligji, një vendim arbitrazhi i huaj nuk do të njihet në shtetin

⁵⁸⁹ Veeder.V.V. "A është e nevojshme të ndryshohet Konventa e Nju Jorkut" (Fjalimi hapës i Forumit të Institutit të Arbitrazhit Ndërkombëtar, Dijon, shtator 2008), Revista e Vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar, qershor 2010, Emmanuel Gaillard, f.187.

⁵⁹⁰ K.Pr.C, neni 399: "*Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe për njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj*".

⁵⁹¹ Ligji Anglez i Arbitrazhit (Arbitration Act) 1996, neni 100-104.

⁵⁹² *Id.*, neni 100, paragrafi (1).

⁵⁹³ *Id.*, neni 101, paragrafi (2), (3) – "*Me leje të gjykatës së zakonshme, vendimi përfundimtar i gjykatës së arbitrazhit do të konvertohet në vendim gjyqësor*".

⁵⁹⁴ *Id.*, neni 102, 103, 104.

⁵⁹⁵ Kodi i Proedurës Civile të Gjermanisë, neni 1061, paragrafi 1.

Gjerman nëse gjykatat do të refuzojnë zbatueshmërinë e tij⁵⁹⁶. Një tjetër version përcjellin parashikimet e Kodit Italian të Procedurës Civile, dispozitat e të cilit rregullojnë drejtpërdrejt arbitrazhin ndërkombëtar⁵⁹⁷ dhe njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj⁵⁹⁸, në Republikën e Italisë, pa i'u referuar Konventës së Nju Jork-ut por në harmoni me të. Në dy dispozita të K.Pr.C të Italisë, parashikohet e drejta e çdo personi për t'iu drejtuar Gjykatës së Apelit për të realizuar njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj. Gjithashtu, rregullohet procedura e kërkesës për njohje, dokumentacioni që i duhet bashkëngjitur kërkesës, si dhe rastet e kundërshtimit të njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj. Të gjitha parashikimet e mësipërme në Kodin Italian të Procedurës Civile, përputhen plotësisht me parashikimet e Konventës së Nju Jork-ut dhe nuk ka përplasje. Për më tepër vetë dispozita e Kodit parashikon se në çdo rast janë të vlefshme normat e parashikuara nga konventat ndërkombëtare⁵⁹⁹, duke kuptuar këtu Konventën e Nju Jork-ut. Një situatë e ngjashme paraqitet dhe nga legjislacioni Hungarez, i cili rregullon njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj drejtpërdrejt (jo duke referuar në Konventë). Ky ligj parashikon se *"Vendimi përfundimtar i arbitrazhit të huaj ka të njëjtën fuqi si çdo vendim përfundimtar i gjykatave të zakonshme. Gjykata e zakonshme mund të refuzojë të zbatojë vendimin e arbitrazhit të huaj, nëse konstaton se sipas legjislacionit Hungarez objekti i mosmarrëveshjes nuk lejohet të zgjidhet me arbitrazh, ose nëse vendimi përfundimtar bie në kundërshtim me rendin publik"*⁶⁰⁰.

VI.3.2. "Shkaqet refuzuese" për njohjen dhe zbatimin e një vendimi arbitrazhi të huaj, sipas K.Pr.C - parashikimet e nenit 394 të K.Pr.C përball nenit 5 të Konventës.

Njohja e një vendimi përfundimtar arbitrazhi të huaj nuk përfaqëson gjë tjetër, përveçse procedurën gjyqësore të verifikimit të kushteve ligjore, me vërtetimin e të cilëve bëhet ligjërisht e mundshme që vendimit të arbitrazhit të huaj të mund t'i njihet fuqi zbatuese në territorin e shtetit Shqiptar⁶⁰¹. Në fakt, në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, ligjvënësi nuk ka parashikuar kushtet për njohjen e një vendimi përfundimtar arbitrazhi të huaj, por ka listuar në mënyrë shteruese kushtet që konsiderohen si "pengesa për njohjen". Një teknikë e tillë e parashikimit në mënyrë eksplicite të kushteve ligjore, vërtetimi i të cilëve sjell si pasojë mosnjohjen dhe mosdhënien e fuqisë zbatuese për një vendim arbitrazhi të huaj, konstatohet

⁵⁹⁶ *Id.*, neni 1061, paragrafi 2.

⁵⁹⁷ Kodi i Procedurës Civile të Italisë (Për procedimet e veçanta – Pjesa II), kreu VI (Për arbitrazhin ndërkombëtar), neni 832 – 838.

⁵⁹⁸ *Id.*, kreu VII (Për vendimet e arbitrazhit të huaj), neni 839, 840.

⁵⁹⁹ *Id.*, neni 840, paragrafi i fundit.

⁶⁰⁰ Kodi i Procedurës Civile të Hungarisë, neni 58 dhe 59.

⁶⁰¹ Alban Abaz Brati, "Procedura Civile", botimi i parë (bot.Dudaj) 2008, f.414.

edhe në Konventën e Nju Jork-ut (neni 5). Këto kushte, duke konsideruar efektin e nenit 399 të K.Pr.C⁶⁰², rezulton të jenë parashikuar në nenin 394 të K.Pr.C⁶⁰³ dhe njihen, sipas terminologjisë procedurale civile, si pengesa ligjore për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja apo si "*shkaqe refuzuese*" të njohjes. Kuptohet që në të gjitha rastet e tjera, që nuk përfshihen në kuadrin e këtyre pengesave ligjore, vendimit të arbitrazhit të huaj mund dhe duhet t'i jepet fuqi ekzekutive.

Më poshtë do të shtjellojmë konkretisht rastet se kur vendimit të një arbitrazhi të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe problematikën që shoqëron shkaqet ligjore të refuzimit.

VI.3.2.1. Shkaku 1 - Kur, sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja për të cilën bën fjalë vendimi nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës (forumit) të arbitrazhit të shtetit që ka dhënë vendimin⁶⁰⁴.

Kjo dispozitë parashikon pengesën ligjore të njohjes së vendimit të arbitrazhit të huaj, pasi vihet në diskutim juridiksioni dhe kompetenca e forumit vendimarrës të arbitrazhit, bazuar në dispozitat që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Gjykoj se analiza e kësaj pengese ligjore të njohjes nga Gjykata, e cila shqyrton kërkesën për njohje, duhet të bëhet bazuar përgjithësisht në vlerësimin e dy momenteve shumë të rëndësishme për vendimin e arbitrazhit të huaj, që janë:

Së pari, për të vërtetuar kushtin e mungesës së kompetencës së forumit, Gjykatës së Apelit i duhet të vlerësojë faktin nëse palët kanë përfunduar apo jo një *marrëveshje të vlefshme arbitrazhi*, e cila sipas parashikimeve të së drejtës Shqiptare përcakton kompetencën e forumit të arbitrazhit dhe përjashton juridiksionin e çdo gjykate nacionale⁶⁰⁵. Praktika

⁶⁰² Neni 399 "Vendimi i gjykatës së arbitrazhit": Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe për njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj.

⁶⁰³ Neni 394 "Pengesat ligjore për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja": *Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur: a) sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin; b) kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet; c) midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare; ç) është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë; d) i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij; dh) nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.*

⁶⁰⁴ Kodi i Procedurës Civile, neni 394, pika "a".

⁶⁰⁵ Njohja e marrëveshjes së arbitrazhit dhe përjashtimi të juridiksionit të një gjykate shtetërore kur palët kanë nënshkruar një marrëveshje të vlefshme arbitrazhi, parashikohet në dispozitat e Konventës së Nju Jorkut, si dhe të K.Pr.C (Konventa, neni 2(1): "*Secila nga shtetet kontraktuese do ta njohë marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër t'ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje,*"; neni 2(3): "*Gjykata e njërit shtet kontraktues, kur është e angazhuar në një padi për një çështje për të cilën palët kanë bërë*

gjqësore e analizuar e vërteton këtë përfundim. Kështu, Gjykata e Apelit, gjate shqyrtimit gjyqësor të kërkesave për njohje të vendimeve të arbitrazhit të huaj, ka marrë në shqyrtim dhe ka analizuar juridiksionin e forumit të arbitrazhit për zgjidhjen e konfliktit, duke vlerësuar pikërisht marrëveshjen e arbitrazhit të lidhur midis palëve në konflikt. Gjatë kësaj analize, Gjykata e Apelit afirmon parimin, që buron nga teoria kontratore e legjitimitetit të autoritetit të arbitrave, se *klauzola e arbitrazhit është premisë e vetme për vendosjen e juridiksionit të arbitrazhit ndërkombëtar*. Për të vërtetuar këtë konstatim, le të sjellim në fokus të analizës disa çështje:

i) Në çështjen e njohjes dhe zbatimit në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006: “AEDP kundër Republika e Shqipërisë”, Gjykata e Apelit konstaton se: “*Mosmarrëveshja midis palëve*⁶⁰⁶ *ka krijuar premisat që njëra nga palët (AEDP) ta adresonte çështjen për zgjidhje para forumit kompetent. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) në Paris, Francë, me një Kërkesë për Arbitrazh. Sipas kërkesës, palë paditëse ishte AEDP dhe palë e paditur ishte Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Qeveria Shqiptare. Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar midis dy palëve, ato kishin rëndë dakort dhe kishin miratuar edhe një Klauzolë Arbitrazhi*⁶⁰⁷. *Konkretisht në seksionin 2/C, paragrafi 8, të marrëveshjes, palët kishin rënë dakort që mosmarrëveshjet e lindura midis tyre, lidhur me këtë marrëveshje, do t’i paraqiteshin për zgjidhje Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) Paris. Kjo dispozitë nuk është kundërshtuar nga palët në*

*një marrëveshje sipas kuptimit të këtij neni, me kërkesën e një prej palëve ia referon palët arbitrazhit, përveç rasteve”; K.Pr.C, neni 403 “Marrëveshja e arbitrazhit”: *Mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm në qoftë se ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë t’ia nënshtrorjnë arbitrazhit”.**

⁶⁰⁶ Rrethanat e çështjes gjyqësore: Kërkuesi, Fondacioni "Albanian Education Development Program" (AEDP - Programi Shqiptar për Edukim dhe Zhvillim) është regjistruar si person juridik, me Vendimin Nr.53 datë 16.7.2002 të Gjykatës së shkallës së parë Tiranë. Ky Fondacion ka lidhur me Qeverinë Shqiptare, në datën 23 qershor 1997, një Marrëveshje Kuadër për vazhdimin e bashkëpunimit dhe zbatimit të programit "Tirana 2000". Ky program bënte fjalë për asistimin e Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e cilësisë së arsimit, nëpërmjet riparimit dhe rindërtimit të shkollave, sipas standartit Evropian. Në marrëveshjen dy palëshe është përcaktuar edhe rimbursimi për TVSH-në e paguar nga fondacioni AEDP në Shqipëri, gjatë zhvillimit të aktivitetit të saj. Pikërisht rimbursimin e TVSH-së fondacioni AEDP e ka kërkuar në vazhdimësi ndaj Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, duke pretenduar se i ka realizuar detyrimet e marra përsipër sipas marrëveshjes së përmendur. Megjithë kërkesat e saj, nuk është bërë e mundur rimbursimi i TVSH-së, duke krijuar kështu një mosmarrëveshje midis palëve në zbatimin e Marrëveshjes Kuadër, të lidhur midis tyre. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka caktuar për gjykimin e çështjes, një panel prej 3 arbitrash (z.Alliot Geisinger, z.Neritan Kallfa, Dr.Christian Borris) dhe si vend i arbitrazhit është përcaktuar Parisi. Pasi ka shqyrtuar mosmarrëveshjen, Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka dhënë vendimin përfundimtar Nr.13962/FM datë 20.10.2006. Në këtë vendim, gjykata ka disponuar në favor të kërkuetit (fondacionit AEDP), duke vendosur detyrimin e Republikës së Shqipërisë t’i paguajë kërkuetit një shumë të caktuar, si dhe të paguajë kostot e arbitrazhit për një shumë tjetër.

⁶⁰⁷ Klauzolë Arbitrazhi – klauzolë në një kontratë dy palëshe, që konsiderohet "Marrëveshje e shkruar" e arbitrazhit, sipas neni 2/2 të Konventës së Nju Jork-ut.

proces, pra nuk është paraqitur asnjë objeksion nga palët, në lidhje me juridiksionin e forumit të arbitrazhit”.

ii) Në çështjen e njohjes në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), për çështjen me nr.12016/ACS/FM datë 02.04.2008: “Shoqëria "BE-HA-SE" kundër Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (DPRR), Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT), Shqipëri”⁶⁰⁸, Gjykata e Apelit analizon marrëveshjen e arbitrazhit në këtë mënyrë: *“Në përbërje të kontratës midis palëve përfshihej edhe një Klausolë Arbitrazhi. Kështu, në pikën 67 të Kushteve të Kontratës, pjesa I-Kushtet e Përgjithshme dhe pjesa II-Kushtet e Veçanta të Zbatimit, parashikohej se në rast mosmarrëveshesh midis punëdhënësit (DPRR, MPPTT) dhe sipërmarrësit ("BE-HA-SE"), në lidhje me këtë kontratë, mosmarrëveshja do t'i referohej arbitrazhit, sipas Rregullave të Pajtimimit dhe të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris (ICC). Vendi i zhvillimit të arbitrazhit do të ishte Republika e Shqipërisë dhe arbitrazhi do të zhvillohej nga arbitra të emëruar sipas Rregullave të Arbitrazhit të ICC, në gjuhën angleze. Sipas pikës*

⁶⁰⁸ Palët, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, strukturë vartëse e MPPTT-së, dhe shoqëria e huaj "BE-HA-SE", me adresë: Ayten Sokak No.8, Tandogan, Ankara, Turqi, kishin lidhur një kontratë më datë 11 gusht 1998, me objekt "Rehabilitimi dhe rindërtimi i seksionit të II, të Korridorit Lindje-Perëndim, në rrugën nga Rrogozhina në Elbasan". Për shkak të konfliktit të lindur midis palëve në lidhje me kontratën, paditësi "BE-HA-SE" në përputhje me klauzolën e arbitrazhit depozitoi, më datë 19 shkurt 2002, *Kërkesën për Arbitrazh*, në Sekretariatit e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC). Duke patur parasysh se klauzola e arbitrazhit nuk përcaktonte numrin e arbitrave, Gjykata e Arbitrazhit, në sesionin e 13 dhjetorit 2002 caktoi arbitrin e vetëm Dr. Anton Baier, të propozuar nga Komiteti Austriak. Në vijim në datë 25 prill 2003, u nënshkruan Termat e Referencës nga palët dhe arbitri i vetëm, si dhe u përcaktua një Kalendar Procedurash, në zbatim të nenit 18 të Rregullave të Arbitrazhit të ICC-së. Kalendarit përcaktonte se kur do të mbaheshin seancat dëgjimore për inxhinierin, si dhe për të trajtuar të gjitha pretendimet e tjera. Më datë 2 maj 2003 arbitri i vetëm përpiloi një urdhër të ndërmjetëm, në lidhje me kërkesën e palës paditëse për Masat Mbrojtëse, që kishin të bënin me disponimin e dokumentave dhe pajisjeve në terren. Në vijim të procedurave të arbitrazhit kalendarit u ndryshua disa herë. U pezullua procesi dhe u depozituan një sërë kërkesash dhe përgjigjesh. U morën një sërë urdhërash proceduriale dhe vendime të ndërmjetme nga arbitri i vetëm, si dhe vendime të Sekretariatit të ICC-së, për efekt të shtyrjes së procedurave dhe përjashtimit të arbitrit të vetëm. Më datë 14 janar 2007 është zhvilluar seanca dëgjimore për pyetjen e ekspertit ndihmës të arbitrit të vetëm, si dhe janë ftuar palët të depozitojnë pretendimet përfundimtare dhe kostot e arbitrimin. Arbitri i vetëm i dorëzoi vendimin përfundimtar Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, e cila e miratoi këtë vendim në seancën e datës 28 mars 2008. Vendimi Përfundimtar i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC), i cili mban datën 2 prill 2008 dhe nr.çështje No.12016/ACS/FM ("BE-HA-SE" kundër DPRR, MPPTT, Republika e Shqipërisë), i është njoftuar dhe i është përcjellë palës paditëse më datë 8 prill 2008, nga Sekretariati i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, konkretisht nga këshilltari i ngarkuar me këtë dosje. Shkresa përcjellëse e vendimit final, përcakton edhe shumën totale të kostove të arbitrazhit, të cilat ishin paguar nga paditësi. Sipas vendimit përfundimtar të arbitrazhit, për këtë çështje arbitri i vetëm ka vendosur: a) Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë palës paditëse një shumë të caktuar, plus interesat, që përfaqësojnë shumën e akorduar nga arbitri i vetëm për pretendimin e paditësit për përfundimin e punësimit (kontratës); b) Kostot e procedimit në arbitrazh, të përcaktuara nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit, në shumën përkatëse, do të përballohen nga pala paditëse; c) Pala paditëse do t'i paguajë palës së paditur një shumë të caktuar, si dëmshpërblim për kostot e arsyeshme gjyqësore dhe për shpenzimet e tarifave të Ekspertit; d) Rrëzimi i të gjitha pretendimeve të tjera.

5.1/(b) të Kushteve të Kontratës, Pjesa II, palët kishin rënë dakort që ligji i zbatueshëm të ishte ligji në fuqi në Republikën e Shqipërisë”.

iii) Në çështjen e njohjes në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), Paris nr.14420/FM datë 25.07.2007: "La Petrolifera Italo-Rumena" Spa. dhe "La Petrolifera Italo-Albanese" Sha. kundër Republikës së Shqipërisë⁶⁰⁹, Gjykata e Apelit shprehet: “Vendimi i dhënë prej Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) ka qenë në kompetencën e saj dhe ky forum nuk ka patur ndonjë pengesë ligjore për të shqyrtuar çështjen⁶¹⁰. Kompetenca e forumit mbështetet në nenin 17 të Marrëveshjes së Konçesionit të datës 24.05.2004, të lidhur midis palëve, ku parashikohet se: "Të gjitha mosmarrëveshjet që do të dalin apo rrjedhin nga kjo Marrëveshje e Konçesionit për, do të trajtohen e zgjidhen mëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar (siç parashikohet në nenin 17 të Ligjit nr.7973 datë 26.07.1995), në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, nga një ose më shumë arbitra, të caktuar në përputhje me Rregullat e sipërpërmendura. Arbitrat do të zbatojnë dhe marrin vendime duke u bazuar në të

⁶⁰⁹ Kërkesa e regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me nr.1779 prot. datë 28.09.2007; Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.104 regj.themeltar, nr.106 i vendimit datë 08.11.2007.

⁶¹⁰ Më datë 24.05.2004, bazuar në ligjin nr.9231 datë 13.05.2004, ndërmjet shoqërisë "La Petrolifera Italo-Rumena" Spa. ("konçesionari") dhe Qeverisë së RSh ("shteti") u nënshkruan dy marrëveshje konçisioni dhe konkretisht: marrëveshja BOO "Për ndërtimin dhe dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar", për depozitimin e naftës dhe nënprodukteve të saj, në gjirin e Vlorës" dhe marrëveshja BOT "Për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në gjirin e Vlorës". Ligji nr.9231 për miratimin e këtyre dy marrëveshjeve hyri në fuqi më datë 21.06.2004, që është edhe data e hyrjes në fuqi të marrëveshjeve të konçesionit. Sipas këtyre dy marrëveshjeve, palëve u lindi disa te drejta për të përmbushur brenda afateve të përcaktuara. Konçesionari kishte detyrimin të përfundonte projektin përfundimtar, brenda 9 muajsh, detyrim të cilin ai e përmbushi disa muaj para afatit. Pas dorëzimit të projektit, shteti i lindi detyrimi që, brenda 60 ditëve, të pajiste konçesionarin me të gjitha konçesionet, lejet dhe autorizimet përkatëse, si dhe të transferonte titullin e pronësisë nga shteti tek konçesionari, me qëllim që ky i fundit të fillonte ndërtimin e terminalit dhe infrastrukturës portuale. Por këto detyrim shteti nuk arriti t'i përmbushte për një kohe prej rreth dy vjetesh dhe nga kjo mospërmbushje e detyrimeve të Marrëveshjes BOO, konçesionarit iu shkaktuan dëme të konsiderueshme. Në këto kushte konçesionari, në zbatim të nenit 17 të Marrëveshjes BOO, iu drejtuar më datë 12.06.2006, Arbitrazhit Ndërkombëtar në Paris. Pas shumë negociatash, palët ranë dakort të zgjidhin me pajtim mosmarrëveshjet midis tyre, të cilat ishin bërë shkak për fillimin e procedimit arbitral. Kështu, ndërmjet shtetit dhe konçesionarit u arrit të nënshkruhet Marrëveshja e Zgjidhjes me Mirëkuptim, e cila u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.235 datë 27.04.2007. Sipas kësaj marrëveshje të fundit, shteti njohu mospërmbushjen detyrimeve nga ana e tij, dëmet e shkaktuara konçesionarit për pasojë, si dhe mori përsipër t'i kompensonte këto dëme, sipas shumave të rëna dakort. Gjithashtu shteti pranoi të përmbushte detyrimet e tij brenda një afati të caktuar në Marrëveshjen e Zgjidhjes me Mirëkuptim. Nga ana e tij, konçesionari ra dakort të hiqte dorë nga kompensimi i dëmeve (pjesës tjetër) në rast se shteti përmbushte detyrimet e papërmbushura. Marrëveshja e Zgjidhjes me Mirëkuptim, pas nënshkrimit dhe miratimit me VKM, iu paraqit Arbitrazhit Ndërkombëtar, i cili i dha kësaj marrëveshje formën e vendimit përfundimtar me vendimin nr.14420/FM datë 25.07.2007. Objekti i Vendimit final të Arbitrazhit të huaj ishte pikërisht: "Konstatimi se palët e kanë zgjidhur plotësisht mosmarrëveshjen midis tyre, sipas Marrëveshjes së Zgjidhjes me Mirëkuptim dhe se palët kanë hequr dorë nga të gjitha pretendimet e tyre në këtë procedurë arbitrazhi" dhe "Urdhërimet e palëve të zbatojnë kushtet e Marrëveshjes së Zgjidhjes me Mirëkuptim".

drejtën Franceze. Vendi i arbitrazhit do të jetë Parisi. Gjuha e arbitrazhit do të jetë anglishtja. Vendimi i dhënë nga arbitri do të jetë detyrues dhe përfundimtar për palët".

iv) Në çështjen e njohjes në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), të datës 19.10.2009, për çështjen me nr.14869/A VH/JEM/GZ: "Shoqëria "ROHDE NIELSEN" A/S kundër Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë"⁶¹¹, Gjykata e Apelit ka konstatuar: "*Midis palës kërkuese (Shoqëria "ROHDE NIELSEN" A/S) subjekt i të drejtës Daneze, në cilësinë e sipërmarrësit dhe personit të tretë (Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë) në cilësinë e porositësit, është lidhur një kontratë sipërmarrje (nr.AlbPIU EIB.E.D, Nr.3, qershor 2004) me objekt "Gërmimin nënujor në portin e Durrësit"*⁶¹². Pjesë e kësaj kontrate është dhe klauzola e arbitrazhit, nëpërmjet të cilës, palët kanë rënë dakort për të zgjidhur mosmarrëveshjet midis tyre në arbitrazhin ndërkombëtar, në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC)"⁶¹³.

Së dyti, kompetenca apo mungesa e kompetencës së forumit të arbitrazhit, duhet të provohet prej Gjykatës së Apelit nëpërmjet vlerësimit të *arbitrueshmërisë* së çështjes apo çështjeve objekt konflikti në arbitrazh. Është pikërisht momenti që Gjykata e Apelit, në

⁶¹¹ Kërkesa e regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me nr.1497 prot. datë 11.10.2010; Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.108 regi.themeltar datë 18.10.2010, nr.122 i vendimit datë 14.12.2010.

⁶¹² Midis palës kërkuese (Shoqëria "ROHDE NIELSEN" A/S) subjekt i të drejtës Daneze, në cilësinë e sipërmarrësit dhe personit të tretë (Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë) në cilësinë e porositësit, është lidhur një kontratë sipërmarrje (nr.AlbPIU EIB.E.D, Nr.3, qershor 2004) me objekt "Gërmimin nënujor në portin e Durrësit". Pjesë e kësaj kontrate është dhe klauzola e arbitrazhit, nëpërmjet të cilës, palët kanë rënë dakort për të zgjidhur mosmarrëveshjet midis tyre në arbitrazhin ndërkombëtar, në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC). Neni 15.3 i Pjesës A të Kushteve të Kontratës: "Arbitrazhi" parashikon se: *Përveç rastit të zgjidhjeve me pajtim, çdo mosmarrëveshje në lidhje me të cilën vendimi i DAB (nëse ka) nuk është përfundimtar dhe detyrues, do të zgjidhet përfundimisht me arbitrazh ndërkombëtar. Përveç rastit kur palët bien dakort ndryshe, mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë; mosmarrëveshja do të zgjidhet nga tre arbitra, të caktuar në përputhje me rregulloren; arbitrazhi do të zhvillohet në gjuhën angleze. Ligji që rregullon kontratën është ligji në fuqi në RSh. Më datë 02.03.2007, shoqëria "Rohde Nielsen" A/S ka paraqitur në Sekretarinë e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë një kërkesë për arbitrazh, me të cilën ka kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura midis saj dhe porositësit (MT). Kjo kërkesë është marrë në shqyrtim nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, e cila në seancën e datës 20.07.2007, sipas Rregullores, ka caktuar Kryetarin e Gjykatës së Arbitrazhit që do të gjykonte kërkesën e paraqitur. Më tej dy arbitrat e tjerë (gjykata e arbitrazhit përbëhet nga tre arbitra) janë emëruar nga palët në mosmarrëveshje⁶¹². Në vijim, gjykata arbitrazhit është mbledhur në Londër, ku ka shqyrtuar mosmarrëveshjen, ka dëgjuar pretendimet e palëve dhe ka marrë provat e paraqitura nga ato. Vendi i zhvillimit të arbitrazhit dhe i dhënies së vendimit është Londra, Mbretëria e Bashkuar.*

⁶¹³ Neni 15.3 i Pjesës A të Kushteve të Kontratës: "Arbitrazhi" – Përveç rastit të zgjidhjeve me pajtim, çdo mosmarrëveshje në lidhje me të cilën vendimi i DAB (nëse ka) nuk është përfundimtar dhe detyrues, do të zgjidhet përfundimisht me arbitrazh ndërkombëtar. Përveç rastit kur palët bien dakort ndryshe, mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë; mosmarrëveshja do të zgjidhet nga tre arbitra, të caktuar në përputhje me rregulloren; arbitrazhi do të zhvillohet në gjuhën angleze. Ligji që rregullon kontratën është ligji në fuqi në RSh".

interpretimin e saj, të vendosë lidhje më dispozitën e pjesës së parë, të paragrafit të dytë, të nenit 5 të Konventës së Nju Jork-ut, e cila e parashikon *mos-arbitrueshmërinë* e konfliktit si një pengesë të njohjes së vendimit të arbitrazhit, të vleresueshme kryesisht nga gjykata që shqyrton kërkesën për njohje⁶¹⁴. Për më tepër, çështja e arbitrueshmërisë, në frymën e Konventës së Nju Jork-ut, duhet ngritur nga gjykata kompetente, që shqyrton kërkesën për njohje (Gjykata e Apelit), që në momentin kur ajo vlerëson dhe shprehet për njohjen e marrëveshjes së arbitrazhit të huaj, si një marrëveshje e vlefshme, e aftë të prodhojë pasojën e përjashtimit të juridiksionit të gjykatës nacionale. Kështu, në nenin 2(1) të saj, Konventa e Nju Jork-ut shprehet në mënyrë implicite se shtetet kontraktuese kanë autoritetin të mos e njohin marrëveshjen e shkruar të arbitrazhit, nëse ajo ka për objekt mosmarrëveshje, që kanë lidhje me çështje, të cilat mund të mos rregullohen me anë arbitrazhi, pra që konsiderohen *të pa-arbitrueshme*.

Sikurse e kemi përmenduar më sipër, *arbitrueshmëria* është një zgjedhje individuale e rendeve juridikë nacionalë. Shtetet që ndjekin traditën e civil-law, përdorin legjislacionin e brendshëm për të identifikuar kufirin midis çështjeve të arbitrueshme dhe të pa-arbitrueshme. Kriteri që përdoret kryesisht për këtë qëllim, është pikërisht dallimi midis pretendimeve që janë dhe atyre që nuk janë të mundshme për t'u disponuar lirisht prej vullnetit të palëve. Me fjalë të tjera, legjislacioni dallon se cilat janë marrëdhëniet në të cilat shoqëria, ose shteti, ka interesa për të arritur një rezultat të caktuar dhe për rrjedhojë rregullat e vendosura nga ky i fundit, për të siguruar këtë qëllim, nuk mund të anashkalojnë apo tejkalohen nga disponimi i vullnetit të palëve në këto marrëdhënie. Janë pikërisht këto çështje, ku rregullimet imperative imponohen nga shteti në mënyrë të detyrueshme (nëpërmjet mandatory rules), të cilat konsiderohen të pa-arbitrueshme, pra në të cilat, arbitrazhi nuk mund të shtrijë efektin e tij.

Parimi klasik mbi arbitrueshmërinë e çështjeve orienton se të gjitha mosmarrëveshjet, rregullimi i të cilave varet nga liria e palëve për të negociuar, mund t'i nënshtrohen arbitrazhit. Kategoritë si marrëdhëniet tregtare, të punës, të investimeve, etj., janë sfera ku të drejtat e palëve përvijohen nga përcaktimet kontraktore, të realizuara nga ata vetë. Në kontrast me to, ka sfera që janë konsideruar si të paarritshme për negociatat e palëve; të tilla janë, për shembull, konfliktet me karakter penal, ato që lidhen me rendin publik, me

⁶¹⁴ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(2): “Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi të arbitrazhit mund të refuzohen gjithashtu në qoftë se autoriteti kompetent i vendit ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi konstaton se: objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi, sipas ligjit të atij vendi, ose njohja ose ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me rendin publik të këtij vendi”.

ushtrimin e funksioneve publike, me të drejtën e konkurrencës, apo disa nga çështjet me natyrë familjare.

Nëse do t'i referohemi praktikës ndërkombëtare, pavarësisht nga lloji i sistemit ligjor të ndjekur prej shtetit konkret (*civil law* apo *common law*), kryesisht fushat, konfliktet e të cilave janë konsideruar të pa-arbitrueshme, janë: fusha *antitrust*⁶¹⁵, fusha e sigurimeve, pronësisë intelektuale, dëmet që vijnë nga zgjidhja e njëanshme e marrëveshjeve eskluze të shpërndarjes, embargot politike, falimetimi dhe kontratat administrative⁶¹⁶. Megjithatë kjo ndarje ka filluar të humbasë konturet e saj. Përmendim për ilustrim se në mënyre tipike çështjet e taksave janë të një natyre publike dhe për një kohë të gjatë janë konsideruar të pa-arbitrueshme, por në kuadër të nxitjes së paleve për t'iu drejtuar arbitrazhit, në disa vende ka filluar të ndryshojë qëndrimi ndaj arbitrueshmerisë së kësaj sfere⁶¹⁷.

Sa më sipër, edhe në rastin e Shqipërisë, Gjykata e Apelit, e investuar për njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj, duhet të vlerësojë me kujdes arbitrueshmërinë e çështjes apo të çështjeve objekt konflikti në arbitrazh, duke u mbështetur në legjislacionin e brendshëm Shqiptar. Sipas këtij të fundit, dispozita bazë që përkufizon sferën e çështjeve të arbitrueshme është nenin 403 i K.Pr.C, i cili (sikurse e kemi përmendur edhe me sipër) e kufizon *arbitrueshmërinë* vetëm në konfliktet që burojnë nga një kontratë⁶¹⁸, duke lënë jashtë objektit të veprimit të arbitrazhit mosmarrëveshjet jashtëkontraktore, si. psh ato të shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor, marrëdhëniet e begatimit pa shkak, pronësisë intelektuale, etj. Gjithashtu, sipas legjislacionit Shqiptar, do të konsiderohen të paarbitrueshme konfliktet që burojnë nga marrëdhëniet e krijuara prej veprimtarisë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike, e ushtruar nëpërmjet akteve administrative. Gjykata e Apelit duhet të mos njohë si të vlefshme marrëveshjen e arbitrazhit të huaj, që ka për objekt zgjidhjen e konflikteve në fushat e mësipërme. Kjo do të çojë, për pasojë, në mos-njohjen e kompetencës së forumit të arbitrazhit të huaj, që ka dhënë vendimin, duke u konsideruar, në dritën e parashikimit të

⁶¹⁵ Një gjykatë e SHBA mund të kundërshtojë njohjen dhe zbatimin e një vendimi, që involvon arbitrazhin për një pretendim *antitrust*, në këndvështrimin e çështjeve të arbitrazhit të brendshëm, të cilat kanë mbështetur idenë që çështje të tilla duhet t'i besohen kompetencës eskluzeve të gjyqësorit; Shiko psh. çështjen: “American Safety Equipment Corp. kundër J.P. Maguire & Co.”, 391 F.2d 821 (2d Cir.1968).

⁶¹⁶ Tibor Varady, John J. Barcelo - “Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Një “Perspektivë Transnacionale” (Seria Amerikane e librave të çështjeve), botimi i katërt, 2009, f.233.

⁶¹⁷ Kyriaki Karadelis, “Gjykata Australiane ia nënshtron mosmarrëveshjen për taksat arbitrazhit”, Përmbledhja Globale e Arbitrazhit, 15 Mars 2010: *Gjykata Supreme e Victorias në Melburn ka penguar një palë që të anashkalojë arbitrazhin në një mosmarrëveshje mbi detyrimet tatimore për operacionet e naftës në Detin e Timorit* (<http://globalarbitrationreview.com/news/article/27911/>).

⁶¹⁸ K.Pr.C, neni 403 “Marrëveshja e arbitrazhit”: *Mund të gjykohet me procedurë arbitrazhi vetëm në qoftë se ekziston një marrëveshje e palëve, me anë të së cilës ato pranojnë t'ia nënshtrorjnë arbitrazhit mosmarrëveshjet që kanë lindur ose mund të lindin nga një kontratë e lidhur ndërmjet tyre.*

nenit 394(a) të K.Pr.C, si shkak i ligjshëm për refuzimin e njohjes së vendimit të arbitrazhit të huaj në Republikën e Shqipërisë.

Të dy momentët e mësipërme, ekzistenca e një *marrëveshje arbitrazhi* të vlefshme dhe *arbitrueshmëria* e konfliktit, duhet dhe mund të vlerësohen nga Gjykata e Apelit pa asnjë problem, në kushtet kur Kodi i Procedurës Civile nuk e pengon, ndërkohë që Konventa e Nju Jork-ut e kërkon si të detyrueshme një analizë të tillë, prej autoritetit që akordon njohjen e vendimit të arbitrazhit (në rastin tonë prej Gjykatës së Apelit)⁶¹⁹. Por, për fat të keq, problemi që konstatohet në praktikën gjyqësore Shqiptare është largimi nga qasja e Konventës së Nju Jork-ut mbi pengesat e njohjes, përse i përket arbitrueshmërisë së konfliktit, objekt shqyrtimi në arbitrazh. Në të gjitha rastet e jurisprudencës, të studiuara në këtë punim, evidentohet “indiferenca” e Gjykatës së Apelit për të vlerësuar arbitrueshmërinë e konfliktit, në momentin që vlerëson kompetencën e forumit të arbitrazhit të huaj për të zgjidhur çështjen, në funksion të verifikimit të kriterit pengues të njohjes, të parashikuar prej nenit 394, pika “a” të K.Pr.C⁶²⁰. Sikurse e përmendëm më sipër, Kodi i Procedurës Civile që rregullon njohjen e vendimeve të huaja, nuk e pengon Gjykatën e Apelit të vlerësojë të gjitha rrethanat e çështjes në fjalë, të cilat çenojnë kompetencën e forumit të arbitrazhit të huaj për të shqyrtuar këtë çështje dhe për të marrë vendim lidhur me të. Këto rrethana janë ekzistenca e një *marrëveshje arbitrazhi* të vlefshme dhe *arbitrueshmëria* e konfliktit, por, sikurse rezulton nga praktika, Gjykata e Apelit konsideron vetëm rrethanën e parë kur vlerëson kompetencën apo mungesën e kompetencës së forumit.

Në këtë pikë duhet theksuar se doktrina e arbitrazhit ndërkombëtar e promovon mundësinë e ngritjes se pretendimit mbi *arbitrueshmërinë e konfliktit* para gjykatës kompetente për shqyrtimin e kërkesës për njohje, të parashikuar nga dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut. Kështu, sipas kësaj doktrine, çështja e arbitrueshmërisë mund të ngrihet në katër momente të “jetës” së arbitrimin të një mosmarrëveshjeje: (a) përpara një gjykate nacionale e cila do të vendosë nëse do të zbatohet apo jo një marrëveshje arbitrazhi; (b) përpara vetë arbitrave, kur ata marrin në shqyrtim dhe vendosin mbi shtrirjen e kompetencës së tyre; (c) përpara një gjykate nacionale, përgjithësisht të shtetit ku arbitrazhi është zhvilluar, në përpjekjen për ta

⁶¹⁹ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5, par.2.

⁶²⁰ K.Pr.C, neni 394, pika “a”: .. sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja për të cilën bën fjalë vendimi nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës (forumit të arbitrazhit) të shtetit që ka dhënë vendimin.

anulluar vendimin e arbitrazhit; dhe në fund, (d) përpara një gjykate nacionale, të investuar për njohjen dhe zbatimin e një vendimi arbitrazhi të huaj⁶²¹.

Sa më sipër, arrijmë në përfundimin se, pavarësisht se ligji i brendshëm (K.Pr.C) e lejon dhe doktrina ndërkombëtare e stimulon kontrollin e *arbitrueshmërisë* së konfliktit nga gjykata nacionale, para së cilës kërkohet njohja e vendimit të arbitrazhit të huaj, praktika gjyqësore Shqiptare largohet nga kjo qasje e Konventës së Nju Jork-ut mbi pengesat e ekzekutimit të vendimit të arbitrazhit, pikërisht duke mos marrë në konsideratë dhe duke mos vlerësuar pengesën që krijon mos-arbitrueshmëria e çështjes objekt konflikti.

VI.3.2.2. Shkaku 2 – Kur, kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq (arbitrazh) nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet⁶²².

Kjo pengesë ligjore është vendosur për të siguruar respektimin e të drejtës për t'u mbrojtur të palës së paditur, kur gjykimi është zhvilluar në mungesë të saj. Procesi i arbitrazhit duhet të zhvillohet duke respektuar parimin e një procesi të rregullt e të barabartë për palet, ku përfshihet edhe e drejta për t'u mbrojtur e palës së paditur. Respektimi i kësaj të drejtë kërkon jo vetëm që palës së paditur t'i jetë dhënë njoftimi i rregullt për zhvillimin e seancave të gjykimit, por që t'i jetë dhënë edhe koha e mjaftueshme për t'u paraqitur dhe për të përgatitur një mbrojtje efektive.

Hetimi i gjykatës mbi këtë pikë është diskrecional edhe pse i nënshtrohet detyrimit për ta arsyetuar atë⁶²³. Në rastin e procedurave të arbitrazhit, njoftimi apo thirrja e palëve dhe paraqitja e tyre në gjykim bëhet sipas dispozitave të Rregullores përkatëse të forumit të arbitrazhit, që ka kompetencën e shqyrtimit të mosmarrëveshjes. Një shkak i tullë refuzues mund të konsiderohet analog i shkakut refuzues të parashikuar nga neni 5, pika 1(b), e Konventës së Nju Jork-ut (*...palës kundër së cilës jepet vendimi nuk i është dhënë njoftimi i rregullt për caktimin e arbitrit ose të procedurës së arbitrazhit, ose, ka qenë e paafte për të paraqitur rastin e saj*).

⁶²¹ Tibor Varady, John J.Barcelo - "Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Një "Perspektivë Transnacionale", botimi i katërt, 2009, f.234.

⁶²² K.Pr.C., neni 394, pika "b".

⁶²³ Alban Abaz Brati, "Procedura Civile", botimi i parë (bot.Dudaj), 2008, f.414.

VI.3.2.3. *Shkaku 3 - Kur, midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata Shqiptare*⁶²⁴.

Në këtë rast, pengesa ligjore e njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj justifikohet për shkak të paraqitjes së elementëve të "gjësë së gjykuar"⁶²⁵, një parim procedural ky i njohur ndërkombëtarisht dhe i pranuar edhe në rendin tonë juridik, në nenin 451/a të K.Pr.C⁶²⁶, i cili, ndër të tjera, parashikon që: "...Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe". Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në çështjen "Macovei dhe të tjerë kundër Moldavisë", ka përdorur këtë interpretim për parimin e gjësë së gjykuar: "...parimi i sigurisë juridike presupozon respekt për parimin e res judicata (gjë e gjykuar), që është parim i gjykimeve përfundimtare. Ky parim kërkon që asnjë palë të mos legjitimohet të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë, të detyrueshëm për zbatim, vetëm me qëllimin për të pasur një ridëgjim dhe një përcaktim apo mbyllje të ndryshme të çështjes nga vendimi i parë përfundimtar...". E njëjta Gjykatë, në çështjen "Driza kundër Shqipërisë", rithekson se: "...siguria juridike presupozon zbatimin e parimit të gjësë së gjykuar, që është dhe parimi i përfundimit të gjykimeve. Një përjashtim nga ky parim është i justifikuar vetëm kur është e domosdoshme, nisur nga rrethanat e një karakteri thelbësor dhe bindës të çështjes"⁶²⁷.

VI.3.2.4. *Shkaku 4 - Kur, është duke u shqyrtuar nga gjykata Shqiptare një padi, që është ngritur përpara se vendimi i arbitrazhit të shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë*⁶²⁸.

Një pengesë e tillë është vlerësuar nga gjykata Shqiptare në çështjen "Njohja në Republikën e Shqipërisë e Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), të datës 19.10.2009 (nr.14869/A VH/JEM/GZ): "Shoqëria "ROHDE NIELSEN" A/S kundër Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së

⁶²⁴ K.Pr.C., neni 394, pika "c".

⁶²⁵ Jani Vasili, "Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë", (Gervis), 2005, f.196.

⁶²⁶ Neni 451/a i K.Pr.C, shtuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001 (neni 77): "Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe".

⁶²⁷ Elsa Toska Dobjani; "Parimi i Sigurisë Juridike"; Revista Juridike "Jeta Juridike" nr.4 Dhjetor 2008, Shkolla e Magjistraturës.

⁶²⁸ K.Pr.C., neni 394, pika "ç".

Shqipërisë"⁶²⁹. Kështu, në lidhje me këtë pikë, Gjykata e Apelit shprehet: "*Nuk është duke u zhvilluar asnjë proces gjyqësor me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt në gjykatat Shqiptare, çka kërkuesi e ka vërtetuar me shkresën nr.6115/1 datë 15.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilën konfirmohet fakti se para saj nuk kishte për gjykim çështje civile me palë shoqëria "Rohde Nielsen" A/S*".

Pengesën ligjore të mësipërme e konsideroj të tepërt në grupin e shkaqeve, të cilat mund të justifikojnë refuzimin nga Gjykata e Apelit për t'i dhënë fuqi një vendimi arbitrazhi të huaj. Duke mos marrë përsipër të bëj interpretime zyrtare të dispozitës, por vetëm me analizën e një praktikanti të ligjeve, këtë konkluzion e mbështes në argumentimin e mëposhtëm:

Së pari, një parashikim i tillë për të penguar njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj, i tejkalon kushtet e njohura si *shkaqe refuzuese* për njohjen e një vendimi arbitrazhi të huaj, të parashikuara nga vetë Konventa e Nju Jork-ut⁶³⁰. Sikurse e përmendëm në kapitullin përshkrues të Konventës, neni 5 i saj i liston *shkaqet refuzuese* në mënyrë shteruese, duke mos krijuar asnjë hapësirë interpretuese për t'i dhënë mundësi aplikimit të *shkaqeve* refuzuese të tjera, pavarësisht nga ngjashmëria me *shkaqet* e nenit 5, apo pavarësisht nga nevoja praktike për aplikimin e tyre.

Së dyti, një pengesë e tillë përfundimtare për njohjen e vendimit të arbitrazhit, gjykoj se bie ndesh me detyrimet që shteti ynë ka marrë përsipër, duke miratuar Konventën e Nju Jork-ut, konkretisht me detyrimin *për të ndaluar apo përjashtuar juridiksionin e gjykatës kombëtare kur midis palëve ka një marrëveshje të vlefshme arbitrazhi*⁶³¹. Në zbatim të këtij detyrimi, gjykata Shqiptare, nëse është duke shqyrtuar një padi, duhet të deklarojë mungesën e juridiksionit kur midis palëve ka një marrëveshje të tillë. Mjafton paraqitja e marrëveshjes së arbitrazhit nga një palë e interesuar që gjykata të deklarojë mungesën e juridiksionit. Në këto kushte, fakti që gjykata Shqiptare po shqyrton një padi në kushtet e mungesës së juridiksionit (pavarësisht se ende nuk e ka deklaruar atë), nuk duhet të pengojë - të paktën jo përfundimisht - njohjen dhe zbatimin e një vendimi arbitrazhi të huaj, sikurse bën parashikimi i mësipërm i Kodit të Procedurës Civile.

⁶²⁹ Kërkesa e regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me nr.1497 prot. datë 11.10.2010; Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.108 regj.themeltar datë 18.10.2010, nr.122 i vendimit datë 14.12.2010.

⁶³⁰ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5.

⁶³¹ *Id.*, neni 2, paragrafi 3 "*Gjykata e njërit shtet kontraktues, kur është e angazhuar në një padi për një çështje për të cilën palët kanë bërë një marrëveshje sipas kuptimit të këtij neni, me kërkesën e një prej palëve ia referon palët arbitrazhit....*"

Së treti, e përmendem më sipër që Kodi i Procedurës Civile bën një parashikim të veçantë në lidhje me kompetencën e forumit të arbitrazhit, kur parashikon si një pengesë ligjore, madje pengesën e parë, për njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj, faktin se *sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e forumit të arbitrazhit të shtetit që ka dhënë vendimin*⁶³². Pra, çështjen e kompetencës së forumit të arbitrazhit të huaj Gjykata e Apelit duhet ta verifikojë që në fillim të hetimit gjyqësor, gjatë procesit të njohjes së vendimit të arbitrazhit dhe nëse bindet për vlefshmërinë e saj (kompetencës) e konsideron të kaluar, pra të pavërtetuar, këtë pengesë ligjore. Vlefshmëria e kompetencës së forumit të arbitrazhit nënkupton vërtetimin indirekt të mungesës së kompetencës së gjykatës Shqiptare për të shqyrtuar këtë mosmarrëveshje. Prandaj Gjykata e Apelit nuk duhet ta vlerësojë si pengesë ligjore, të njohjes së një vendimi arbitrazhit të huaj, faktin se një Gjykatë e zakonshme Shqiptare po shqyrton një padi në lidhje me mosmarrëveshjen objekt të vendimit të arbitrazhit, sepse gjykata Shqiptare nuk ka kompetencën ta shqyrtojë atë (padinë), fakt të cilin Gjykata e Apelit e ka vërtetuar tashmë në momentin kur ka vërtetuar juridiksionin e forumit të arbitrazhit. E thënë shkurt, vlerësimi i pengesës ligjore të njohjes të parashikuar në pikën "ç" të nenit 394, konsiderohet i tejkaluar me vlerësimin e pengesës ligjore të parashikuar në pikën "a" të po këtij neni, pra gjykoj se kemi të bëjmë me një pengesë të përsëritur.

Së katërti, një parashikim i tillë (neni 394, pika "ç") mund të përdoret me qëllim, si një pengesë artificiale për njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj, nga pala kundër të cilës drejtohet vendimi. Kjo e fundit mund të ngrejë një padi në një gjykatë Shqiptare qëllimisht për të penguar më pas njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj, në shtetin tonë. Kështu psh, në rastin e sipërpërmendur, Gjykata e Apelit do të kishte dhënë një vendim për të mos njohur Vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (për çështjen me nr.14869/A VH/JEM/GZ), mjafton që pala Shqiptare e interesuar të paraqiste një vërtetim ku të konfirmohej fakti se *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë kishte para saj për gjykim një çështje civile me palë shoqërinë "Rohde Nielsen" A/S dhe me të njëjtin objekt*. Kjo do të cënonte seriozisht frymën e Konventës së Nju Jork-ut, qëllimi i të cilës është lehtësimi i kushteve për njohjen vendimeve të arbitrazhit të huaj.

⁶³² K.Pr.C., neni 394, pika "a".

*VI.3.2.5. Shkaku 5 - Kur, vendimit të arbitrazhit të huaj i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e zbatuar prej tij*⁶³³.

Një pengesë e tillë për njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj, duhet vlerësuar duke i'u referuar dispozitave të rregullores së forumit të arbitrazhit dhe legjislacionit procedural të vendit të arbitrazhit. Kështu, në çështjen "Njohja dhe zbatimi në Republikën e Shqipërisë i Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006: AEDP kundër Republikës së Shqipërisë"⁶³⁴, Gjykata e Apelit shprehet: "*Vendimi i Arbitrazhit të Huaj Ndërkombëtar, i dhënë nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) Paris, Francë, është përfundimtar dhe ndaj tij, sipas Rregullores*⁶³⁵ *përkatëse, nuk lejohet ankim*".

Këtij shkaku refuzues, të parashikuar prej nenit 394(d), i përgjigjet edhe parashikimi i nenit 396 të K.Pr.Civile⁶³⁶, i cili kërkon domosdoshmërisht paraqitjen, si një nga dokumentat që pala e interesuar duhet t'i bashkëngjisë kërkesës për njohje, e vërtetimit që "*vendimi i arbitrazhit ka marrë formë të prerë*". Një shkak i tillë mund të justifikohet me kërkesën që njohja e vendimeve të arbitrazhit i mundësohet vetëm vendimeve finale të arbitrazhit dhe jo atyre të ndërmjetëme. Megjithatë, formulimi i kësaj pengese në një dispozitë të Kodit të Procedurës Civile, le për të dëshiruar. Në fakt, një kërkesë e tillë e parashikuar nga K.Pr.C, për të mos njohur vendime të ndërmjetëme, i referohet vendimeve të gjykatave shtetërore të huaja, por në dritën e nenit 399, sikurse të gjitha parashikimet e këtij kreu⁶³⁷, ky parashikim do të aplikohet njëloj duke pamundësuar edhe njohjen dhe zbatimin e një vendimi të ndërmjetëm arbitrazhi.

Praktika gjyqësore Shqiptare e ka mbështetur rigorozisht këtë interpretim të ngushtë, të paktën për vendimet e gjykatave shtetërore të huaja. Në këtë pike, do të ishte me shumë interes të përmendej analiza e Gjykatës së Apelit⁶³⁸, mbi kërkesën e paraqitur nga Sky

⁶³³ *Id.*, neni 394, pika "d".

⁶³⁴ Çështja civile me nr.22 i Regj.Themeltar, datë 22.02.2007, që i përket Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.54, datë 29.05.2007.

⁶³⁵ Rregullat e Arbitrazhit të ICC, neni 28 (International Chamber of Commerce, International Court of Arbitration) të vlefshme nga 1 janari 1998; website - www.iccarbitration.org.

⁶³⁶ K.Pr.C, neni 396: "*Kërkesës për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet t'i bashkëngjiten: (a) kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri; (b) vërtetim nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimi e legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit ashtu edhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë; (c) prokura, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri*".

⁶³⁷ K.Pr.C., Kreu 9 i Titullit III "Për njohjen e vendimeve të shteteve të huaja (të gjykatave shtetërore)".

⁶³⁸ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë Nr.34 Regj.Themeltar, datë 08.02.2012; Nr.32/1010 Vendimi, datë 01.03.2012.

Petroleum INC për njohje të Vendimit të Gjykatës së Teksasit SHBA, me objekt “Sigurimin e objektit të padisë”⁶³⁹. Gjykata e Apelit Tiranë konkludoi se “Vendimi i ndërmjetëm i Gjykatës së Teksasit SHBA, nëpërmjet të cilit disponohej marrja e masave të sigurimit të objektit të padisë, nuk ka marrë formë të prerë sipas parimeve bazë të legjislacionit Shqiptar. Për rrjedhojë kërkesa e paraqitur nga Sky Petroleum INC për njohje të këtij vendimi nuk është e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të rrëzohet”. Gjykata, për këtë analizë, i referohet pikërisht parashikimit të nenit 394(d) dhe 396 të K.Pr.Civile, ku parashikohet se: “Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur... i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij” dhe “Kërkesës për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet t'i bashkëngjiten....vërtetimi nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë”.

Një interpretim tillë, edhe pse në dukje i bazuar në ligj, nuk duket krejtësisht i saktë kur çështja shtrohet për të njohur dhe ekzekutuar një vendim të ndërmjetëm arbitrazhi. Sikurse analizuam në kapitullin e III-të⁶⁴⁰, pavarësisht se fryma e Konventës e Nju Jork-ut i referohet në përgjithësi ekzekutimit të vendimeve finale të arbitrazhit, kjo nuk do të thotë se duhen përjashtuar apriori nga efekti i Konventës vendimet e ndërmjetëme, apo të përkohshme të arbitrazhit. Do të jetë pikërisht përmbajtja substanciale e vendimit të ndërmjetëm dhe efekti që prodhon ai, faktorët që duhen konsideruar si determinant në përcaktimin e karakterit final të vendimit të arbitrazhit⁶⁴¹. Në këtë llogjikë, edhe një vendimi të ndërmjetëm arbitrazhi duhet t'i garantohet mundësia për t'iu nënshtruar efektit njohës të dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut.

⁶³⁹ Nëpërmjet Kontratës së Hidrokarbure për Ndarjen, Prodhimin Zbulimin, Zhvillimin dhe Prodhim Hidrokarburesh (marrëveshje hidrokarburesh), Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) i ka dhënë shoqërisë “Sky Petroleum INC” operimin e Bllokut 4, 5 si dhe Bllokut të Dumrese. Si rrjedhojë e një mosmarrëveshje që ka lindur në lidhje me pretendimin e mospërmbushjes së disa detyrimeve kontraktore, AKBN i ka njoftuar shoqërisë Sky Petroleum INC, zgjidhjen e kontratës së sipërpërmendur. Sky Petroleum INC, duke mos qenë dakort me shkaqet dhe procedurën e ndjekur për zgjidhjen e kontratës, e ka referuar mosmarrëveshje pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) në Zvicër sipas rregullave të UNCITRAL. E drejta për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëpërmjet arbitrazhit ndërkombëtar është parashikuar në nenin XXI të marrëveshjes së hidrokarbureve, e titulluar “Mosmarrëveshjet dhe arbitrimi” e cila parashikon se: “Çdo mosmarrëveshje, konflikt, pretendim apo debat opinionesh që buron ose ka lidhje me këtë kontratë ose me shkelje, përfundimin ose vlefshmërinë e saj, në lidhje me operacionet e hidrokarbureve të kryera më poshtë do të zgjidhen përfundimisht me arbitrazh, në përputhje me rregullat e arbitrazhit të UNCITRAL”. Kërkuesi, Sky Petroleum INC, është një shoqëri e të drejtës së SHBA. Ajo ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Teksasit SHBA, me objekt marrjen e masës për sigurimin e padisë, për t'i paraprirë padisë që ka paraqitur pranë Arbitrazhit Ndërkombëtar të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) në Zyrë, Zvicër. Gjykata e Teksasit ka pranuar kërkesën nëpërmjet një vendimi të ndërmjetëm, me të cilin ka urdhëruar marrjen e masës së sigurimit të objektit të padisë.

⁶⁴⁰ Shiko *supra* nënseksionin III.4.1. Llojet e vendimeve dhe efekti i Konventës mbi ta.

⁶⁴¹ Shiko çështjen “Yasuda Fire & Marine Ins. Co. of Europe kundër Continental Casualty Company”, 37 F.3d, 345 (7th Cir.1994): “Urdhëri i përkohshëm i sigurimit” u konsiderua si vendim final sipas Ligjit Federal të Arbitrazhit të SHBA.

Sa më sipër, gjykoj se do të ishte me vend të vlerësojmë nevojën për të ridimensionuar interpretimin e kërkesës së “ngurtë” të parashikuar nga K.Pr.C⁶⁴² për vendimet e gjykatave shtetërore të huaja, duke mos e konsideruar karakterin përfundimtar të vendimit si një kriter absolutisht të domosdoshëm për njohjen e tij, pikërisht kur bëhet fjalë për një vendim të ndërmjetëm arbitrazhi të huaj. Natyra “përfundimtare” duhet të vlerësohet, rast pas rasti, nga gjykata që shqyrton kërkesën për njohje të vendimit të arbitrazhit, duke mbajtur gjithnjë parasysh përmbajtjen substanciale të vendimit (qoftë edhe të vendimit të ndërmjetëm), si dhe pasojat që ai prodhon për palët në gjykim.

VI.3.2.6. Shkaku 6 - Kur, vendimi i arbitrazhit të huaj nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit Shqiptar⁶⁴³.

Në çështjen "Njohja në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Arbitrazhit të huaj LCIA nr.5720 datë 04.06.2006: “McKinsey & Comany Inc.Croatia kundër Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Agjencisë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja”⁶⁴⁴, Gjykata e Apelit shprehet: "*vendimi i arbitrazhit të huaj ndërkombëtar (LCIA) nuk bie ndesh me parimet bazë të legjislacionit shqiptar*". Kjo pengesë ligjore për njohjen presupozon faktin që, për t'i dhënë fuqi vendimit të arbitrazhit të huaj është e domosdoshme që urdhërimet e tij të mos jenë në kundërshtim me parimet e të drejtës Shqiptare. Vlen të theksohet se për këtë kusht, nuk ka rëndësi rregulla e normës juridike materiale apo procedurale që aplikohet nga forumi i arbitrazhit, por kanë rëndësi vetëm efektet apo pasojat që rrjedhin nga njohja e vendimit të arbitrazhit të huaj dhe përputhshmëria e këtyre efekteve me parimet bazë të legjislacionit Shqiptar⁶⁴⁵.

Në fakt, në të gjitha rastet e analizuara nga praktika, vendimi i Gjykatës së Apelit kur vlerëson pengesat e njohjes përdor termin "*parimet bazë të legjislacionit Shqiptar*", duke shprehur faktin se gjykata ka vlerësuar nëse vendimi konkret i arbitrazhit të huaj nuk bie ndesh me këto parime. Në këto raste, Gjykata e Apelit i ka qëndruar besnike përkufizimit juridik të përdorur në pikën (dh) të nenit 394 të K.Pr.C. Ndërkohë që Konventa e Nju Jork-ut, për të njëjtin qëllim, parashikon si definicion atë të "*rendit publik*"⁶⁴⁶, definicion i cili është i

⁶⁴² Të parashikuar bashkërisht nga neni 394(d) dhe 396 i K.Pr.C.

⁶⁴³ K.Pr.C., neni 394, pika “dh”.

⁶⁴⁴ Çështja e regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë me nr.93/1 të regj.themeltar datë 30.11.2006; Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.17 datë 27.02.2007.

⁶⁴⁵ Alban Abaz Brati, Procedura Civile, botimi i parë, (bot.Dudaj) 2008, f.415.

⁶⁴⁶ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5, par.2: “Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi të arbitrazhit mund të refuzohen gjithashtu në qoftë se autoriteti kompetent i vendit ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi konstaton se: (a) objekti i

ndryshëm në shtete të ndryshme. Në fakt, ka qënë dhe është shumë e vështirë për të përkufizuar një politikë të tillë publike. Përveç defekteve që mund të ketë një sistem ligjor kombëtar, është e qartë se është e pamundur për gjyqtarët lokalë për të përcaktuar dhe zbatuar *politikën publike*, si një parim uniform që zbatohet nga të gjitha gjykatat e shtetit⁶⁴⁷. Nëse do t'i referohemi historisë legjislative të Konventës (*travaux préparatoires*), interpretimi i këtij definicioni nënkupton mundësinë e gjykatës së shtetit, ku kërkohet njohja, që të refuzojë zbatimin e një vendimi arbitrazhi të huaj, i cili është haptazi në kundërshtim apo në mashtrim të ligjit, që është dhunues i të drejtave apo lirive themelore, apo skandaloz në përmbajtjen e tij⁶⁴⁸. Panvarësisht termit të përdorur në këtë pikë, mund të konkludojmë se praktika gjyqësore Shqiptare shkon paralel më frymën e Konventës së Nju Jork-ut, përse i përket kësaj pengese të njohjes dhe zbatimit të vendimit të arbitrazhit të huaj.

VI.3.2.7. Barra e provës për të vërtetuar pengesat e njohjes ndaj një vendimi arbitrazhi të huaj, në fokusin e legjislacionit të brendshëm.

Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile nuk parashikojnë se kush e ka barrën e provës për të provuar para Gjykatës së Apelit se një apo disa nga pengesat ligjore të mësipërme, janë përmbushur apo gjenden në vendimin e arbitrazhit, objekt të kërkesës për njohje. Në fakt, neni 397 përcakton se "*Gjykata e Apelit kontrollon nëse vendimi i paraqitur nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394*". Në vështrim të përgjithshëm të kësaj dispozite, kontrolli i të gjitha pengesave ligjore të parashikuara nga K.Pr.C⁶⁴⁹, nuk ndalohej të bëhet edhe kryesisht nga Gjykata e Apelit, pa u ngritur asnjë pretendim nga pala e interesuar, kundër të cilës kërkohet njohja e vendimit të arbitrazhit të huaj.

Në dallim të dukshëm nga ligji i brendshëm Shqiptar, Konventa e Nju Jork-ut në këtë pikë është e qartë kur parashikon detyrimin e pales, kundër të cilës shprehet vendimi, për të paraqitur prova për të kundërshtuar njohjen dhe zbatimin e një vendimi final arbitrazhi⁶⁵⁰. Sikurse e kemi analizuar në kapitullin që trajton veçoritë e Konventës, kjo e fundit parashikon (në nenin 5/1) pesë shkaqet e mbrojtjes së palës që kundërshton njohjen, apo, siç i

mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi, sipas ligjit të atij vendi, ose (b) njohja ose ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me rendin publik të këtij vendi".

⁶⁴⁷ Veeder.V.V. "A është e nevojshme të ndryshohet Konventa e Nju Jorkut", Revista e Vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar, qershor 2010, Emmanuel Gaillard, f.190.

⁶⁴⁸ Koment i Qeverisë së Britanisë së Madhe mbi draft-Konventën "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj", dokument i OKB, ECOSOC, E/2822/Add.4. Annex I, 3 prill 1956, f.8.

⁶⁴⁹ Pengesat e parashikuara në pikat "a", "b", "c", "ç", "d" dhe "dh" të nenit 394 të K.Pr.C.

⁶⁵⁰ Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(1): *Njohja dhe ekzekutimi i vendimit mund të refuzohen me kërkesën e palës kundër së cilës drejtohet, vetëm në qoftë se ajo palë i paraqet autoritetit kompetent ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi, provën që:....*

kemi quajtur ndryshe, pesë shkaqet e refuzimit të njohjes, që janë: (i) *pazotësia e palëve, apo pavlefshmëria e marrëveshjes*; (ii) *mungesa e njoftimit dhe ndershmërisë së procesit*; (iii) *arbitri ka vepruar në tejkalim të autoritetit të tij*; (iv) *forumi apo procedura nuk ishin në përputhje me marrëveshjen e palëve, dhe (v) vendimi nuk ka marrë formë të prerë, apo është anuluar*. Këto shkaqe duhet të ngrihen vetëm nga pala, që kundërshton njohjen, e cila ka barrën e provës⁶⁵¹. Vetëm për dy shkaqet shtesë, të parashikuara nga neni 5(2) i Konventës⁶⁵², mund të justifikohet veprimi *ex officio* i gjykatës kompetente, që shqyrton kërkesën e njohjes, konkretisht për mungesën e *arbitrueshmërisë* dhe dhunimit të klauzolës së *politikës publike* sipas ligjit të forumit, duke mos përjashtuar në të njëjtën kohë mundësinë e ngritjes se këtyre pretendimeve edhe nga pala që kundërshton njohjen⁶⁵³.

Në këtë pikë, interpretimi jurisprudencial shqiptar⁶⁵⁴ mbron qëndrimin se, kur kërkohet njohja e vendimit të arbitrazhit të huaj, në lidhje me tre pengesat ligjore të parashikuara nga neni 394, pika “b”, “c” dhe “ç” të K.Pr.C⁶⁵⁵, është pala *gjqbjerrëse* (pala kundër të cilës kërkohet njohja) ajo që ka barrën e provës që të vërtetojë para Gjykatës së Apelit ekzistencën e së paku njëres prej këtyre pengesave. Ndërsa, në tre rastet e parashikuara nga neni 394, pikat “a”, “d” dhe “dh” të K.Pr.C⁶⁵⁶, prova dhe argumente ligjore mund të paraqiten nga palët në proces, por gjithsesi, nisur nga natyra e tyre parimore procesuale e juridiksionale, si dhe duke qenë çështje që lidhen vetëm me zbatimin e ligjit, Gjykatës së Apelit i mbetet detyrimi ligjor që të hetojë e konstatojë, edhe kryesisht, mbi ekzistencën ose jo të këtyre pengesave ligjore. Në interpretimin unifikues të Gjykatës së Lartë, shkaqet e parashikuara në pikat “a”, “d” dhe “dh” të K.Pr.C, mbeten, në thelb, me qëllim e natyrë të njëjtë me dy shkaqet refuzuese të parashikuara nga neni 5(2) i Konventës, ku justifikohet veprimi kryesisht i gjykatës kompetente.

⁶⁵¹ Margaret L.Moses, “Parimet dhe Praktika e Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar”, Cambridge University Press, 2008, f.208.

⁶⁵² Konventa e Nju Jork-ut, neni 5(2): *Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi të arbitrazhit mund të refuzohen gjithashtu në qoftë se autoriteti kompetent i vendit ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi konstatojnë se: a) objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi, sipas ligjit të atij vendi, ose b) njohja ose ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me rendin publik të këtij vendi.*

⁶⁵³ Margaret L.Moses, “Parimet dhe Praktika e Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar”, Cambridge University Press, 2008, f.208.

⁶⁵⁴ Shiko Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.6, datë 01.06.2011, par.28.3 dhe 29.

⁶⁵⁵ K.Pr.C, neni 394, pika (b) *kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet*; pika (c) *midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare*; pika (ç) *është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë.*

⁶⁵⁶ K.Pr.C, neni 394, pika (a) *sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin*; pika (d) *i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij*; pika (dh) *nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.*

VI.3.3. Kërkesa formale për paraqitjen e marrëveshjes së arbitrazhit si kusht për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj – një mungesë në parashikimet e K.Pr.C.

Legjislacioni i brendshëm Shqiptar, paraqet disa veçori edhe përsa i përket aspekteve procedurale të paraqitjes formale të kërkesës për njohje të një vendimi arbitrazhi të huaj. Kërkesa për t'i dhënë fuqi vendimit të arbitrazhit të huaj i paraqitet Gjykatës së Apelit, që i përket rrethit gjyqësor në territorin e të cilit do të ekzekutohet vendimi i arbitrazhit⁶⁵⁷. Kompetenca territoriale e Gjykatës së Apelit, në këtë rast nuk përcaktohet shprehimisht, por duke iu referuar parimeve të përgjithshme procedurale, ndërkohë që legjislacione të tjera e kanë rregulluar drejtpërdrejt këtë kompetencë⁶⁵⁸. Kërkesa për njohje mund të paraqitet edhe në rrugë diplomatike kur ajo është e lejueshme nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe mbi bazën e reciprocitetit. Në këto raste, nëqoftëse pala e interesuar nuk ka emëruar përfaqësues, kryetari i Gjykatës së Apelit emëron një avokat për të paraqitur kërkesën⁶⁵⁹.

Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten disa dokumenta, në mënyrë që të konsiderohet e rregullt. Konkretisht kërkohet të paraqitet: (a) kopja e vendimit të arbitrazhit të huaj, që kërkohet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe, i legalizuar nga noteri; (b) vërtetim nga forumi i arbitrazhit që e ka nxjerrë vendimin, që të vërtetojë se ky vendim ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimi e legalizimi noterial i tij; (c) prokura, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri⁶⁶⁰. Kopja e vendimit të arbitrazhit dhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë.

Në gjykimin e të gjitha çështjeve, të trajtuara në punim dhe të përmendura më sipër, bazuar në kërkesat për njohje të vendimeve të huaja të arbitrazhit, Gjykata e Apelit përgjithësisht është treguar e vëmendshme ndaj aspekteve formale të kërkesës, apo më saktë ndaj rregullshmërisë së dokumentacionit që duhet të shoqërojë kërkesën për njohje të një vendimi arbitrazhi të huaj.

⁶⁵⁷ Shiko Pyetësorin Ndërkombëtar për implementimin e Konventës: website-

<http://www.uncitral.org/pdf/english/texts/arbitration/NY-conv/NYCCompilation31August2010.xls>

⁶⁵⁸ Legjislacioni Italian bën një përcaktim të qartë për çështjen e kompetencës së gjykatës së apelit, që shqyrton kërkesën për njohje dhe zbatim të një vendimi arbitrazhi të huaj. Sipas tij, kompetente është gjykata e apelit të rrethit, ku ka vendbanimin pala tjetër (kundër të cilës drejtohet zbatimi i vendimit) dhe në rast se pala tjetër nuk ka banim, atëherë kompetenca lëndore i takon gjykatës së apelit në Romë (Kodi i Proçedurës Civile të Italisë, kreu VII-Për vendimet e arbitrazhit të huaj, neni 839).

⁶⁵⁹ K.Pr.C., neni 395.

⁶⁶⁰ *Id.*, neni 396.

(i) Kështu, në çështjen e njohjes dhe zbatimit në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006: “AEDP kundër Republikës së Shqipërisë”, Gjykata e Apelit shprehet: “Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit Tiranë, i përbërë nga 3 gjyqtarë, në seancën gjyqësore të datës 29.05.2007, mori në shqyrtim këtë çështje civile, e cila kishte vetëm një palë (palën kërkuese) Fondacionin AEDP, të përfaqësuar në proces. Përveç kërkesës formale, kërkuesi ka paraqitur bashkëngjitur: (a) Vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, objekt të kërkesës për njohje, të përkthyer dhe noterizuar, si dhe (b) Prokurën e Posaçme, për përfaqësimin e kërkuesit nga një avokat. Sa më sipër, janë zbatuar kërkesat e nenit 396, paragrafi (a) dhe (c) të Kodit të Procedurës Civile, pasi vendimi i arbitrazhit të huaj është i përkthyer dhe i legalizuar nga noteri. Ky dokument është i vërtetuar, duke vendosur në trupin e tij vulën "Apostille". Gjithashtu kërkesës i bashkëngjitet prokura përkatëse, e përkthyer dhe e legalizuar nga noteri. Përsa i përket kërkesës së pikës "b", të nenit 396 të K.P.Civile, ku kërkohet paraqitja e "vërtetimit nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin e arbitrazhit, se ai ka marrë formë të prerë", duhet thënë se në rastin e vendimeve të dhëna nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit, ky vërtetim prezumohet i dhënë. Kjo sepse, sikurse sqarohet edhe më poshtë, vetë Rregullorja e Arbitrazhit të ICC-së, parashikon se vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare e Arbitrazhit është përfundimtar dhe ndaj tij nuk lejohet ankim”.

(ii) Po kështu, në çështjen e njohjes në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), për çështjen me nr.12016/ACS/FM datë 02.04.2008: “Shoqëria "BE-HA-SE" kundër Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (DPRR), Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT), Shqipëri”, Gjykata e Apelit ka shqyrtuar dokumentat shoqërues të kërkesës, duke konstatuar: “Kërkesës për Njohje drejtuar Gjykatës së Apelit, kërkuesi (DPRR) i ka bashkëngjitur dokumentat: a) Kopje të Kontratës midis palëve, të lidhur më datë 11 gusht 1998, e cila përmban Klauzolën e Arbitrazhit, e vërtetuar në mënyrën e duhur; b) Kopjen e përkthyer në gjuhën shqipe të kontratës së mësipërme; c) Kopje të Vendimit Përfundimtar të Arbitrazhit Nr.12016/ACS/FM, datë 2 prill 2008, e vërtetuar në mënyrën e duhur; d) Tekstin në gjuhën shqipe (përkthimin zyrtar) të Vendimit Përfundimtar të Arbitrazhit; e) Shkresën e datës 07 prill 2008 të Sekretariatit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit për komunikimin e vendimit përfundimtar dhe përkthimin zyrtar në gjuhën shqipe; f) Autorizimin e DPRR-së, për përfaqësimin e saj pranë Gjykatës së Apelit në këtë çështje, nga juristët e Institucionit (zëvendëson prokurën)”.

(iii) E njëjta vëmendje ndaj çështjeve formale të kërkesës për njohje, rezulton në çështjen e njohjes në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), të datës 19.10.2009, për çështjen me nr.14869/A VH/JEM/GZ: "Shoqëria "ROHDE NIELSEN" A/S kundër Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë", ku Gjykata e Apelit, gjatë procedimit gjyqësor, shprehet se: "*Vendimi i gjykatës së arbitrazhit të huaj, së bashku me çertifikatën që vërteton formën e prerë të tij, në përputhje me ligjin nr.9060 datë 08.05.2003 "Për aderimin e R.Sh në Konventën e Hagës (5 tetor 1961) "Për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumentave zyrtare të huaja", janë çertifikuar sipas nenit 3(1) dhe 4 të Konventës, duke përmbajtur çertifikatën "Apostille". Gjithashtu këto dokumenta janë të përkthyer (nga anlishtja në shqip) nga një përkthyes i autorizuar nga Ministria e Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 4(2) të Konventës së Nju Jork-ut, si dhe janë të legalizuara nga një noter publik".*

Nga analizimi i këtyre rasteve, konstatohet se Gjykata e Apelit përgjithësisht ka treguar kujdes vetëm për të respektuar kërkesat formale të parashikuara nga K.Pr.C, duke anashkaluar kërkesat e Konventës së Nju Jork-ut. Kështu psh. në çështjen "Njohja e Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006 - AEDP kundër Republikës së Shqipërisë", nga kërkuesi nuk paraqitet si dokument shkresor provues para trupit gjykues, marrëveshja e arbitrazhit midis palëve, e cila ka formën e Klauzolës së Arbitrazhit⁶⁶¹. Për pasojë Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit nuk e ka administruar si provë këtë dokument. Gjykata e Apelit nuk e përmend fare Klauzolën e Arbitrazhit në vendimin e saj, kur argumenton kompetencën e Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) për të shqyrtuar mosmarrëveshjen dhe për të dhënë vendim arbitrazhi. Mosparaqitja si dokument bashkëngjitur *Kërkesës për Njohje*, mosadministrimi si dokument shkresor në seancë, si dhe mungesa e referimit nga Gjykata e Apelit ndaj Marrëveshjes së Arbitrazhit (Klauzolës së Arbitrazhit), vjen sepse Gjykata e Apelit i qëndron besnike, në procedurë dhe në argumentimin e vendimit, vetëm parashikimit të dispozitave të nenit 396 të Kodit të Procedurës Civile dhe neglizhon Konventën e Nju Jork-ut. Sipas kësaj dispozite, për të siguruar njohjen dhe zbatimin e vendimit të arbitrazhit të huaj, duhet të paraqitet bashkë me kërkesën, *vendimi* i arbitrazhit, *vërtetimi* që ai ka marrë formë të prerë dhe *prokura* e përfaqësimit. Të gjitha këto dokumenta janë paraqitur bashkëngjitur kërkesës për njohje, të depozituar nga kërkuesi (Fondacioni "AEDP"), duke përmbushur kërkesat e nenit 396.

⁶⁶¹ Seksioni 2/C, paragrafi 8, i Marrëveshjes Kuadër, të lidhur midis "AEDP" dhe Qeverisë Shqiptare, me datë 23 qershor 1997.

Sikurse vërehet qartë në këto raste, nga Gjykata e Apelit nuk janë vlerësuar kërkesat e dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut, në lidhje me dokumentacionin që duhet të paraqesë kërkuesi i njohjes së vendimit të arbitrazhit, para autoritetit kompetent të vendit ku kërkohet njohja. Konkretisht nuk janë vlerësuar kërkesat e nenit 4 të Konventës, ku parashikohet se kërkesës për njohje duhet t'i bashkëngjitet *vendimi i arbitrazhit dhe marrëveshja e arbitrazhit*⁶⁶² midis palëve. Kjo sepse, dispozitat e Kodit të Procedurës Civile nuk kërkojnë specifikisht të paraqitet *marrëveshja e arbitrazhit*, nga pala që kërkon njohjen e vendimit. Një parashikim i tillë, pavarësisht se, në një këndvështrim mund të konsiderohet si një "lehtësim" procedural, përsa i përket dokumentacionit shoqërues të kërkesës, nuk gjen mbështetje në frymën e Konventës së Nju Jork-ut⁶⁶³, ku kërkohet që aplikimit për njohje t'i bashkëngjitet *marrëveshja e arbitrazhit*, pasi në të kundert aplikimi nuk konsiderohet i rregullt. Neglizhenca e Gjykatës së Apelit, në këtë pikë, nuk i përshtatet qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Lartë, në vendimin e saj unifikues nr.6, datë 01.06.2011, ku Gjykata e Lartë shprehet se: *përsa i përket kushteve formale-procedurale (rregullshmërisë formale të paraqitjes), për efekt të pranimit për shqyrtim të kërkesës për njohje të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, Gjykata e Apelit detyrimisht mban parasysh edhe kushtet e rregullat e posaçme, të parashikuara në nenin 4 të Konventës së Nju Jork-ut*⁶⁶⁴.

Kodi i Procedurës Civile nuk e parashikon paraqitjen e "marrëveshjes së arbitrazhit" si kusht të drejtpërdrejt (si dokument që duhet të shoqërojë taksativisht kërkesën për njohje të vendimit të arbitrazhit të huaj), por kjo është një kërkesë indirekte, që gjykoj se duhet të vlerësohet në fakt nga Gjykata e Apelit. Kjo sepse, sikurse u përmend më lart, dispozitat e Kodit parashikojnë se vendimit të arbitrazhit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur mosmarrëveshja nuk është në kompetencën e forumit të arbitrazhit, që ka dhënë vendimin. Për të provuar vlefshmërinë e kompetencës së forumit të arbitrazhit të huaj, Gjykata e Apelit që shqyrton kërkesën për njohje duhet të administrojë prova. Prova kryesore është marrëveshja e arbitrazhit, sipas të cilës palët kanë shprehur vullnetin e tyre për të zgjidhur mosmarrëveshjet që kanë lindur apo që do të lindin, nëpërmjet arbitrazhit. Është pikërisht kjo marrëveshje, shprehje e vullnetit të palëve, premisa e vetme që përjashton juridiksionin e gjykatës së zakonshme kombëtare dhe vendos juridiksionin e forumit të arbitrazhit. Pra, mendoj se Gjykata e Apelit duhet ta marrë në shqyrtim dhe duhet ta vlerësojë në tërësi "marrëveshjen e arbitrazhit", pavarësisht se ky dokument nuk kërkohet specifikisht

⁶⁶² Konventa e Nju Jork-ut (1958), neni 4, pika 1, paragrafi "b".

⁶⁶³ *Id.*

⁶⁶⁴ Shiko Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.6, datë 01.06.2011, par.19.1

të paraqitet bashkë me kërkesën për njohje. Madje, jam i mendimit se Gjykata e Apelit duhet të shkojë edhe më tej në vlerësimin e të metave të mundshme (veseve), që mund të ketë kjo marrëveshje, të meta të cilat mund të vlerësohen kryesisht nga gjykata, ose me kërkesë të palës kundër të cilës kërkohet zbatimi i vendimit të arbitrazhit. Të meta të tilla mund të jenë psh. pazotësia e palëve për të lidhur marrëveshje apo karakteri jo arbitral i mosmarrëveshjes, që është objekt i marrëveshjes së arbitrazhit.

Është gjithashtu e rëndësishme të sqarohet kush janë kërkesat ligjore të formës së dokumentave të huaja, që paraqiten para gjykatës së Apelit, së bashku me kërkesën për njohjen e një vendimi arbitrazhi të huaj. Këto kërkesa formale do të përcaktojnë vlefshmërinë e një dokumenti të huaj (të lëshuar nga një autoritet i huaj, në gjuhë të huaj), për t'u paraqitur dhe pranuar si i tillë nga Gjykata e Apelit. Për këtë qëllim duhen marrë në konsideratë kërkesat e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme të formës, të Kodit të Procedurës Civile dhe akteve të tjera në fuqi.

i) Kërkesat e përgjithshme janë ato të parashikuara në Kodin e Procedurës, ku përcaktohet se kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhën shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent⁶⁶⁵. Gjithashtu kërkesa të përgjithshme për vlefshmërinë formale të dokumentave të huaja, të cilat paraqiten para gjykatave apo institucioneve shqiptare, janë ato të përcaktuara nga dispozitat e ligjit nr.9060, datë 08.05.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja (Konventa e Hagës, 5 tetor 1961)"⁶⁶⁶, si dhe nga dispozitat e VKM nr.134 dt.07.03.2003 "Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit"⁶⁶⁷.

ii) Kërkesat specifike për dokumentat në gjuhë të huaj, të cilat duhet të paraqiten para Gjykatës së Apelit, për të njohur dhe për t'i dhënë fuqi një vendimi arbitrazhi të huaj, janë ato të parashikuara në nenin 396 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas kësaj dispozite parashikohet

⁶⁶⁵ K.Pr.C., neni 266 "Shkresa në gjuhë të huaj".

⁶⁶⁶ Neni 3, 4, 5 i ligjit nr.9060 datë 08.05.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja": "Për shtetët anëtare të Konventës së Hagës, legalizimi i dokumentave bëhet nëpërmjet vendosjes së certifikatës "Apostille", për së gjati, në një qoshe të dokumentit që legalizohet. Kjo certifikatë vërteton autenticitetin e firmës, cilësinë në të cilën ka vepruar personi që e ka firmosur dokumentin dhe, nëse është rasti, identitetin e vulës ose pullës që ky dokument bart".

⁶⁶⁷ Pika 4 dhe 5 të VKM nr.134 dt.07.03.2003: "Dokumentet e autoriteteve të huaja, që do të përdoren brenda vendit, legalizohen në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, ndërsa dokumentet e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara në Tiranë, legalizohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Në vendet ku Republika e Shqipërisë nuk ka përfaqësi të akredituar, legalizimi i dokumenteve të huaja, të legalizuara më parë nga Ministria e Jashtme e vendit të origjinës, kryhet në Ministrinë e Punëve të Jashtme".

se kopja e *vendimit* të arbitrazhit dhe *vërtetimi* nga gjykata e arbitrazhit se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të paraqiten në gjuhën origjinale por dhe të përkthyer në gjuhën shqipe. Gjithashtu duhet të paraqitet legalizimi noterial i çdo dokumenti. Të dy këto dokumenta duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë. Ndërsa *prokura*, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i pales së interesuar, nëse është në gjuhë të huaj duhet të jetë e përkthyer dhe e legalizuar te noteri. Për prokurën si dokument nëse është hartuar në Shqipëri, kuptohet që duhet të plotësohen edhe kushtet e parashikuara në dispozitat e Kodit Civil⁶⁶⁸.

Plotësimi i dokumentave, duke respektuar kërkesat ligjore të formës së tyre, është shumë i rëndësishëm, sepse në të kundërt gjykata mund të vendosë të kthejë, pa e shqyrtuar, kërkesën për njohje të vendimit të arbitrazhit të huaj. Një qëndrim të tillë, Gjykata e Apelit ka mbajtur ndaj kërkesës së shoqërive "*I.C.M.A*" srl dhe "*Agri.Ben*" sas, paraqitur para Gjykatës së Apelit Tiranë, me objekt njohjen e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) të datës 22.12.2005, dhënë nga arbitri i vetëm për çështjen nr.12112/ACS "*I.C.M.A*" SRL dhe "*AGRI.BEN*" SAS kundër *Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit të RSh-së*⁶⁶⁹. Në vendimin e saj nr.56 datë 14.07.2006, Gjykata e Apelit shprehet se ka konstatuar të meta në dokumentacionin e paraqitur nga kërkuesi, për të cilat është lënë afat që të plotësoheshin, duke u shtyrë seanca gjyqësore. Por përfaqësuesi i kërkuesit kërkoi një afat të ri, pasi për arsye objektive nuk i kishte plotësuar këto mangësi të dokumentacionit. Për shkak të këtyre mangësive në dokumentacionin që shoqëron kërkesën, në dispozitivin e vendimit Gjykata e Apelit shprehet se "*Gjykata, duke çmuar se kërkesa nuk lidhet me afate të afërta parashkrimi, bazuar në nenin 154/a të K.Pr.C vendosi "Kthimin e kërkesës (dhe akteve bashkëngjitur) kërkuesit pa veprime"*.

Por, duhet theksuar, se faza e vlerësimit të aspekteve procedurale-formale të kërkesës konsiderohet vetëm si fazë e parë e procesit të njohjes, ku Gjykata e Apelit, nëse konstaton mangësi dhe të meta të rregullshmërisë formale të paraqitjes, i cakton kërkuesit një afat të arsyeshëm për plotësimin e tyre, në të kundërt, e kthen kërkesën dhe aktet e tjera pa veprim të

⁶⁶⁸ Neni 72 i Kodit Civil: "*Prokura për kryerjen e veprimeve para gjykatave dhe institucioneve të tjera shtetërore, duhet të bëhet me akt noterial, përveç kur me dispozita ligjore lejohet që ajo të bëhet me shkresë të thjeshtë. Prokura në emër të personave juridikë publikë e privatë mund të bëhet edhe vetëm me nënshkrimin e drejtuesit të tij dhe me vulën përkatëse, përveç kur ligji kërkon që veprimi juridik të kryhet me akt noterial*".

⁶⁶⁹ Çështja civile e regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë nr nr.36 regj.themeltar datë 31.05.2006; Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.56 datë 14.07.2006: *Paditësit "I.C.M.A" SRL dhe "AGRI.BEN" SAS janë shoqëri të krijuara sipas të drejtës italiane, të cilat i janë drejtuar arbitrazhit ndërkombëtar (Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë(ICC) për të shqyrtuar mosmarrëveshjen me palën tjetër Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit të RSh. Arbitri i vetëm Prof.Dr.Claudie B.Roullier me qendër në Gjenevë ka dhënë vendimin e datës 22.12.2005 me të cilin detyrohet pala e paditur t'i paguajë kërkuesit shumat.....*

mëtejshëm. Këto verifikime, Gjykata e Apelit, duke vepruar si gjykatë e shkallës së parë, i realizon me paraqitjen e kërkesës për njohje, ose në kuadër të veprimeve përgatitore, kryesisht apo me kërkesën e palëve. Pra, në këtë fazë të procesit, sikurse veprohet edhe me kërkesëpaditë e tjera në gjykatat e shkallës së parë, Gjykata e Apelit nuk mund të rrëzojë (refuzojë) kërkesën për njohje, me motivin se ka të meta e mangësi të paraqitjes formale të saj. Pranimi apo rrëzimi i kërkesës për njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj bëhet në fazën e dytë të gjykimit, vetëm në varësi të vërtetimit ose jo të ekzistencës së ndonjërës prej pengesave e ndalimeve ligjore substanciale që ka parashikuar ligji për njohjen e atij vendimi (neni 394 i Kodit të Procedurës Civile dhe neni 5 i Konventës së Nju Jork-ut, apo ndonjë dispozitë tjetër e posaçme për këtë qëllim, e parashikuar nga ligji ose një marrëveshje tjetër ndërkombëtare).⁶⁷⁰

VI.3.4. Shqyrtimi jo në themel i konfliktit nga Gjykata e Apelit dhe vlerësimi i shkaqeve refuzuese, të parashikuara prej Konventës së Nju Jork-ut.

Gjykata e Apelit nuk e shqyrton çështjen në themel, pra nuk shqyrton se si është vendosur dhe zgjidhur në themel mosmarrëveshja midis palëve, nëpërmjet vendimit të arbitrazhit të huaj. Gjykata e Apelit vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur përmban ose jo elemente që, sipas ligjit konsiderohen pengesa ligjore për zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj⁶⁷¹. Pra, shqyrtimi gjyqësor i kërkesës për njohje të një vendimi arbitrazhi të huaj, ka për objekt vetëm vërtetimin e egzistencës ose jo të kushteve ligjore penguese të njohjes, të përmendura në nenin 394 të K.P.C⁶⁷². Në këtë pikë, parashikimi i ligjit të brendshëm (K.Pr.C) është në përputhje me parashikimin e Konventës së Nju Jork-ut, e cila liston shkaqet e kundërshtimit të njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj. Karakteristika kryesore e këtyre shkaqeve është që ato nuk kanë lidhje me themelin e çështjes. Sipas Konventës, një gjykatë nuk mund të refuzojë njohjen e një vendimi arbitrazhi për shkak se arbitrat kanë gjykuar gabim mbi faktet apo mbi ligjin⁶⁷³.

Praktika gjyqësore Shqiptare vërteton pikërisht faktin se Gjykata e Apelit nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm verifikon ekzistencën e shkaqeve të cilat e “eksopozojnë” vendimin e arbitrazhit kundrejt mundësisë së mos-njohjes dhe mos-ekzekutimit të tij (shkaqet

⁶⁷⁰ Shiko Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.6, datë 01.06.2011, par.19; 20; 31.2; 31.3; 31.4; 31.5.

⁶⁷¹ K.Pr.C., neni 397.

⁶⁷² Alban Abaz Brati, “Procedura Civile”, botimi i parë (bot.Dudaj) 2008, f.415.

⁶⁷³ Margaret L.Moses, “Parimet dhe Praktika e Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar”, Cambridge University Press, 2008, f.208.

e nenit 394 të K.Pr.C)⁶⁷⁴. Ky është një konstatim që i përket të gjitha çështjeve të shqyrtuara nga praktika gjyqësore, çka nënkupton se kjo praktikë ndjek rigorozisht kërkesat e nenit 397 të K.Pr.C, dispozitë e interpretuar së bashku me nenin 399, i cili barazon procesin e njohjes së një vendimi gjyqësor të huaj me atë të një vendimi arbitrazhi të huaj. Le të sjellim në vëmendje disa çështje gjyqësore:

i) Në çështjen e njohjes në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006: “AEDP kundër Republikës së Shqipërisë”, Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit, në përputhje me kërkesat e nenit 397 të Kodit të Procedurës Civile, nuk e shqyrtoi çështjen (mosmarrëveshjen midis palëve) në themel. Ai vetëm kontrolloi nëse vendimi i paraqitur përmbante ose jo elementë që konsiderohen si "pengesa ligjore të zbatimit", të parashikuara në dispozitat e nenit 394 të K.P.Civile. Konkretisht, Kolegji Civil, në vështrim të kërkesave të këtij neni, konstatoi sa më poshtë⁶⁷⁵:

-Sipas dispozitave në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja është në kompetencën e Arbitrazhit të Huaj Ndërkombëtar. Ky është një vlerësim i drejtë i bërë nga Kolegji Civil, pavarësisht se në vendimin e tij nuk janë dhënë arsyet që kanë çuar Gjykatën e Apelit në këtë përfundim. Është evidente se nuk mund të ketë objeksion për juridiksionin e forumit të arbitrazhit, pasi palët kishin miratuar në marrëveshjen e tyre (Marrëveshjen Kuadër) të ashtuquajturën "Klauzolë Arbitrazhi". Vlefshmërinë e kësaj klauzole, si një formë të marrëveshjes së arbitrazhit, Republika e Shqipërisë e njeh në zbatim të Konventës së Nju Jork-ut, të ratifikuar prej saj. Pra, një gjykatë e Republikës së Shqipërisë është e detyruar, në bazë të angazhimit ndërkombëtar të shtetit Shqiptar, të njohë vlefshmërinë e një marrëveshje arbitrazhi, e cila përfaqëson vullnetin e palëve për të adresuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis tyre tek një forum arbitrazhi ndërkombëtar.

-Kërkesa për gjykimin në arbitrazh dhe njoftimet përkatëse, i janë adresuar të dy palëve në gjykim dhe palët kanë qenë të pranishme gjatë gjykimit. Pra, Kolegji Civil ka konstatuar se palëve, veçanërisht palës së paditur (Republika e Shqipërisë), u është dhënë mundësia që të mbrohen dhe të paraqesin lirisht çështjen dhe objeksionet e tyre për

⁶⁷⁴ Shiko Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.6, datë 01.06.2011, par.16, ku Gjykata e Lartë shprehet: “Pra, në çështjet gjyqësore me objekt kërkimi dhënien fuqi të vendimeve të gjykatave të huaja dhe të gjykatave të huaja të arbitrazhit, objekti i hetimit gjyqësor është vetëm verifikimi i ekzistencës ose jo të ndonjëres prej pengesave ligjore substanciale që parashikohen nga neni 394 i K.Pr.C”.

⁶⁷⁵ Pikat e mëposhtme janë cituar shprehimisht nga pjesa argumentuese e Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.54, datë 29.05.2007.

kërkesë-padinë para tribunalit të arbitrazhit. Ky përfundim del përgjithësisht nga të dhënat e vendimit të arbitrazhit të depozituar në dosje, por mund të pranohet si i mirëqënë edhe për faktin se pala, kundër të cilës është dhënë vendimi (Republika e Shqipërisë), nuk ka paraqitur ndonjë provë për të kundërtën.

-Ndërmjet palëve në fjalë, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, nuk rezulton të jetë dhënë vendim tjetër i ndryshëm nga një gjykatë Shqiptare. Pra nuk jemi në kushtet e prezencës së elementëve të "gjësë së gjykuar".

-Nuk rezulton të jetë duke u shqyrtuar nga një gjykatë Shqiptare një padi që është ngritur përpara se të jetë dhënë vendimi përfundimtar i Arbitrazhit të Huaj Ndërkombëtar.

-Vendimi i Arbitrazhit të Huaj Ndërkombëtar, i dhënë nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) Paris, Francë, është përfundimtar dhe ndaj tij, sipas Rregullores⁶⁷⁶ përkatëse, nuk lejohet ankim (neni 28 i Rregullores së Arbitrazhit). Ky konstatim i Kolegjit Civil është plotësisht i vërtetë, referuar disponimit të nenit 28 të rregullores në fjalë, me titull "Njoftimi, Depozitimi dhe Zbatueshmëria e Vendimit të Arbitrazhit". Në paragrafin 6 të këtij neni parashikohet se: "Çdo vendim arbitrazhi do të jetë detyrues për palët. Duke ia nënshtruar mosmarrëveshjen arbitrazhit sipas këtyre rregullave, palët marrin përsipër për të zbatuar çdo vendim pa vonesë dhe do të konsiderohet se ato kanë hequr dorë nga e drejta e tyre për çdo formë të rekursit, përderisa dorëheqja nuk mund të bëhet në mënyrë të vlefshme". Gjithashtu neni 33 i Rregullores së Arbitrazhit të ICC, me titull "Heqja dorë", parashikon se: "Një palë, e cila procedon me arbitrazhin pa ngritur kundërshtime për papajtueshmëri me ndonjë dispozitë të këtyre rregullave⁶⁷⁷, ose me ndonjë nga rregullat e tjera të zbatueshme në procedurë, me ndonjë direktivë të caktuar nga tribunali i arbitrazhit, apo me çdo kërkesë të marrëveshjes së arbitrazhit në lidhje me themelimin e tribunalit të arbitrazhit ose kryerjen e procedurës, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e saj për të kundërshtuar".

Nga konstatimet si më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit Tiranë ka çmuar se kërkesa e fondacionit AEDP është e drejtë dhe në përputhje me kërkesat ligjore. Për këto arsye, Gjykata e Apelit, në mbështetje të kërkesave të nenit 393 e vijues të K.Pr.C, ka vendosur⁶⁷⁸: (a) Pranimin e kërkesës së Fondacionit "Albanian Education Development Program" (AEDP) dhe

⁶⁷⁶ Rregullat e Arbitrazhit të ICC (International Chamber of Commerce, International Court of Arbitration) të vlefshme nga 1 janari 1998; website - www.iccarbitration.org.

⁶⁷⁷ Id.

⁶⁷⁸ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.54, datë 29.05.2007.

(b) Njohjen dhe dhënien fuqi ligjore Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006.

ii) Po kështu, në çështjen e njohjes në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC): “Shoqëria "BE-HA-SE" kundër Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (DPRR), Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT), Shqipëri”, Gjykata e Apelit ka verifikuar vetëm pengesat procedurale të njohjes, pa u ndalur në themelin e pretendimeve të palëve, duke u shprehur se “..gjykata ka vlerësuar të ashtuquajturat "pengesa ligjore të zbatimit", të parashikuara në disponimet e nenit 394 të K.P.Civile, si dhe në nenin 5 të Konventës së Nju Jork-ut. Ajo ka konkluduar se nuk ekzistojnë pengesa ligjore që të justifikojnë moslejimin e dhënies fuqi vendimit të arbitrazhit të huaj, i paraqitur në çështjen konkrete”. Për këto arsye Gjykata e Apelit, në vendimin nr.34 datë 31.03.2009, ka vendosur njohjen e Vendimit të Arbitrazhit Nr.12016/ACS/FM, datë 02.04.2008, të dhënë nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë Paris.

iii) I njëjti qëndrim paraqitet në çështjen e njohjes në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Arbitrazhit të huaj LCIA nr.5720 datë 04.06.2006: “McKinsey & Comany Inc.Croatia kundër Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Agjencisë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja”, ku gjykata shprehet se: “Kolegji Civil i Gjykatës së Apelit, në përputhje me kërkesat e nenit 399 në lidhje me nenin 397 të K.Pr.C nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur (për njohje) nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394 të K.Pr.C”. Gjykata e Apelit ka analizuar një për një kërkesat e nenit 394, duke vlerësuar kështu të gjitha pengesat e njohjes për rastin konkret të këtij vendimi arbitrazhi të huaj: (a) sipas dispozitave në fuqi në RSh, mosmarrëveshja është në kompetencën e arbitrazhit të huaj (ndërkombëtar); (b) kërkesa për gjykimin në arbitrazh dhe njoftimet përkatëse i janë adresuar të dy subjekteve të palës tjetër (Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Agjencisë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja), nga të cilat janë marrë konfirmimet përkatëse; (c) ndërmjet palëve në fjalë nuk rezulton të jetë dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata Shqiptare; (d) nuk rezulton të jetë duke u shqyrtuar nga gjykata Shqiptare ndonjë padi, që është ngritur përpara se të jetë dhënë vendimi përfundimtar i LCIA-së; (e) vendimi i arbitrazhit të huaj (LCIA) është përfundimtar dhe ndaj tij, sipas Rregullores përkatëse, nuk

lejohet ankimi⁶⁷⁹; (f) vendimi i arbitrazhit të huaj (LCIA) nuk bie ndesh me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

iv) Po kështu, në çështjen e njohjes në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), Paris nr.14420/FM datë 25.07.2007: "La Petrolifera Italo-Rumena" Spa. dhe "La Petrolifera Italo-Albanese" Sha. kundër Republikës së Shqipërisë", Gjykata e Apelit analizoi të gjitha pengesat e mudshme, të parashikuara nga K.Pr.C, që mund të përbënin shkak për mosnjohjen e këtij vendimi arbitrazhi të huaj, duke u shprehur se: (a) *Vendimi i dhënë nga Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) ka qenë në kompetencën e saj dhe ky forum nuk ka patur ndonjë pengesë ligjore për të shqyrtuar çështjen;* (b) *Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit, Paris ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor dhe palëve në proces u është dhënë mundësia për të parashtruar të gjitha pretendimet e tyre;* (c) *Kërkesa e paraqitur për njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj, është në përputhje me të gjitha përcaktimet ligjore, të shprehura në Kreun IX "Njohja e vendimeve të shteteve të huaja" të K.Pr.C. Nuk ekziston asnjë pengesë ligjore, e parashikuar në dispozitën procedurale (në nenin 394 të K.Pr.C), për t'i dhënë fuqi zbatimit në RSh, të vendimit nr.14420/FM datë 25.07.2007 të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit;* (d) *Gjykimi i zhvilluar nga kjo gjykatë arbitrazhi, është në pajtim të plotë me parimet bazë të legjislacionit Shqiptar.* Për rrjedhojë, Gjykata e Apelit, me vendimin e saj nr.106 datë 08.11.2007, vendosi: Njohjen dhe dhënien fuqi të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, Paris, nr.14420/FM datë 25.07.2007.

v) Në çështjen e njohjes në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), të datës 19.10.2009 (nr.14869/A VH/JEM/GZ): "Shoqëria "ROHDE NIELSEN" A/S kundër Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë", situata paraqitet më komplekse, përse i përket shkaqeve ligjore të refuzimit. Gjykata e Apelit, gjatë procedimit gjyqësor, ka vlerësuar pengesat ligjore të njohjes që parashikohen nga neni 394 të K.Pr.C. Në vendimin e saj gjykata shprehet: (a) *Vendimi i gjykatës së arbitrazhit të huaj ka marrë formë të prerë, pa u apeluar sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi. Kjo vërtetohet me një dokument të posaçëm të paraqitur nga kërkuesi, nëpërmjet të cilit Gjykatësi i Gjykatës së Lartë të Drejtësisë (Paul Walker) ka vërtetuar se vendimi i arbitrazhit nuk është*

⁶⁷⁹ Ky fakt është provuar nga gjykata nëpërmjet shkresës konfidenciale të datës 11 janar 2007 të LCIA, administruar në dosjen gjyqësore.

ankimuar sipas ligjit të vendit ku është marrë vendimi (ligjit Anglez të arbitrazhit, neni 58, paragrafi 1) dhe afati për një apelim të tillë ka përfunduar. Për rrjedhojë vendimi i arbitrazhit të huaj është final dhe detyrues për palët; (b) Nuk ishte duke u zhvilluar asnjë proces gjyqësor me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt në gjykatat Shqiptare, çka kërkuesi e ka vërtetuar me shkresën nr.6115/1 datë 15.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilën konfirmohet fakti se para saj nuk kishte për gjykim çështje civile me palë shoqëria "Rohde Nielsen" A/S; (c) Nuk rezulton të jetë dhënë paraprakisht një vendim gjyqësor për të njëjtën çështje (me të njëjtat palë dhe për të njëjtin objekt) nga një gjykatë Shqiptare. Por në këtë çështje, Gjykata e Apelit ka analizuar gjithashtu pengesat e njohjes, sikurse ato parashikohen nga neni 5 i Konventës së Nju Jork-ut (1958) "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", duke u shprehur: (a) Bazuar në nenin 5(1) të Konventës së Nju Jork-ut, personi i tretë në gjykim, pala kundër të cilit kërkohet njohja dhe ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit të huaj, nuk pretendoi dhe as nuk provoi që: palët në arbitrazh ishin të paafta për të vepruar; marrëveshja për arbitrazh ishte e pavlefshme; nuk i është dhënë njoftim i regullt për caktimin e arbitrit apo procedurën e arbitrazhit; ka qenë e paaftë të paraqiste rastin e saj; vendimi trajton një mosmarrëveshje jashtë marrëveshjes për arbitrazh, apo jashtë fushës që i nënshtrohet arbitrazhit; përbërja e gjykatës së arbitrazhit nuk ishte në përputhje me marrëveshjen e palëve; vendimi nuk ka marrë formë të prerë, apo është pezulluar; (b) Referuar në nenin 5(2) të Konventës së Nju Jork-ut, Gjykata e Apelit çmoi se legjislacioni Shqiptar nuk e pengon zgjidhjen me arbitrazh të mosmarrëveshjes kontraktore midis palëve ndërgjyqëse. Po kështu ndryshe nga sa pretendoi Avokati i Shtetit, Gjykata e Apelit çmoi se njohja dhe ekzekutimi i vendimit të gjykatës së arbitrazhit të huaj, nuk vjen në kundërshtim me rendin publik të R.Sh.

Sa më sipër, Gjykata e Apelit, bazuar në nenin 399 të K.Pr.C, me vendimin nr.122 datë 14.12.2010, vendosi njohjen dhe dhënien fuqi për zbatim në R.Sh të vendimit të gjykatës së arbitrazhit të huaj (Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë) të datës 19.10.2009.

Rasti i mësipërm dëshmon përsëri për qëndrimin jo të unifikuar të Gjykatës së Apelit, përsa i përket vlerësimit të pengesave të njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj në Republikën e Shqipërisë.

VI.3.5. Ndërgjyqësia në procesin civil të njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj.

Në të gjitha rastet e shqyrtuara nga praktika gjyqësore Shqiptare, legjitimi aktiv i kërkuesit për njohje të vendimit të arbitrazhit të huaj nuk ka qenë asnjëherë objekt shqyrtimi nga Gjykata e Apelit. Një rast shumë interesant, në këtë aspekt, paraqitet në çështjen e njohjes së Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC), për çështjen: “BE-HA-SE” kundër DPRR dhe MPPTT, Shqipëri”, ku kërkesa për njohje është paraqitur në Gjykatën e Apelit Tiranë nga pala e paditur në arbitrazh (DPRR)⁶⁸⁰, kundër të cilës është drejtuar kërkesa për arbitrazh dhe që është konsideruar kryesisht “humbëse”⁶⁸¹ nga vendimi i arbitrazhit të huaj⁶⁸².

Sikurse rezulton nga analiza e rastit të mësipërm, Gjykata e Apelit e ka pranuar kërkesën për njohje dhe e ka shqyrtuar atë, duke u mjaftuar me faktin që kjo kërkesë është paraqitur nga një subjekt, që ka qenë palë në procedimin e arbitrazhit dhe që pretendon një interes legjitim nga njohja e këtij vendimi në Republikën e Shqipërisë. Në fakt, në lidhje me këtë aspekt, Kodi i Procedurës Civile nuk bën asnjë rregullim të posaçëm, por përdor një herë të vetme, në nenin 395, vetëm shprehjen “pala e interesuar”⁶⁸³. Sipas këtij parashikimi, për Gjykatën e Apelit nuk ka fare rëndësi nëse kërkuesi është paditësi apo i padituri në procedimin arbitral, nga ku është marrë vendimi, apo është një palë e tretë, sikurse nuk ka rëndësi nëse është personi në favor apo në disfavor të të cilit ka disponuar vendimi i arbitrazhit të huaj. Gjykata e Apelit do të legjitimojë kërkesën për njohje, përse kohë kërkuesi është “palë e interesuar” pra një person (fizik apo juridik, Shqiptar apo i huaj) që ka një interes të ligjshëm, qoftë në realizimin e të drejtës apo në përmbushjen e detyrimit që sanksionon vendimi i arbitrazhit.

⁶⁸⁰ Kërkesa e DPRR-së, shkresa nr.1528 prot. dt.17.02.2009, e protokolluar nga Gjykata e Apelit më datë 19.02.2009, dokument i dosjes të çështjes civile me nr.90006-00372-30-2009, datë 19.02.2009.

⁶⁸¹ Sipas vendimit përfundimtar të arbitrazhit, për këtë çështje arbitri i vetëm ka vendosur, ndër të tjera: a) Detyrimin e palës së paditur (DPRR) t’i paguajë palës paditëse një shumë të caktuar, plus interesat, që përfaqësojnë shumën e akorduar nga arbitri i vetëm për pretendimin e paditësit për përfundimin e njëanshëm të kontratës; b) Kostot e procedimit në arbitrazh, të përcaktuara nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit, në shumën përkatëse, do të përballohen nga pala paditëse; c) Pala paditëse do t’i paguajë palës së paditur një shumë të caktuar, si dëmshpërblim për kostot e arsyeshme gjyqësore dhe për shpenzimet e tarifat e Ekspertit; d) Rrëzimi i të gjitha pretendimeve të tjera; Kërkuesi i njohjes së vendimit të arbitrazhit (i padituri - DPRR) me shkresën nr.2099 prot. datë 03.03.2009, e ka vënë në dijeni shoqërinë "BE-HA-SE" për marrjen njoftim mbi vendimin përfundimtar të arbitrazhit. Gjithashtu e ka njoftuar për kërkesën e tij drejtuar Gjykatës së Apelit për të kërkuar njohjen e këtij vendimi, si dhe ka kërkuar ekzekutimin vullnetar të këtij vendimi arbitrazhi duke likuiduar detyrimet reciproke ndërmjet palëve (informacion i marrë prej shkresës së DPRR-së, me nr.2099 prot. datë 03.03.2009, drejtuar shoqërisë “BE-HA-SE”, dokument i dosjes të çështjes civile me nr.90006-00372-30-2009, datë 19.02.2009).

⁶⁸² Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.12016/ACS/FM, datë 2 prill 2008 ("BE-HA-SE" kundër DPRR, MPPTT, Republika e Shqipërisë).

⁶⁸³ K.Pr.C, neni 395(2): “...Në këto raste, në qoftë se pala e interesuar nuk ka emëruar përfaqësues, kryetari i gjykatës së apelit emëron një avokat për të paraqitur kërkesën”.

Për sa i përket *ndërgjyqësisë* në procesin gjyqësor të njohjes, interpretimi jurisprudencial Shqiptar mbron qëndrimin se, pavarësisht se dispozitat e Kodit të Procedurës Civile nuk përmbajnë ndonjë rregullim të shprehur, Gjykata e Apelit duhet të mbajë parasysh se edhe në këtë lloj gjykimi duhet të garantohet *kontradiktorialiteti* për atë që janë vetë qëllimi, objekti e kufijtë e këtij gjykimi. Kjo realizohet, pikësisht, nëpërmjet garantimit të së drejtës për të marrë pjesë e për t'u dëgjuar nga gjykata, si të palës që kërkon njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të huaj, ashtu edhe të palëve debitoare që ngarkohen me detyrime nga ai vendim. Për pasojë, Gjykata e Apelit duhet të verifikojë dhe, eventualisht, të kryejë të gjitha veprimet ligjore për të garantuar, edhe kryesisht, thirrjen në gjykim të të gjitha palëve debitoare që rezultojnë nga përmbajtja e vendimit të huaj të arbitrazhit, të cilit kërkohet t'i jepet fuqi⁶⁸⁴.

Sikurse rezulton nga të gjitha rastet e praktikës gjyqësore Shqiptare të sipërpërmendura⁶⁸⁵, Gjykata e Apelit thërret në gjykim, duke bërë njoftimet përkatëse, edhe Avokaturën e Shtetit si përfaqësuese të palës së paditur (Republika e Shqipërisë), në procesin e zhvilluar para forumit të huaj të arbitrazhit. Institucioni i Avokaturës së Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat pasurore të shtetit Shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë⁶⁸⁶.

Në fund, duhet ritheksuar se, në të gjitha rastet e shqyrtuara, për kërkesën e paraqitur, Gjykata e Apelit ka dhënë vendim, ku shprehet për njohje dhe dhënie fuqi ligjore ndaj vendimit konkret të arbitrazhit të huaj ose për refuzimin e njohjes (në një rast)⁶⁸⁷. Vendimi i arbitrazhit të huaj zbatohet në Republikën e Shqipërisë vetëm në bazë të vendimit të Gjykatës së Apelit, që i jep fuqi këtij vendimi arbitrazhi dhe ekzekutohet në përputhje me dispozitat përkatëse procedurale civile⁶⁸⁸, sikurse çdo vendim gjyqësor Shqiptar. Në këtë mënyrë, ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të arbitrazhit të huaj nuk do të jetë gjë tjetër, veçse ekzekutim i detyrueshëm tashmë i një vendimi gjyqësor Shqiptar⁶⁸⁹. Në mungesë të një vendimi pozitiv (njohës) të Gjykatës së Apelit, vendimi i arbitrazhit të huaj nuk mund të ketë asnjë efekt juridik në Republikën e Shqipërisë, pra ajo çfarë është disponuar në të nuk mund të gjejë zbatim nëpërmjet forcës shtrënguese të shtetit Shqiptar.

⁶⁸⁴ Shiko Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr.6, datë 01.06.2011, par.21 dhe 31.1.

⁶⁸⁵ Përmendim psh. çështjen “Njohja dhe zbatimi në Republikën e Shqipërisë i Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006: “AEDP kundër Republika e Shqipërisë”.

⁶⁸⁶ Ligji Nr.10018, datë 13.11.2008 “Për avokaturën e shtetit”, neni 5, pika 1, paragrafi “b”.

⁶⁸⁷ Vendimet e Gjykatës së Apelit që kanë akorduar njohjen: nr.54, dt.29.05.2007; nr.34, dt.31.03.2009; nr.17, dt.27.02.2007; nr.106, dt.08.11.2007; nr.122, dt.14.12.2010. Vendimi që ka refuzuar njohjen: nr.82, dt.7.9.2007.

⁶⁸⁸ K.Pr.C, neni 398.

⁶⁸⁹ Alban Abaz Brati, “Procedura Civile”, botimi i parë (bot.Dudaj) 2008, f.416.

VI.4. Qasja e ligjit Shqiptar për të drejtën ndërkombëtare private drejt njohjes së vendimeve të arbitrazhit të huaj.

Me rëndësi për këtë punim paraqitet edhe sqarimi i mënyrës se si kuadri ligjor në fuqi për të drejtën ndërkombëtare private ka rregulluar njohjen e vendimeve të juridiksioneve të huaja, në përgjithësi, dhe atyre të arbitrazhit, në veçanti. Objektivi apo synimi i afirmuar, që kërkon të arrijë parimisht e drejta ndërkombëtare private, si pjesë e rendit juridik të një shteti, është i trefishtë; *Së pari*, të përcaktojë kushtet juridike, sipas të cilave gjykata vendos juridiksionin mbi shqyrtimin e një mosmarrëveshje me elementë të huaj; *Së dyti*, të rregullojë çështjen e identifikimit të ligjit, i cili do të aplikohet për rregullimin e themelit të kësaj mosmarrëveshje; *Së treti*, të identifikojë rrethanat në të cilat një vendim i një forumi të huaj të mund të njihet dhe e drejta e kreditorit të mund të ekzekutohet nga autoriteti kompetent nacional. Kjo është faza e fundit, në të cilën realizohet drejtësia dhe ku e drejta nga një nocion iluzionar kthehet në një përfitim të prekshëm⁶⁹⁰. Pikërisht këtë moment të fundit - zbatimin e vendimeve të juridiksioneve të huaja në Republikën e Shqipërisë - ligji për të drejtën ndërkombëtare private e trajton në kuadër të parashikimit që ai i bën institutit procedural të ndihmës juridike nga gjykatat e huaja.

Ndihma juridike nga gjykatat e huaja, kryesisht, rregullohet nga marrëveshjet ndërshtetërore dhe përfshin në sferën e saj të veprimit edhe marrëdhënien e njohjes dhe dhënies fuqi reciprokisht të vendimeve të huaja, nga shtetet që lidhin marrëveshjen⁶⁹¹. Konkretisht, në nenin 86 të ligjit për të drejtën ndërkombëtare private, parashikohet se ndihma e ndërsjellë juridike nga gjykatat e shteteve të huaja rregullohet nga marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga legjislacioni në fuqi. Në këtë mënyrë, ligji për të drejtën ndërkombëtare private nuk e rregullon drejtpërdrejtë njohjen e vendimeve të huaja, por i referohet rast pas rasti marrëveshjeve ndërshtetërore ku Shqipëria është palë. Përmendim këtu marrëveshjen ndërshtetërore për ndihmë të ndërsjellë juridike midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë apo atë midis Republikës së Shqipërisë

⁶⁹⁰ “E Drejta Ndërkombëtare Private - Konflikti i Ligjeve”, Cikël Leksionesh të Av.Fatos Lazimi, biblioteka e Universitetit “Marin Barleti”, 2011, f.8.

⁶⁹¹ K.Pr.C, neni 219 “Ndihma juridike nga gjykatat e shteteve të huaja”: “Kur është e nevojshme të kryhet një veprim procedural gjyqësor jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, për sqarimin e rrethanave, kostatimin e fakteve, dërgimin e një dokumenti apo për arsye të tjera që gjykata e quan të nevojshme për sqarimin e çështjes në gjykim, gjykata nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë i kërkon ndihmën juridike përkatëse organit kompetent të shtetit tjetër.... Kur midis dy shteteve ka marrëveshje për dhënien e ndërsjellë të ndihmës juridike, zbatohen dispozitat e kësaj marrëveshjeje”.

dhe Republikës së Bullgarisë⁶⁹². Pjesë e rëndësishme e këtyre marrëveshjeve ndërshtetërore janë edhe dispozitat që rregullojnë njohjen reciproke të vendimeve të dhëna në territorin respektiv të sejcilës palë kontraktuese⁶⁹³.

Problemi qëndron se këto marrëveshje nuk kanë mbajtur një qëndrim të unifikuar përsa i përket njohjes së vendimeve të arbitrazhit të huaj. Kështu, në disa raste, këto marrëveshje ndërshtetërore e parashikojnë njohjen reciproke të vendimeve të arbitrazhit dhe në raste të tjera jo, duke u kufizuar vetëm në vendimet gjyqësore. Psh. në marrëveshjen me Greqinë parashikohet se shtetet palë kontraktuese do të zbatojnë në tokën e tyre vendimet e arbitrazhit të marra në territorin e palës tjetër dhe për këtë qëllim do të zbatohen drejtpërdrejt dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut⁶⁹⁴. Ndërsa në marrëveshjen midis Shqipërisë dhe Bullgarisë nuk përfshihet njohja reciproke e vendimeve të arbitrazhit, por parashikohet vetëm njohja e vendimeve gjyqësore civile apo atyre penale që kanë të bëjnë me një pretendim civil⁶⁹⁵. Në këtë mënyrë qasja që ligji për të drejtën ndërkombëtare private ofron, në drejtim të njohjes së vendimeve të arbitrazheve të huaja dhe Konventës së Nju Jork-ut, nuk përfaqëson një qëndrim të unifikuar dhe të drejtpërdrejtë, pasi i lihet në dorë marrëveshjeve bilaterale të thonë fjalën e fundit.

Një situatë shumë më të qartë, në këtë drejtim, ofronte drafti i ligjit për të drejtën ndërkombëtare private, i paraqitur për miratim në Parlament, i cili në nenin 75 të tij parashikonte rregullimin e drejtpërdrejt të njohjes dhe zbatimit të vendimeve të gjykatave shtetërore të huaja dhe vendimeve të arbitrazheve të huaja. Drafti parashikonte se për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja zbatohen dispozitat e K.Pr.C, ndërsa për njohjen e vendimeve të gjykatave të arbitrazheve të huaja zbatohen dispozitat e K.Pr.C dhe Konventës

⁶⁹² Ligj Nr.7760 datë 14.10.1993, "Për ratifikimin e "Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale", Flet.Zyrtare Nr.12, faqe:787; Ligji nr.9348, datë 24.02.2005 "Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile", Flet.Zyrtare nr.19/2005, faqe 706.

⁶⁹³ Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale, Kapitulli i Tretë "Njohja dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore" (nenet 23-30); Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bullgarisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile, Kapitulli IV "Njohja dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore" (nenet 19-24).

⁶⁹⁴ Konventa ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë, ratifikuar me Ligjin Nr.7760 datë 14.10.1993, neni 23, pika 1: "Palët kontraktuese do të njohin dhe do të zbatojnë në tokën e tyre vendimet që vijojnë, të cilat janë publikuar në tokën e palës tjetër kontraktuese: ...(c) vendime arbitrazhi"; neni 25, pika 1: "Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit zbatohen dispozitat e Konventës që u nënshkrua në Nju Jork me 10 Qershor 1958".

⁶⁹⁵ Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bullgarisë, ratifikuar me ligjin nr.9348, datë 24.02.2005, neni 19: "(1) Në pajtim me këtë Marrëveshje, Palët Kontraktuese njohin dhe zbatojnë në territorin e tyre vendimet gjyqësore që janë dhënë dhe kanë hyrë në fuqi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese; (2) Termi "vendim gjyqësor" për të dyja Palët ka kuptimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar ose të ndërmjetëm dhe të një vendimi penal që ka të bëjë me një pretendim civil".

së Nju Jork-ut. Ky formulim, i cili është zëvendësuar me nenin 86 të ligjit aktual, do të ishte shumë më i vlefshëm dhe efektiv përse i përket zbatimit në praktikë nga gjykatat shqiptare të Konventës së Nju Jork-ut.

VI.5. Gabimet e përkthimit të Konventës së Nju Jork-ut në tekstin e ligjit Shqiptar.

Vetë Konventa e Nju Jork-ut⁶⁹⁶ përcakton se teksti origjinal i dispozitave të saj është i përkthyer në 5 gjuhë të ndryshme (kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle), duke patur secili tekst i përkthyer autenticitet të barabartë, përse i përket efektit legal të dokumentit. Për fat të keq, pavarësisht 5 gjuhëve të mundshme në dispozicion për t'iu referuar nga ligjvënësi Shqiptar, teksti i Konventës së Nju Jork-ut i përkthyer në shqip, si pjesë e ligjit implementues të saj (shtojca e ligjit nr.8688, datë 09.11.2000), përmban disa gabime që kanë të bëjnë me përkthimin jo korrekt krahasuar të paktën me tekstin origjinal në anglisht të Konventës⁶⁹⁷. Kështu psh. në tekstin e Konventës së përkthyer⁶⁹⁸ parashikohet shprehimisht se: "*Kjo Konventë zbatohet për vendimet e arbitrazhit që nuk konsiderohen si vendime të arbitrazhit në shtetin ku kërkohet dhe ekzekutimi i tyre*", ndërkohë që dispozita përkatëse e Konventës në tekstin origjinal në anglisht parashikon: "*Kjo Konventë zbatohet për vendimet e arbitrazhit që nuk konsiderohen si vendime të brendshme të arbitrazhit në shtetin ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi i tyre*". Një gabim material i tillë mund të çojë, në praktikë, në keqinterpretime të dëmshme për palët, por dhe për vetë procesin gjyqësor të njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj. Nëse gjykata që akordon njohjen do t'iu referohet strikt tekstit zyrtar të ligjit shqiptar, do të duhet të zbatojë Konventën edhe për vendime që nuk konsiderohen si *vendime arbitrazhi* në Shqipëri. Në këtë rast gjykatës do t'iu duhet të bëjë një interpretim se kush konsiderohet *vendim arbitrazhi* (psh. vendimet që janë marrë nga një forum jashtë-gjyqësor bazuar në marrëveshjen e palëve) dhe kush jo (psh. vendimet gjyqësore), pavarësisht nëse vendimi është marrë nga një forum shqiptar apo i huaj, në Shqipëri apo jashtë territorit të saj. Ndërkohë parashikimi i vërtetë i Konventës imponon zbatimin e saj për ato vendime që nuk konsiderohen si vendime të arbitrazhit të brendshëm në Shqipëri e për rrjedhojë duhen konsideruar si vendime të një arbitrazhi të huaj.

Përmendim gjithashtu nenin 3 të Konventës së Nju Jork-ut, i cili në versionin e përkthyer në shqip, si pjesë e ligjit, paraqitet: "*Secili shtet kontraktues do t'iu zbatojë ato (vendimet) në*

⁶⁹⁶ Konventa e Nju Jork-ut (1958), neni 16, paragrafi 1.

⁶⁹⁷ Konventa e Nju Jork-ut në anglisht (Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards – United Nations 1958 - Website - <http://untreaty.un.org/cod/avl/ha/crefaa/crefaa.html>.)

⁶⁹⁸ Neni 1, paragrafi 1, i Konventës së Nju Jork-ut në shqip, pjesë e ligjit nr.8688, datë 09.11.2000.

përputhje me rregullat e procedurës në territorin ku vendimi është mbështetur", ndërkohë që teksti i dispozitës në origjinal parashikon: *"Secili shtet kontraktues do t'i zbatojë ato në përputhje me rregullat e procedurës të territorit ku vendimi zbatohet"*. Interpretimi ngushtësisht literal i tekstit të përkthyer të kësaj dispozite, imponon zbatimin e ligjit procedural të shtetit të huaj, ku është marrë vendimi i arbitrazhit, nga gjykata shqiptare në procedurën e njohjes së këtij vendimi në Shqipëri. Kjo mënyrë interpretimi bie ndesh me parimin e të drejtës ndërkombëtare private, sipas të cilit çdo gjykatë e një shteti sovran i'a nënshton procedurën për zgjidhjen e një konflikti, pavarësisht elementëve të huaj që mund të përfshihen në të, ligjit procedural të vendit të saj (*lex forit*) dhe nuk mund të detyrohet t'i nënshtrohet, përsa i përket procedurës, asnjë juridiksioni të huaj⁶⁹⁹.

Po kështu teksti i përkthyer⁷⁰⁰ parashikon: *"Në qoftë se vendimi ose marrëveshja në fjalë nuk është hartuar në një gjuhë zyrtare të vendit ku jepet vendimi, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin e vendimit duhet të paraqesë një përkthim të këtyre dokumenteve në ato gjuhë"*, ndërkohë që përkthimi i saktë duhet të jetë: *"Në qoftë se vendimi ose marrëveshja në fjalë nuk është hartuar në një gjuhë zyrtare të vendit në të cilin zbatohet vendimi, pala që kërkon njohjen....."*. Edhe në këtë rast gabimi material i përkthimit të tekstit zyrtar të Konventës mund të shkaktojë në praktikën gjyqësore një parregullsi formale, përsa i përket aspektit procedural të paraqitjes dhe vlefshmërisë së dokumentacionit që do të shoqërojë kërkesën e njohjes. Ky dokumentacion (vendimi dhe marrëveshja) duhet të paraqitet i përkthyer në gjuhën zyrtare të shtetit ku kërkohet njohja, nëse nuk është në atë gjuhë. Kjo është fryma e Konventës, e cila në fakt konvergon edhe me kërkesat formale-procedurale të parashikuara nga legjislacionet nacionale të ndryshme⁷⁰¹. Këto gabime të përkthimit, duke qënë se janë trupëzuar në shtojcën e ligjit implementues të Konventës së Nju Jork-ut, janë shumë të rëndësishme dhe mund të ndikojnë në praktikë, në interpretimin dhe kuptimin e gabuar të shprehjeve dhe termave të tekstit të saj. Prandaj sugjeroj që, sa më shpejt, t'i bëhet një korrektim tekstit të përkthyer të Konventës si pjesë e ligjit nr.8688, datë 09.11.2000⁷⁰².

⁶⁹⁹ Ky parim i përgjithshëm është parashikuar në nenin 82(1) të ligjit nr.10428, datë 02.06.2011 "Për të drejtën ndërkombëtare private", ku shprehimisht parashikohet se: "Gjykimi i çështjeve gjyqësore me elemente të huaja para gjykatave shqiptare bëhet sipas ligjit procedural shqiptar".

⁷⁰⁰ Neni 4, paragrafi 2, i Konventës së Nju Jork-ut në shqip, pjesë e ligjit nr.8688, datë 09.11.2000.

⁷⁰¹ Shiko nenin 396(a) të K.Pr.C: "Kërkesës për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet t'i bashkëngjiten: a) kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri;".

⁷⁰² Teksti i plotë i Konventës së Nju Jork-ut, i përkthyer në shqip, gjendet në shtojcën bashkëngjitur këtij punimi. Vlerësimet dhe analizat në këtë punim, për rastet kur ato referojnë në dispozitat e Konventës, janë bazuar në tekstin origjinal të saj në anglisht.

Përfundime për kapitullin e gjashtë.

Pavarësisht se Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar Konventën e Nju Jork-ut, njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar realizohet nëpërmjet një kuadri ligjor të brendshëm jo bashkohor. Kështu, një grup dispozitash të Kodit të Procedurës Civile rregullojnë njohjen dhe zbatimin në shtetin tonë të vendimeve të arbitrazhit të huaj (ndërkombëtar) për referencë të njohjes së vendimeve të gjykatave shtetërore të huaja. Ligji i brendshëm nuk ofron një rregullim të veçantë për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj. Barazimi i pengesave ligjore të njohjes dhe zbatimit për këto dy kategori vendimesh (vendime gjyqësore dhe vendime arbitrazhi), që burojnë nga procese me tipare të ndryshme, nuk mund të konsiderohet zgjidhja më e mirë.

Parashikimet e dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut nuk janë plotësisht në harmoni me atë çka parashikojnë dispozitat e K.Pr.C, në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj, gjë e cila mund të krijojë pengesa në procedurat gjyqësore të njohjes. Kështu, dispozitat e Konventës parashikojnë saktësisht barrën e provës së palës së interesuar për të kundërshtuar njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj, ndërkohë që Kodi i Procedurës Civile nuk e bën një parashikim të tillë dhe, si rrjedhojë, Gjykata e Apelit kontrollon me iniciativën e saj nëse vendimi i arbitrazhit të huaj përmban elementë që përbëjnë pengesa ligjore të njohjes së tij. Dispozitat e K.Pr.C nuk kërkojnë paraqitjen e *marrëveshjes së arbitrazhit*, nga pala e interesuar, si kusht për vleshmërinë e kërkesës për njohje, në ndryshim nga dispozitat e Konventës. Për më tepër, dispozitat e K.Pr.C parashikojnë pengesa ligjore për njohjen e një vendimi arbitrazhi, të cilat jo vetëm që tejkalojnë ato të parashikuara nga Konventa, por mund të bëhen pengesë në praktikë për zbatimin e frymës së Konventës.

Nga analiza e kuadrit normativ, por dhe e praktikës gjyqësore, konstatohet një frymë e përgjithshme "*pro*" trajtimit si përfundimtare të vendimeve të arbitrazhit, nëpërmjet kufizimit të cënueshmërisë në themel të këtyre vendimeve, prej gjykatave shtetërore Shqiptare. Një gjë e tillë është sanksionuar në legjislacionin Shqiptar nëpërmjet parashikimit shterues të shkaqeve, për të cilat mund të godidet apo çënohet një vendim arbitrazhi (neni 434 i K.Pr.C). Këto shkaqe janë vetëm të natyrës procedurale dhe jo të themelit të çështjes apo konfliktit në gjykim. Qasja e ligjit shqiptar për të drejtën ndërkombëtare private në drejtim të njohjes së vendimeve të huaja, nuk e plotëson kuadrin përkatës normativ dhe nuk e favorizon zbatimin adekuat të Konventës së Nju Jork-ut. Ndërkaq, gabimet materiale të përkthimit të tekstit zyrtar të Konventës mund të ndikojnë negativisht në praktikë, në kuptimin e gabuar të dispozitave të saj.

KAPITULLI VII

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE DHE REKOMANDIME

VII.1. Përfundime dhe konkluzione.

-Efektiviteti i arbitrazhit ndërkombëtar tregtar kryesisht vjen si pasojë e institucionalizimit të dy shtyllave: njohja e kompromisit për arbitrazh dhe ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit. Konventa e Nju Jork-ut ka themeluar dhe ndërkombëtarizuar pikërisht shtyllën e dytë. Efekti pozitiv, që kanë luajtur rregullatorët e kësaj Konvente, ka qenë faktori thelbësor që ka shëndruar arbitrazhin në alternativën kryesore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tregtisë, në mbarë botën. Fryma e ndërtimit të dispozitave të Konventës por edhe ajo e manifestuar në praktikë nga implementimi i tyre, ka qenë lehtësimi në tërësi i procedurave të zbatimit të një vendimi arbitrazhi, duke garantuar mirë-përcaktimin e pengesave të njohjes.

-Për fat të keq, arbitrazhi nuk paraqitet aq atraktiv sa duhet në mjedisin shqiptar, ndër të tjera edhe për shkak të mungesës së një rregullimi ligjor bashkëkohor. Si shkaqe të tjera mund të përmendim: vetëdijen e ulët juridike të shoqërisë shqiptare; mungesën e besimit të palëve në konflikt për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet në një gjykatë private; si dhe perceptimin negativ e kritik, madje deri stigmatizues, të biznesit shqiptar për veprimtarinë e institucionit të Arbitrazhit Shtetëror deri në fillimin e viteve 90^{te}. Për vetë fokusin e tij të hulumtimit, punimi e vë theksin tek shkaku i parë, duke analizuar pamjaftueshmërinë dhe paqartësinë e kuadrit rregullator të brendshëm. Pavarësisht përmirësimeve që ka sjellë Kodi i Procedurës Civile, duke lënë pas kuadrin ligjor që kishte shëndruar arbitrazhin në një *sistem të posaçëm të gjykimit shtetëror*, përsëri ky institut nuk gjen trajtimin që i rezervohet atij në vendet me ekonomi të zhvilluara. Më së shumti, kjo pasqyrohet në mungesën e parashikimit, apo në parashikimin jo bashkëkohor të disa momenteve proceduriale dhe substanciale të procesit të arbitrazhit, në ligjin e brendshëm (si psh. mosparashikimi i parimit të “ndashmërisë” së klauzolës së arbitrazhit, apo parashikimi se Gjykata e Apelit, kur prish ose ndryshon vendimin e arbitrazhit, vendos për themelin e mosmarrëveshjes). Momenti më i paqartë në juridiksionin nacional konsiston në faktin që, pavarësisht se parashikohen shkaqet ligjore, për të cilat një vendim arbitrazhi ndërkombëtar i marrë në territorin shqiptar mund të kundërshtohet, nuk ekzistojnë instrumentat proceduralë për t'i vënë ato në zbatim, pasi nuk është përcaktuar formalisht autoriteti kompetent se ku duhet drejtuar kundërshtimi. Gjithashtu, krahasuar me rregullimin ndërkombëtar, legjislacioni shqiptar paraqitet i kufizuar,

përsa i përket spektrit të mosmarrëveshjeve të arritshme prej arbitrazhit, duke nxjerrë jashtë këtij spektri si të pa-arbitrueshme konfliktet jashtë-kontraktore.

-Një angazhim i rëndësishëm, që duhet të merret përsipër prej legjislacionit dhe jurisprudencës shqiptare është të identifikojë qartë kriteret ligjore, që përcaktojnë nëse ekzekutimi i një vendimi arbitrazhi do t'i referohet neneve 432-438 të K.Pr.C, që rregullojnë zbatimin forcërisht të vendimeve të *brendshme* të arbitrazhit, apo do t'i nënshtrohet efektit të Konventës së Nju Jork-ut dhe neneve 393-399 të K.Pr.C, të cilat aplikohen për njohjen e vendimeve të *huaja*. Një vendim arbitrazhi, që nuk konsiderohet *i huaj* për Shqipërinë, del jashtë sferës së veprimit të Konventës, pasi nuk ka nevojë që ky vendim arbitrazhi të njihet në Republikën e Shqipërisë, në kushtet kur ai i prodhon drejtpërdrejtë efektet e tij për palët. Nga interpretimi i përbashkët i dispozitave të K.Pr.C dhe atyre të Konventës, arrijmë në konkluzionin se vendimi i arbitrazhit do të konsiderohet si *i brendshëm* (jo *i huaj*), në të gjitha rastet kur palët në proces janë me vendbanim në Shqipëri dhe vendi i procedurës së arbitrazhit është Shqipëria, me përjashtim të rastit kur palët kanë zgjedhur me marrëveshje një ligj të ndryshëm nga ligji shqiptar, për të administruar procedurën. Një mangësi e konstatuar në praktikën gjyqësore, në lidhje me këtë aspekt, është se në asnjë prej rasteve të kërkesave për njohje të vendimeve të arbitrazhit të huaj (të analizuara në punim), Gjykata e Apelit nuk është shprehur për natyrën e vendimit të arbitrazhit, nëse ai duhet të konsiderohet vendim *i huaj* apo *i brendshëm* (lokal). Një shprehje e tillë është e nevojshme në mënyrë që Gjykata e Apelit të saktësojë juridiksionin e saj për çështjen konkrete.

-Njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit të huaj në Republikën e Shqipërisë rregullohet nëpërmjet dy instrumentave ligjor, aplikimit drejtpërdrejt të dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut, të ratifikuar nga Parlamenti dhe një grupi dispozitash të Kodit të Procedurës Civile (nenet 393 – 399), që rregullojnë njohjen e vendimeve të huaja. Përtej kuadrit formal, të përmbushur nëpërmjet aderimit, nga një analizë e thelluar juridike e situatës së implementimit të Konventës, në juridiksionin shqiptar, evidentohen një sërë problemesh në kuadrin ligjor dhe praktikën gjyqësore në këtë fushë. Kështu, psh. pavarësisht autoritetit *de jure* që Konventa e Nju Jork-ut ka në rendin juridik të brendshëm shqiptar, Gjykata e Apelit, jo në pak raste, e “injonon” ekzistencën e kësaj Konvente, duke u fokusuar vetëm tek dispozitat e K.Pr.C.

-Aktet normative që prodhojnë efekte për rregullimin e një procedure njohjeve të një vendimi arbitrazhi të huaj, në Shqipëri, paraqiten sipas hierarkisë me këtë renditje: (a) marrëveshjet e

posaçme bilaterale, midis RSH-së dhe një shteti të huaj, me objekt njohjen reciproke të vendimeve të arbitrazhit; (b) dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut dhe (c) dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Kjo renditje, sipas rëndësisë, duhet të pranohet si e vërtetë, në rastin kur vendimi i arbitrazhit është marrë në një shtet të ndryshëm nga Shqipëria, ndërsa kur vendimi është marrë në Shqipëri, por konsiderohet *i huaj* (jo *i brendshëm*) për rendin juridik shqiptar, për njohjen e tij do të zbatohen vetëm dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut. Në një rast të tillë nuk mund të zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, sepse neni 399 parasheh aplikimin e dispozitave të K.Pr.C vetëm për njohjen e vendimit përfundimtar të një *arbitrazhi të një shteti të huaj*, duke mos patur mundësi aplikimi për të ashtuquajturin *vendim të arbitrazhit ndërkombëtar shqiptar*.

-Nuk gjenden sot në K.Pr.C dispozita që rregullojnë posaçërisht njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj, por për këtë qëllim zbatohen të njëjtat dispozita që rregullojnë njohjen e vendimet të gjykatave të shteteve të huaja (nenet 393-399). Rregullimi ligjor në mënyrë krejt të barabartë, prej të njëjtave dispozita, të këtyre dy procedimeve gjyqësore (procedimi i njohjes së vendimeve gjyqësore dhe ai i njohjes së vendimeve të arbitrazhit të huaj), duhet të konsiderohet i tejkualuar. Kjo sepse, pavarësisht se efektet juridike të vendimeve përfundimtare të arbitrazhit janë të njëjta me ato të vendimeve të gjykatave të zakonshme, procesi i arbitrazhit manifeston tipare mjaft të dallueshme nga ai gjyqësor (psh. natyra juridike kontraktuale e procesit), të cilat, qoftë dhe apriori, e justifikojnë miratimin e kriterëve të veçanta të njohjes për vendimet e dala nga secili proces. Gjithsesi, një konstatim, që gjen mbështetje edhe nga jurisprudenca shqiptare, është se dispozitat e K.Pr.C, për njohjen e vendimeve të gjykatave shtetërore të huaja, duhet të aplikohen për vendimet e arbitrazhit të huaj, për aq sa përmbajtja e tyre nuk bie në kundërshtim, apo për aq sa pajtohet (*mutatis mutandis*) me parashikimet dhe në përgjithësi me frymën e Konventës së Nju Jork-ut.

-Ekzekutimi forcërisht i një vendimi arbitrazhi të huaj në Shqipëri bëhet në dy faza. *Faza e parë* përfshin procedimin gjyqësor të Gjykatës së Apelit, për njohjen dhe dhënien fuqi vendimit të arbitrazhit të huaj. *Faza e dytë* i përket një tjetër procedimi gjyqësor, që zhvillohet po nga Gjykata e Apelit, e cila ka akorduar njohjen, me objekt lëshimin nga kjo gjykatë të Urdhërit të Ekzekutimit. Vendimi i Gjykatës së Apelit që akordon njohjen e vendimit të arbitrazhit dhe ai që urdhëron ekzekutimin e tij, për shkak të natyrës procedurale të tyre, nuk pasqyrojnë në pjesën urdhëruese objektin konkret të detyrimit që disponon vendimi i arbitrazhit të huaj, por vetëm i referohen këtij të fundit. Duke e lënë eventualisht organin përmbarues të analizojë vetë përmbajtjen e vendimit të arbitrazhit dhe të nxjerrë

detyrimin konkret për debitorin, mund të krijohen premisa për paqartësi në zbatimin e asaj çfarë ka vendosur forumi i arbitrazhit.

-Për të vërtetuar shkakun refuzues të njohjes, që ka të bëjë me mungesën e kompetencës së forumit (neni 394/a i K.Pr.C), Gjykatës së Apelit i duhet të vlerësojë dy momente shumë të rëndësishme të procedimit arbitral: përfundimin e një marrëveshjeje të vlefshme arbitrazhi dhe arbitrueshmërinë e çështjes objekt konflikti. Të dy këto momente, që legjitimojnë kompetencën e forumit të huaj, mund të vlerësohen nga Gjykata e Apelit pa asnjë kufizim, në kushtet kur Kodi i Procedurës Civile nuk e pengon, ndërkohë që Konventa e Nju Jork-ut e kërkon si të detyrueshme një analizë të tillë. Por, për fat të keq, në praktikën gjyqësore evidentohet “indiferenca” e Gjykatës së Apelit për të vlerësuar arbitrueshmërinë e konfliktit, duke u mjaftuar vetëm me vërtetimin e kriterit të ekzistencës së marrëveshjes së arbitrazhit.

-Kodi i Procedurës Civile, në nenin 394, pika “ç”, parashikon si arsye ligjore për të justifikuar refuzimin e njohjes për një vendim arbitrazhi të huaj, faktin se është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi, që është ngritur përpara se vendimi i huaj të këtë marrë formë të prerë. Pengesën ligjore të mësipërme e konsideroj të tepërt në grupin e shkaqeve refuzuese të njohjes, bazuar në argumentimin e mëposhtëm: *Së pari*, një parashikim i tillë bie ndesh me dispozitat dhe në përgjithësi me frymën e Konventës së Nju Jork-ut, pasi i tejkalon kushtet e konsideruara si *shkaqe refuzuese të njohjes*, të parashikuara nga vetë Konventa. Teksti i kësaj të fundit i liston *shkaqet refuzuese* në mënyrë shteruese (neni 5), duke mos krijuar asnjë hapësirë interpretimi për t'i dhënë mundësi aplikimit të *shkaqeve* të tjera, pavarësisht nga ngjashmëria me *shkaqet* e nenit 5, apo pavarësisht nga nevoja praktike për aplikimin e tyre; *Së dyti*, një pengesë e tillë përfundimtare për njohjen e vendimit të arbitrazhit, gjykoj se bie ndesh me detyrimet që shteti ynë ka marrë përsipër, duke miratuar Konventën e Nju Jork-ut, konkretisht me detyrimin *për të ndaluar apo përjashtuar juridiksionin e gjykatës kombëtare kur midis palëve ka një marrëveshje arbitrazhi* (neni 2/3 i Konventës). Në zbatim të këtij detyrimi, gjykata shqiptare nëse është duke shqyrtuar një padi, duhet të deklarojë mungesën e juridiksionit kur midis palëve ka një marrëveshje të tillë. Mjafton paraqitja e marrëveshjes së arbitrazhit nga një palë e interesuar që gjykata nacionale të deklarojë mungesën e juridiksionit. Në këto kushte, fakti që gjykata shqiptare po shqyrton një padi, në kushtet e mungesës së juridiksionit (pavarësisht se ende nuk e ka deklaruar atë), nuk duhet të pengojë - të paktën jo përfundimisht - njohjen dhe zbatimin e një vendimi arbitrazhi të huaj, sikurse bën parashikimi i mësipërm i Kodit të Procedurës Civile; *Së treti*, çështjen e kompetencës së forumit të arbitrazhit, Gjykata e Apelit duhet ta verifikojë që në fillim të procesit, në zbatim

të detyrimit që parashikon neni 394/a i K.Pr.C, dhe nëse bindet për vlefshmërinë e kompetencës e konsideron të kaluar këtë pengesë ligjore. Vlefshmëria e kompetencës së forumit të arbitrazhit vërtetohet, indirekt, mungesën e kompetencës së një gjykate shqiptare për të shqyrtuar këtë mosmarrëveshje. E thënë shkurt, vlerësimi i pengesës ligjore të njohjes të parashikuar në pikën "ç" të nenit 394, konsiderohet i tejkaluar me vlerësimin e pengesës ligjore të parashikuar në pikën "a" të po këtij neni, pra gjykoj se kemi të bëjmë me një pengesë të përsëritur; *Së katërta*, parashikimi i nenit 394/ç të K.Pr.C, mund të përdoret me keqbesim si një pengesë artificiale për njohjen e vendimit të arbitrazhit të huaj, nga pala kundër të cilës drejtohet vendimi. Kjo e fundit mund të ngrejë një padi në një gjykatë shqiptare qëllimisht, për të penguar më pas njohjen e vendimit të huaj në shtetin tonë. Një praktikë e tillë, pavarësisht se nuk është vërtetuar, do të cënonte seriozisht frymën e Konventës së Nju Jork-ut, qëllimi i të cilës është lehtësimi i kushteve për njohjen vendimeve të arbitrazhit të huaj. Kjo pengesë ligjore për njohjen, e parashikuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (394/ç) mund të zbatohet dhe të ketë efekt për vendimet e gjykatave të shteteve të huaja, por, për arsytet e sqaruara më sipër, nuk duhet të ketë efekt për një vendim arbitrazhi të huaj. Një konstatim i tillë e përforcon konkluzionin që rregullimi me të njëjtat dispozita i njohjes së vendimeve të gjykatave shtetërore të huaja dhe atyre të arbitrazhit të huaj, është i papërshtatshëm.

-Formulimi i dispozitës së nenit 394/d dhe 396/b të K.Pr.Civile, e përjashton njohjen dhe zbatimin e një vendimi të huaj të ndërmjetëm, interpretim ky i mbështetur edhe nga praktika gjyqësore shqiptare, e cila nuk i ka akorduar njohjen atyre vendimeve që nuk kishin statusin e vendimit final. Një interpretim i tillë, edhe pse në dukje i bazuar në ligj, nuk duket krejtësisht i saktë kur çështja shtrohet për të njohur dhe ekzekutuar një vendim të ndërmjetëm arbitrazhi. Për përcaktimin e karakterit përfundimtar të vendimit të arbitrazhit duhen konsideruar përmbajtja substanciale e vendimit dhe efekti që prodhon ai, duke i'u njohur kështu mundësia edhe një vendimi të ndërmjetëm arbitrazhi për t'iu nënshtruar efektit të Konventës së Nju Jork-ut.

-Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile nuk parashikojnë shprehimisht se kush e ka barrën e provës për të vërtetuar, para Gjykatës së Apelit, ekzistencën e një apo disa pengesave ligjore të njohjes së vendimit të arbitrazhit të huaj. Formulimi i nenit 397 të K.Pr.C nuk ndalon që verifikimi i shkaqeve ligjore të refuzimit të bëhet edhe kryesisht nga Gjykata e Apelit. Një parashikim i tillë bie ndesh me Konventën e Nju Jork-ut, e cila në këtë pikë është e qartë kur i ngarkon barrën e provës palës, kundër të cilës disponon vendimi i arbitrazhit. Veprimi *ex*

officio i gjykatës kompetente, që shqyrton kërkesën e njohjes, pranohet nga Konventa vetëm për shkakun e mungesës së *arbitrueshmërisë së konfliktit* ose dhunimit të klauzolës së *politikës publike* sipas ligjit të forumit.

-Gjykata e Apelit, përgjithësisht, ka treguar kujdes vetëm për të respektuar kriteret formale të paraqitjes së kërkesës për njohje, të parashikuara nga neni 396 i K.Pr.Civile (kopja e vendimit të arbitrazhit të huaj, vërtetimi nga forumi i arbitrazhit dhe prokura), duke anashkaluar kërkesat e Konventës së Nju Jork-ut. Për pasojë, jo gjithmonë është kërkuar t'i bashkëngjitet kërkesës për njohje *marrëveshja e arbitrazhit* midis palëve, ndërkohë që mungesa e saj, sipas Konventës (neni 4/1/b), përbën shkak për mos-fillimin e procedimit të njohjes. Gjithsesi, aspektet formale të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për njohje, nuk duhet të konsiderohen, në asnjë rast, nga Gjykata e Apelit, si shkaqe refuzuese për njohjen e një vendimi të huaj.

-Përsa i përket autoritetit që ka Gjykata e Apelit në shqyrtimin e kërkesës për njohje, legjislacioni i brendshëm, në harmoni me frymën e Konventës së Nju Jork-ut, nuk i atribuon kësaj gjykate mundësinë për të shqyrtuar çështjen në themel. Shqyrtimi gjyqësor i kërkesës për njohje, të një vendimi arbitrazhi të huaj, ka për objekt vetëm vërtetimin e ekzistencës ose jo të kushteve ligjore penguese të njohjes. Në këtë pikë, konstatohet një qëndrim jo i unifikuar i praktikës gjyqësore, sepse, përgjithësisht, nga Gjykata e Apelit vlerësohen vetëm shkaqet ligjore të refuzimit të njohjes, të përmendura në nenin 394 të K.P.Civile dhe vetëm në pak raste janë analizuar, përpos të parave, edhe pengesat e njohjes të parashikuara nga neni 5 i Konventës së Nju Jork-ut.

Sa më sipër, analiza e kuadrit ligjor të brendshëm e gërshetuar me elementë tipikë të praktikës gjyqësore, e legjitimon përfundimin e përgjithshëm se eksperiencia e bashkëjetesës së rendit juridik shqiptar me institutin procedural të arbitrazhit dhe veçanërisht me Konventën e Nju Jork-ut, përsa i përket njohjes së vendimeve të arbitrazhit të huaj në Shqipëri, paraqitet problematike dhe e pakonsoliduar. Njohja e efektit të këtyre vendimeve karakterizohet nga një kuadër normativ i pamjaftueshëm dhe jo bashkohor, por dhe nga një praktikë gjyqësore e varfër në interpretime dhe analiza, e pa-unifikuar dhe jo plotësisht në harmoni me frymën e Konventës dhe praktikës ndërkombëtare në këtë fushë. Ky përfundim e bën të domosdoshëm dhënien e rekomandimeve për përmirësime të këtij mjedisi juridik dhe përqasjen e tij me frymën dhe parimet bashkohore.

VII.2. Rekomandime.

1. Ligjvënësi shqiptar duhet të shqyrtojë dhe miratojë, sa më shpejt, dispozita të veçanta për arbitrazhin ndërkombëtar, detyrim ky i parashikuar nga neni 439 i Kodit të Procedurës Civile. Në këtë drejtim një opion i mirë do të ishte që rregullimi i njohjes së vendimeve të arbitrazhit të huaj të bëhej drejtpërdrejt nëpërmjet normave juridike, të strukturuar si dispozita të një ligji të veçantë. Një ligj i emërtuar psh. "Për arbitrazhin", ose "Për arbitrazhin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar" mund të ishte akti i duhur që do të konsolidonte kuadrin ligjor. Por, dispozitat që rregullojnë arbitrazhin ndërkombëtar dhe zbatimin e vendimeve të tij, mund të përfshihen edhe si një pjesë e veçantë e ligjit "Për të drejtën ndërkombëtare private", një ligj ky shumë i rëndësishëm i korpusit të së drejtës sonë të brendshme.

Dispozitat hipotetike të mësipërme, mund të kishin të paktën dy variante të parashikimeve të tyre, përse i përket rregullimit të njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit të huaj. *Së pari* dispozitat e këtij ligji hipotetik mund të përfshinin, të përshtatura, parashikimet e Konventës së Nju Jork-ut, konkretisht dispozitat që rregullojnë në parim detyrimin e shtetit për të njohur vendimin dhe marrëveshjen e arbitrazhit, si dhe dispozitat që rregullojnë paraqitjen e kërkesës për njohje dhe shkaqet e refuzimit të njohjes të një vendimi arbitrazhi të huaj. Këto dispozita mund të përditësoheshin edhe me parashikimet e akteve të tjera ndërkombëtare, të cilat e kanë modernizuar dhe përmirësuar aplikimin e Konventës. Në këtë pikë një mundësi e mirë do të ishte marrja në konsideratë e parashikimeve të ligjit model UNCITRAL, të cilat jo vetëm që nuk bien ndesh me parashikimet e Konventës së Nju Jork-ut, por edhe përmirësojnë procedurat e njohjes së vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar. Një model i ngjashëm që mund të zbatohet për referencë është ligji anglez i arbitrazhit, i cili rregullon drejtpërdrejtë njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj. *Së dyti* dispozitat hipotetike mund të rregullonin njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj, vetëm duke referuar në dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut. Këtu mund të orientohemi psh. nga eksperiencia e ligjit Gjerman, i cili për këtë qëllim parashikon shprehimisht se "*Njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit të huaj do të bëhet konform Konventës "Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj", datë 10 Qershor, 1958*". I ngjashëm me modelin Gjerman është edhe parashikimi që bënte drafti i ligjit për të drejtën ndërkombëtare private (por që pas miratimit ndryshoi), i cili përcaktonte se për njohjen e vendimeve të gjykatave të arbitrazheve të huaja zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe ato të Konventës së Nju Jork-ut.

Një tjetër version i mundshëm i rregullimit të njohjes dhe zbatimit të vendimeve të arbitrazhit të huaj, mund të jetë amendimi i përmirësuar i dispozitave të Kodit të Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë. Për analogji mund t'i referohemi parashikimeve të Kodit Italian apo atij Hungarez të Procedurës Civile, dispozitat e të cilit rregullojnë drejtpërdrejt njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj, jo duke referuar në Konventën e Nju Jork-ut, por nëpërmjet parashikimeve që janë në harmoni të plotë me të.

2. Në fakt, me ligjin nr.122/2013, Këshilli i Ministrave është angazhuar të hartojë një projekt-ligj për arbitrazhin vendas dhe atë ndërkombëtar. Gjykoj se në hartimin e këtyre projekt-akteve ligjore, të paraqitur qoftë në formën e ligjit të veçantë për arbitrazhin, apo amendimit të përmirësuar të Kodit të Procedurës Civile, nga ligjvënësi duhet të mbahen patjetër në vëmendje disa aspekte, të cilat po i rendis si më poshtë:

(i) Do të ishte i arsyeshëm dhe efektiv parashikimi, prej një dispozite të veçantë, i kriterëve të aplikueshme për të përkufizuar arbitrazhin (kuptohet dhe vendimin që ai prodhon) si *të brendshëm* apo *të huaj*, ku një nga këto kriterë të ishte ligji procedural i aplikueshëm në procesin e arbitrazhit, i identifikuar nga zgjedhja e palëve, apo nga forumi kompetent, në mungesë të shprehjes së vullnetit të palëve. Gjithashtu, edhe një dispozitë më specifike dhe më e drejtpërdrejtë në këtë drejtim, që do të definonte statusin e procesit dhe për rrjedhojë edhe të vendimit të arbitrazhit të brendshëm (sikurse është përkufizimi që bën ligji anglez i arbitrazhit specifikisht për marrëveshjen e arbitrazhit të brendshëm), mund t'i vinte në ndihmë këtij interpretimi për të bërë dallimin midis arbitrazhit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar.

(ii) Duhet të sistemohet çështja e përcaktimit të autoritetit kompetent në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku duhet adresuar ankimi ndaj një vendimi arbitrazhi ndërkombëtar që është dhënë në Republikën e Shqipërisë, por që nuk e ka statusin e një vendimi të brendshëm arbitrazhi. Në kushtet kur Gjykata e Apelit është parashikuar me ligj si autoriteti kompetent, ku adresohet kërkesa për njohjen e një vendimi arbitrazhi të huaj (ndërkombëtar), gjykoj që në rolin e autoritetit, ku duhet të paraqitet ankimi ndaj këtij vendimi, duhet të jetë një gjykatë e një niveli tjetër, konkretisht Gjykata e Lartë. Një parashikim i tillë do të kishte kuptim edhe për faktin se ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë nuk mund të bëhet ankim, çka konformohet me qasjen e rregullimit juridik ndërkombëtar të arbitrazhit, ku ndaj një vendimi arbitrazhi ndërkombëtar pranohet vetëm një ankim dhe nuk ka rekurs (psh. parashikimi i ligjit model UNCITRAL).

(iii) Një zgjidhje e mirë do të ishte nëse në ligjin e brendshëm shqiptar do të transpozoheshin kriteret apo shkaqet e kundërshtimit të njohjes dhe zbatimit të një vendimi arbitrazhi të huaj, të parashikuara nga Konventa e Nju Jork-ut. Kjo mënyrë rregullimi: *Së pari*, i ofron rendit juridik të brendshëm një qasje bashkëkohore, që favorizon zbatueshmërinë e vendimeve të arbitrazhit të huaj; *Së dyti*, siguron një dallim të qartë midis kriterëve refuzuese të njohjes së vendimeve të gjykatave shtetërore të huaja dhe shkaqeve që ligjërisht duhet të pengojnë njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj; *Së treti*, zgjidh problemin e krijuar, nga dispozitat aktuale të K.Pr.C, në lidhje me barrën e provës për t'i vërtetuar këto shkaqe, duke identifikuar si palë të cilës i përket barra e provës, palën kundër të cilës kërkohet njohja e vendimit të arbitrazhit të huaj; *Së katërti*, shmang keqinterpretimet e shkaqeve ligjore të refuzimit të njohjes, duke aplikuar rregullat e interpretimit tradicional të Konventës së Nju Jork-ut (rregullat e interpretimit të përfshira në "*Travaux préparatoires*"); *Së pesti*, garanton zbatimin e dispozitave dhe, në përgjithësi, të frymës së Konventës në çdo rast, duke shmangur përdorimin e klauzolës së *dispozitës më të favorshme*, prej të cilës mund të lindë dilema se cilat dispozita favorizojnë më shumë njohjen: dispozitat e Konventës apo ato të ligjit të brendshëm; *Së gjashti*, unifikon kushtet ligjore të kundërshtimit të njohjes së një vendimi arbitrazhi të huaj me ato të kundërshtimit të njohjes së një vendimi arbitrazhi ndërkombëtar Shqiptar (një vendim arbitrazhi i dhënë në Shqipëri, por që nuk gëzon statusin e një vendimi të brendshëm arbitrazhi).

(iv) Në dispozitat për arbitrazhin e brendshëm, nuk duhet të gjejë vend parashikimi aktual i Kodi të Procedurës Civile (neni 436), sipas të cilit, nëse vërtetohet ndonjë nga shkaqet ligjore të kundërshtimit, Gjykata e Apelit e prish ose e ndryshon vendimin e gjykatës së arbitrazhit dhe vendos për themelin e mosmarrëveshjes. Një parashikim i tillë cënon vullnetin legjitim të shprehur të palëve për të qëndruar larg dyerve të gjykatave shtetërore dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjen e tyre në rrugë private, nëpërmjet arbitrazhit.

(v) Ligji ynë i brendshëm duhet të parashikojë shprehimisht autonominë e klauzolës arbitrale nga pjesa tjetër e kontratës, duke adoptuar kështu parimin e ndashmërisë (*separability*). Në këtë pikë, mund të përdoret si parashikim analog, për ligjin shqiptar, parashikimi i nenit 808 të Kodit të Procedurës Civile Italiane për *vlerësimin e klauzolës së arbitrazhit në mënyrë të pavarur nga kontrata në të cilën ajo bën pjesë*. Një parashikim i tillë do të bëjë të mundur që, pretendimet për pavlefshmërinë e kontratës, të ngritura për kontratën kryesore, në princip, të mos prekin klauzolën e arbitrazhit.

(vi) Ligji i brendshëm duhet të parashikojë mundësinë që pala e interesuar të kërkojë kontroll të menjëhershëm nga një gjykatë shtetërore mbi juridiksionin e forumit të arbitrazhit, që në momentin që ky i fundit shprehet për juridiksionin e tij. Një parashikim i tillë, siç mund të jetë psh. ai i nenit 16(3) të Ligji Model UNCITRAL, shmang mundësinë e humbjes së kohës dhe të parave, në rastin e ndjekjes së një procedure arbitrazhi, e cila më vonë, në një apelim të mundshëm, do të konsiderohej e pavlefshme për shkak të mungesës së juridiksionit të forumit.

(vii) Të korrigjohet teksti zyrtar i Konventës së Nju Jork-ut, i përkthyer në shqip si pjesë përbërëse e ligjit nr.8688, datë 09.11.2000, në ato dispozita që përmbajnë gabime formale të përkthimit. Këto të fundit mund të ndikojnë në interpretimin dhe kuptimin e gabuar të shprehjeve dhe termave të tekstit të Konventës, gjatë zbatimit në praktikë prej gjykatave shqiptare.

3. Arbitrazhi, si zgjidhje alternative e mosmarrëveshjeve, është privat në natyrë dhe si i tillë palët do të kenë nevojë për gjykatat nacionale për t'i dhënë fuqi marrëveshjes arbitrale, pa të cilën nuk ka juridiksion forumi, si dhe për të zbatuar vendimet e arbitrazhit. Kësisoj merr përparësi arritja e një ekuilibri midis autonomisë së arbitrazhit dhe kompetencës minimale për kontrollin gjyqësor nacional. Lind nevoja, gjithashtu, për të sensibilizuar gjykatat e brendshme nacionale për të mbështetur procesin e arbitrazhit, pasi pa këtë mbështetje arbitrazhi dhe veçanërisht arbitrazhi ndërkombëtar do të mbesë ineffektiv. Në këtë drejtim, një rol të rëndësishëm luan Gjykata e Apelit si autoriteti kompetent që autorizon njohjen, thënë ndryshe, autoriteti që bën efektive vendimin e arbitrazhit të huaj në Republikën e Shqipërisë. Kësaj të fundit, deri në momentin e miratimit të kuadrit të ri ligjor, i del si detyrë të kapërcejë handicapin ligjor, të krijuar si rezultat i mospërputhjes midis dispozitave të Konventës së Nju Jork-ut dhe Kodit të Procedurës Civile.

Kolegjet civile të Gjykatave të Apelit, për rastet konkrete të paraqitjes së kërkesave për njohje, duhet të zbatojnë në mënyrë komplementare dhe për aq sa nuk bien ndesh dispozitat e Konventës dhe ato të Kodit. Një zbatim i tillë i dispozitave është i nevojshëm për të vlerësuar procedurat e paraqitjes së kërkesës për njohje dhe dokumentacionit shoqëruar të saj, si dhe për të verifikuar shkaqet e refuzimit apo pengesat ligjore të njohjes së vendimeve, që janë objekt i Konventës. Për më tepër, nuk duhet harruar fakti se dispozitat e Konventës së Nju Jork-ut kanë epërsi dhe, në rast konflikti, prevalojnë mbi dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Për rrjedhojë në çdo vendim të Gjykatës së Apelit që shprehet mbi njohjen e një vendimi arbitrazhi të huaj, duhet të përmendet domosdoshmërisht mbështetja apo referimi në

dispozitat e Konventës. Mungesa e një referimi të tillë mund të përbëjë një shkak ligjërish të mjaftueshëm për të goditur me rekurs një vendim njohës të Gjykatës së Apelit.

4. Në kuadër të përmirësimit të praktikës gjyqësore të procedimeve për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj, paraqes edhe disa rekomandime si më poshtë:

(i) Gjykata e Apelit, në procedimin e kërkesës për njohje të një vendimi arbitrazhi të huaj, duhet të kërkojë depozitimin, si dokumentacion që shoqëron kërkesën, edhe të marrëveshjes së arbitrazhit. Gjithashtu kjo gjykatë duhet të shprehet për vlerësimin e të metave të mundshme, që mund të ketë kjo marrëveshje, të meta të cilat mund të vlerësohen kryesisht nga gjykata, ose me kërkesë të palës kundër të cilës është dhënë vendimi. Të meta të tilla mund të jenë psh. pazotësia e palëve për të lidhur marrëveshje apo karakteri jo arbitral i konfliktit, që është objekt i marrëveshjes së arbitrazhit.

(ii) Gjykoj se është detyrë e Gjykatës së Apelit, në rastet kur asaj i paraqiten kërkesa për njohje vendimesh arbitrazhi, që të shprehet paraprakisht nëse vendimi i paraqitur i plotëson apo jo kriteret e një vendimi të *huaj* arbitrazhi, kritere këto të parashikuara nga Konventa e Nju Jork-ut dhe legjislacioni i brendshëm. Një shprehje e tillë është e nevojshme në mënyrë që Gjykata e Apelit të saktësojë juridiksionin e saj për çështjen konkrete.

(iii) Gjykatat shqiptare, në procedimet për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj, duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje Konventës së Nju Jork-ut dhe interpretimit tradicional të saj. Në këtë kuadër, ato duhet të zbatojnë rregullat e interpretimit të përfshira në "*Travaux préparatoires*", që presupozon interpretimin e dispozitave të Konventës bazuar në shpjegimet e dokumenteve të ndryshme (raporte, komente, etj.), që janë prodhuar para dhe gjatë hartimit të saj. Ndërsa, për disa nocione juridike, që themelojnë pengesa ligjore për njohjen e një vendimi të huaj, si psh, "*rend publik*", apo "*politikë publike*", është e domosdoshme që doktrina e së drejtës të bëjë një interpretim të gjerësisë së shtrirjes së kuptimit të këtyre termave. Në këtë aspekt, me shumë vlerë do të ishte edhe një interpretim unifikues, nëpërmjet një apo disa vendimeve të Gjykatës së Lartë, të cilët do të bënin njësimin e praktikës gjyqësore.

(iv) Në rast pamundësie për t'u ndryshuar nga ligjvënësi parashikimi i neneve 394/d dhe 396 të K.Pr.C, duhet të ridimensionohet interpretimi jurisprudencial i tyre, duke u interpretuar më gjërë kërkesa për natyrën përfundimtare të vendimeve të huaja, pikërisht kur bëhet fjalë për një vendim të ndërmjetëm arbitrazhi të huaj. Natyra *përfundimtare* duhet të vlerësohet rast pas rasti nga gjykata që shqyrton kërkesën për njohje, duke mbajtur gjithnjë parasysh

përmbajtjen substanciale të vendimit (qoftë edhe vendimit të ndërmjetëm), si dhe pasojat që ai prodhon për palët në gjykim.

5. Zhvillimi ekonomik në rritje i Shqipërisë, shpeshimi i marrëdhënieve tregtare, si dhe aderimi i Shqipërisë në organizata të rëndësishme ndërkombëtare të tregtisë (psh. OBT), sjell si domosdoshmëri ngritjen e forumeve të përhershme të arbitrazhit pranë dhomave të tregtisë, por njëkohësisht edhe të institucioneve të trajnimit dhe formimit profesional të arbitrave. Gjithashtu, i rëndësishëm është edhe intensifikimi i promovimit të avantazheve që ofron zgjidhja e mosmarrëveshjeve me arbitrazh, me qëllim që bizneset shqiptare të mos e shohin si një zgjidhje tepër luksoze apo si një shpenzim të tepërt investimin e një gjykate private.

* * *

Arbitrazhi, e veçanërisht arbitrazhi ndërkombëtar tregtar, gjithnjë e më shumë, po konsiderohet në kushtet e një ekonomie të globalizuar, si një qasje efektive e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, efektivitet që garantohet në saj të perfeksionimit që Konventa e Nju Jork-ut u ka bërë instrumentave të njohjes së vendimeve që merren në arbitrazh. Ndërkohë në Shqipëri, rregullimi normativ i brendshëm dhe praktika gjyqësore e njohjes së këtyre vendimeve, nuk janë në nivelin e duhur, duke mos e justifikuar rëndësinë që tentohet t'i jepet në ditët e sotme arbitrazhit. Nevojiten përpjekje të të gjithë aktorëve, institucioneve shtetërore dhe biznesit, për të ndërtuar një kuadër ligjor të standarteve ndërkombëtare. Miratimi dhe zbatimi i instrumentave juridike bashkohore për njohjen e vendimeve të arbitrazhit të huaj do t'i shërbejë drejtpërdrejt zgjerimit të marrëdhënieve tregtare dhe në përgjithësi procesit të integritetit të ekonomisë shqiptare.

Shpresoj që ky punim të vlejë sadopak në përmbushjen e këtij qëllimi. Jam i bindur se ai sjell një risi në doktrinën e të drejtës kombëtare për arbitrazhin, e cila për fat të keq, paraqitet e varfër në këtë drejtim. Besoj se studentët, pedagogët, por edhe studiuesit e së drejtës do të gjejnë në këtë studim diçka të munguar në bibliografinë shqiptare, që shpresoj t'i ndihmojë ata për ta thelluar edhe më tej dijen në këtë fushë të së drejtës shumë të rëndësishme për biznesin dhe ekonominë e vendit. Punimi mund të vlejë fare mirë edhe si një komentuar, që shtjellon dispozitat ligjore dhe aspektet jurisprudenciale më tipike, që lidhen me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj, duke i shërbyer fare mirë edhe praktikës gjyqësore të kësaj fushe në Shqipëri.

SHTOJCË
Teksti i plotë i Konventës së Nju Jork-ut i përkthyer në shqip

**KONVENTË PËR NJOHJEN DHE EKZEKUTIMIN
E VENDIMEVE TË HUAJA TË ARBITRAZHIT**

Nju Jork, 10 qershor 1958
Hyrë në fuqi më 7 qershor 1959

Neni 1

1. Kjo Konventë zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, që janë dhënë në territorin e një shteti të ndryshëm prej atij ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi i vendimeve, dhe që u përkasin marrëveshjeve midis personave fizike ose juridike. Ajo zbatohet gjithashtu për vendimet e arbitrazhit që nuk konsiderohen si vendime të brendshme të arbitrazhit në shtetin ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi i tyre.

2. Termi “vendime të arbitrazhit” do të përfshijë jo vetëm vendimet që kanë dhënë arbitrat e emëruar për çdo rast, por gjithashtu edhe ato që kanë dhënë organet e përhershme të arbitrazhit, të cilave iu janë nënshtruar palët.

3. Në momentin kur do të nënshkruhet, ratifikohet ose do të aderohet në këtë Konventë, ose do të njoftohet shtrirja sipas nenit 10, çdo shtet mundet, në bazë reciprociteti, të deklarojë se do të zbatojë Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve, që janë dhënë vetëm në territorin e një shteti tjetër kontraktues. Mund të deklarojë gjithashtu se ai do të zbatojë Konventën vetëm për mosmarrëveshjet e lindura nga marrëdhëniet juridike, kontraktore ose jokontraktore, të cilat konsiderohen si marrëdhënie tregtare nga legjislacioni kombëtar i shtetit që bën këtë deklaratë.

Neni 2

1. Secila nga shtetet kontraktuese do ta njohë marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër t’ia paraqesin arbitrazhit të gjitha ose ndonjë mosmarrëveshje, që kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jokontraktore, që ka lidhje me një çështje, e cila mund të rregullohet me anë arbitrazhi.

2. Termi “marrëveshje e shkruar” do të përfshijë një klauzolë arbitrazhi në një kontratë, ose një marrëveshje arbitrazhi e nënshkruar nga palët ose që përmbahet në një shkëmbim letrash ose telegramesh.

3. Gjykata e njërit shtet kontraktues, kur është e angazhuar në një padi për një çështje, për të cilën palët kanë bërë një marrëveshje sipas kuptimit të këtij neni, me kërkesën e një prej palëve i’a referon palët arbitrazhit, përveç rasteve kur ajo gjen se marrëveshja në fjalë është nul dhe e pavlefshme, jooperative ose e pamundur për t’u zbatuar.

Neni 3

Secili shtet kontraktues do të njohë vendimet e arbitrazhit si vendime detyruese dhe do t’i zbatojë ato në përputhje me rregullat e procedurës të territorit (*kupto* shtetit) ku vendimi zbatohet, sipas kushteve të përcaktuara në nenet vijuese. Nuk do të imponohen në thelb me shumë kushte pagese ose shpenzime e pagesa më të larta për njohjen ose zbatimin e vendimeve të arbitrazhit, për të cilat zbatohet kjo Konventë nga ato që imponohen për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit të vendit të tij.

Neni 4

1. Për të siguruar njohjen dhe ekzekutimin e vendimit siç përmendet në nenin e mësipërm, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin duhet të paraqesë, në të njëjtën kohë me kërkesën sa vijon:

- a. origjinalin e vendimit, të vërtetuar rregullisht ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur;
 - b. origjinalin e marrëveshjes së parashikuar në nenin 2 ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur.
2. Në qoftë se vendimi ose marrëveshja në fjalë nuk është hartuar në një gjuhë zyrtare të vendit në të cilin zbatohet vendimi, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin e vendimit duhet të paraqesë një përkthim të këtyre dokumenteve në atë gjuhë. Përkthimi duhet vërtetuar nga një përkthyes zyrtar, ose një përkthyes i betuar, ose nga një agjent diplomatik apo konsullor.

Neni 5

1. Njohja dhe ekzekutimi i vendimit mund të refuzohen me kërkesën e palës kundër së cilës drejtohet, vetëm në qoftë se ajo palë i paraqet autoritetit kompetent ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi, provën që:

a) palët në marrëveshjen që i referohet nenit 2, në bazë të ligjit të zbatueshëm për to, ishin të paafta për të vepruar, ose marrëveshja në fjalë nuk është e vlefshme sipas ligjit, të cilit palët ia kanë nënshtruar atë ose, nëse mungon ndonjë përcaktim i mësipërm, sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi, ose

b) palës kundër së cilës jepet vendimi nuk i është dhënë njoftimi i rregullt për caktimin e arbitrit ose të procedurës së arbitrazhit, ose, ka qenë e paaftë për të paraqitur rastin e saj, ose

c) vendimi trajton një mosmarrëveshje të paparashikuar ose që nuk hyn brenda kufijve të objektit për arbitrazh, ose ai (*kupto* vendimi) përmban vendime për çështjet që kalojnë objektin, që i nënshtrohet arbitrazhit; megjithatë në qoftë se vendimet për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit mund të veçohen nga ato që nuk i nënshtrohen, ajo pjesë e vendimit e cila përmban vendime për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit, mund të njihet dhe të ekzekutohet; ose

d) përbërja e autoritetit të arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ishte në përputhje me marrëveshjen e palëve, ose nëse mungon një marrëveshje e tillë, nuk ishte në përputhje me ligjin e vendit ku është zhvilluar arbitrazhi; ose

e) vendimi nuk ka marrë formën përfundimtare për palët, ose është anuluar ose pezulluar nga autoriteti kompetent i vendit në të cilin, ose sipas ligjit të të cilit, është dhënë vendimi.

2. Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi arbitrazhi mund të refuzohen gjithashtu në qoftë se autoriteti kompetent i vendit, ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi, konstaton se:

a) objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi, sipas ligjit të këtij vendi, ose

b) njohja ose ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me **rendin publik** të këtij vendi.

Neni 6

Në qoftë se një kërkesë për anulimin ose pezullimin e vendimit është bërë pranë një autoriteti kompetent në bazë të nenit 5/(1)/(e), autoriteti në të cilin kërkohet zbatimi, në rast se e konsideron me vend, e shtyn vendimin për ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit dhe mundet gjithashtu që, me kërkesën e palës që kërkon ekzekutimin e vendimit, të urdhërojë palën tjetër të japë garancira të përshtatshme.

Neni 7

1. Dispozitat e kësaj Konvente nuk prekin vlefshmërinë e marrëveshjeve shumëpalëshe ose dypalëshe, që lidhen me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, që kanë hyrë në fuqi midis shteteve kontraktuese dhe as i heq të drejtën ndonjë pale tjetër të interesuar për të përfituar nga ndonjë vendim arbitrazhi në mënyrën, si dhe përsa parashikohet nga ligji ose traktetet e vendit ku kërkohet të zbatohet një vendim i tillë.

2. Protokolli i Gjenevës "Për klauzolat e arbitrazhit" i vitit 1923 dhe Konventa e Gjenevës "Për

ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit" e vitit 1927 do të pushojnë efektin e tyre ndërmjet shteteve kontraktuese, që nga dita që ata lidhen, dhe në masën që ato lidhen me këtë Konventë (*kupto* Konventa e Nju Jorkut).

Neni 8

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur deri me datën 31 dhjetor 1958 për nënshkrimin në emër të çdo anëtari të Kombeve të Bashkuara dhe gjithashtu në emër të ndonjë shteti tjetër, i cili është, ose bëhet më vonë anëtar i ndonjë agjencie të specializuar të Kombeve të Bashkuara ose është, ose bëhet më vonë palë e Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ose ndonjë shtet tjetër, të cilit i është adresuar një ftesë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

2. Kjo Konventë do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 9

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për aderim për të gjitha shtetet e parashikuar në nenin 8.

2. Aderimi do të bëhet (*kupto* do të ketë efekt) duke depozituar një instrument të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 10

1. Çdo shtet mundet, në çastin e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, të deklarojë se kjo Konventë do të shtrihet deri tek të gjitha ose ndonjë nga territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare, për të cilat ai është përgjegjës. Një deklaratë e tillë do të ketë efekt kur Konventa të hyjë në fuqi për shtetin në fjalë.

2. Më pas, në çdo kohë, një shtrirje e tillë do të bëhet me njoftimin që i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe do të ketë efekt nga dita e 90-të pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, ose nga data e hyrjes në fuqi të Konventës për shtetin në fjalë, kushdo që është afati më i fundit.

3. Përsa u përket atyre territoreve tek të cilat kjo Konventë nuk shtrihet në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit, çdo shtet në fjalë do të konsiderojë mundësinë e marrjes së hapave të domosdoshme me qëllim që të shtrijë zbatimin e Konventës në ato territore, duke marrë, atje ku është e domosdoshme për arsye kushtetuese, pëlqimin e qeverive të këtyre territoreve.

Neni 11

Në rastin e një shteti federativ ose jounitar, do të zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a. Për sa u përket neneve të kësaj Konvente, që hyjnë në juridiksionin ligjor të autoriteteve federative, detyrimet e qeverisë federale do të jenë të njëjta me ato të shteteve kontraktuese, që nuk janë shtete federative;

b. për sa i takon neneve të kësaj Konvente, që hyjnë në juridiksionin ligjor të shteteve ose provincave përbërëse, që, në bazë të sistemit kushtetues të federatës, nuk janë të detyruara të ndërmarrin masa legjislative, qeveria federale do t'ua bëjë të njohur sa më parë nenet në fjalë, me një rekomandim të favorshëm, autoriteteve kompetente të shteteve ose provincave përbërëse;

c. çdo shtet federativ, që është palë në këtë Konventë, do të paraqesë, me kërkesën e çdo shteti tjetër kontraktues që do t'i transmetohet nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, një deklaratë mbi ligjin dhe praktikën e federatës dhe njësisë të saj përbërëse, lidhur me ndonjë dispozite të veçantë të kësaj Konvente, duke treguar shtrirjen e efektit, që i është dhënë kësaj dispozite nga ndonjë veprim ligjor ose ndonjë veprim tjetër.

Neni 12

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së dorëzimit të instrumentit të tretë të ratifikimit ose aderimit.
2. Për secilin nga shtetet që do të ratifikojnë Konventën ose që do të aderojnë në të pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit ose të aderimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së depozitimit nga ana e këtij shteti të instrumentit të ratifikimit ose të aderimit.

Neni 13

1. Çdo shtet kontraktues mund të denoncojë këtë Konventë, duke njoftuar me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi do të sjellë efekt një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
2. Çdo shtet, cili ka bërë një deklaratë ose një njoftim sipas nenit 10 mundet, në çdo kohë më vonë, të deklarojë, me një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, se Konventa do të pushojë së zbatuari në territorin në fjalë një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
3. Kjo Konventë do të vazhdojë të zbatohet për vendimet e arbitrazhit, për të cilat ka qenë filluar një procedurë njohjeje ose ekzekutimi para hyrjes në fuqi të denoncimit.

Neni 14

Një shtet kontraktues nuk ka të drejtë të përfitojë nga kjo Konventë kundër shteteve të tjera kontraktuese, vetëm në masën në të cilën ai është edhe vetë i detyruar ta zbatojë këtë Konventë.

Neni 15

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t'u njoftojë të gjitha shteteve të parashikuara në nenin 8 sa vijon:

- i. nënshkrimet dhe ratifikimet në përputhje me nenin 8;
- ii. aderimet në përputhje me nenin 9;
- iii. deklaratat dhe njoftimet në bazë të neneve 1, 10 dhe 11;
- iv. datën kur do të hyjë në fuqi kjo Konventë, në përputhje me nenin 12;
- v. denoncimet dhe njoftimet në përputhje me nenin 13.

Neni 16

1. Kjo Konventë, tekstet e së cilës kanë të njëjtën vlerë në gjuhën kineze, angleze, franceze ruse dhe spanjolle, do të depozitohen në arkivat e Kombeve të Bashkuara.
2. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të t'i transmetojë një kopje të vërtetuar të kësaj Konvente shteteve të parashikuara në nenin 8.

Shënim: Për tekstin e mësipërm është shfrytëzuar teksti i Konventës së Nju Jorkut, si pjesë e ligjit nr.8688, datë 9.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", duke u përkthyer saktë disa fjalë apo shprehje.

BIBLIOGRAFIA

Literaturë:

- Pedro J. Martinez-Fraga; *"The American Influences on International Commercial Arbitration: Doctrinal developments and discovery methods"*, Cambridge University Press, 2009.
- Georgios I. Zekos, *"International Commercial and Marine Arbitration"*, Routledge-Cavendish, 2008.
- Margaret L. Moses, *"The Principles and Practice of International Commercial Arbitration"*, Cambridge University Press, 2008.
- William Holdsworth, xiv *"A History of English law"*, A.L.Goodhart & H.G.Hanbury, 1964.
- Julius Henry Cohen, *"Commercial Arbitration and the Law"*, D.Appleton, 1918.
- W.Laurence Craig, William W.Park, Jan Paulsson, *"International Chamber of Commerce Arbitration"*, Oceana Publications, 2000.
- Gary B.Born, *"International Commercial Arbitration: Commentary and Materials"* (2nd ed), Transnational Publishers, Kluwer Law International, 2001 (2009).
- William W.Park, *"Procedural evolution in Business Arbitration"* in *Arbitration of International Business disputes*, Oxford University Press, 2006.
- Henry J. Brown, Arthur L. Marriott, *"ADR Principles and Practice"*, Sweet & Maxwell, 1993.
- Reisman M., Craig L., Park W., & Paulsson J., *"International Commercial Arbitration"*, 1997.
- Jean-François Poudret, Sébastien Besson, *"Comparative Law of International Arbitration"*, Sweet Maxwell 2007.
- Kalia Ardjan, *"E drejta ndërkombëtare private"*, bot.FLESH, 2010.
- Tibor Varady, John J.Barcelo - *"International Commercial Arbitration: A Transnational Perspective"* (American Casebook Series), bot.4^t, 2009.
- Semini (Tutulani) Mariana, *"E Drejta e Detyrimeve dhe e Kontratave, Pjesa e Përgjithshme"*, Skanderbeg books, 2006.
- Lew, Julian D.M., *"Applicable Law in International Commercial Arbitration: A Study in Commercial Arbitration Awards"*, Oceana Publications, Inc.1978.
- Jean Hippolyte Paulin Niboyet, *"Traité de droit international privé français"*, Volume 6, Sirey,1950.
- Domke Martin, *"Commercial arbitration"*, Englewood Cliffs: N. J. Prentice-Hall, 1965.
- Rubellin-Devichi, Jacqueline, *"L'arbitrage. Nature Jurisdigue Droit interne et droit international privé"*, Paris: Librairie Genei le de Droit et Jurisprudence 1965.
- Mëneri Suela, *"E drejta e arbitrazhit dhe e ndërmjetësimit ndërkombëtar tregtar"*, bot.Dudaj 2012.
- William F.Fox. (Jr) *"International commercial agreements: a primer on drafting, negotiating, and resolving disputes"*, 3rd ed, Kluwer Law International, 1998.
- Redfern A., & Hunter M., *"Law and Practice of International Commercial Arbitration"*, 4th ed, Sweet and Maxwell, 2004.
- Thomas E. Carbonneau, *"The Remaking of Arbitration: Design and Destiny"*, in Carbonneau (ed.), *Lex Mercatoria and Arbitration*, Transnational Juris Publications, Inc., Dobbs Ferry, New York, 1990.
- Wetter Curtiss E., *"The Legal Framework of International Arbitral Tribunals-Five Tentative Markings, in International Contracts"*, 1981.
- Albert Jan van den Berg, *"The New York Arbitration Convention of 1958: Enforcement of Arbitration Agreements and International Arbitral Awards"*, ed.Emmanuel Gaillard & Domenico Di Pietro, (bot. Cameron May) 2008.
- Bühring-Uhle, C., *"Arbitration and Mediation in International Business"*, Kluwer Law International, 2006.
- Emmond Paul, Zaka Tefta, Kalo Përparim, *"Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi"*, Shkolla e Magjistraturës së RSH, Tiranë 2007.

- Fukuyama Francis, *“Trust: the social virtues and the creation of prosperity”*, Free Press Paperback 1996.
- Vasili Jani, *“Procedura Civile e Republikës së Shqipërisë”*, (Gervis) 2005.
- Carpi F., Colesanti V., Taruffo M., *“Commentario breve al Codice di procedura civile e alle disposizioni sul processo societario”*, CEDAM, 2006.
- Brati Alban, *“Procedura Civile”*, bot.I (Dudaj), 2008.
- Albert Jan van den Berg, *“The New York Arbitration Convention of 1958: Towards a Uniform Judicial Interpretation”*, T.M.C. Asser Institute, Kluwer Law and Taxation, 1981.

Artikuj:

- V.V. Veeder, *“Is There a Need to Revise the New York Convention?”* in E. Gaillard (ed.), *The Review of International Arbitral Awards (Keynote Speech, IAI Forum, Dijon, 2008)*.
- Sarah Rudolph Cole, *“Arbitration and State Action”*, Brigham Young University, Law Review 1, 2005.
- Margit Mantica, *“Arbitration in Ancient Egypt”*, Arb.Journal, 1957.
- Samuel Marful-Sau, *“Can International Commercial Arbitration be effective without national courts? A perspective of courts involvement in International Commercial Arbitration”*, CEPMLP, 2010..
- Henry P. de Vries, *“International Commercial Arbitration: A Contractual Substitute for National Courts”*, Tulane Law Rev., 1982
- Mazza Francesca, *“Il nuovo Regolamento di Arbitrato della ICC”*, De Jure, 2012, A.Giuffrè Editore S.p.A.
- Emmanuel Gaillard, *“Legal Theory of International Arbitration”*, Leiden - Boston 2010.
- Hong-lin Yu, *“A theoretical overview of the foundations of international commercial arbitration”*, Contemporary Asia Arbitration Journal 1(2), 2008.
- Angualia Daniel *“The role of domestic courts in International Commercial Arbitration”*, 2010.
- Hong-lin Yu, *“Total Separation of International Commercial Arbitration and National Court Regime”*, Journal of Int.Arb., 5(2) 1988.
- Georgios I. ZEKOS, *“Problems of Applicable Law in Commercial and Maritime Arbitration”*, 16(4) Journal of Int.Arb., 1999.
- William W.Park, *“The United Nations Convention on the Recognition and Enforcement of Foreign Arbitral Awards”*, B.Barin ed.1999.
- Gunther J. Horvath, *“The Duty of the Tribunal to Render an Enforceable Award”*, 18(2) Journal of Int.Arb., 2001.
- Han Jian, *“Theory and Practice on Modern International Commercial Law”*, Beijing: Law Press, 2000.
- Kitagawa T, *“Contractual autonomy, in international commercial arbitration: liber amicorum for Martin Domke”*, Pieter Sanders ed., 1967
- Babatunde Osadare, *“Jurisdiction and powers of arbitral tribunals: who decides?”*, Dundee University, CEPMLP, 2010.
- William W.Park, *“Detyra dhe Diskrecioni në Arbitrazhin Ndërkombëtar”*, Revista Amerikane e të Drejtës Ndërkombëtare, 1999.
- Sauser-Hall, Georges, *“L'arbitrage en droit international privé”*, in 44-I Anuaire de L'institut de Droit International 1952, Grand: Bureau de la Revue de droit international
- Alan Redfern, *“Jurisdiction Denied: The Pyramid Collapses”*, Journal of Business Law 15 (1986);
- Loukas Mistelis, *“International Arbitration-Corporate Attitudes and Practices – 12 Perceptions Tested: Myths, Data and Analysis Research Report”*, 15 Am. Rev. Int'l Arb (results of a survey conducted in 2005).

- Emmanuel Gaillard, *"The Representations of International Arbitration"*, New York Law Journal, volume 238 - Nr.67, 2007.
- J.Paulsson, *"May or Must Under the New York Convention: An Exercise in Syntax and Linguistics"* ARBITRATION INTERNATIONAL, 1998.
- Mandro Arta, *"Relativizmi" i lirisë së profesioneve të lira në funksion të një shërbimi "absolutisht" në të mirë të qytetarëve dhe në përputhje me ligjin: zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve: Ndërmjetësimi dhe Arbitrazhi"*, Zgjidhjet Alternative të Mosmarrëveshjeve – RSHSL, Konferenca Vjetore 2008.
- Jana Herboczková, *"Amiable composition in the international commercial arbitration"*, 2007.
- Kyriaki Karadelis, *"Australian court submits tax dispute to arbitration"*, Global Arbitration Review, 15 March 2010
- Elsa Toska Dobjani, *"Parimi i Sigurisë Juridike"*, Revista "Jeta Juridike" nr.4/2008, Shkolla e Magjistraturës.
- Silvia Kaugia, *"Structure of Legal Consciousness"*, Juridica international Journal, 1996.

Konventa, akte dhe dokumente të tjera ndërkombëtare:

- Ligji model UNCITRAL "Mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar", 21 qershor 1985 (amenduar në 2006).
- Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38).
- Protokolli i Gjenevës "Për dispozitat e arbitrazhit", 1923.
- Konventa "Mbi ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", Gjenevë, 1927.
- Raportim i UNCITRAL "Problemet që lidhen me aplikimin dhe interpretimin e Konventave ekzistuese multilaterale mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar dhe çështjet e lidhura me to", (A/CN.9/64, para.29, 1972)
- Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve, Arbitrazhi Ndërkombëtar Tregtar – Konferenca e Kombeve të Bashkuara për tregtinë dhe zhvillimin, Nju Jork dhe Gjenevë 2005, (UNCTAD/EDM/Misc.232/Add.38).
- Konventa e Nju Jork-ut "Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", 10 qershor 1958.
- Raport i ICC-së, "Zbatimi i vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar", broshura e ICC-së Nr.174, 1953 (E/C.2/373).
- Memorandum i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj, dokument i Këshillit Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara (ECOSOC), nr.E/2840, 22 mars 1956.
- Rezoluta e AALCC, UNCITRAL, A/CN.9/127.
- Marrëveshja ndërmjet Shoqatës Amerikane të Arbitrazhit, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike dhe Dhomës Ekonomike të Stokholmit, 12 janar 1977.
- Rregullore e Arbitrazhit UNCITRAL; Rregullorja e ICC-së; Rregullorja e LCIA; Rregullorja e ICSID-së; Rregullorja WIPO.
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme K.B, 61/33, 4 dhjetor 2006, (U.N.Publication Sales No.E.08.V.4, p.viii).
- Ligji i Arbitrazhit (Angli), 1979.
- Akti Anglez i Arbitrazhit, 1996.
- Raporti i Grupit të Punës mbi Praktikën e Kontratës Ndërkombëtare, A/CN.9/216.
- Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm - Tiparet e mundshme të një ligji Model për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar, A/CN.9/207.
- Kodi i Procedurës Civile të Gjermanisë.
- Kodi i Procedurës Civile të Hungarisë.

- Kodi i Procedurës Civile Italiane, miratuar me Dekretin Mbretëror të datës 28 tetor 1940 nr.1443, i ndryshuar.
- Buletini Austriak për Arbitrazhin, janar 2005 (Gjykata Supreme).
- Konventa e Brukselit “Për juridiksionin dhe për zbatimin e Vendimeve gjyqësore për çështjet civile dhe tregtare”, 1968
- Rregullore e Këshillit (KE) nr.44/2001 “Për juridiksionin dhe njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare”.
- Konventa e Luganos “Për juridiksionin dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe tregtare”, 1988.
- Konventa Inter-amerikane “Për arbitrazhin ndërkombëtar tregtar”, 1975.
- Konventa “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e Investimeve” (ICSID), 1965.
- Konventa Evropiane “Mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar”, Gjenevë, 21 Prill, 1961.
- Instituti i të Drejtës Ndërkombëtare Private, Vjetari 1952.
- Kofi Annan, ish Sekretari i Përgjithshëm i OKB, fjalë përshëndetëse në festimin e 40 vjetorit të Konventës së Nju Jork-ut. Nju Jork, 10 qershor 1998.
- Memorandum i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj, dokument i Këshillit Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara (ECOSOC), sesioni 21, nr.E/2840, 22 mars 1956.
- Raporti i Komitetit “ad hoc” për Zbatimin e Vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar, dokument zyrtar i Këshillit Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara, sesioni 19, nr.E/2704, E/AC.42/4/Rev.1.
- Rezoluta e Kombeve të Bashkuara (Këshilli Ekonomik dhe Social) nr.520, datë 6 prill 1954; nr.570 (XIX) e datës 20 maj 1955; nr.604 (XXI), datë 3 maj 1956.
- Raporti UNCITRAL për studimin në lidhje me zbatimin legjislativ të Konventës "Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", Nju Jork, sesioni 41 (16 qershor - 3 korrik 2008), dokument A/CN.9/656.
- Sanders Pieter, “Bërja e Konventës” *Zbatimi i vendimeve të arbitrazhit, sipas Konventës së Nju Jorkut-Eksperiencia dhe Prospekte*, Nju Jork në 10 qershor 1998, Publikimi i KB, Nr.E.99.V.2.
- Koment i Qeverisë së Britanisë së Madhe mbi draft-Konventën “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit të huaj”, dokument i OKB, ECOSOC, E/2822/Add.4. Annex I, 3 prill 1956.
- Shënime Shpjeguese të Sekretariatit të UNCITRAL mbi Ligjin Model 1985 “Për arbitrazhin ndërkombëtar tregtar”, (United Nations Publication Sales No.E.08.V.4, Part II).
- Raporti Final mbi Vendimet e Përkohëshme dhe të Pjesëshme, 2, Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit (ICC), Buletini 26 (1990).
- Shënim shpjegues i Sekretariatit UNCITRAL për Ligjin Model “Mbi Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar” (No.E.08.V.4).

Akte normative kombëtare:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr.8688, datë 9.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit", Flet.Zyrtare nr.38/2000, faqe 1836.
- Dekreti nr.1872 dt.07.05.1954 “Mbi arbitrazhin shtetëror”.
- Dekreti nr.5009 dt.10.11.1972 “Mbi arbitrazhin shtetëror”, Flet.Zyrtare nr.6/1972, faqe 75.
- Dekreti nr.6927, datë 14.11.1984 “Për disa ndryshime në Dekretin nr.5009 “Për arbitrazhin shtetëror”, Flet.Zyrtare nr.3/1984, faqe 45.
- Ligj nr.7424, datë 14.11.1990 “Për arbitrazhin shtetëror”, Flet.Zyrtare nr.7/1990, faqe 240.
- Dekret nr.4359, datë 16.01.1968 “Mbi arbitrazhin e tregëtisë së jashtme pranë Dhomës së Tregtisë të Republikës Popullore të Shqipërisë”; Flet.Zyrtare nr.1/1968, faqe 4.

- VKM nr.26, datë 04.01.1991 “Për miratimin e "Rregullores për shqyrtimin e çështjeve nga Arbitrazhi Shtetëror”, Flet.Zyrtare nr.2/1991, faqe 63.
- VKM nr.178, datë 24.10.1973 “Mbi aprovimin e rregullores mbi shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nga arbitrazhi shtetëror”; Flet.Zyrtare nr.79/1973.
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996, Flet.Zyrtare nr.9/1996, faqe 343, i ndryshuar.
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, Flet.Zyrtare nr.11/1994, faqe 491, i ndryshuar.
- Ligji nr.8687, datë 9.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit”, Flet.Zyrtare nr.38/2000, faqe 1829.
- Ligji nr.10428, datë 02.06.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”, Flet.Zyrtare nr.82/2011, faqe 3319.
- Ligji nr.10194, datë 10.12.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja në fushën civile dhe tregtare”, Flet.Zyrtare nr.184/2009, faqe 8153.
- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Drejtësisë nr.13, datë 12.2.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime dhe shërbime të administratës gjyqësore, Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, ndryshuar me udhëzimin nr.991/3, datë 02.03.2010.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.9 datë 15.03.2013, me objekt “Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.00-2012-1572, datë 22.6.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë”, Flet.Zyrtare Nr.41/2013, faqe 1758.
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.7 datë 27.02.2012, me objekt “Konstatimin e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji”, Flet.Zyrtare Nr.18/2012, faqe 755.
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.2, datë 01.02.2011, me objekt “Konstatimin e cënimit të parimit për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut (KEDNJ)”, Flet.Zyrtare Nr.9/2011, faqe 219.
- Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr.6, datë 01.06.2011 “Njohja e vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC), të datës 22.12.2005 që i përket çështjes nr.12112/ACS, të dhënë nga arbitri i vetëm me qendër në Gjenevë, prof.Dr. Claudie B.Rouillier, për “I.C.M.A” srl. në likuidim” dhe “AGRI.BEN” sas kundër Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të R.Shqipërisë”; Flet.Zyrtare nr.171, datë 29 tetor 2013.
- Ligji Nr.7760 datë 14.10.1993, “Për ratifikimin e "Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale"; Flet.Zyrtare Nr.12/1993, faqe 787.
- Ligji nr.9348, datë 24.02.2005 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile”, Flet.Zyrtare nr.19/2005, faqe 706.
- Ligji nr.9060 datë 08.05.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja", Flet.Zyrtare nr.47/2003, faqe 1794.
- VKM nr.134 dt.07.03.2003 "Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”, Flet.Zyrtare nr.18/2003, faqe 527.
- Ligji Nr.10018, datë 13.11.2008 “Për avokaturën e shtetit”, Flet.Zyrtare nr.176/2008, faqe 8735.

Çështje gjyqësore të praktikës ndërkombëtare:

- Çështja “Delaware & H. Canal Co. kundër Pennsylvania Coal Co.” (1872).
- Çështja “Hamilton kundër Insurance Co.” (1890).

- Çështja “Scherk *kundër* Alberto-Culver” (1973).
- Çështja: “Channel Tunnel Group Ltd. *kundër* Balfour Beatty Construction Ltd.” (1993).
- Çështja: “Compagnie Europeene de Cereals SA *kundër* Tradax Export SA” (1986).
- Çështja: “K/S Norjarl A/S *kundër* Hyundai Heavy Industries Co. Ltd.” (1991).
- Çështja: “Arab African Energy Corp. Ltd *kundër* Olieprodukten Nederland BV” (1983).
- Çështja: “Fulgensius Mungereza *kundër* kompanisë Pricewatercoopers të Afrikës Qendrore” (2001).
- Çështja: “Boart Sweden AB *kundër* NYA Stromnes AB” (1988)
- Çështja: “Mitsubishi *kundër* Solar Chrysler Plymouth Inc” (1985).
- Çështja: “Gulfstream Aerospace Corp *kundër* Mayacamas Corp” (1988).
- Çështja: “Prima Paint Corp. *kundër* Flood & Conklin Manufacturing Co.” (1967).
- Çështja: “Dalmia Dairy industries *kundër* National Bank of Pakistan” (1978).
- Çështja: “AT&T Corp *kundër* Saudi Cable Co.” (2000).
- Çështja: “Commonwealth Coatings Corp. *kundër* Continental Casualty Co.” (1968).
- Çështja: “Olex focas Pvt. Ltd *kundër* Skoda Export Co. Ltd.” (2000).
- Çështja: “Sion Soleimany (babai) *kundër* Abner Soleimany (i biri)” (1998).
- Çështja: “American Construction Machinery & Equipment Corp.Ltd. *kundër* Mechanised Construction of Pakistan Ltd”. (1987).
- Çështja: “Parsons & Whittemore Overseas Co., Inc. *kundër* Societe Generale de L’industrie du Papier” (1974).
- Çështja: “Animalfeeds International Corp. *kundër* S.A. A.Becker et Cie (France no.2)” (1970).
- Çështja: “Lanificio Walter Banci S.a.S. *kundër* Bobbie Brooks Inc. (Italy no.40)” (1980).
- Çështja: “Vimar Seguros S.A. *kundër* M/V Sky Reefer” (1995).
- Çështja: “Fertilizer Corporation of India *kundër*. IDI Management Inc.” (1982).
- Çështja: “Banco de Seguros del Estado *kundër* Mutual Marine Offices, Inc.” (2003).
- Çështja: “Gjykata e Apelit të Parisit: SA Caisse Federale de Credit Mutuel du Nord de la France *kundër* Banque Delubac et Compagnie” (2001).
- Çështja: “Republika e Kazakistanit *kundër* Istil Group Inc.” (2006).
- Çështja: “Metalgeseellschaft *kundër* M/V Capitan Constante” (1986).
- Çështja: “Publicis Communication & Publicis SA *kundër* True North Communications Inc.” (2000).
- Çështja: “Resort Condominiums Int’l, Inc. *kundër* Ray Bolwell et al. (S. Ct. Queensland)” (1995).
- Çështja: “Island Creek Coal Sales *kundër* City of Gainesville, Florida” (1984).
- Çështja: “Alcom Ltd. *kundër* Republikës së Kolumbisë dhe të tjerë” (1984).
- Çështja: “AIG Capital Partners Inc. *kundër* Republikës së Kazakistanit dhe të tjerë” (2005).
- Çështja: “Heyman *kundër* Darwins Ltd” (1942).
- Çështja: “Bergesen *kundër* Joseph Muller Corp.” (1983).
- Çështja: “American Safety Equipment Corp. *kundër* J.P.Maguire & Co.” (1968).
- Çështja: “Yasuda Fire & Marine Ins. Co. of Europe *kundër* Continental Casualty Company” (1994).

Çështje gjyqësore të praktikës kombëtare:

- Çështja: “Marini *kundër* Shqipërisë”, Ankimi nr.3738/02, Vendim 18 Dhjetor 2007, Strasbourg.

- Çështja: “Vlash Marini kundër Këshillit të Ministrave” (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 08.11.1995).
- Çështja: "Shoqëria "CLASSIC" shpk kundër "Televizioni Arbëria" sha, Vendimi nr.3/2007 datë 24.09.2007 i Gjykatës së Arbitrazhit pranë Qendrës MEDART (Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.111, datë 02.10.2008).
- Çështja: “Artel” shpk kundër “Albanova” shpk” (Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.186, datë 10.10.2013).
- Çështja: “La Petrolifera Italo-Rumena" Spa. dhe "La Petrolifera Italo-Albanese" Sha. kundër Republika e Shqipërisë” (Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.106, datë 08.11.2007).
- Çështja: “Shoqëria “Marko Tel & Hes Kablo Albania” kundër Shoqëria “ZTE Albania” shpk” (Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.1460, datë 18.02.2013).
- Çështja: “Njohja në Republikën e Shqipërisë të Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) Nr.13962/FM datë 20.10.2006: “AEDP kundër Republika e Shqipërisë” (Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.54, datë 29.05.2007).
- Çështja: “Njohja në R.Shqipërisë e Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) nr.12016/ACS/FM datë 02.04.2008: "BE-HA-SE" kundër Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (DPRR - MPPTT), Shqipëri” (Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.34 i vendimi dt.31.03.2009).
- Çështja: “Njohja në R.Shqipërisë të Vendimit të Arbitrazhit të huaj LCIA nr.5720 datë 04.06.2006: “McKinsey & Comany Inc.Croatia kundër Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë dhe Agjencinë Shqiptare për Nxitjen e Investimeve të Huaja” (Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.17 datë 27.02.2007).
- Çështja: “Njohja në R.Shqipërisë e Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) nr.14420/FM datë 25.07.2007: "La Petrolifera Italo-Rumena" Spa. dhe "La Petrolifera Italo-Albanese" Sha. kundër Republika e Shqipërisë” (Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.106, datë 08.11.2007).
- Çështja: “Njohja në R.Shqipërisë e Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) nr.14869/A VH/JEM/GZ: “Shoqëria "ROHDE NIELSEN" A/S kundër Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të R.Shqipërisë” (Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.122, datë 14.12.2010).
- Çështja: “Njohja në R.Shqipërisë e Vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (ICC) nr.12112/ACS: “I.C.M.A” srl. në likuidim” dhe “AGRI.BEN” sas. kundër Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të R.Shqipërisë” (Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.56 datë 14.07.2006).
- Çështja: “Lëshimi i urdhërit të ekzekutimit të Vendimit të Arbitrazhit Ndërkombëtar të Romës nr.3546 datë 09.06.1997: "ACCA-1" shpk kundër Bashkisë së Tiranës" (vendimi i Gjykatës së Apelit nr.4 datë 30.03.1998).
- Çështja: “Njohja në R.Shqipërisë e Vendimit të Gjykatës së Teksasit SHBA, me objekt “Sigurimin e objektit të padisë, paraqitur nga Sky Petroleum INC” (Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë Nr.32/1010, datë 01.03.2012).

Të tjera burime:

- Anketim i “Queen Mary” University of London – “Arbitrazhi Ndërkombëtar: Sjellja e Korporatave dhe praktika” 2008.
- Cikël leksionesh pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, 2013, “Historik i zhvillimit të arbitrazhit në Shqipëri”, Dr.Flutura Tafaj.
- Cikël leksionesh “E Drejta Ndërkombëtare Private - Konflikti i Ligjeve”, biblioteka e Universitetit “Marin Barleti”, 2011, Av.Fatos Lazimi.
- Guida ligjore krahasuese ndërkombëtare për “Arbitrazhin ndërkombëtar 2008”, bot.Global Legal Group Ltd. Londër, me kontributin e “Kalo & Associates, Attorneys at Law”.
- Pyetësori i UNCITRAL, 31 gusht 2010.
- Punimi i Doktoraturës me titull “Vendimi i arbitrazhit, kundërshtimi, njohja dhe ekzekutimi i tij”, me autor Dr.Flutura Kola (Tafaj); Udheheqës: Prof.Dr.Kudret Çela; dhjetor 2008; Biblioteka e Fakultetit të Drejtësisë së UT, nr.invent.14669.

Burime interneti on line:

- <http://www.iccwbo.org/about-icc/history/>.
- <http://www.iccwbo.org/products-and-services/arbitration-and-adr/arbitration/>.
- http://www.ila-hq.org/en/about_us/index.cfm.
- <http://www.newyorkconvention.org/new-york-convention-countries/contracting-states>.
- http://www.ibanet.org/Publications/publications_IBA_guides_and_free_materials.aspx.
- <http://untreaty.un.org/cod/avl/ha/crefaa/crefaa.html>.
- http://International_Chamber_of_Commerce
- http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/arbitration/NYConvention.html.
- http://www.uncitral.org/uncitral/en/uncitral_texts/arbitration/NYConvention_implementation.html
- <http://www.uncitral.org/pdf/english/texts/arbitration/NY-conv/NYCCompilation31August2010.xls>
- <http://untreaty.un.org/cod/avl/ha/crefaa/crefaa.html>.